monumentet

DO NOT COPY



14, 1977

DO NOT COPY

Kopertina e parë: **Ura e Golikut – Rrethi i Pogradecit**

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E KULTURËS
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

DO NOT COPY

monumentet

14, 1977

LEGJUMI I REDAKSISË

DO NOT COPY

Shtypur: Kombinati Poligrafik, Shtypsh. M. Duri – Tiranë

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

Lazër Papajani

— Punimet restauruese në qytetin ilir në Zgërdhesh 5

Gjerak Karaiskaj

— Fortifikimet prehistorike në Shqipëri 19

Emin Riza

— Vështrim mbi urbanistikën e qytetit shqiptar (shek. XII-XX) 47

Apollon Baçe

— Kështjella e Vigut, arkitektura, rikonstruksioni dhe restaurimi i saj 75

Valter Shtylla

— Disa ura të vjetra në Shqipërinë e Jugut 101

Aleksandër Meksi
Gjergj Frashëri

— Arkitektura dhe restaurimi i xhamisë së Haxhi Ethem Beut në Tiranë 125

Stilian Adhami

— Tri bazilika të mëdha të ndërtuara në Voskopojë brënda katër vjetëve 145

Petro Maraçi

— Rilevimi fotogrametrik i kishës së Mesopotamit 169

DO NOT COPY

TABLES DES MATIERES

Pages

Lazër Papajani

– Les travaux de restauration effectués dans la ville illyrienne à Zgërdhesh 5

Gjerak Karaiskaj

– Les fortifications préhistoriques en Albanie 19

Emin Riza

– Aperçu sur l'urbanistique de la ville albanaise (XIIe-XXe s.) 47

Apollon Baçe

– Le castellum de Vig 75

Valter Shtylla

– Certains ponts anciens dans l'Albanie du Sud 101

Aleksandër Meksi
Gjergj Frashëri

– Architecture et restauration de la mosquée de Haxhi Ethem Bey à Tirana 125

Stilian Adhami

– Trois grandes basiliques construites à Voskopojë en l'espace de quatre années 145

Petro Maraçi

– Relevé photogrammétrique de l'église de Mesopotam 169

DO NOT COPY

Lazër PAPAJANI

DO NOT COPY

PUNIMET RESTAURUESE NË QYTETIN ILIR NË ZGËRDHESH

Në një nga kodrat që shtrihen në krahun e djathtë të rrugës automobilistike Fush-Krujë – Krujë, gjënden mbeturinat e një qyteti antik që sot njihet me emrin e fshatit Zgërdhesh, pranë të cilit ndodhet.

Në verën e vitit 1969 u kryen për herë të parë gërmime arkeologjike dhe punime pastrimi, të cilat vazhduan disa vjet me rradhë. Ato nxorën në dritë pjesë të murit rrethues, të mureve të terracimit të banesave etj.[1] Në pjesën më të madhe këto u gjetën të dëmtuara nga shkaqe të ndryshme si rrëshqitje dhe cedime të terrenit, nga rritja e pemëve sipër tyre, si edhe nga faktorë të tjerë. Për të ndaluar dëmtimin e mëtejshëm ishte e nevojshme të ndërhyhej me masa konservimi dhe restaurimi në to. Duke filluar që nga viti 1970 deri në vitin 1977 në këto rrënoja janë kryer herë pas here punime restaurimi. Kryesisht punimet janë përqëndruar në murin rrethues kryesor të qytetit, në atë të akropolit, në kullat dhe hyrjen e tij dhe më pak në muret e terracimit dhe të banesave. Një përqëndrim i tillë i punimeve është përcaktuar nga gjendja, në të cilën ndodheshin ato, duke pasur për qëllim që të punohet kryesisht në ato vende ku dëmtimet ishin më të mëdha.

Në përgjithësi mundësia e ndërhyrjeve restauruese në monumentet e këtij qyteti, është e kufizuar, mbasi anastiloza shpesh nuk mund të realizohet, kryesisht sepse një pjesë e gurëve mungojnë, ndërsa pjesa tjetër është e dëmtuar rëndë. Gurët janë të dëmtuar si pasojë e kualitetit të tyre jo të mirë. Duke qenë gëlqerorë të shkrifët ata përshkohen nga damarë të hollë dheu, që me kohë ndikojnë në dekompozimin e tyre.

Ashtu si në të gjithë qtyetet antike edhe këtu punimet resturuese kanë patur kryesisht karakter anastiloze. Ndërhyrjet janë kryer me materialin e gjetur në vend duke i vendosur muret në drejtimet fillestare dhe secilin bllok në vendin e vet. Në rastet kur drejtimet e mureve nuk përcaktohen dot dhe blloqeve të veçantë nuk i gjendej vendi me saktësi ose ai është i dyshimtë, punimet nuk janë filluar ose janë ndërprerë. Në mënyrë të veçantë për zgjidhjen e shumë problemeve që dolën gjatë procesit të restaurimit ndihmoi së tepërmi njohja e karakteristikave, parimeve dhe metodave teknike të përdorura në ndërtimet fortifikuese ilire[2].

Qyteti është vendosur në faqen perëndimore të kodrës, ai ka formën e një trapezi me bazën e madhe poshtë. Gjurmët e banimit më të lashta, i takojnë periudhës së parë të hekurit, shekullit VI-V p.e.sonë. Trakte të kësaj murature gjënden në pjesën më të lartë të kodrës. Në shekujt IV-III p.e.sonë qyteti zgjerohet duke përfshirë edhe pjesën e poshtëme të kodrës. Mure të fuqishëm të forcuar edhe me kulla mbronin qytetin. Një mur i tërthortë, që kalon në traktet e murit të shekujve VI-V p.e.sonë e ndan qytetin në dy pjesë, në qytetin e sipërm ose akropolin dhe qytetin e poshtëm. Mure të tjerë tarracimi janë ndërtuar për përshtatjen e terrenit të pjerrët për ndërtimin e banesave, gjurmët e të cilave dallohen edhe sot.

Në sistemin e fortifikimit dallohen disa teknika që i takojnë periudhave të ndryshme të ndërtimit. Në

1) S. Islami, **Qyteti Ilir në Zgërdhesh,** Monumentet, 1, 1971, fq. 23-38. Gërmimet arkeologjike si edhe ato të pastrimit janë drejtuar nga Prof. S. Islami. Të gjitha datimet që janë përdorur në këtë artikull janë marrë nga artikulli i mësipërm.

2) Koço Zheku, **Probleme të restaurimit në sistemet e fortifikimit të qyteteve ilire,** «Monumentet», 12, 1976 fq. 17-25.

DO NOT COPY



Fig. 1

shekullin IV të e.sonë pranë murit perëndimor të rrethimit vendoset një varrezë, e cila tregon se muret e kanë humbur funksionin mbrojtës. Një pjesë e banorëve në këtë kohë janë larguar nga qyteti i cili më vonë braktiset përfundimisht[3].

Muri perëndimor. Kalonte në të gjithë gjerësinë e kodrës prej përroit të Çinarit në veri deri në buzë të përroit të Lanës në jug. Prej këtij muri ruhet një trakt i gjatë afërsisht prej 90 m, me një portë të vogël 1,30 m të gjerë dhe i përforcuar me tri kulla katërkëndëshe. Pas kësaj distance me përjashtim të disa blloqeve të veçruara nga muri dhe linja e tij nuk ruhet asnjë gjurmë tjetër. Muri është ndërtuar në periudhën e dytë, shekulli IV-III p.e.sonë[4].

Nga gërmimet arkeologjike dhe punimet e pastrimit doli se muri në pjesën më të madhe ruhet në lartësinë e një blloku, në pjesë të kufizuara edhe në dy tri rradhë. Trakti më i lartë i tij ndodhet në qoshen që krijohet me kullën Nr. 1 në pjesën më veriore të këtij muri. (Tab. I). Po nga gërmimi doli se muri që përfshihet ndërmjet kullës Nr. 2 dhe Nr. 3 ishte i dëmtuar (fig. 1, Tab. I, 1). Nga linja e drejtë ai kishte një shmangie rreth dy metra. Vetëm disa blloqe nga të faqes së jashtme e ruanin pak a shumë drejtimin dhe radhën njeri pas tjetrit. Ndërsa në faqen e brendshme, me gjithë devijimin e madh, blloqet deri në një farë mase e ruanin radhën si drejtim dhe vendet e tyre (Tab. II, 3). Gjatë punimeve restauruese u vu re se themeli i kësaj faqeje kishte tri nivele lartësish. Afërsisht në mes të gjatësisë së saj themeli ulet edhe dy rreshta më poshtë, ndërsa në gjysmën tjetër pranë kullës Nr. 3 muri ngrihet një bllok më lart nga pjesa tjetër. Kjo mënyrë ndërtimi me sa duket është diktuar nga terreni jo i sheshtë.

Mbrapa këtij muri ndodhet një kanal, i cili e përshkon murin rrethues. Kanali ka shërbyer për mbledhjen e ujrave të shiut që grumbulloheshin në sheshin mbrapa tij dhe të ujërave që zbrisnin nga kodra për t'i nxjerrë jashtë territorit të kalasë. Një kanal tjetër që shërben për të njejtin qëllim vërehet edhe në murin lindor.

Në dëmtimin e murit një rol negativ ka luajtur edhe vendosja e kanalit. Pika maksimale e largimit të murit nga vija e drejtë është pikërisht aty ku është kanali (Tab. II, 2, 3). Ndërtuesit e tij në këtë pjesë e kanë ulur themelin e murit deri sa kanë arritur në shkëmbin natyror, por shtytjes së dheut dhe lagështirës së vazhdueshme ai nuk ka mundur t'i qëndrojë. Gjatë punimeve restauruese, mbas lëvizjes së blloqeve, u vu re se ndërmjet bllokut të themelit dhe shkëmbit natyror ishte grumbulluar një shtresë e hollë dheu në ngjyrë gri dhe okër, e lagët dhe shumë e rrëshqitshme, e cila ka ndikuar së tepërmi në lëvizjen e murit. Drejtimi i murit u përcaktua me lehtësi dhe saktësi, mbasi në të dy anët e kundërta të tij muri është i pa lëvizur. Themeli është i ndërtuar me blloqe masivë me pjesën e sipërme të gjerë. Në pjesën më të madhe këto blloqe janë të pa punuar me përjashtim të faqes së sipërme. Gjatë punës për vendosjen e tyre në vendet fillestare u hasën vështirësi si në vendosjen në drejtim ashtu edhe në nivelimin e tyre për shkak të bazës jo të rregullt.

Vendosja e blloqeve të themelit shikohet vetëm në dy paretet e murit, në brendësi, ose në bërthamën e murit, megjithëqë gurët mbushës janë vendosur në rradhë nuk ka blloqe themeli. Ato janë vendosur drejtpërdrejt në tokë, ose në terrenin shkëmbor të kodrës. Po kështu vihet re se pareti i jashtëm me atë të brendshëm nuk lidhen ndërmjet tyre me mure lidhës. Kjo mungesë elementi konstruktiv është konstatuar edhe në pjesën tjetër të pa dëmtuar të këtij muri[5]. Nga një masë e çrregullt blloqesh, dheu dhe disa pemësh të rritura mbi to, prej punimeve të pastrimit dhe restaurimit ajo u kthye në një mur të drejtë dhe të rregullt ndërmjet dy kullave. Faqja e jashtme e tij u ngrit në një dhe dy rreshta lartësi ndërsa faqja e brendshme, ku blloqet ruheshin më mirë, u ngrit në lartësinë e katër rradhëve. Fig. 2. Prej kanalit u përfitua një trakt i gjatë 5 m me gjerësi 0,50 m dhe thellësi 0,25 m. Ai është ndërtuar me blloqe. Blloqet

3) Selim Islami, **Qyteti Ilir në Zgërdhesh,** «Monumentet», 1, 1971, fq. 23-38.
4) Selim Islami, **po aty,** fq. 31.
5) Selim Islami, **po aty,** f. 28.

DO NOT COPY



Fig. 2

ku kalon uji janë pak më të thelluar se anët dhe janë të vendosura njeri pas tjetrit. Po kështu edhe anash është i kufizuar me blloqe më të vogla, ndërsa sipër ka qenë i mbuluar me gurë në formë rrasash. (Tab. II, 1).

Pjesa që kalonte mbi mur nuk ruhet, por në kanalin në murin lindor ajo ruhet mirë. Lugu formohet nga rrasa me një të thelluara të lehtë të mbivëna si tjegullat me qëllim që uji të mos kalonte në brendësi të murit.

Porta veriore. Gjurmët e portës veriore para fillimit të gërmimeve dukeshin vetëm në krahun e djathtë ose në anën lindore të saj. Punimet e pastrimit e zbuluan plotësisht atë (Tab. I, 2). Ana lindore e saj përbëhet nga një shkëmb masiv i prerë drejt, me lartësi rreth 3 m. Në pjesën e brendshme të kalasë me që shkëmbi nuk ka qenë i plotë, është mbushur me blloqe. Po kështu lartësia e nevojshme për mbrojtjen e hyrjes, është ngritur me mur. Prej tij sot kanë mbetur vetëm gjurmët e gdhendura në shkëmbin ku mbështeteshin blloqet (Tab. III, C).

Krahu perëndimor i hyrjes, sa tregojnë gjurmët, ka qenë i përforcuar me një kullë. Nga gërmimi doli se ajo ishte e dëmtuar. Me ndërhyrjet restauruese mundëm të ngrejmë një pjesë të murit të saj që kufizon korridorin nga kjo anë. (Tab. III, D, A, B). Gjatësia e tij është 6,70 m dhe gjerësia 1.45-1.50 m. Blloqet kishin rënë në koridorin e hyrjes pak a shumë në mënyrë të rregullt. Gjatë punimeve mundëm të gjejmë edhe një nga blloqet që bën kthesën e këtij muri dhe formon ballin e kullës. Në këtë bllok ruhen gjurmët e shkallëzimit për vijën e peshimit.

Në murin e restauruar vërehet një element me rëndësi konstruktive, por i rallë për muret e këtij qytëti, ai i blloqeve transversalë që shërbejnë për lidhjen e pareteve[6]. Në ndryshim me rastet e tjera të këtyre lloj mureve që lidhin dy faqet e kundërta, këtu secili paret lidhet me bërthamën e murit. Po kështu blloqet lidhës të një pareti nuk vendosen njeri mbi tjetrin në një faqe dhe as në një drejtim me ato të faqes tjetër. (Tab. III, D). Me përjashtim të këtij muri prej kullës kanë mbetur vetëm disa gjurmë të gdhendura në shkëmbin ku kalonte. Në koridorin me gjerësi 2.90 m ndodhet një bllok me dy të thelluara rrethore pranë njera-tjetrës për vendosjen e kasës dhe të boshtit të portës për lëvizjen e saj[7]. Në krahasim me portat në qytetin antik të Lezhës, ku boshti i portës mbështetej në dy pllaka bronzi të vendosura në bllokun e pragut dhe lëviznin mbi njera-tjetrën[8], në atë të Zgërdheshit me që diametri i të thelluarave është i vogël, boshti i portës duhet të ketë qënë vendosur drejtpërdrejt në të thelluarën, në bllokun e gurit (fig. 3).

Kulla e akropolit. Përveç murit rrethues interes dhe vlerë për punimet e restaurimit paraqiste dhe muri rrethues i akropolit. Punimet e para në këtë sektor filluan në kullën jugore të tij në vitin 1970.

Dy kullat katërkëndëshe që sot dallohen mirë janë të ndërfutur në murin rrethues të periudhës së parë, në një periudhë të dytë ndërtimi në shek. IV-III p.e.sonë, pa u lidhur me të anash[9]. (Tab. I, 3).

6) Selim Islami, **Po aty,** fq. 28.
7) Selim Islami, **Po aty,** fq. 28.
8) F. Prendi – K. Zheku, **Lisi në dritën e të dhënave të reja arkeologjike,** «Monumentet», 2, 1971, fq. 13, fig. 14.
9) Selim Islami, **Po aty,** fq. 28.



Fig. 3



Fig. 4

Para fillimit të punimeve nga kulla ruhej vetëm ana lindore dhe pjesërisht ajo veriore. Dy pjesët e tjera ishin të rrënuara, dhe prej tyre ishte krijuar një masë e madhe me blloqe (fig. 4).

Punimet e pastrimit në pjesën e sipërme të kullës nxorën portën që e lidhte me sheshin e akropolit, ndërsa në pjesët e tjera sqaruan konturet dhe problemin për restaurimin e saj.

Muret e kullës ashtu si edhe ato të kullave në murin rrethues perëndimor janë me dy parete të mbushura në mes me gur të çfardoshëm. Janë ndërtuar në këtë mënyrë mbasi kanë pasur ambjente të brendshme qenia e të cilëve provohet edhe nga zbulimi i gjurmëve të portave në muret e tyre. Nga pastrimi doli se kjo kullë është ndërtuar me blloqe me faqe të sheshta, por së bashku me to janë përdorur edhe blloqe me faqe pak të gufmuara dhe me punim me rustika anash. Përdorimi i këtyre blloqeve me teknika të ndryshme punimi tregon se kulla ka pësuar një rindërtim në periudhën e tretë të ndërtimeve, shekulli III-II p.e. sonë (fig. 5).

Nga punimet e pastrimit që u kryen në zonën pranë kullës, në jug të saj u zbuluan gjurmët e një hyrjeje të gdhendur në shkëmb, që lidhte qytetin e poshtëm me zonën jashtë tij.

Kulla e rrumbullaktë. Ndërmjet shumë monumenteve që kanë dalë në dritë nga gërmimet arkeologjike dhe punimet e pastrimit është edhe një pjesë e kullës së rrumbullaktë në murin e akropolit. Prej saj dukej vetëm një pjesë e vogël në anën jugore. Pastrimi dhe restaurimi i saj do të sqaronte në radhë të parë formën e harkut të kullës dhe e dyta, më e rëndësishmja, si lidhej kulla me murin e akropolit dhe ky me murin verior të rrethimit të qytetit (Tab. I, 4). Kulla është ndërtuar në periudhën e dytë të ndërtimit në sh. IV-III p. e. sonë. Në muraturën e pa dëmtuar të saj vërehen edhe gjurmë rindërtimi që duhet t'i takojnë periudhës së tretë sh. III-II p. e. sonë. Në anën jugore të kullës, në radhën e parë vërehet një bllok, faqja ballore e të cilit është vendosur si bazament. Në themel shikohet një bllok tjetër ku pjesa e sipërme është vendosur në faqe. Aty dallohet një kllopë për lidhjen me plumb me bllokun pranë në periudhën e mëparshme të ndërtimit.

Nga punimet e pastrimit rezultoi se blloqet e harkut të kullës nga presioni i dheut brenda saj si edhe nga rrëshqitja e tabanit ku mbështetej bazamenti ishin rrëzuar. Asnjë nga blloqet nuk mund të quhej i palëvizur. Ata ishin përzier me njeri-tjetrin. Vetëm në pikën ku bashkohet kulla me murin e akropolit në pjesën veriore të saj mundëm të gjejmë bllokun e themelit pak a shumë pranë vendit të vet. Ky bllok në ndryshim nga blloqet e tjera të faqes së kullës, që janë me faqe pak sa të harkuara, ishte me faqe të drejtë. Në pjesën e sipërme të tij ku mbështetet bllloku i radhës së dytë, është gdhendur foleja në formë të harkuar.

Në gjendje pak a shumë më të mirë paraqitej muri i drejtë që lidhej me kullën. Disa blloqe të themelit ishin të lëvizura, por pranë vendit të tyre, ndërsa blloqet e radhës së dytë kishin rënë pranë njeri-tjetrit dhe atyre të themelit në mënyrë të parregullt. Mbas dokumentimit të gjëndjes egzistuese u krye lëvizja e blloqeve dhe pastrimi i dheut. Nëpërmjet tyre në shkëmb doli foleja e gdhendur ku vendosej bllloku i murit. Në këtë mënyrë u sqarua më mirë drejtimi fillestar i murit.

DO NOT COPY

Problemi kryesor mbas pastrimit të dherave dhe zbulimit të blloqeve ishte përcaktimi i formës së harkut të kullës. Për këtë qëllim u pastrua dhe u nivelua tabani ku do të mbështetej themeli i murit. U kontrolluan të gjithë blloqet që dolën nga pastrimi duke përcaktuar dhe veçuar ata të rradhës së parë. Në këtë rast ndihmoi së tepërmi gjetja e të gjithë blloqeve të pjesës së dëmtuar të kësaj rradhe. Mbledhja e gjatësive të tyre është e barabartë me gjatësinë e harkut të dëmtuar, afërsisht 9 m. Mbas kësaj pune përgatitore harku mund të formohej me lehtësi. Duke patur dy pikat e skajme të murit, në njerën anë murin e pa dëmtuar dhe në tjetrën pak a shumë vendin ku u gjet blloku i fundit të harkut si edhe gjatësinë e pjesës së dëmtuar mund të trasohej forma e harkut. Mbas shumë matjeve mundëm t'i japim harkut formën e duhur dhe t'a fiskojmë atë në tokë. Një problem tjetër ishte edhe ai i nivelit të vendosjes së blloqeve. Gjatë punimeve, ky problem u zgjidh thjeshtë, mbasi rreshti kishte vetëm dy nivele kryesore.

Në pjesën veriore, në brendi të kullës doli një trakt prej tri blloqesh që i takon periudhës së dytë sh. IV-III p. e. sonë. Me rindërtimin dhe zmadhimin e kullës në periudhën e tretë sh. III-II p. e. sonë këto mbeturina janë përfshirë brenda rrethimit të ri. Faqet e këtyre blloqeve janë kuadratike, të sheshta dhe të çukitura me daltë. Ato nuk u lëvizën nga vendi dhe në gjëndjen e sotme janë të mbuluar nga faqja e jashtme e kullës.

Së bashku me pjesën ekzistuese kulla është më tepër se një gjysmë rrethi. Gjatë punës u konstatua se, duke filluar nga radha e dytë e sipër blloqet e një rreshti janë të lidhura me njeri-tjetrin me ganxha hekuri të fiksuara në gur me plumb. Një gjë e tillë nuk ndodh me ato të themelit, në disa raste edhe në ato të radhës së parë. Kjo ndodh mbasi blloqet në lartësi të murit janë më pak të qëndrueshme ndaj presionit të dheut. Muret e saj janë me dy parete me gjerësi rreth 1.50 — 1.80 m. Po kështu është edhe muri i drejtë në veri të kullës, për faqja ose pareti që bie jashtë kalasë fillonte në një nivel më të lartë nga ai brenda territorit të qytetit. Ky mur duhet të ketë qenë lidhur me murin që vjen nga poshtë nga porta veriore e pasi bën kthesën këtu prej 4,70 m vazhdon drejt lindjes.

Një pikë tjetër ku u punua gjatë vitit 1977 ishte edhe ajo në murin në jug të kullës së rrumbullaktë d.m.th. ndërmjet kullës dhe hyrjes për në akropol (Tab. I, 5). Problemi kryesor në këtë pikë që duhej të zgjidhej para se të fillonin punimet ishte caktimi i drejtimit që ka pasur ai. Lëvizjet dhe rrëshqitjet e terrenit kanë qenë më të mëdha pranë kësaj kulle. Kulla vetë duke luajtur njëkohësisht edhe funksionin e



Fig. 5

një kontraforte nuk ka pësuar lëvizje në bazament, sidomos pjesa jugore e saj.

Së bashku me dheun kanë lëvizur edhe blloqe të mëdha shkëmbi, mbi të cilët mbështetej muri rrethues i akropolit. Si pasojë e këtyre lëvizjeve bazamenti i tij është larguar nga drejtimi fillestar rreth 2 m. Në drejtim të jugut pranë portës së akropolit lëvizjet janë më të vogla. Kjo gjë ka ndodhur mbasi mbrapa murit në këtë pjesë shtrihet një shkëmb masiv që është i lidhur me sa duket me bazamentin shkëmbor të vetë kodrës. Si pasojë e këtyre lëvizjeve drejtimi fillestar i murit nuk e ruante më linjën e vet (fig. 6). Nga gjendja që ndodhej ky mur pas lëvizjeve paraqiteshin dy variante për drejtimin fillestar të tij. Mendimi i parë ishte që linja e murit shkonte drejt, nga porta deri te kulla. Vështirësia e këtij varianti qëndron në lidhjen e murit rrethues të akropolit me kullën dhe me murin e drejtë ose ballor të kullës. Në këtë rast lidhja do të bëhej me kënd, kulmi i të cilit do të ishte në anë të kullës. Në murin e drejtë ose ballor të kullës si para fillimit të punimeve, po kështu edhe gjatë punimeve nuk mundëm të shikonim ndonjë gjurmë të kësaj mënyre lidhjeje.

Varianti më i mundshëm ishte ai që muri, duke u nisur nga kulla deri në një farë distancë të shkojë drejt, në një linjë me faqen e drejtë të kullës nga akropoli dhe pastaj të bëjë një kthesë të vogël me kënd të gjerë për të shkuar deri tek porta. Në këtë rast muri rrethues me kullën dhe me murin e brendshëm të saj, blloqet e sipërme të të cilit edhe para restaurimit dilnin drejt, lidhet mjaft mirë. Në vetë blloqet e zhvendosura të murit rrethues dukej një farë drejtimi si edhe vendi ku bëhej kthesa. Më e qartë kjo

PROOF COPY



Fig. 6

gjendje dukej në gurët mbushës mbrapa bllogeve të murit. Afërsisht kjo kthesë krijohet 8 m larg kullës. Edhe drejtimi i pjesës tjetër të këtij muri që ndodhet pranë portës së akropolit dhe që ka pësuar më pak lëvizje dëshmon për këtë variant.

Për të përcaktuar pikën ku bëhet kthesa u kryen shumë matje, si rezultat i të cilave dilte që kthesa të bëhej pak a shumë në vendin që dukej nga gurët mbushës.

Duke ditur dy pikat ekstreme të tij, fillimin te kulla dhe përfundimin pranë portës, do të mund të caktonim me saktësi drejtimin e tij në rast se do t'i kishim të gjitha bllogët e radhës së parë. Gjatësitë e bllogeve të veçanta do të na jepnin atë të të gjithë murit, ashtu si u veprua për të gjetur harkun e kullës. Një mundësi e tillë në këtë rast nuk ekziston për arsye se muri ndërpritet nga që bllogët nuk janë ruajtur në të gjithë gjatësinë e murit. Gërmimi i dheut dhe heqja me rregull e bllogeve për të nxjerrë bazamentin dhe themelin e murit, e sqaroi këtë pikë. Pranë Kullës së rrumbullaktë, ku shmangiet kanë qënë më të vogla, u vu re që dy-tri bllogët e themelit dhe dy bllogë të radhës së parë e ruanin deri në një farë mase drejtimin dhe kishin një shmangie shumë të vogël nga jashtë prej vijës së drejtë fillestare të murit. Në këtë mënyrë u caktua që muri të vendoset drejt në një linjë me atë të ballit të kullës dhe me kthesën me kënd të gjerë (Tab. I, 8).

Themeli i faqes së brendshme të murit ashtu si edhe në murin në veri të kullës, nuk fillon në një nivel me atë të faqes së jashtme, por 1,40 m më lart. Prej tij ruhen pranë kullës vetëm disa gurë të themelit të papunuar, me forma të çrregullta dhe madhësi të ndryshme.

Gjatë punimeve restauruese u vu re se edhe ky mur ashtu si i kullës ka pasur një rindërtim. Bllogët e tij kanë forma kuadratike, por edhe poligonale. Faqet janë të punuara drejt në disa raste edhe të gufuara dhe me rustika. Në dy-tri raste kemi vërejtur se një nga brinjët e bllogeve me faqe poligonale nuk mbështetet fare ose pjesërisht me bllogët e tjera. Edhe lidhja me kullën nuk kryhet simbas rregullave teknike. Duke filluar nga blloku i themelit të murit dhe dy të tjerat mbi to, nuk krijojnë lidhje me bllogët e kullës por më sipër, ku lartësitë e bllogeve të kullës korespondojnë me ato të murit.

Me vendosjen e bllogeve në vëndet e tyre muri mori një pamje të rregullt dhe ambjenti para tij u sistemua (fig. 7).

Porta e akropolit. Një vëmëndje të veçantë kërkonte sqarimi i portës së akropolit që lidhte qytetin e poshtëm me atë të sipërmin. Terreni dhe disa gjurmë të zbeta tregonin se kjo duhet të ishte pranë kishës (Tab. I, 6). Para fillimit të punimeve mendohej se porta e ndërpriste murin rrethues dhe koridori i saj formohej nga trashësia e murit. Gërmimet arkeologjike dhe punimet e pastrimit e sqaruan këtë problem deri në një farë mase.

Prej saj dalloheshin të lëvizura nga vendi disa bllogë të murit që kufizon koridorin nga ana lindore, ndërsa nga krahu tjetër shikohej vetëm një grumbull bllogesh (fig. 8). Një faktor që ka ndikuar në rrënimin e portës është dhe ndërtimi i kishës së vogël në taracën mbi portë. Në këtë rast bllogët e mureve të saj kanë shërbyer për ndërtimin e kishës. Përveç gurëve të thyer, ndërtuesit në disa raste në muraturën e kishës kanë vendosur edhe bllogë të plota, që shihen edhe sot.

Rolin e kullës për mbrojtjen e portës e ka plotësuar kthesa prej 90° e murit rrethues. Para saj dhe murit rrethues në anën lindore krijohet një shesh që kontrollohet dhe mbrohet mirë prej këtyre së bashku. (Tab. I, 8).

Me shumë interes ishte zbulimi i gjurmëve të murit në anën perëndimore të koridorit. Gërmimi dhe pastrimi me kujdes e sqaruan edhe këtë problem dhe krijuan mundësinë për ndërhyrjet restauruese në të.

Në murin e kullës u vendos pjesërisht edhe bllo-

DO NOT COPY

ku i prakut të portës me një të thelluar katrore përvendosjen e trarit të kasës prej druri. Gdhendja është bërë në anën e jashtme të bllokut, kështu që ka të kufizuara vetëm dy anë. Kufizimi i dy anëve të tjera bëhej me sa duket me vendosjen e një radhe me blloqe të tjera para tij. Ky bllok është vendosur në radhën e dytë të blloqeve të murit, i cili tregon nivelin e dyshemesë së portës. Në krahasim me tabanin e sotëm ai ka qenë rreth 0.50 m më lart.

Faqja veriore e kësaj kulle u ngrit deri në pesë radhë blloqesh afërsisht 2,20 m (fig. 9). Një pjesë e mirë e blloqeve janë të dëmtuara, sidomos ato të radhës së sipërme, që kanë rënë të parët në tokë dhe kanë pritur goditjet dhe peshën e blloqeve që kanë rënë herë pas here nga muri.

Nga punimet e pastrimit doli se porta formohet nga zgjatimi i murit në anën lindore dhe të kthesës së murit që formon kullën në anën tjetër perëndimore. Koridori i saj pranë hyrjes është më i ngushtë nga vazhdimi i tij në thellësi. Zbulimi dhe vendosja në vendin e vet e bllokut të prakut tregon se kanatat e portës kanë qenë vendosur në fillim të koridorit në ndryshim me rastet më të shumëta kur ato vendosen afërsisht në mes të gjatësisë së koridorit. (Tab. I, 8).

Kryerja e punimeve të restaurimit në këtë kompleks: hyrja e akropolit, muri pranë deri tek kulla e rrumbullaktë, si edhe restaurimi i vetë kullës dhe i murit në anën veriore të saj, sqaruan drejtimet e këtyre mureve, mënyrën e vendosjes së portës, krijuan një ambjent të sistemuar dhe korigjuan e plotësuan planimetrinë e kësaj pjese të qytetit.

Një sektor tjetër ku janë kryer punime është edhe ai në jug të qytetit, në një mur teracimi (Tab. I, 7). Në këtë pjesë të qytetit punimet e pastrimit kanë nxjerrë në dukje një mur teracimi. Afërsisht në mes të gjatësisë së tij dallohet një ndërprerje që të lë përshtypjen e një hyrjeje të madhe, kalimi i së cilës është mbyllur me një mur të thjeshtë në një periudhë të vonë. Muri kryesor paraqitet në gjendje të dëmtuar. Përveç blloqeve të radhëve të sipërme edhe ato të radhës së parë si edhe ato të themelit kanë rëshqitur dhe lëvizur nga drejtimi dhe niveli fillestar.

Punimet restauruese u kryen në gjysmën jugore të tij duke filluar nga kthesa e murit të hyrjes. Para murit terreni është i pjerrët, prandaj një pjesë e blloqeve ishin larguar në një distancë jo të vogël. Problemi kryesor në restaurimin e këtij muri ishte përcaktimi i drejtimit të tij. Gjatë procesit të punimeve ky problem u zgjidh pa vështirësi, sepse përveç qoshes së murit pranë hyrjes u gjetën edhe dy pika të tjera ku lëvizjet ishin shumë të vogla, dhe nëpërmjet tyre mundëm të gjejmë drejtimin që ka patur ai.



Fig. 7



Fig. 8



Fig. 9

DO NOT COPY



Fig. 10

Në disa nga blloqet e rrëzuara në bazamentin e tyre shikoheshin disa kanale me gjerësi 15-20 cm dhe me lartësi 8-14 cm, që e përshkonin bllokun në të gjithë gjerësinë. Me ngritjen e murit në lartësi u pa se blloqet e përshkuara nga kanalet e kishin vendin e tyre mbi radhën e dytë të blloqeve dhe në një lartësi dhe nivel. Ka raste që një kanal është gdhendur në dy blloqe. Funksioni i tyre duhet të ketë qënë për vendosjen e trarëve të ndonjë dyshemeje. Një mënyrë pak a shumë të ngjashme me këtë kemi edhe në pjesën e brendshme të murit rrethues në Butrint, pranë portës me kulla. Në këtë rast hapësirat janë më të mëdha sipas trarëve, që janë vendosur në to. Përveç kësaj ato nuk janë në një bllok, por formohen nga kufizimet me blloqe të tjera[10].

Me punimet e kryera këtu u ngrit një mur me gjatësi 26 m, ekstremi jugor i të cilit kryqëzohet me murin rrethues të qytetit të kësaj ane Fig. 10. Gjatë punimeve u konstatua se në mur janë vendosur blloqe që i takonin një ndërtimi tjetër. Kështu që së bashku me blloqet me faqe pak të gufuar janë përdorur edhe ato me faqe të sheshtë. Në raste më të rralla faqja e punuar, dikur e dukshme është vendosur si bazament.

Si rezultat i këtyre punimeve një serë ndërtimesh në qytetin ilir në Zgërdhesh u sistemuan duke i dhënë asaj ç'ka ruhet një pamje më të plotë. Në të ardhmen punimet restauruese do të vazhdojnë përsëri në muret rrethuese, në ato të teracimit dhe në mënyrë të veçantë në sistemimin e rënojave të banesave të tij, që do të ndihmojë në krijimin e një tablloje më të plotë për urbanistikën e këtij qyteti dhe për qytetin antik ilir në përgjithësi.

10) Këto gjurmë kanë dalë nga gërmimet e kryera nga Dh. Budina.

DO NOT COPY

QYTETI ILIR NE ZGERDHESH

PLANIMETRIA



DO NOT COPY

DO NOT COPY


Planimetria e KANALIT
1
0 1 2m


2
PRERJA A-A E MURIT DHE KANALIT
0 1 2m


PLANIMETRIA E MURIT
A
3
A
0 1 2 3 4m

DO NOT COPY

ZGERDHESH · HYRJA VERIORE



PLANIMETRIA E HYRJES VERIORE



PAMJE "A"



PAMJE "B"



PRERJE 1-1 E HYRJES



PAMJE "C"



Lazër PAPAJANI

DO NOT COPY

LES TRAVAUX DE RESTAURATION EFFECTUES DANS LA VILLE ILLYRIENNE A ZGERDHESH

RESUME

C'est pendant l'été 1969 que les premières fouilles archéologiques et des travaux de nettoyage furent effectués dans les ruines de l'ancienne ville à Zgërdhesh. Ils ont mis au jour une partie du mur d'enceinte de la ville, des murs de terrassement des habitations et d'autres objets. Dans la majorité des cas ces objets été endommagés par suite de l'affaissement et de l'éboulement du terrain, de la croissance d'arbres à sa surface, etc. Afin de mettre un frein à cette situation, il fallait prendre sans autre des mesures de conservation et de restauration. Dans la période allant de 1970 à 1977, des travaux de restauration furent entrepris parmi ces ruines. Ils eurent essentiellement pour objet le principal mur d'enceinte, le mur de l'acropole, les tours de la muraille et l'entrée de la ville et, dans une moindre mesure, les murs de terrassement des habitations et celles-ci mêmes. Une telle concentration des travaux fut rendue nécessaire par la situation dans laquelle se trouvait les objets susmentionnés, l'objectif à atteindre étant celui d'intervenir surtout dans les endroits le plus endommagé.

La possibilité d'intervenir par des travaux de restauration dans les monuments de cette ville est en général plutôt limitée, et cela du fait que l'on ne peut réaliser souvent l'anastilose car une bonne part des pierres manquent et celles qui se trouvent sur place sont gravement endommagées. L'endommagement des pierres est dûe aussi à leur mauvaise qualité. Etant d'origine calcaire friable, celles-ci sont traversées par de fines veines de terre qui, avec le temps, entraînent leur décomposition.

Comme dans toutes les villes de l'antiquité, ici aussi les travaux de restauration ont eu pour but l'anastylose. Les matériaux découverts sur place furent disposés sur les murs dans les directions initiales, en mettant chaque bloc de pierres à sa place. Dans l'impossibilité de définir la direction des murs ou de déterminer la place exacte d'un bloc de pierres, les travaux de restauration furent interrompus ou ne furent pas commencés.

Le mur occidental. Il traversait toute la largeur de la colline depuis le torrent de Çinar au nord jusqu'au bord du torrent de Lana au sud. Actuellement il n'en reste qu'un tronçon long environ de 90 m. Les fouilles ont fait ressortir que le mur reliant les tours N° 2 et N° 3 était endommagé (Fig. 1, Tab. I, 1). Il déviait presque 2 m de la ligne droite. Quelques blocs de son parement extérieur seulement respectaient plus ou moins la direction initiale du mur et étaient rangés régulièrement. En ce qui concerne la face intérieure de ce mur, en dépit de la grande déviation qu'il avait subi, ses blocs de pierres conservaient dans une certaine mesure leur direction initiale et se trouvaient à leur place (Tab. II, 3).

Derrière ce mur il y a un canal qui longeait la muraille. Il servait à recueillir les eaux de pluie venant de la place qui s'y trouvait derrière ou les eaux descendant des collines, pour les conduire hors du territoire de la forteresse. Un autre canal semblable à celui-ci longeait le mur oriental.

La présence de ce canal a entraîné l'endommagement du mur. En fait la déviation maximale du mur de la ligne droite se trouve précisément à proximité du canal (Tab. II, 2, 3).

Il n'a pas été difficile de déterminer exactement la direction du mur, du fait que ses deux extrémités n'avaient enregistré aucun déplacement. Les fondements comportent de grands blocs de pierres dont la partie supérieure est plus large. La plupart de ces blocs ne sont pas équarris, exception faite de leur partie supérieure.

La disposition des blocs de pierre des fondements n'est visible que dans les deux parements du mur, dans sa partie intérieure ou dans le noyau du mur. Ils sont posés à même le sol, ou sur le terrain rocheux de la colline. Par ailleurs, le parement extérieur et celui intérieur ne sont pas liés entre eux par un mur de liaison. A la suite des travaux de nettoyage et de restauration, cette masse irrégulière de blocs de pierre, de terre et d'arbres qui y avaient poussé dessus a pris la forme d'un mur rectiligne et régulier reliant les deux tours. On a déblayé aussi un tronçon du canal long de 5 m, large de 0.50 m et profond de 0,25 m.

La porte septentrionale. Les travaux de restauration l'ont mis complètement au jour. Son côté est comporte une masse rocheuse tombant à pic, dont la hauteur est d'environ de 3 m. La roche n'étant pas complète à l'intérieur de la forteresse, on l'a rempli de blocs de pierres. Un mur fut élevé pour atteindre la hauteur nécessaire à la protection de l'entrée. Il n'en reste actuellement que des traces laissées sur la roche par les blocs de pierre. (Tab. III, C).

Le mur restauré comporte un important élément de construction, que l'on observe rarement dans les murs de cette ville. Il s'agit de certains blocs de pierres disposés transversalement pour

relier les parement entre eux. Différemment de ce qui se passe généralement avec ces types de murs, qui relient les deux parement opposés, dans ce cas chaque parement se rattache au moyau du mur.

La tour de l'acropole. Outre le mur d'enceinte, un grand intérêt pour les travaux de restauration présentait le mur cernant l'acropole. Les premiers travaux dans ce secteur furent entamés à sa tour sud en 1970.

De cette tour, il n'en restait que son côté est et en partie celui nord. Les deux autres côtés en ruine constituaient un grand amas de blocs de pierres (Fig. 4). Les travaux de nettoyage ont fait ressortir que cette tour était construite de blocs ayant leurs faces plates, tout en employant des blocs aux faces légèrement bosselées et garnies latéralement d'un appareil rustique. L'usage de ces blocs comportant différentes techniques indique que cette tour a été l'objet d'une reconstruction pendant la troisième période de construction, soit aux IIIe-IIe siècles av. n. è. (Fig. 5).

La tour ronde. Les fouilles archéologiques et les travaux de nettoyage ont mis au jour nombre de monuments, entre autres, une partie de la tour ronde relevant du mur de l'acropole. On ne pouvait observer qu'une petite partie de son côté sud. Cette tour appartient à la deuxième période de construction, les IVe-IIIe siècles av. n.è. Sa maçonnerie non endommagée comporte des traces de reconstruction de la troisième période (IIIe-IIe siècles av. n.è.).

Les travaux de nettoyage ont fait ressortir que les blocs de l'arc de la tour, sous la poussée du terrain et par suite du glissement des assises de la tour, s'étaient écroulés. Presque tous les blocs s'étaient déplacés, ils se trouvaient dans un désordre complet. Une seule exception: au point où la tour se relie au mur de l'acropole, dans sa partie nord nous avons pu trouver un bloc des assises plus ou moins à sa place.

Après avoir enregistré la situaton existante, les blocs de pierre furent déplacés et l'on procéda au nettoyage du terrain. C'est ainsi que fut découverte dans la roche la cavité où se trouvait le bloc du mur, ce qui nous a permis d'en fixer la direction initiale.

Après le nettoyage du terrain et la découverte des blocs, le problème le plus important qui se posait aux restaurateurs était celui de la détermination de la forme de l'arc de la tour. Leur tâche fut facilitée du fait qu'on avait récupéré tous les blocs de pierres relevant de la partie endommagée de cette rangée. La somme de leurs longueurs était égale à la longueur de l'arc écroulé, approximativement 9 m. En connaissant les deux extrémités du mur, d'une part le mur non endommagé et de l'autre l'endroit où fut trouvé le dernier bloc de l'arc ainsi que la longueur de la partie écroulée, les restaurateurs se mirent à la tâche pour tracer la forme de l'arc et de le reproduire sur place.

Dans la partie nord, à l'intérieur de la tour fut mis au jour un tronçon de trois blocs appartement à la deuxième période (IVe-IIIe siècle av. n.è). Après la reconstruction et l'agrandissement de la tour pendant la troisième période (IIIe-IIe siècles av. n.è), ces résidus furent inclus dans la nouvelle enceinte. Les faces de ces blocs sont quadratiques, plates et rustiquées. Elles furent laissées sur place et sont actuellement couvertes par la face externe de la tour.

En y ajoutant aussi la partie existante, la tour constitue actuellement plus d'un demi-cercle. Au cours des tarvaux on a pu relever qu'à partir de la deuxième rangée et dans celles supérieures, les blocs de chaque rangée sont reliés entre eux par des crampons de fer fixés à la pierre avec du plomb. Cette technique ne s'observe que dans les blocs des assises, parfois pas même dans les blocs de pierre de la première rangée. Ceci s'explique par le fait que les blocs se trouvant dans la partie haute du mur sont moins résistants à la poussée de la terre.

En 1977 les travaux furent centrés sur le mur méridional de la tour ronde, c'est-à-dire entre la tour et l'entrée à l'acropole (Tab. I,5). Avant d'entamer les travaux ici, il fallait déterminer la direction de ce mur, et cela en raison du fait que le terrain à proximité de la tour avait enregistré des mouvements et des glissements plus accentués.

L'affaissement de la terre avait entraîné aussi le déplacement de grands blocs de roche, sur lesquels s'appuyait le mur d'enceinte de l'acropole. Par suite de ces déplacements, les assises de celui-ci s'étaient éloignés d'environ 2 m de leur direction initiale. Dans les conditions qui s'étaient créées, il y avait deux variantes à considérer quant à la direction initiale de ce mur.

La variante la plus probable faisait suivre au mur une ligne droite depuis la tour jusqu'à une certaine distance, selon une ligne identique à celle de la face droite de la tour regardant l'acropole, puis le mur faisant un petit détour à angle large pour rejoindre la porte. Dans ce cas le mur d'enceinte se relie bien à la tour et à son mur intérieur, dont les blocs supérieurs constituaient une ligne droite même avant leur restauration. Même en observant les blocs déplacés du mur d'enceinte on pouvait y relever un certaine direction et préciser l'endroit où il faisait un détour.

Afin de fixer le point où avait eu lieu le détour, il a fallu procéder à plusieurs mesurages. Et les restaurateurs sont arrivés à la conclusion que le détour devait être fait plus ou moins à l'endroit où il y avait des matériaux de remplage.

Après avoir remis en place les blocs, le mur acquis un aspect régulier. Puis le milieu environnant fut remis en ordre (Fig. 7).

La porte de l'acropole. Il fallait avant tout élucider le problème de la porte de l'acropole reliant la basse ville à la haute ville. Le terrain et certaines traces peu évidentes indiquaient que celle-ci devait se trouver à proximité de l'église (Tab. I, 6). Avant d'entamer les travaux, on pensait que cette porte coupait le mur d'enceinte et que son couloir était constitué par l'épaisseur du mur. Les fouilles archéologiques et les travaux de nettoyage ont éclairci ce problème jusqu'à un certain point.

On pouvait encore observer sur place certains blocs du mur délimitant le couloir du côté est, tandis que de l'autre côté, il n'y avait qu'un amas de blocs (Fig.

POOR COPY

INST. MON. KULTURES
BIBLIOTEKA
№ INV. 8669

D'un grand intérêt fut la découverte des traces du mur dans la partie ouest du couloir. Les fouilles et le nettoyage du terrain permirent aux restaurateurs d'éclaircir ce problème et d'entamer les travaux de restauration.

La face nord de cette tour fut élevée jusqu'à cinq rangées de blocs, soit approximativement 2.20 m (Fig. 9).

Les travaux de nettoyage ont montré que cette porte était formée du prolongement du mur en direction est et du détour que faisait le mur de la tour en direction ouest. Son couloir à proximité de l'entrée est plus étroit que son prolongement en profondeur.

Les travaux de restauration effectués dans ce complexe ont concerné principalement l'entrée de l'acropole, le mur contigu jusqu'à la tour ronde, la tour elle-même et son mur nord; ils nous ont permis de déterminer la direction de ces murs et le mode d'aménagement de la porte, de créer un milieu ordonné et de corriger et compléter la planimétrie de cette partie de la ville à Zgërdhesh

Les travaux de restauration ont concerné aussi un autre secteur, celui située dans la partie sud de la ville, où se trouve un mur de terrassement (Tab. I, 7).

Dans ce cas de restauration aussi, il importait avant tout de déterminer la direction du mur. Ce problème fut résolu facilement au cours même des travaux, du fait qu'outre l'angle du mur à proximité de l'entrée, furent mis au jour deux autres points qui n'avaient subi que des affaissements très légers.

Certains blocs écroulés de leur soubassement montrent des cannelures d'une largeur de 15 à 20 cm. et d'une hauteur de 8 à 14 cm., qui traversent de part la largeur du bloc. En élevant le mur, les restaurateurs s'aperçurent que les blocs à cannelures devaient être mis au-dessus de la deuxième rangée, à la même hauteur et au même niveau. Parfois une seule cannelure se trouve à la fois sur deux blocs de pierre. Dans ce cas elles indiquent la place où doivent être posées les poutres du plancher. Cette même technique, plus ou moins semblable, nous la retrouvons aussi dans la partie intérieure du mur d'enceinte de Butrint, à proximité de la porte à tours. Dans ce cas les ouvertures sont plus grandes, et cela en raison de l'épaisseur des poutres qui s'y trouvent. En plus ces ouvertures ne concernent pas un seul bloc, mais sont constituées par les jointures avec d'autres blocs (Fig.).

A la suite des travaux effectués dans ce secteur, fut élevé un mur long de 25 m dont l'extrémité sud croise le mur d'enceinte de la ville (Fig. 10).

Les travaux de restauration ont remis en ordre une série de monuments de la ville illyrienne à Zgërdhesh, en conférant aux objets conservés actuellement un aspect plus complet. A l'avenir les travaux de restauration seront continués à nouveau dans les murs d'enceinte, les murs de terrassement et en particulier parmi les ruines des habitations, afin de dresser un tableau plus complet de l'urbanistique de cette ville et de l'ancienne ville illyrienne en général.

DO NOT COPY

sinë e shtatit të njeriut. Kjo sipërfaqe rrethohet nga një ledh sipas një planimetrie eliptike. Ai nuk është ndërtuar mbi konturet e platformës së kodrës por disa metra më poshtë në shpatet e pjerëta të saj. Ledhi ndjek një linjë të valëzuar, ndiqet gjatë gjithë gjatësisë dhe është ndërtuar me gurë të vegjël dhe mesatarë të hedhur pa rregull njeri mbi tjetrin (Tab. I, 4). Vende-vende midis shkëmbinjve janë hedhur gurë për të plotësuar boshllëqet, ndërsa hyrja formohet nga faqja e një shkëmbi dhe skaji i ledhit. Qafa që lidh këtë kodër me kodrat fqinjë mbyllet në anën e kalueshme më lehtë nga një mur i drejtë me gjatësi 90 m i ndërtuar me një teknikë më të përparuar (Tab. I, 1,3). Ai ka një gjerësi prej 2.70 m, përbëhet nga dy faqe të ndërtuara me gurë të papunuar, pa ndonjë mjet lidhës dhe prej brendësisë që mbushet me gurë më të vegjël. Ky mur i përket një periudhe të dytë ndërtimi. Kështjella e Marshejt është i vetmi fortifikim ku na shfaqen të dalluara qartë dy teknika prehistorike ajo me ledhe dhe ajo me mure guri dhe ku ruhet thuajse i plotë një fortifikim i tipit të parë.

Megjithëse nuk janë kryer akoma gërmime arkeologjike në këtë vendbanim teknika dhe ekzistenca e dy periudhave, të ndërtimit të çon në përfundimin se fortifikimi me ledhe duhet ti përkasë periudhës së bronxit. Materiale të bronxit të vonë dhe të fillimit të hekurit ka dhënë dhe një vendbanim tjetër i fortifikuar po në rrethin e Shkodrës, kalaja e Gajtanit[14] (Tab. II, 3) ku muri prej guri si element mbrojtës është formuar plotësisht. Muri është ruajtur në anën më pak të mbrojtur nga natyra e platformës së kodrës me një gjatësi prej 90 m. Lartësia maksimale e ruajtur është 2,40 m ndërsa trashësia 3,50 m. Ai formohet nga dy faqet dhe nga mbushja midis tyre. Faqet janë ndërtuar me gurë të mëdhenj e mesatare të papunuar të cilët krijojnë boshllëqe të konsiderueshme në bashkimin midis tyre.

Përmasat maksimale të një blloku arrijnë deri në 1,5 m gjatësi dhe 1 m lartësi. Në këtë fortifikim ruhet dhe një hyrje e thjeshtë që krijohet nga ndërprerja e murit. Ajo ka një gjerësi prej 1.80 m dhe një koridor sa gjerësia e murit. Fortifikimi i Gajtanit me muret e tij të fuqishëm tregon për një hap të rëndësishëm përpara në raport me ndërtimet pararendëse dhe shënon si epokë fillimet e periudhës së hershme të hekurit. Në periudhën e hershme të hekurit diferencimi shoqëror kishte bërë hapa përpara në krahasim me periudhën e Bronxit, gjë që solli si pasojë shtimin e konflikteve dhe lakminë gjithnjë e më të madhe të një grupi njerëzish për t'u pasuruar në kuriz të të tjerëve. Konsolidohen federatat fisnore dhe lufta për grabitje midis fiseve apo federatave bëhet një fenomen i zakonshëm. Kjo dukuri gjen mbështetje të plotë nga të dhënat arkeologjike. Ndërsa në periudhën e bronxit vendosja e armëve në varre ishte një shfaqje sporadike, në periudhën e hershme të hekurit, u bë një fenomen i zakonshëm. Nuk është e rastit që pikërisht në këtë periudhë kemi një intensifikim të fortifikimeve dhe një përparim të teknikës së ndërtimit të tyre. Madje dhe të krijimit të sistemeve të fortifikimit për krahina të veçanta që i përgjigjen nga pikëpamja e zhvillimit shoqëror konsolidimit të federatave fisnore.

Vendbanimi i fortifikuar bëhet vendbanimi me karakteristik i Ilirëve. Tipar dallues i ndërtimeve mbrojtëse të kësaj periudhe janë muret e fuqishme prej gurësh të mëdhenj, të ndërtuar në të shumtën e rasteve në mënyrën e përshkruar për kalanë e Gajtanit. Mungojnë kullat dhe në përgjithësi kthesat me kënde të drejta të mureve për të siguruar një mbrojtje anësore. Deri diku në disa raste këtë rol e luajnë valzimet e çrregullta të linjës së mureve. Hyrjet janë të thjeshta, të formuara nga ndërprerja e murit rrethues, i vetmi kujdes për ruajtjen e tyre është vendosja në vende me mbrojtje natyrore ose në shumë raste rruga për në hyrje kalon nga një largësi e konsiderueshme bri murit rrethues duke qënë kështu nën kontrollin e mbrojtësve që qëndronin mbi të.

Këto janë karakteristikat më të përgjithshme të fortifikimeve të periudhës së parë të hekurit (v. 1200--500 p.e.r.). Por shpesh ato dallohen midis tyre nga forma planimetrike në përshtatje me terrenin, nga teknika e ndërtimit dhe nga disa elementë të fortifikimit të cilat së bashku bëjnë të mundur të krijohet një kronologji e përafërt dhe të ndiqet deri diku evolucioni i tyre.

Format më të thjeshta të fortifikimeve me mure guri janë ato kur muri mbrojtës rrethon vetëm pjesën më pak të mbrojtur të kodrës duke lënë të pafortifikuar pjesë të tjera të saj me mbrojtje natyrore të mjaftueshme siç janë për shembull pjesët shkëmbore që bien me pjerrësi apo thikë mbi terrenin. Ekzemplarë të tillë ndodhen me shumicë. Një nga tiparet më përfaqësues në të cilin janë kryer dhe gërmime arkeologjike është fortifikimi mbi shpellën e Trenit në Rrethin e Korçës[15]. Ky i fundit është ndërtuar mbi një kodër që ngrihet vetëm 6-8 m mbi nivelin e fushës. Një mur 90 m i gjatë dhe 3,50 m i gjerë rrethon anën më pak të mbrojtur të kësaj kodre, ndërsa pjesa tjetër e kodrës më e lartë përfundon me një faqe të pjerrët shkëmbore që bie mbi kanalin e Ventrokut. Muri

14) S. Islami – H. Ceka, **Vep. cit.** 448.
15) M. Korkuti, **Vendbanimi prehistorik i Trenit,** Konferenca II e Studimeve Albanologjike, Vëll. II, Tiranë 1969, 276.

është ndërtuar me gurë të papunuar të lidhur në të thatë dhe është datuar nga lënda arkeologjike e zbuluar gjatë gërmimit në fillimin e epokës së hekurit[16].

Sisteme të ngjashëm fortifikimi me atë të Trenit por të ngritur mbi lartësi mjaft më të mëdha janë hetuar dhe në krahina të tjera të vendit tonë siç janë Kalaja e Ganjollës[17] (Tab. VIII, 2) në rrethin e Shkodrës, Kalaja e Qytetit[18], Maja e Shenmërisë[19] dhe Kalaja e Bodinit[20] në rrethin e Elbasanit etj. Një formë të veçantë planimetrike përfaqëson Marshej ku një mur i drejtë mbyllte në trajtën e një dige pjesën më pak të mbrojtur të qafës midis dy kodrave[21]. Një nga format mbizotëruese të fortifikimeve është ajo rrethore e më tepër ovale ku muri rrethon konturin natyral të kodrave me shpatë të baraspjerët ose platformat natyrore që ndodhen mbi to. Shembulli më tipik është kalaja e Bilishtit[22] (Tab. II, 1, 2). Ajo ndodhet mbi një kodër në verilindje të qytetit me të njejtin emër e cila ka formën e një kupole me pjerrësi pothuaj të barabartë nga të gjitha anët. Muri mbrojtës rrethon në pjesën më të lartë të saj një sipërfaqe eliptike me gjatësi 120 m dhe gjerësi 60 m.

Qeramika e mbledhur në sipërfaqe nuk shkon më vonë nga periudha e hershme e hekurit (1200-800 p.e.r.)[22]. Forma të ngjashme planimetrike paraqesin dhe Kalaja e Kakaçit dhe Gjonomadhit[23]) (Rrethi i Korçës). Kalaja e Hollmit (Rrethi Ersekës)[24] etj. Në këtë të fundit muri mbrojtës rrethon një sipërfaqe me trajtë eliptike ku përfshihet pjesa e sipërme e një kodre me dy maja të ndara nga një qafë e lartë.

Në disa raste pjesa më e mbrojtur e platformës së kodrës së rrethuar nga muret ndahej nga një mur tërthor i cili krijonte një farë akropoli që shërbente si vend strehim i fundit dhe njëkohësisht si vendbanim i aristokracisë fisnore[25]. Dy fortifikime të tilla që kanë edhe një farë dallimi nga formulimi planimetrik janë: Kalaja e Bellovodës[26] (Tab. III) dhe e Podgories[27] (Tab. II, 4). Në kalanë e Bellovodës, muri mbrojtës rrethon konturin natyror të platformës së një kodre shkëmbore, pjesa më e lartë e së cilës ndahet nga një mur tërthor që kufizon një sipërfaqe të vogël. Teknika e ndërtimit të murit është e njëllojtë me atë të fortifikimeve të përmendura më sipër, ai ka një gjerësi prej 3.20-3.40 m dhe ruhet në lartësi prej 1 m. Kalaja e Podgories (Tab. II, 4) e thirrur nga vendasit «Qyteti në Podgorie» ndodhet mbi vargun e kodrave që shënojnë skajin më verior të fushës së Korçës. Maja e kodrës përfundon me një platformë të përzgjatur, konturet e së cilës i rrethonte një mur me gurë të papunuar me gjerësi 2 m. Gjurmët e një hyrjeje me gjerësi 1,5 m janë konstatuar në anën jugore. Pjesa e ndarë «Akropoli» ndodhet në skajin më të mbrojtur nga natyra të platformës, ku një pjesë shkëmbore e aksidentuar nuk ka patur nevojë për mure mbrojtës. Ndryshe nga Bellovoda këtu Akropoli nuk krijohet nga një ndarje me mur e një pjese të fortifikimit por formon një rrethim të pavarur.

Një zgjidhje tjetër planimetrike e fortifikimeve me akropol është ajo kur muret rrethues formojnë rrathë koncentrike. Rrethimi i parë zë majën e kodrës ndërsa tjetri më i madh shpatet e saj. Shembuj të këtij tipi kemi kalanë e Hadërajt (Rrethi i Vlorës), Kalanë e Lumalasit (Rrethi i Korçës)[28] dhe deri diku Kalanë e Bllacës (Rrethi i Pogradecit)[29] e cila ngrihet mbi një kodër me dy maja të mbrojtura nga fortifikime të pavarura të cilat përfshihen në një rrethim të madh të përbashkët.

Më së fundi kemi fortifikime të ndërtuara në shpatin e një kodre. Kjo ndodh atëhere kur njëra faqe e kodrës bie me pjerrësi të butë dhe krijohen shpesh

16) M. Korkuti, **Vep. cit.** 276.
17) M. Korkuti, **Rreth vendbanimeve të fortifikuara të periudhës së parë të hekurit në territorin e Shqipërisë,** St. Hist. 3, 1973, 110.
18) N. Ceka – A. Baçe, **Vrojtime arkeologjike në Rrethin e Pogradecit, luginën e Devollit e të Shkumbinit**, Monumentet, 3, 1972, 209.
19) Po aty, 210.
20) N. Ceka, **Gjurmime arkeologjike në krahinën e Elbasanit** Buletin Arkeologjik 1968, 108.
21) Gj. Karaiskaj, **Vep. cit.** Iliria 7 (në shtyp).
22) Gj. Karaiskaj, P. Lera, **Fortifikimet e periudhës së parë të hekurit në Rrethin e Korçës,** Kuvendi i I i studimeve Ilire (Tiranë 15-20 Shtator 1972) Tiranë 1974, 266.
22) Gj. Karaiskaj, P. Lera, **Vep. cit.** 266.
23) **Po aty,** 267.
24) S.Aliu, **Rezultatet e gërmimeve në Kodrën e Hollmit – Kolonjë,** Materiale të sesionit Arkeologjik (Tiranë 2-3/X/; 79 Tiranë 1968, 30-39.
25) Gj. Karaiskaj – P. Lera, **Vep. cit.** 272.
26) **Po aty,** 268-269.
27) Gj. Karaiskaj, **Kalaja e Podgories dhe e Kuçit të Zi në rrethin e Korçës,** Mjeshtrat dhe arkitektura popullore, Tiranë, 1976, 45-48.
28) Zh. Andrea, **Rezultatet e kërkimeve informative në Rrethin e Korçës,** Buletin arkeologjik, 1968 131.
29) N. Ceka – A. Baçe, vep. cit. 205.

PO KOPJE COPY

taraca të përshtatshme për banim ndërsa ana e kundërt e thepisur, në të shumtën e rasteve i besohet mbrojtjes natyrore. Këto lloj fortifikimesh i takojmë gjithmonë me dy ose më shumë rrethime. Muret krijojnë gjysëm rrathë që pasojnë njeri-tjetrin mbi një bazë të përbashkët ose krijohen ndarje të ndryshme në përshtatje me terenin dhe nevojat e herëpashershme të mbrojtësve. Duke u nisur nga forma më e thjeshtë te më e ndërlikuara mund të përmendim sipas rradhës Kalanë e Drishtit (Tab. V), Rrethi i Shkodrës[30], Qytezën e Karos (rrethi i Vlorës)[31] dhe kalanë e Trajanit (rrethi i Korçës)[32] (Tab. IV).

Në Kalanë e Drishtit vetëm pak gjurmë janë ruajtur nga ndërtimet prehistorike. Një mur me gurë të papunuar me gjerësi mbi 2 m. rrethonte majën e kodrës duke zënë një sipërfaqe pak më të madhe nga ajo e kështjellës mesjetare (Tab. V, 2), ndërsa muri tjetër ndiqte linjën e konturëve të shpatit duke u përputhur me murin mesjetar (Tab. V, 3).

Qyteza e Karos, ndodhet në veri të fshatit Qeparo mbi një majë shkëmbore me lartësi 450 m mbi nivelin e detit. Ana perëndimore e kodrës përfundon me një humnerë e cila krijon një mbrojtje natyrore mjaft të fuqishme. Me pjerësi të madhe bien dhe dy shpatet e tjera. Fortifikimi përbëhet nga tri harqe muresh që zenë shpatin lindor me ekstreme në bazën e greminës. Harku më i madh ka një gjatësi prej 370 m, ndërsa më i vogli 30 m dhe diametër 10 m. Trashësitë e mureve, nga rrethimi më i madh tek më i vogli janë respektivisht 3 m, 2 m dhe 2-3 m. Të tri pjesët e fortifikimit komunikojnë me hyrje të thjeshta njëra me tjetrën. Të tri hyrjet me pak spostime në drejtim janë vendosur nga ana jugore e kodrës.

Kalaja e Trajanit (Tab. IV) paraqet tipin më të ndërlikuar me shumë rrethime, që zë njëkohësisht një sipërfaqe mjaft të madhe. Ajo ngrihet mbi një kodër 400 m të lartë në afërsi të fortifikimit mbi shpellën e Trenit. Një faqe e kodrës krejt shkëmbore bie thikë mbi liqenin e Prespës së vogël. Me pjerësi të madhe bien dhe faqet e tjera, me përjashtim të anës jugperëndimore, ku ka mjaft taraca të gjëra natyrore të përshtatshme për banim. Një sipërfaqe e sheshtë ndodhet edhe në pjesën më të lartë të Kodrës, e cila është rrethuar me mure të lidhur me llaç që ndjekin trasenë e mureve të vjetra. Ashtu si në kalanë e Bellovodës dhe Podgories pjesa më e lartë e platformës nga veriperëndimi është ndarë nga një mur tërthor që veçon një sipërfaqe mjaft të vogël.

Tri rradhë të tjera muresh të dallueshme qartë prej të cilëve njeri ka mbetur i papërfunduar, përshkojnë faqen jugperëndimore të Kodrës. Vetëm buza veriperëndimore e saj krejt shkëmbore dhe e pangjitshme është lënë e pafortifikuar.

Muret kanë një trashësi prej 3,20-3,50 m dhe janë ndërtuar me gurë të papunuar, gjatësia e të cilëve në faqet anësore shkon nga 60-1,20 m. Kalaja e Trajanit, është një nga vendbanimet e fortifikuara prehistorike, më të mëdha në territorin e Ilirisë. Ai përfshin brenda mureve që kanë gjatësi të përgjithshme prej 3 km një sipërfaqe prej 22 ha.

Megjithatë mbrojtja e këtij vendbanimi nuk përfundon me kaq. Në anën jugore të kalasë ngrihet një kodër që lidhet me të parën me një qafë, e cila shërben si rrugë kalimi për t'u ngjitur në kala nga ana juglindore. Pikërisht në këtë vend ruhet një mur me gjatësi 500 m i cili kalon nëpër lartësinë e kodrës, duke e përshkuar atë mespërmes. Ky mur i njohur me emrin «Muri i Mokut» mund të jetë ndërtuar në një periudhë më të vonë dhe ka shërbyer si pritë në rastin e ndonjë sulmi të befasishëm për banorët që jetonin jashtë mureve të kalasë.

Vendbanime të fortifikuara të një madhësie të tillë kanë lindur në një stad më të zhvilluar të shoqërisë prehistorike, kur nevoja gjithmonë në rritje për t'u mbrojtur i detyronte njerëzit të grumbulloheshin me shumicë në disa pika, për të siguruar një mbrojtje më të efektshme. Fortifikimi i Trajanit siç kuptohet nga vetë forma planimetrike e tij është zhvilluar nëpërmjet të disa fazave. Fortifikimi i platformës së sipërme që është kryer në fazën e parë paraqet një tip të ngjashëm me kalanë e Podgories (Muri 5,4). Në një periudhë të dytë është fortifikuar një pjesë e shpatit juglindor të kodrës (muri 3) për aq sa kërkonin nevojat për mbrojtje të asaj periudhe, duke përfshirë në të një pjesë të popullsisë që banonte shpatin e kodrës. Periudhës së tretë i përket muri i madh rrethues (muri 1) brenda të cilit përfshihej një pjesë e konsiderueshme e faqes së kodrës, ndërsa muri tjetër (muri 2) i periudhës së fundit i mbetur papërfunduar synonte të krijonte një ndarje të re të brendshme që do të bashkonte buzën e greminës me murin rrethues.

Vendbanimet e mbrojtura me shumë mure rrethuese janë një tipar karakteristik për fortifikimet ilire të një periudhe të hershme. Në Greqi ato kufizoheshin zakonisht në majën e kodrës duke luajtur rolin e një akropoli. Madje «edhe pasi qytetet e mëdhenj qenë përhapur përtej kufijve të mbrojtjeve të tyre fillestare, muret rrallë qenë shtrirë për të përfshirë këto

30) Gj. Karaiskaj, **Gjurmë fortifikimesh ilire në disa kështjella të rrethit të Shkodrës,** Buletin Arkeologjik, 4, 150.
31) J. Koçi, **Qyteza e Karos** (Qeparo), Buletin Arkeologjik 3, 1971, 181-183.
32) Gj. Karaiskaj, P. Lera, **Vep. Cit.** 269.

DO NOT COPY

zona të reja përpara fundit të shek. 7 ose fillimit të shek. 6» p.e.s.[33].

Shembujt e vendbanimeve të mbrojtura nga disa rradhë muresh me shumë rrethime në territoret e Ilirisë janë të shumtë dhe i gjejmë kudo si në Ilirinë e Jugut, krahinat qendrore dhe ato veriore. Midis tyre të tërheq vemendjen vendbanimi i fortifikuar i Stiçnas (Tab. XI, 8) në Sllloveni[34]. Ai zë një sipërfaqe të përafërt me atë të Trajanit (23 ha) dhe formohet nga tri rradhë muresh, prej të cilëve një mur tërthor e ndan fortifikimin në dy pjesë, brënda njerës prej tyre ndodhet dhe një ndarje tjetër e vogël që zë vendin më të lartë. Po ajo që ka më tepër rëndësi është se nga gërmimet arkeologjike ka dalë e qartë se fortifikimi në Stiçnas është konceptuar dhe projektuar që në fillim në gjithë madhësinë e tij dhe datohet rreth fundit të shek. 8 p.e.r.

Në kalanë e Trajanit nuk janë kryer gërmime arkeologjike, objekte të gjetura në afërsi që me sa duket i përkasin një tume datohen në shek. XVIII-VII p.e.r.[35]. Gërmimet arkeologjike që mund të kryhen në të ardhmen në këtë kala, do të mund të zbulonin një qendër të rëndësishme paraurbane për pellgun e Korçës dhe ndoshta në fazën e fundit të zhvillimit të saj një nga qytetet e para të Ilirëve të cilat nuk kanë munguar të përmenden në Ilirinë e Jugut nga autorët antikë që në shek. VI-V p.e.r.[36].

Një tip tjetër fortifikimi që rradhitet në ndërtimet mbrojtëse me mure guri është ai me «tumula kufizuese» në Vëntrok[37]. Kalaja e Ventrokut (Tab. VI) ndodhet rreth 300 m në perëndim të fortifikimit mbi shpellën e Trenit, e ndërtuar mbi një kodër shkëmbore me formë të përzgjatur që shkëputet nga vargu i kodrave më të larta në veri të saj.

Ajo që tërheq më tepër vëmendjen në këtë fortifikim janë dy pirgje të krijuar artificialisht, të ndërtuar me gurë të vegjël e dhe, të cilët në bazën e tyre rrethohen nga një mur i thatë në lartësinë e dy deri në tre rradhë gurësh. Njëri prej tyre ndodhet në ekstremin verior të kodrës atje ku ajo nëpërmjet një qafe lidhet me kodrën fqinjë. Pirgu tjetër ndodhet në mezin e kalasë, duke e ndarë atë në dy pjesë që komunikojnë me vështirësi me njëra-tjetrën. Ky element mbrojtës që takohet për herë të parë në vendin tonë është mjaft i përhapur dhe i njohur në fortifikimet e krahinave veriore dhe qendrore të Ilirisë, ku këto objekte arkitektonike kanë tërhequr për një kohë të gjatë vëmendjen e studiuesve të cilët i kanë quajtur me emra të ndryshme sipas rolit që ata i atribuonin p.sh. «Tumula mbrojtëse» duke parashikuar në rradhë të parë rolin e tyre strategjik fortifikues ose «tumula kufizuese» duke patur parasysh funksionin e tyre ndarës të kodrës së fortifikuar nga mali apo kodra mëmë. Ekziston edhe mendimi që këto «Tumula» të kenë patur një karakter të theksuar kulti[38]. Duke patur parasysh funksionin e tyre mbrojtës dhe njëkohësisht ndarës në Ventrok, ku ato e ndajnë në dy pjesë këtë fortifikim, kontrollojnë shtegun e komunikimit midis këtyre pjesëve, kryejnë njëkohësisht edhe një funksion ndarës nga kodra mëmë, kemi parapëlqyer për këto objekte arkitektonike termin «tumula kufizuese»[39].

Në qoftë se në Bosnje-Herzegovinë karakteri i këtyre ndërtimeve nuk është përcaktuar përfundimisht[40] ose u atribuohen disa funksione[41], në rajonin qendror të Japodëve (Kroaci) karakteri i tyre mbrojtës është krejtësisht i dokumentuar[42]. Ato vendoseshin në hyrjet e gradinave, shpesh në çifte dhe lidheshin me skajet e mureve mbrojtës, ose në pjesët më pak të mbrojtura nga tereni. Zëvendësonin një mur apo një digë mbrojtëse. Në një prerje që i është bërë një «tumule» është konstatuar që ajo ishte ndërtuar nga një shtresë dheu me lartësi 2 m, mbi të cilën qe hedhur një shtresë gurësh 0,5 m e trashë[43].

Disa elemente që tregojnë për një zhvillim të më-

33) F.E. Winter **Greek fortifications,** Toronto 1971, 106.
34) S. Gabrovec, **Uberblick uber Eisenzeitliche Befestingungen in Slovenien.** Colloque Intr. Mostar, Sarajevo 1975, 59-71.
35) Gj. Karaiskaj, P. Lera, **Vep. cit.**
36) Lindja e qyteteve nuk duhet lidhur veçse në raste të veçanta me ndërtimin e mureve mbrojtës me gurë të latuar, të cilët janë futur në përdorim relativisht vonë në Iliri. Mendim që ekziston në literaturën tonë arkeologjike, Shih. F. Prendi, **Urbanizmi i Ilirisë së Jugut në dritën e të dhënave arkeologjike,** Kuv. I i St. Ilire, Tiranë 1974, 107-122.
37) Gj. Karaiskaj, P. Lera, **Vep. cit.** 265.
38) D. Basler, **Prethistorijske gradine i njohova zastita,** «Naše Starine» 2 1954, 87-98.
39) Gj. Karaiskaj, P. Lera, **vep. cit.** 265.
40) D. Basler, **vep. cit.** 87-98.
41) A. Benac, **Quelques caractéristiques des agglomérations fortifiées dans la Région des Delmates,** Colloque international «Agglomérations fortifiés Illyriennes» Sarajevo 1975, 81-91.
42) R. Drechaler – Bizic, **Caractréistiques des agglomérations fortifiées dans la région centrale des Japodes,** Colloque Intr. Sarajevo 1975, 71-79.
43) Po aty, 71-79.

Dokument

tejshëm të sistemeve mbrojtëse prehistorikë i takojmë në Akrolis[44] (Tab. VII) dhe në fortifikimin më të hershëm të Butrintit. Këtu ndeshemi për herë të parë në kthesa pak a shumë me kënde të drejtë të linjës së mureve, që kishin për qëllim të siguronin një mbrojtje anësore.

Në Akrolis i cili ngrihet mbi majën e një kodre të lartë shkëmbore në lindje të qytetit të Lezhës, ndeshemi me dy kthesa të tilla muresh. Ndërsa në Akropolin e Butrintit ato pak gjurmë që janë ruajtur nga muri prehistorik (Tab. VIII, 3) i përkasin pikërisht një kthese këndrejtë që bën linja e këtij muri. Këtu përveç ngjashmërisë që vërejmë nga kjo pikëpamje me Akrolisin, konstatojmë edhe një përparim në teknikën e ndërtimit. Tek gurët që formojnë faqen e jashtme vërehet një përpunim i lehtë për të arritur një përputhje më të mirë të tyre nga ajo e gurëve natyrorë, gjë që nuk e takojmë në fortifikimet e përshkruara deri tani[45]. Fortifikimet me trase të dhëmbëzuar i përkasin një periudhe më të vonshme. Në Greqi ky element u shfaq për herë të parë në shek. VIII-VII p.e.r. dhe u përdor gjerësisht në fortifikime vetëm gjatë shek. V[46]. Shek. VI-V p.e.r. i përkasin dhe objektet arkeologjike më të hershme të zbuluara deri tani në Butrint.

Një evolucion të mëtejshëm të fortifikimeve të kësaj periudhe e shohim te Kalaja e Mbolanit (rrethi i Beratit)[47], Tab. V, 4. Nga formulimi planimetrik dhe disa elemente të fortifikimit ajo paraqet një fazë tranzitore midis periudhës së parë dhe të dytë të hekurit.

Me fortifikimet e periudhës së parë të hekurit atë e lidh teknika e ndërtimit me gurë të papunuar dhe mungesa e kullave, ndërsa me periudhën e dytë, kthesat me kënde të drejtë për të mbrojtur hyrjet ose për të ndryshuar drejtimin e murit, ndjekja e linjave të drejta të mureve, dhe së fundi një përpunim i trashë i faqeve të jashtme të gurëve.

Kalaja e Mbolanit (Tab. V, 4) ngrihet mbi një kodër midis fshatrave Sinje dhe Arpaxhias të rrethit të Beratit. Pjesa e sipërme e kodrës përfundon me një sipërfaqe të sheshtë mjaft të përshtatëshme për banim, konturet e së cilës rrethohen nga një mur me gjatësi 660 m që përfshin një sipërfaqe prej rreth 3 ha. Në qendër të kalasë, në pjesën më të ngritur të saj ndodhet Akropoli që ka një formë katërkëndëshe me një qoshe të prerë për të krijuar mundësinë e flankimit të hyrjes. Duke u nisur nga dy qoshe të këtij katërkëndëshi zbresin dy mure të drejtë deri tek muri rrethues kryesor. Duke krijuar kështu një ndarje të tretë e cila komunikon nëpërmjet një porte me gjerësi 4.00 m me pjesën tjetër të kalasë. Muret janë ndërtuar me gurë gëlqerorë të shtresëzuar ku gjatësia e një guri arrin nga nji herë deri në 1 m dhe lartësia nuk e kalon 0.20 m.

Gjerësia e murit rrethues të platformës është 1.40 m ndërsa e mureve të brendshëm ndarës 2,30 m.

Një kufiri të tillë kohor i përket edhe kalaja e Kalivosë (rrethi i Sarandës),[48] Tab. IX. Kjo ndodhet në një kodër të lartë, e cila laget në tre anë nga liqeni i Butrintit. Nga veriu dhe perëndimi ajo bie thikë mbi liqen prandaj nuk është parë e nevojshme të ndërtohen mure mbrojtës në këto anë. Muri mbrojtës që rrethon pjesët e tjera të kodrës është ndërtuar me blloqe të mëdhenj gurësh pak të përpunuar por që nuk puthiten mirë me njeri-tjetrin ashtu si dhe muret më të hershme të Butrintit. Bllоqet e gurëve kanë një gjatësi që lëviz nga 0,60 – 1,80 m dhe lartësi 0,40 – 1,00 m. Muret ruhen në një lartësi maksimale prej 4 m. dhe po kaq është trashësia e tyre. Në këtë fortifikim janë zbuluar dy hyrje njera prej të cilave ka një gjerësi prej 2.50 m dhe mbrohet nga një koridor i brendshëm i krijuar nga dy mure paralele, në të cilin të çojnë një palë shkallë. Hyrja tjetër është pajisur gjithashtu me shkallë dhe ka një gjerësi prej 1.80 m.

Kalaja e Kalivosë akoma nuk është eksploruar plotësisht por nga të dhënat që disponohen, del qartë se ajo paraqet një shkallë më të lartë zhvillimi nga fortifikimet e tjera prehistorike, pararendëse, jo vetëm nga teknika e ndërtimit me gurë gjysëm të punuar por edhe nga mënyra e mbrojtjes së hyrjeve dhe ekzistenca e shkallëve.

Një tip fortifikimi të një destinacioni të veçantë përfaqëson muri pengues në Zvezdë[49] (Tab. VIII, 1) i cili kishte një karakter thjeshtë strategjik. Ai mbyll qafën e Zvezdës e cila krijon një rrugë komunikimi midis fushës së Korçës dhe territoreve që shtrihen pranë liqenit të Prespës së Madhe si dhe me Maqedoninë. Muri zbret nga të dy shpatet e kodrave përbri rrugës

44) F. Prendi, K. Zheku **Lisi në dritën e të dhënave të reja arkeologjike,** Monumentet 2, 1971, 8.

45) Klasifikimin e fortifikimeve të periudhës së parë të hekurit sipas teknikës së ndërtimit, me gurë natyrore dhe pak të përpunuar e ka bërë K. Zheku, Iliria 7 (në shtyp).

46) R.L. Skranton, **Greek Walls,** Cambridge 1941, 149-158.

47) N. Ceka, **Monumente antike dhe mesjetare në luginën e Osumit,** Monumentet 5-6, 1973, 121-123.

48) Dh. Budina, **Harta arkeologjike e bregdetit Jon dhe pellgut të Delvinës,** Iliria I, Tiranë 1971, 324-325.

49) Gj. Karaiskaj, P. Lera **Vep. cit.** 271.

Dokument

duke bllokuar dhe këtë të fundit. Ai ka një gjatësi prej 550 m dhe gjerësi 2,20-3 m, i ndërtuar me gurë të papunuar të përmasave të vogla dhe mesatare të vendosur në të thatë.

Thuajse në mesin e murit dallohet një linjë gurësh më të mëdhenj që e përshkon atë në drejtim gjatësor. Në mos qoftë kjo një veçori e teknikës së ndërtimit, kemi të bëjmë me një fazë të dytë ndërtimi që ka patur qëllim të shtojë trashësinë e murit, veprim që është kryer në anën e brendshme të tij. Kjo tregon se ky mur ka qenë i nevojshëm për një periudhë të gjatë kohe dhe i është nënshtruar riparimeve të herpashershme. Fundi i kësaj periudhe mund të konsiderohet mesi i shek. IV p.e.r. kur midis «dy liqejve» kalonte kufiri me Maqedoninë dhe kjo e fundit me Filipin e II ishte kthyer në një fuqi ekspansioniste. Mure pengues me destinacion të ngjashëm me atë të Zvezdës, të ndërtuar me gurë të papunuar, i takojmë edhe në Greqinë kontinentale. Ata datohen zakonisht nga shek. 8-6 p.e.r. të tillë janë: muri i Lokrianëve në Termopile, muri Demë në Epano Liossia[50] i Istmit të Korintit[51] etj. Në periudhën helenistike vazhdohet të ndërtohen mure të tillë, siç është në vendin tonë muri i Demës në Gadishullin e Ksamilit. Nuk ka dyshim se muri i Zvezdës përfaqëson shembullin më të hershëm të këtij lloji ndërtimi, në vendin tonë dhe ndoshta edhe në territoret e tjera të Ilirisë. Me ndërtimin e murit të Zvezdës u plotësua sistemi i fortifikimit për gjithë krahinën, në pellgun e Korçës. Ai vetë është dëshmi e pranisë së këtij sistemi, i cili u formua gradualisht dhe u përfundua në një etapë të caktuar të zhvillimit ekonomiko-shoqëror. Kjo etapë i përgjigjet më tepër periudhës së krijimit të federatave fisnore, të cilat u krijuan së pari nga fiset e Enkelejve dhe Taulantëve që në shek. VII p.e.r.

Tani qëllimi kryesor nuk ishte mbrojtja e një vendbanimi nga fqinji më i afërt, por i një grupi vendbanimesh që kanë krijuar një rezistencë të organizuar, kundrejt një armiku të jashtëm. Kjo vërtetohet edhe nga prania e vendbanimeve të pafortifikuara brenda këtij rrethi fortifikimesh, siç janë në fushën e Korçës, Barçi dhe Kuçi i Zi, por këto të fundit janë më të pakëta pasi vendbanimi i fortifikuar, ishte bërë vendbanimi më karakteristik në këtë periudhë.

Sistemet e fortifikimit për rajone të veçanta janë të njohura edhe në krahinat qendrore dhe veriore të Ilirisë. Rafshnalta e Glasinacit (Bosnje) e cila ka një mbrojtje të fuqishme natyrore, rrethohet dhe nga një zinxhir sistematik fortifikimesh dhe vendbanimesh të fortifikuara, që zënë pikat dominuese, mbyllin vendkalimet dhe grykat e luginave[52]. Deri sot në këtë krahinë janë gjurmuar 47 fortifikime ose vendbanime të fortifikuara prehistorike[53]. Në Sllloveni dhe Kroaci janë hetuar disa sisteme fortifikimesh që grupohen rreth pllajash të mëdha. Fortifikimet janë vendosur në pika dominuese ose me rëndësi strategjike ku midis tyre takohen edhe mure barierë. Këto sisteme kanë luajtur një rol me rëndësi, për mbrojtjen e këtyre krahinave edhe gjatë luftërave kundër ushtrive pushtuese romake[54].

Mjaft interesant është dhe sistemi i fortifikimit rreth pllajës së Duvnos (Bosnje) në territorin e banuar nga fisi ilir i Delmatëve ku janë vendosur 37 gradina[55].

Një pjesë e lokaliteteve të fortifikuara këtu shërbenin si vend vrojtimesh dhe shtriheshin në zonën periferike të fortifikimeve ndërsa «tumulat kufizuese» si element përbërës të një pjese të mirë të gradinave janë vendosur zakonisht në anët e jashtme të fortifikimeve kundrejt pllajës, duke treguar me pozicionin e tyre drejtimin e mbrojtjes për çdo «gradinë»[56].

Fortifikimet me ledhe dheu në vendin tonë deri sot përfaqësohen nga një shembull i vetëm i ndodhur pranë fshatit Shuec të Rrethit të Korçës. Ai njihet nga banorët pranë tij me emërin «Gradishta e Shuecit»[57]. Gradishta e Shuecit (Tab. X) është ndërtuar mbi një kodër të vogël shkëmbore që shkëputet në formën e një gjuhe prej terrenit kodrinor pranë saj, dhe laget pjesërisht nga liqeni i Prespës së vogël. Vetëm faqja që sheh nga liqeni që zë vetëm një pjesë të sipërfaqes së gjithë kodrës është rrethuar nga një ledh me gjatësi 600 m. Ledhi është ndërtuar me gurë të thyer të dimensioneve të vogla të përzjerë me çakëll dhe me dhe. Në prerje ai ka formën e një trapezi me bazën e poshtme 10 – 11 m të sipërmen 3 m dhe lartësi 2 m.

50) R.L. Seranton, **Greck Walls** Cambridge, 1941, 145-149.
51) Ch. P. Kardara, **The Istmian Well** «Athens annais of Archeology» 1971, 85-89.
52) C. Truhelke, **Hugelgraber und Ringwalle anf der Hochebene Glasinac,** Wissenschaftliche Mitteillungen aus Bosnien und der Hercegovine, Wien, 1893, 65.
53) B. Covié, **Die Befestigungen und Befestigte Siedlungen des Glasinacer Gebietes,** Colloque International, Mostar (24-26 Octobre 1974) Sarajevo 1975, 93.
54) B. Saria, **Die Vorgeschichtlichen Ringwallsysteme in Slowenien** «Sudastforsihungen» 15, 1956, 41-48.
55) A. Benac, **Vep. Cit.** 83.
56) **Po aty,** 86.
57) Gj. Karaiskaj, P. Lera, **Vep. cit.** 264.

DOKUMENTI

Hyrja 2,5 m e gjerë, është e thjeshtë dhe formohet nga ndërprerja e ledhit, por ajo është vendosur në një pozicion të mbrojtur nga natyra. Për të shkuar deri tek ajo ke në dispozicion një rip toke të ngushtë që kufizohet nga njera anë prej rënies shkëmbore mbi liqen dhe nga ana tjetër prej vetë ledhit të Gradishtës.

Lartësija e vogël e këtij të fundit, presupozon ekzistencën e një sistemi palisadash mbi të, për të garantuar mbrojtjen. Brenda rrethimit nuk është gjetur qeramikë që të vërtetojë praninë e jetës së vazhdueshme. Për këtë arsye mendohet që Gradishta të ketë shërbyer si vend strehimi, vetëm në raste rreziku për banorët e vendosur në fushë rrëzë të saj ku gjenden me shumicë fragmente qeramike të periudhës së hershme të hekurit si dhe dy kodërvarre, në njerin prej të cilëve është gjetur një byzylyk bronxi që datohet në vitet 800 – 700 p.e.r.[58]

Gradishta e Shuecit ashtu si dhe fortifikimi i Vëntrokut shënojnë kufirin më jugor të tipave që përfaqësojnë; shembuj të ngjashëm nuk gjejmë në Greqi, ndërsa fortifikimet prej ledhesh si ato të Gradishtës së Shuecit kanë një përhapje të gjerë edhe përtej territoreve veriore të Ilirisë, deri në Angli[59].

Si nga teknika e ndërtimit të ledhit ashtu edhe nga pajisja me palisada Gradishta e Shuecit ka shembuj të shumtë në territoret qendrore dhe veriore të Ilirisë. Në këto të fundit kjo traditë u ruajt për një kohë të gjatë deri në pushtimin romak, gjë që mund të kuptohet lehtë nga një pasazh i Appianit i cili përshkruan betejën e Qezarit, për të marë qytetin Metul, kryeqytet i Japodëve, ku thuhet midis të tjerave se «Romakët zunë murin e braktisur dhe e dogjën»[60]. Gjithashtu në territorin e Japodëve janë të përhapura fortifikimet të quajtura «binjake» ku dy maja të së njëjtës kodër fortifikohen më vete, ashtu siç ndodh edhe në kalanë e Bllacës (rrethi Pogradecit) që përbën ndoshta dhe kjo kufirin jugor të këtij tipi fortifikimesh.

Përsa i përket shtrirjes planimetrike të fortifikimeve prehistorike, përveç shumicës së formave të përmendura më sipër për fortifikimet e vendit tonë, të cilat në të shumtën e rasteve kushtëzohen nga konturet e vetë terrenit në krahinat qendrore dhe veriore të Ilirisë, do të ndeshim edhe forma të tjera të konceptuara nga vetë ndërtuesit. Të tilla janë disa fortifikime me forma të rregullta gjeometrike si katërkëndëshe trapezoidale, rombike etj. Më të shpeshta janë format e rregullta rrethore, ovale dhe gjysmë rrethore. Format e rregullta gjeometrike janë karakteristike sidomos për fortifikimet rreth pllajës së Glasinacit dhe përgjithësisht në terrene të ulëta kodrinore ku mungojnë formacionet gëlqerore. Këto fortifikime zakonisht kanë përmasa të vogla dhe rrallë herë arrijnë përmasat e fortifikimeve të krahinave veriperëndimore të Ilirisë.

Një nga elementet përbërës kryesorë të fortifikimeve prehistorike janë hyrjet. Në shumicën e rasteve, çdo fortifikim ka vetëm një hyrje, ose nga një hyrje për çdo ndarje kur ai përbëhet nga dy ose më shumë rrethime. Numri i paktë i hyrjeve tregon se ato ishin pika delikate dhe paraqitnin probleme për mbrojtësit, po kështu paraqitnin edhe vështirësi teknike veçanërisht për mbulimin e tyre. Shumica e hyrjeve janë të ngushta 1,2 deri 1,80 m. Të pakta janë rastet kur gjerësia e hyrjeve arrin në 2,50 m e më tepër si në Kalivo e Mbolan fortifikimet e të cilave i përkasin një periudhe më të vonë. Një përjashtim bën Gradishta e Shuecit (2.50) e cila është ndërtuar me një teknikë tjetër. Brenda diapazonit të parë 1.20 – 1.80 m ndryshimet e gjerësive të hyrjeve mvareshin kryesisht nga nevojat dhe mjetet e komunikimit. Ndërsa për grupin e dytë edhe nga mundësitë teknike për zgjidhjen e mbulesës së tyre. Nuk dihet me saktësi se sa ka qenë lartësia e mureve prehistorike, por po ta gjykojmë nga traktet më të larta të ruajtura deri sot në Kalivo 4 m. dhe Dors mbi 3 m, mund të mendohet se hyrjet kanë qenë të mbuluara dhe të pajisura me porta të forta druri. Për fortifikimet prehistorike me mure guri nuk ekziston sot asnjë e dhënë për të na treguar se në çfarë mënyre kanë qenë mbuluar hyrjet e tyre. Por në një farë mënyre kjo mund të arrihet me anë të retrospektivës dhe të krahasimit me portat e fortifikimeve prehistorike të botës Mesdhetare. Po t'u referohemi ndërtimeve megalitike, që në kohët më të lashta do të shohim dy zgjidhje kryesore në konstruksionin e hyrjeve, me arkitra, prej blloqesh guri monolit të papunuar ose pak të punuar në vendet e mbështetjes dhe me hark të rremë me majë. Takohet gjithashtu dhe një konstruksion i përzjerë ku mbi arkitraun ndodhet një hark shkarkues me majë[61]. Por nuk përjashtohet mundësia që të ketë patur dhe hyrje pa konstruksion mbulese sidomos kur muret qenë të ulët. Kjo mund të thuhet më me siguri për fortifikimet me ledhe ku konstatohen hyrje mjaft të gjera.

Një shqetësim tjetër për ndërtuesit prehistorikë ishte dhe mënyra e mbrojtjes së tyre. Për këtë shfrytë-

58) **Po aty,** 254.

59) Për këtë informatë i detyrohem Prof. N. Hammondit që pati mirësinë të ma sygjeronte gjatë seancave të punimeve të Kuvendit të parë mbi Ilirët në Tiranë, (15-20 Shtator 1972).

60) Appian, **Illyrike,** 19.

61) A. Faber, **Zum Mahalithenbau, Einige Bemerkungen uber die uberwolbung der Stadttore der Magalithenbefestigungen und ihre Datierung,** Colloque Intr. Sarajevo 1975, 299-300.

DOKTORI

DOKTORATË

zohej terreni ose arrihej nëpërmjet vetë mënyrës së ndërtimit, ka edhe raste ku për mbrojtjen e hyrjeve nuk është treguar ndonjë kujdes i veçantë ose janë shfrytëzuar të dy mundësitë e para.

Shumica e hyrjeve i përket grupit të parë. Ato ndërtoheshin në pjesët më të rrëpitta të terrenit ku sulmuesit detyroheshin të bënin një pjesë të rrugës, bri murit rrethues si në Gajtan, Shuec dhe qytezën e Karos. Në dy rastet hyrjet janë të mbrojtura nga një koridor i brendshëm që kufizohet nga dy mure paralele në të dy anët e portës, të cilët mund të krijojnë kënde të drejtë me murin rrethues (Kalivo) ose të kenë formë të harkuar (Akropoli i Zgërdheshit)[62] dhe së fundi mund të përmendim hyrjen e Akropolit të kalasë së Mbolanit, e cila mbrohet nga një dalje këndrejtë e murit që bie në krahun e djathtë të zbuluar (të pambrojtur me mburojë) të sulmuesve sipas rregullave të strategjisë antike. Tipi i fundit i portave gjen një përhapje të gjerë dhe përsoset në fortifikimet e kohëve më të vona. Një tip interesant përfaqëson hyrja e kalasë së Dedejanit. Për t'u futur brenda këtij vendbanimi të fortifikuar, duhet të përshkosh më parë një koridor të ngushtë e të gjatë që krijohet midis dy mureve rrethues të taracave, të cilat megjithëse janë ndërtuar në të njëjtën lartësi të pjerrësisë së shpatit të kodrës rrethohen secila me nga një mur të veçantë. Një larmi formash dhe mënyrash mbrojtjeje të hyrjeve i hasim në fortifikimet prehistorike të krahinave qendrore dhe veriore të Ilirisë ku mbizotërojnë fortifikimet me ledhe. Ajo që të bie në sy më tepër në këto ndërtime mbrojtëse janë përmasat e mëdha të hyrjeve që arrijnë deri në 5 m[63]. Është e kuptueshme që në raste të tilla ato nuk kishin ndonjë konstruksion mbulesë ose ajo ka qenë prej druri. Përsa i përket mënyrave kryesore të mbrojtjes, ato mund t'i gruponim si vijon: 1) Hyrje të thjeshta që krijohen nga ndërprerja vertikale e ledhit apo e murit rrethues. Këto mund t'i takojmë në disa variante duke filluar nga një deri në tri rradhë hyrjesh që pasojnë njëra-tjetrën në të njejtin drejtim, për këtë ndërtoheshin ledhe ndihmës përpara ledhit kryesor[64] (Tab. XI, 4). 2) Hyrje oblike ku ledhi ndërpritet pjerrtas për të krijuar një korridor të mbrojtur sa më të gjatë[65] (Tab. XI, 3). 3) Hyrje tangencionale ose anësore. Këto krijohen nga shvendosja paralele e dy skajeve të murit apo ledhit, midis të cilave krijohet një koridor[66] (Tab. XI, 1).

4) Hyrje të mbrojtura nga një krah nga zgjatimi anësor i ledhit[67] (Tab. XI, 5). Ky i fundit mund të kryente vetëm një mbrojtje pasive në njerin drejtim kur këtë e lejonte terreni. Një variant të zhvilluar të këtij tipi e takojmë në fortifikimin e Debelobrdos (Tab. XI, 6) ku kemi një kombinim të hyrjeve me mbrojtje në një krah me hyrjen tangenciale. Këtu për mbrojtjen e hyrjes shërben jo vetëm zgjatimi anësor i njerit nga ledhet por dhe një koridor shumë i gjatë e i përkulur i cili krijohet nga muri rrethues dhe një mur i brendshëm thuajse paralel me të parin, i cili zë fill nga njera anë e hyrjes. Ky mur i dytë shërbente dhe për ta mbrojtur më mirë krejt vendbanimin nga kjo anë me mbrojtje natyrore më të dobët[68]. 5) Një tip tjetër përbëjnë hyrjet e mbrojtura nga tumula kufizuese[69] (Tab. XI, 2) ose nga një zgjerim (trashje) i dy skajeve të ledhit që kufizojnë hyrjet. Në këtë rast tumulat kufizuese luajnë deri diku rolin e kullave dhe të kujtojnë hyrjet e mbrojtura nga dy kulla anësore të përdorura gjerësisht në antikitet dhe mesjetë. Dhe së fundi po përmendim hyrjen e fortifikimit të Bjelomaliqit në Glasinac[70] e cila mbrohet nga dy zgjatime anësore të jashtme dhe dy të brendshme të ledhit duke krijuar midis tyre një oborr të fortifikuar (Tab. XI, 7). Megjithëse me një teknikë më primitive nga fortifikimet me mure guri, këto ndërtime mbrojtëse me ledhe të tërheqin vëmendjen për konceptin e përparuar për kohën, lidhur me mbrojtjen e një pike kaq delikate siç janë hyrjet në fortifikimet e të gjitha kohëve.

Në ndërtimet më të hershme me ledhe ose me mure guri të vendit tonë (neolit-bronx) gurët janë të dimensioneve të vogla, ledhet nuk arrijnë një gjerësi më të madhe se 1,70 m, ndërsa muret me gurë e kalojnë këtë masë. Në vazhdim të periudhës së parë të hekurit, vihet re në përgjithsi një rritje e trashësisë së mureve dhe vetë gurëve të përdorura për ndërtimin e

62) S. Islami, **Qyteti Ilir në Zgërdhesh,** Monumentet, 1, 1971, 23-39.
63) Shih gradinën në Culjane W. Buttler, **Burgwalle in Nordalmatien,** Bericht der Romisch-Germanischen Kommossion, 21, 1931, 196 (Tab. 40, 1).
64) B. Covic, Die Befestigungen und. . . . , 93.
65) Një hyrje të tillë ka fortifikimi i Puhovacit, shih C. Trunhalka, **vep. cit.** 69 (fig. 99) B. Covic, vep. cit. (Tab. I, 2).
66) Shih fortifikimin Magdalenska Gora, S. Grabovac, vep. cit. Tab. 1.
67) G. Stratimirovic **Ausgrabungen auf der Hochebene Glasnac in Jahre 1891,** W.M.B.H., Wien (Tab. II, 1), 40.
68) F. Fiala, **Prahistorische Wohsadtatten in Sobunar bei Sarajevo,** W.M.B.H. 1893. 41 (fia. 1).
69) R. Drecheler – Bizic, **Vep. cit.** Plan, 3, 77.
70) C. Truhelka, **Vep. cit.** 69, fig. 10.

faqeve të tyre. Kjo teknikë e re i jepte një qëndrueshmëri më të madhe mureve mbrojtës. Përmasat mesatare të gurëve të përdorur për ndërtimin e faqeve të mureve gjatë periudhës së parë të hekurit janë rreth 1 m gjatësi dhe 50 – 60 cm lartësi, por në raste të veçanta gjatësia e tyre i kalon 2 m. Shumica e fortifikimeve ka një gjerësi muresh prej 3-3.5 m mjaft prej tyre 2-3 m dhe në dy raste takojmë mure me gjerësi 1,40 m dhe 4 m. Në vartësi nga formacionet shkëmbore të shtresëzuara lartësia e gurëve disa herë është mjaft e vogël (0.20 m). Gurët e faqeve krijojnë boshllëqe të konsiderueshme në bashkimin midis tyre dhe shpesh janë përdorur gurë më të vegjël për plotësimin e këtyre boshllëqeve. Zakonisht muret janë me faqe vertikale por ka dhe raste si në Kalanë e Dedejanit, Vëntrokut, Kalivosë dhe Mbolanit kur ato e kanë faqen e jashtme të pjerrët. Ky fakt nuk ka ndonjë rëndësi kronologjike pasi këtë veçori e takojmë si në fortifikimet më të hershme të kësaj periudhe ashtu edhe tek më të vonat. Dallimin kryesor përsa i përket teknikës së ndërtimit e shohim ndërmjet mureve me gurë krejt të papunuar dhe atyre pak të punuar të cilët krijojnë një puthitje më të mirë. Teknika e fundit tregon për një koncept të ri në ndërtimin e mureve si dhe për përsosjen e veglave të punës dhe më e rëndësishmja është që këtë teknikë e takojmë në fortifikime të cilat dhe nga elemente të tjerë të ndërtimit datohen në një periudhë më të vonë, siç janë Butrinti, Kalaja e Kalivosë dhe e Mbolanit. Megjithatë teknika me gurë të papunuar zë një diapazon kohor mjaft më të gjerë nga kjo e fundit. Kjo vjen si pasojë e kushteve ekonomike të veçanta të vendbanimeve të ndryshme të cilat bëjnë që këto dy teknika jo vetëm të bashkëjetojnë, por nga një herë teknika me gurë të papunuar të përdoret dhe në kohë më të vona, nga e para. Teknika e ndërtimit të fortifikimeve të Ilirisë qendrore dhe jugore, paraqet një sërë veçorish nga ajo e Ilirisë së Jugut. Krahas ndërtimeve me mure guri në këto zona takohen më shpesh fortifikimet me ledhe. Ledhet ndërtoheshin me dhe, zhavor dhe gurë të vegjël të ngjeshur mirë (Glasinac)[71] ose me gurë të vegjël e të mëdhenj të hedhur mbi njeri-tjetrin pa ndonjë rregull[72] dhe nga një herë me gurë të përzjerë me pak dhe[73]. Nga një herë ledhet kishin një bazë mjaft të gjerë dhe mbi to mendohet të ketë patur palisada. Një teknikë interesante paraqesnin muret e disa fortifikimeve në Sllloveni, ku ato me gjerësi rreth 3 m të ndërtuar me gurë të papunuar, përforcoheshin me trarë druri të vendosura vertikalisht në faqet e murit[74] të cilët lidheshin me sa duket me breza horizontalë. Në fortifikimin e Stiçnas trarët vendoseshin në largësi të rregullta çdo 3,40 m.[75]

Evolucionin e fortifikimeve prehistorike të vendit tonë mund ta shohim në tre drejtime kryesore, në teknikën e ndërtimit, formulimin planimetrik dhe konstruksionin e hyrjeve. Sidomos kur kemi të bëjmë me kombinimin e disave nga këto elemente i përkasin një shkalle më të lartë zhvillimi, në mungesë të dhënash arkeologjike të sigurta, jemi të prirur të datojmë disa fortifikime si Butrinti, Kalivoja dhe Mbolani, në shekujt e fundit të periudhës së parë të hekurit (rreth vitet 70 – 500 p.e.r.).

Përsa i përket destinacionit fortifikimet mund t'i ndajmë në vendbanime të fortifikuara, ku përfshihen shumica e fortifikimeve të vendit tonë, në vendstrehime, të cilat përdoren vetëm në raste rreziku dhe ndërtime thjeshtë strategjike, si muri i Zvezdës.

Po të përfshijmë në këtë klasifikim edhe fortifikimet e krahinave të tjera të Ilirisë do të ndeshim fortifikime që shërbenin për vrojtim, madje ka mendime që një pjesë e tyre përdoreshin për mbylljen e bagëtisë[76] në raste rreziku, si edhe për qëllime kulti[77]. Në këtë punim nuk kemi përmendur të gjitha fortifikimet prehistorike të vendit tonë, por vetëm ato që na janë dukur më tipiket për të krijuar një ide mbi tipat dhe evolucionin e tyre. Duke i krahasuar këto dhe me ndërtime të këtij lloji në Ilirinë veriore, dalin në dukje lidhjet që ekzistojnë midis fortifikimeve ilire në përgjithësi dhe deri ku arrijnë kufijt e përhapjes së elementeve karakteristike dalluese të këtyre fortifikimeve siç janë p.sh. fortifikimet me ledhe dhe tumula kufizuese.

Duke qënë të një karakteri më konservativ se sa materiali i lëvizshëm, studimi më i hollësishëm i sistemeve të fortifikimeve prehistorike mund të sjellë të dhëna me interes për kulturën materiale të Ilirisë si dhe për përhapjen dhe drejtimin e lëvizjes së fiseve të veçanta brenda territorit ilir gjatë fundit të epokës së bronxit dhe periudhës së hershme të hekurit.

71) B. Covic, **Vep. cit.** 99.
72) A. Benac, **Vep. cit.** 85.
73) A. Covic, **Vep. cit.** 99.
74) S. Grabovec, **Vep. cit.** 68, B. Saria, **Vep. cit.** 44.
75) S. Grabovec, **Vep. cit.** 68.
76) D. Basler, **Vep. cit.**
77) W. Radimsky, **W.M.B.H.** 1984, 53-55, A. Stipcevic, **Gli Iliri** Milano, 1966, 102-108, A. Stipcevic; **Colloque Intern.** Mostar 1975, 320.

DO NOT COPY

TAB. I





1



3

2





4

DO NOT COPY

KALAJA E BILISHTIT
-Korçë-



1



2

KALAJA E GAJTANIT
-Shkodër-



3

KALAJA E PODGORIES
-Korçë-



4

DO NOT COPY

DO NOT COPY



KALAJA E BELLOVODES
-Korçë-





FRAGMENT MURI

Kalaja e TRAJANIT







DO NOT COPY

KALAJA E DRISHTIT - *Shkodër* -



1



2



3

KALAJA E MBOLANIT
- *Berat* -





4

DO NOT COPY

KALAJA E VENTROKUT
Korçë





DO NOT COPY



Fragment muri

Akrolis · PAMJE E PERGJITHËSHME





Fragment muri



DO NOT COPY

DO NOT COPY



Δ Vënd-banime të hekurit të herëshme.
1 Mur i periudhës së parë të hakurit.
2 Fortifikim i periudhës së vonë antike

1

MURI
I
ZVEZDES
- KORÇË -

KALAJA E GANJOLLES
- *Shkodër* -



2 FRAGMENT MURI

KALAJA E BUTRINTIT
- *Sarandë* -



3 FRAGMENT MURI

DO NOT COPY





FRAGMENT MURI I KALASE SE Kalivosë"


GRADISHTA E SHUECIT
KALAJA E VENTROKUT
TRENI
MURI I MOKUT
0 500 1000 M


GRADISHTA E SHUECIT -Korçë-
Ligeni i prespës vogël
0 20 40 60 m
3 M
PROFILI I LEDHIT



DO NOT COPY


1
0 50M
2
3
0 10 20 30 40 50M
4
0 10 20 30M
5
0 10 20 30 40 50M
6
0 10 20 30 40 50M
7
0 10 20 30M
8
0 144 288M

DO NOT COPY

Gjerak KARAISKAJ

DO NOT COPY

LES FORTIFICATIONS PREHISTORIQUES EN ALBANIE

RESUME

Comme en Europe centrale et méridionale, chez nous aussi les fortifications plus anciennes remontent jusqu'au néolithique. De leur nombre nous connaissons actuellement deux types de remparts, les remparts de pierres et ceux de bois. Le premier type nous le retrouvons sur des collines de formation rocheuse et le deuxième dans la zone plate.

La fortification plus ancienne à remparts de pierres fut mise au jour dans le village de Kamnik, district de Kolonja. Elle cernait une petite agglomération surplombant une colline rocheuse à l'entrée du village, que les habitants du pays appellent «Shkëmbi i Kamnikut» (= Roche de Kamnik).

Par suite des fouilles archéologiques effectuées dans les années 1969-1970 fut mise au jour un rempart défensif, sur le flanc de la colline. Il était construit de pierres cassées et disposées en tas l'une sur l'autre, sans aucun lien entre elles et sans créer la face latérale. La largeur maximale de ce rempart est de 1,70 m et sa hauteur actuelle de 0.40 m. Du point de vue chronologique, il se rattache à la couche culturelle plus ancienne de l'agglomération, soit à la phase plus ancienne du Néolithique récent, les années 2800-2700 av.n.è. L'autre type de fortification fut découvert à la suite des fouilles archéologiques effectuées à Maliq de Korçe, où, entre autres, fut mis au jour une agglomération de type palafitte. Cette agglomération était cernée par un rempart comportant deux rangées de poutres enfoncées dans la terre et fendillées en leur milieu, disposées l'une à côté de l'autre, alors que l'espace libre entre les deux rangées était rempli de terre tassée.

Ainsi ce dernier rempart avait une largeur allant de 0,70 à 0,80 m et cernait une surface en forme d'ellipse, comme cela ressort de la découverte de ses deux extrémités arrondies. Sur la base du matériel archéologique récupéré, il ressort que cette agglomération fortifiée appartient au néolithique, c'est-à-dire environ les années 2600 av.n.è.

Puis des remparts de pierres et de troncs mis en place pour créer un obstacle quelconque, on est passé à la construction de vrais murs défensifs de pierres qui étaient de beaucoup plus solides, plus hauts et rendaient par conséquent plus difficile l'attaque éventuelle de l'ennemi. Cette évolution, sans toutefois renoncer aux remparts habituels, s'est probablement réalisée chez nous vers la fin du bronze moyen et s'est cristallisée dans la dernière période du bronze et surtout dans la première période du fer, du fait qu'au cours de ces périodes l'existence des murs de pierres était désormais un fait réel. Ce qui est confirmé par les résultats des fouilles effectuées à l'agglomération fortifiée de Dedejan (district de Përmet). La fortification de Dedejan cerne la partie non protégée d'une colline peu haute, dont un flanc est fortement escarpé. Les murs d'enceinte cernent une surface d'envion 1 ha et forment des sections entourant des terrasses échelonnées sur le flanc légèrement incliné de la colline, où l'on a relevé des traces d'habitations en murs de pierre. Les murs défensifs sont larges de 1,80 à 3 m et construits avec des pierres non travaillés de dimensions petites et moyennes, dont la longueur ne dépasse pas les 0,40-0,50 m. Le parement du mur descend en pente vers le terrain. Les différentes sections de la fortification qui entourent la partie supérieure de la colline et les deux terrasses qui se trouvent dans sa partie inférieure sont reliées entre elles par des entrées étroites d'une dimension de 0,80-1,0 m. A cette même période appartiennent aussi deux autres fortification à remparts de pierres. Au cours de fouilles archéologiques effectuées à Gradishte de Symizë, district de Korça, afin de mettre au jour son mur d'enceinte, le long du contour naturel de la colline fut découverte une ligne de pierres de dimensions moyennes et petites, jetées en tas et ne créant pas une face latérale. Ce rempart, d'une largeur de 1,5 m, était relié à l'ancienne couche de l'agglomération qui date le bronze récent (1500-1200 av.n.è.).

La même technique se retrouve à la forteresse de Marshej, district de Shkodër (Tab. I). Celle-ci se dresse sur une colline rocheuse à proximité du village de Marshej et ses flancs sont assez escarpés (Tab. I, 2). En direction Nord, cette colline se relie à travers un col assez haut à la chaîne de collines avoisinantes. A son sommet se trouve une petite place, d'une dimension de 50 x 60 m, cernée d'un rempart à planimétrie elliptique. Ce rempart suit une ligne ondulée, dont toute la longueur est conservée actuellement; il est construit de pierres de dimensions petites et moyennes, disposées en tas les unes sur les autres (Tab. I, 4). Par endroits, entre les roches, on a jeté des pierres

pour remplir les vides, tandis que l'entrée est constituée par le flanc d'un roc et l'extrémité du rempart. Le col reliant cette colline aux collines avoisinantes est fermé du côté plus accessible par un mur rectiligne d'une longueur de 90 m, construit selon une technique plus avancée (Tab. I, 1, 3). Il est large 2.70 m et comporte deux faces en pierres non équarries, sans liant et dont l'intérieur est rempli de pierraille. Ce mur appartient à une deuxième période de construction. La forteresse de Marshej est l'unique fortification du pays où l'on relève nettement deux techniques préhistoriques, le rempart et le mur de pierres, et où est entièrement conservée une fortification appartenant au premier type.

Bien qu'on n'ait pas encore effectué des fouilles dans cette agglomération, la technique et la présence de deux périodes de construction nous induisent à aboutir à la conclusion que la fortification à rempart doit appartenir à la période du bronze. Des matériaux appartenant au bronze récent et au commencement de l'âge du fer ont été également retrouvés dans une autre agglomération fortifiée, à la forteresse de Gajtan, toujours dans le district de Shkodër.

La fortification de Gajtan, avec ses murs puissants, témoigne d'une facture plus avancée par rapport aux constructions précédentes; elle indique en tant qu'époque les débuts de la première période du fer. Dans la première période du fer la différentiation sociale avait accompli des pas importants par rapport à la période du bronze, ce qui entraina l'intensification des conflits et l'avidité toujours plus grande d'un groupe de personnes à s'enrichir aux dépens des autres. C'est au cours de cette période que les fédérations de tribus se consolident et que la guerre de rapine entre les tribus ou les fédérations devient un phénomène courant. Ce qui a été entièrement confirmé par les données archéologiques. Pendant la période du bronze le fait d'ensevelir les morts avec leurs armes est un phénomène sporadique, tandis que pendant la première période du fer il devient un phénomène courant. C'est justement au cours de cette période que l'on relève une intensification des fortifications et le progrès de leur technique de construction. On construit même des systèmes de fortifications pour des régions particulières, ce qui correspond du point de vue de l'évolution sociale à la consolidation des fédérations de tribus.

Les fortifications de la première période du fer (1200-500 av.n.è.) se distinguent entre elles par la forme de leur planimétrie qui est en corformité au terrain, par leur technique de construction et par certains autres éléments, qui, dans leur ensemble, nous permettent de tracer une chronologie approximative et de suivre jusqu'à un certain point leur évolution.

Les formes plus simples de fortifications en murs de pierres sont celles où la muraille cerne seulement la partie moins protégée de la colline et que ses parties jouissant d'une suffisante protection naturelle, exemple le côté escarpé de la roche ou celle tombant à pic sur le terrain, ne sont pas fortifiées. Des exemplaires de ce genre abondent chez nous. Un des types le plus représentatif, qui a été aussi l'objet de fouilles archéologiques, est la fortification surmontant la grotte de Tren, dans le district de Korçe, et qui date le début de l'âge du fer.

Des systèmes de fortifications semblables à celui de Tren, mais s'élevant à des altitudes de beaucoup supérieures, ont été identifiés dans d'autres régions du pays. De leur nombre mentionnons la Forteresse de Ganjollë (Tab. VIII, 2), district de Shkodër; la Forteresse de Qytet, Maja e Shenmërisë et la forteresse de Bodin, district d'Elbasan. D'une planimétrie particulière est la fortification de Marshej, où un mur rectiligne cernait en forme de barrière la partie moins protégés du col reliant les deux collines. Une des formes de fortifications plus répandue est celle circulaire ou plutôt ovale, où le mur cerne le contour naturel des collines dont les versants ont une inclinaison égale ou les plateformes naturelles surmontant ces collines. Exemple typique la forteresse de Bilisht (Tab. II, 1, 2), où la céramique recueillie à la surface ne dépasse pas la première période du fer (1200-800 av.n.è.). D'une planimétrie analogue sont les Forteresses de Kakaç et de Gjonomadh, district de Korçe, la Forteresse de Hollm, district d'Ersekë, et autres. Chez cette dernière le mur d'enceinte cerne une surface de forme elliptique, qui comprend la partie supérieure d'une colline à deux sommets qui sont séparés par un col assez haut.

Dans certains cas la partie plus protégée de la plateforme de la colline, cernée de murs, était divisée par un mur transversal en créant une sorte d'acropole qui servait d'abri ultime et, peut-être même, de résidence à l'aristocratie tribale. Deux fortifications semblables, qui se distinguent cependant par leur formule planimétrique, sont la Forteresse de Bellovode (Tab. III) et la Forteresse de Podgorice (Tab. II, 4). Chez cette dernière l'acropole n'est pas le résultat de la séparation d'une partie de la fortification par un mur comme à Bellovode, mais il constitue une enceinte indépendante.

Une autre solution planimétrique des fortifications à acropole est celle où les murs d'enceinte constituent des cercles concentriques. Le premier cercle couvre le sommet de la colline, tandis que le cercle plus grand cerne ses versants. Exemple la forteresse de Hadëraj, district de Vlore, la forteresse de Lumalas, district de Korçe et, jusqu'à un certain point, la forteresse de Bllace, district de Pogradec, qui surplombe une colline à deux sommets qui sont protégés par des fortifications indépendantes faisant part d'une grande muraille commune.

Et en dernier lieu nous avons des fortifications mises en place sur le versant de la colline. On constate cela lorqu'un des flancs de la colline tombe en pente douce et créent ainsi des terrasses appropriées à la construction d'habitations, et que l'autre flanc tombe à pic et constitue de la sorte une protection naturelle. Ce type de fortifications se caractérise toujours par deux ou plusieurs murs d'enceinte. Les murs engendrent des demi-cercles successifs reposant sur une base commune ou diverses sections s'adaptant au terrain et aux nécessités des défenseurs. En partant des formes les plus simples pour arriver à celles plus complexes, mentionnons successivement la Forteresse de Drisht (Tab. V), district de Shkodër, la Citadelle de Karos,

BONTOBY

district de Vlore et la forteresse de Trajan, district de Korçe (Tab. IV).

La Forteresse de Trajan (Tab. IV) représente le type le plus complexe à plusieurs enceintes, qui couvrent en même temps une surface assez étendue (22 ha).

Les agglomérations fortifiées ayant plusieurs murs d'enceinte sont un trait caractéristique des fortifications illyriennes appartenant à la période ancienne. En Grèce elle cernait généralement le sommet de la colline, remplissant ainsi la fonction d'un acropole.

Les agglomérations protégés par plusieurs rangées de murs comportant différentes murailles sont une caractéristique pour l'ensemble du territoire illyrien; en effet, nous les retrouvons tant dans l'Illyrie méridionale, que dans ses régions centrales et septentrionales. Une attention particulière mérite l'agglomération fortifiée de Stiçnas (Tab. XI, 8), en Slovénie, couvrant une surface égale à celle de Trajan (23 ha) et comportant trois rangées de murs. Conçue et projetée dès le début dans toute sa grandeur, elle date la fin du VIIIe siècle av.n.è.

Bien que la forteresse de Trajan n'ait pas encore été l'objet de fouilles archéologiques, certains objets retrouvés à sa proximité et appartenant à un tumulus datent une période allant du VIIIe au VIIe siècles avant notre ère.

Un autre type de fortification se rangeant parmi les constructions défensives en murs de pierres est la forteresse à «tumulus limitatif» de Ventrok.

Ce qui frappe l'attention dans cette fortification ce sont deux amas créés artificiellement avec des petites pierres et de la terre, entourés à leur base par un mur sec dont la hauteur est égale à celle de deux à trois rangées de pierres. Un de ces amas se situe à l'extrémité septentrionale de la colline, juste au point où celle-ci se relie à la colline avoisinante à travers un col. L'autre amas se trouve au milieu de la forteresse, en la séparant en deux parties qui communiquent difficilement entre elles. Cet élément de défense, que l'on rencontre pour la première fois chez nous, connaît une vaste diffusion dans les fortifications des régions septentrionales et centrales de l'Illyrie. Ces objets architectoniques ont depuis longtemps attiré l'attention des hommes d'étude, qui leur ont donné divers appellatifs selon le rôle qui leur était attribué: «tumulus défensif», quand ils envisageaient tout d'abord la fonction stratégique de la fortification ou «tumulus limitatif», quand ils avaient en vue leur fonction de séparation de la colline fortifiée de la colline ou de la montagne mère. Il y a même des hommes d'étude qui pensent que ces tumuli avaient un caractère marqué de culte. En considération de leur fonction de défense et en même temps de séparation comme à Ventrok, où ils divisent en deux cette fortification, ont sous leur contrôle le sentier mettant en communication ces deux sections et remplissent, en même temps, une fonction de séparation de la colline mère, nous avons opté pour ces objets architectoniques le terme de «tumulus limitatif».

Si en Bosnie-Herzègovine le caractère de ces constructions n'a pas encore été défini définitivement ou on leur attribue plusieurs fonctions, dans la région centrale des Japodes (Croatie), par contre, leur caractère défensif est solidement documenté. On les retouve aux entrées des citadelles, souvent en paire et reliées aux extrémités des murs d'enceinte, ou bien elles se substituent à un mur ou une barrière défensive dans les parties moins protégées du terrain. A la suite d'une coupe effectuée à un «tumulus», il a été constaté qu'il comportait une couche de terre haute de 2 m et couverte d'une couche de pierres ayant une épaisseur de 0,5 m.

Certains éléments qui montrent une évolution des systèmes de défense préhistoriques nous les retrouvons à Acrolis (Tab. VII) et dans l'ancienne fortification de Butrint. C'est ici que pour la première fois la ligne des murs, destinés à une protection latérale, se caractérise par des turnants plus ou moins à angle droit.

A Akrolis, qui surplombe une haute colline rocheuse à l'est de la ville de Lezhe, on relève deux turnants semblables des murs. Le peu de traces conservées du mur préhistorique (Tab. VIII, 3), à l'Acropole de Butrint, appartient justement à un tournant à angle droit que fait la ligne de ce mur. Les pierres de la face extérieure sont légèrement équarries afin d'obtenir une jonction meilleure que celle des pierres non travaillées, ce qui n'est pas le cas de fortifications citées jusqu'à présent. Les fortifications ayant un tracé dentelé appartiennent à une époque plus récente. En Grèce cet élément s'est manifesté pour la première fois aux VIIIe-VIIe siècle av.n.è. et il a connu sa plus vaste diffusion seulement au cours du Ve siècle. Les plus anciens objets archéologiques mis au jour à Butrint appartiennent aux VIe-Ve siècle av.n.è.

Une évolution plus marquée des fortifications de cette période se retrouve dans la forteresse de Mbolan, district de Berat (Tab. V, 4); par sa formulation planimétrique et par certains éléments défensifs, elle représente une phase de passage de la première à la deuxième période du fer.

Cette forteresse se rattache aux fortifications de la première période du fer par sa technique de construction en pierres non travaillées et par l'absence de tours, et à celles de la deuxième période du fer par les tournants à angle droit pour défendre les entrées ou pour modifier la direction du mur, par le caractère linéaire des murs et par le travail grossier des faces extérieures des pierres.

A cette même période de temps appartient aussi la forteresse de Kalivos, district de Sarande, où la muraille cernant les autres parties de la colline est construite avec de grands blocs de pierres, légèrement équarries et ne se joignant pas bien, tout comme les murs anciens de Butrint. Dans cette fortification ont été mises au jour deux entrées, dont l'une, large de 2.50 m, est protégée par un couloir intérieur créé par deux murs parallèles, auxquels on y accède par des escaliers. L'autre entrée, large de 1.80 m, est également pourvue d'escaliers.

La forteresse de Kalivos n'a pas encore été explorée entièrement, mais des données dont nous disposons il apparaît clairement qu'elle représente un niveau de développement plus éle-

DOMJOB

DOKTORSKY

vé par rapport aux précédentes fortifications préhistoriques non seulement quant à sa technique de construction en pierres mi-travaillées, mais encore par le mode de défense de ses entrées et par la présence des escaliers.

Un type de fortification à part est le mur-barrière de Zvezde (Tab. VIII, 1), qui avait un caractère exclusivement stratégique. Il clôture le col de Zvezde, qui en fait représente une voie mettant en communication la plaine de Korça avec les territoires s'étendant à proximité du lac de Prespe e Madhe, ainsi qu'avec la Macédoine. Ce mur descend des deux versants des collines longeant la route, en bloquant cette dernière aussi. Long de 550 m et large de 2,20 à 3 m, il est en pierres non équarries de dimensions moyennes et petites disposées à sec.

Presque au milieu de ce mur on relève une ligne de grosses pierres, qui la traverse en direction longitudinale. S'il ne s'agit pas d'une particularité de sa technique de construction, nous avons affaire alors à une deuxième phase de construction dans le but d'augmenter l'épaisseur du mur dans sa partie interne. Ce fait montre que le besoin de ce mur s'est fait sentir pendant longtemps et qu'il a subi maintes réparations. La moitié du IVe siècle av.n.è correspond à la fin de cette période, alors qu'entre ces «deux lacs passaient le confin avec la Macédoine» et cette dernière était devenue avec Philippe II une puissance ayant des visées expansionnistes. Pendant la période hellénistique on continue à construire de pareils murs, exemple le mur de Deme dans la presqu'île de Ksamil chez nous. Il est certain que le mur de Zvezde constitue l'exemple le plus ancien de ce type de construction dans notre pays et, peut-être même, dans les autres territoires de l'Illyrie. Par la construction du mur de Zvezde fut portée à terme le système de fortifications pour toute la région du bassin de Korçe. Ce mur même témoigne de la présence de ce système, dont la formation graduelle s'est conclue à une étape donnée de développement économique et social. Cette étape correspond plutôt à la période de naissance des fédérations tribales, qui furent créées tout d'abord par les tribus des Enchéléens et des Taulantes dès le VIIe siècle av.n.è.

Désormais le but principal n'est plus la défense d'une agglomération du voisin plus proche, mais celle d'un groupe d'agglomération qui ont organisé une résistance face à l'ennemi extérieur. Cela est confirmé aussi par la présence d'agglomérations non fortifiées à l'intérieur de cette ceinture de fortifications, comme le sont Barçi et Kuçi i Zi dans la plaine de Korçe, mais ces derniers sont plutôt limités en nombre du fait que l'aglomération fortifiée était désormais devenue l'agglomération caractéristique de cette période.

Les systèmes de fortification pour des régions particulières sont aussi le fait des régions centrales et septentrionales de l'Illyrie. Le plateau de Glasinac (Bosnie), dotée d'une puissante défense naturelle, est entourée aussi par une chaîne de fortifications systématique et par des agglomérations fortifiées qui occupent les hauteurs dominantes, ferment les passages stratégiques et les gorges des vallées. En Slovénie et en Croatie ont été identifiés des systèmes de fortification pour la défense de vastes plateaux. Ces fortifications surplombent les hauteurs dominantes ou les passages stratégiques, où l'on retrouve aussi des murs type barrière. Ils ont rempli un rôle important dans la défense de ces régions même pendant les guerres soutenues contre les armées de l'envahisseur romain.

D'un intérêt particulier est aussi le système de fortification mis en place autour du plateau de Duvno (Bosnie), dans le territoire habité par la tribu illyrienne des Delmates où se trouvent 37 forteresses.

Les fortifications à rempart de terre n'ont qu'un seul exemplaire chez nous, qui se situe à proximité du village de Shuec, district de Korçe, et connu par les habitants du pays sous le nom de «Gradishta e Shuecit». Long de 600 m, il est construit avec de petites pierres, du gravier et de la terre. Sa section représente un trapèze haut de 2 m et dont la grande base a une dimension de 10 à 11 m et la petite base une dimension de 3 m.

Sa petite hauteur présuppose l'existence d'un système de palissade dans sa partie supérieure, afin d'en garantir la défense. A l'intérieur de l'enceinte on n'a pas trouvé de céramique, ce qui montre que Gradishta ne servait que d'abri en cas de péril aux habitants de la plaine, où l'on a récupéré de la première période du fer et identifié deux collines-tombeaux, dans l'une desquelles fut trouvé un bracelet de bronze datant les années 800-700 av.n.è.

Gradishta e Shuecit et la fortification de Ventrok marquent le confin plus méridional des types qu'elles représentent. La Grèce n'offre pas des exemples similaires. Quant aux fortifications à rempart de terre, comme celle de Gradishta de Shuec, elles connaissent une vaste diffusion même au-delà des territoires septentrionaux de l'Illyrie.

Tant sur le plan de la technique de construction de son rempart que sur le plan de celle de sa palissade, Gradishta e Shuecit se répète par de nombreux exemples dans les contrées centrales et septentrionales de l'Illyrie. Cette tradition y fut conservée pendant un long temps, jusqu'à l'occupation romaine du pays.

Un des principaux éléments constitutifs des fortifications préhistoriques sont les entrées. Dans la majorité des cas chaque forteresse n'a qu'une entrée, ou une entrée pour chaque section quand elle comporte deux murailles et même plus. Le nombre restreint des entrées indique qu'elles constituaient un point délicat de la défense et que leur couverture présentaient des difficultés techniques. La plupart des entrées sont étroites, leur largeur variant de 1,2 à 1,8 m. Rares sont les cas quant cette largeur atteint les 2,50 m et même plus, comme à Kalivo et Mbolan dont les fortifications appartiennent à une période postérieure. La Gradishta e Suecit (2.50 m), construite selon une technique différente, fait exception à la règle. Dans les limites du premier diapason 1.20 – 1.80 m, les différences de largeur sont principalement une conséquence des exigences et des moyens de

DO NOT COPY

communication. Pour ce qui est du second groupe, cela dépend aussi des possibilités techniques concernant leur couverture.

Une autre préoccupation des bâtisseurs préhistoriques fut aussi, naturellement, le mode de protection des entrées. A cette fin ils mirent à profit la nature du terrain, en lui adaptant le mode de construction; cependant, dans certains cas, les constructeurs n'ont pas accordé une attention particulière aux entrées, ou ont mis à profit les deux premières possibilités.

La plupart des entrées appartiennent au premier groupe. Elles étaient construites dans la partie plus escarpée du terrain, contraignant de la sorte les assaillants à faire à pied une partie du trajet le long du mur d'enceinte, comme à Gajtan, Shuec et à la citadelle de Karos. En deux cas seulement les entrées sont protégées par un couloir intérieur, limité par deux murs parallèles des deux côtés de la porte. Ces murs forment des angles droits avec le mur d'enceinte (Kalivos) ou prennent une forme arquée (Acropole de Zgërdhesh). Mentionnons encore l'entrée de l'Acropole de la forteresse de Mbolan, qui est protégée par une saillie à angle droit du mur se trouvant sur le côté gauche découvert (non protégé par un bouclier) des assaillants, selon les règles de la stratégie antique. Ce dernier type de porte a connu une vaste diffusion et a subi des améliorations plus récentes. Un type de grand intérêt représente l'entrée de la forteresse de Dedejan. Pour entrer dans cette agglomération fortifiée, il faut tout d'abord traverser le couloir étroit et long constitué par les deux murs d'enceinte des terrasses, qui, bien que construits à la même hauteur de l'inclinaison du versant de la colline, sont entourés chacun par un mur particulier.

Les entrées des fortifications préhistoriques, situées dans les régions centrales et septentrionales de l'Illyrie et où l'on relève une prédominance des fortifications à rempart, se caractérisent également par une variété de formes et de modes de protection. Ce qui attire sur tout l'attention dans ces ouvrages défensifs ce sont les grandes dimensions des entrées allant jusqu'à 5 m. Il est compréhensible qu'en ces cas elles manquaient de couverture ou celle-ci était en bois. En ce qui concerne les principaux modes de défensé des entrées, on peut les grouper en trois: 1) Entrées simples constituées par l'intersection verticale du rempart ou du mur d'enceinte. On les retrouve à plusieurs variantes: une ou trois rangées d'entrées successives dans la même direction, avec en plus un rempart auxiliaire par devant le rempart principal, (Tab. XI, 4); 2) Entrées obliques, où le rempart est interrompu obliquement afin de créer un couloir le plus long possible, (Tab. XI, 3); 3) Entrées tangentielles ou latérales. Celles-ci sont le résultat du déplacement parallèle des deux extrémités du mur ou du rempart, de façon à créer un couloir entre eux (Tab. XI, 1); 4) Entrées protégées sur un seul flanc par le prolongement latéral du rempart (Tab. XI, 5). Ces constructions ne servaient qu'à une défense passive dans une seule direction, si les conditions du terrain permettaient une telle chose. Une variante plus évoluée de ce type nous l'avons dans la fortification de Debelobido (Tab. XI, 6), qui constitue une combinaison des entrées protégées sur un seul flanc et des entrées tangentielles. Ici l'entrée est protégée non seulement par le prolongement latéral d'un des remparts mais aussi par un couloir très long et incliné, qui est créé par le mur d'enceinte et par un mur intérieur presque parallèle à celui-ci, qui débute sur l'un des côtés de l'entrée. Ce deuxième mur servait aussi à mieux défendre toute l'agglomération du côté où la protection naturelle était moins faible; 5) Un autre type est celui des entrées protégées par des «tumuli limitatifs» (Tab. XI, 2), ou par l'élargissement des deux extrémités du rempart limitant les entrées. En ce cas les tumuli limitatifs remplissent plus ou moins la fonction des tours et nous rappellent les entées flanquées de deux tours latérales, méthode défensive largement utilisée pendant l'antiquité et le moyen âge. Et enfin mentionnons l'entrée de la fortification de Bjelosaliq à Glasinac, protégée par les deux prolongements latéraux extérieurs et les deux autres intérieurs du rempart, en créant de la sorte une cour fortifiée entre eux (Tab. XI, 7). Bien que d'une technique plus primitive par rapport aux fortification en murs de pierres, ces ouvrages défensifs à rempart attirent l'attention par leur conception évoluée pour l'époque, quant à la défense d'un élément si délicat comme le sont les entrées des fortifications de toutes les périodes.

Dans les ouvrages plus anciens à rempart ou en murs de pierres de chez nous (néolithe-bronze), les pierres sont de petites dimensions, les remparts n'ont pas une largeur supérieure à 1,70 m alors que les murs dépassent cette largeur. Dans le courant de la première période du fer, on relève en général un accroissement tant de l'épaisseur des murs que de la dimension des pierres même employées pour la construction de leur parement. Les pierres employées pour la construction du parement des murs, pendant la première période du fer, ont une dimension moyenne de 1 m pour la longueur et de 50 à 60 cm. pour la hauteur, mais parfois leur longueur dépasse les 2 mètres. La majorité des fortifications ont une largeur des murs variant de 3 à 3.5 m, d'autres ont une largeur de 2 à 3 m; en deux cas seulement la largeur des murs est de 1,40 m et de 4 m. En dépendance des formations rocheuses stratifées, la hauteur des pierres est parfois assez réduite (0.20 m). Les pierres du parement créent des vides considérables à leur jointure, et souvent ces vides sont remplis de pierraille. En général les murs ont un parement vertical, mais à la forteresse de Dedejan, de Ventrok, de Kalivos et de Mbolan le parement extérieur des murs est incliné. Cela n'a aucune importance chronologique, du fait que nous sommes en présence d'une particularité que l'on retrouve tant dans les fortifications plus anciennes de cette période que dans celles plus récentes. La principale distinction quant à la technique de construction concerne les murs en pierres non équarries et ceux en pierres peu travaillées et créant une jointure meilleure. Cette dernière technique indique une nouvelle conception dans la construction des murs ainsi qu'un perfectionnement des outils de travail. Mais le plus important ici est le fait que cette technique nous la retrouvons dans des fortifications qui, par d'autres éléments de la construction, datent une période de temps plus récente, comme c'est le cas de Butrint,

de la Forteresse de Kalivos et de Mbolan. Malgré cela la technique de construction en pierres non travaillées occupe un diapason de temps beaucoup plus étendu que la technique précédente. Et cela en raison des conditions économiques particulières des différentes agglomérations, ce qui a permis la coexistence de ces deux techniques; mais parfois la technique à pierres non équarries fut employée aussi pendant des périodes de temps plus récentes. La technique de construction des fortifications de l'Illyrie centrale et méridionale présente des particularités qui la distiguent de celle de l'Illyrie du Sud.

L'évolution des fortifications préhistoriques de notre pays peut être envisagée en trois directions principales: la technique de leur construction, leur formulation planimétrique et la construction de leurs entrées. Notamment quand nous avons affaire à une combinaison de certains de ces éléments, lorsque ceux-ci appartiennent à un niveau de développement plus élevé, nous sommes enclins à dater certaines fortifications, comme celles de Butrint, de Kalivo et de Mbolan, aux derniers siècles de la première période du fer (environ les années 700-500 av.n.è.).

En ce qui concerne la destination de ces fortifications, nous pouvons les répartir en agglomérations fortifiées, qui englobent la majorité des fortifications de notre pays, en lieux d'abri qui sont utilisés en cas de péril et en constructions stratégiques dans le vrai sens du terme, comme c'est le cas du mur-barrière de Zvezde.

Si nous incluons dans cette classification les fortifications des autres régions de l'Illyrie aussi, nous y trouverons des ouvrages défensifs destinés uniquement à l'observation, voire même certains d'entre eux étaient employés comme abri des animaux en cas de péril ou comme édifices du culte. Dans cet ouvrage nous n'avons pas mentionné toutes les fortifications préhistoriques du pays, mais uniquement celles qui nous sont apparues plus caractéristiques, et cela afin de permettre aux lecteurs de se faire une idée de leur typologie et de leur évolution.

DO NOT COPY

Emin RIZA

VËSHTRIM MBI URBANISTIKËN E QYTETIT SHQIPTAR (Shek. XII – XX)

DO NOT COPY

Qëllimi i këtij artikulli është të japë një panoramë të përgjithshme të zhvillimit urbanistik të qytetit shqiptar, brënda kufijve të sotëm politikë, prej shek. XII deri në zhvillimin e marëdhënieve kapitaliste, pra afërsisht prej shek. XII-XX. Materiali mbi të cilin mbështetet kjo panoramë për periudhën e hershme deri në shek. XVII i përket burimeve dhe trajtimit të kësaj problematike nga autorë të ndryshëm, kryesisht historianë, të cilët në mënyrë anësore kanë prekur dhe çështje të zhvillimit dhe karakterit urbanistik të qyteteve tona. Natyrisht këto të dhëna janë relativisht të pakëta dhe vështirësojnë dhënien e një kuadri të plotë dhe të saktë të zhvillimit të qytetit shqiptar të kësaj periudhe. Veçanërisht të mangëta janë burimet, apo punimet që prekin gjendjen e qyteteve shqiptare gjatë shekujve XII-XV, periudhë e cila ka interesuar veçanërisht historianin M. Shufflai. Ky autor trajton kryesisht qytetet veriore, duke përfshirë këtu dhe ata që sot janë jashtë kufijve tona. Të dhënat për qytetet e brendshëm të kësaj periudhe janë shumë të pakëta. Pas pushtimit turk, duke filluar prej shek. XVI dhe veçanërisht shek. XVII. të dhënat vinë e shtohen, ndërsa për gjendjen e qytetit shqiptar gjatë shek. XVIII-XIX të dhënat janë mjaft të plota, pasi mjaft qendra ruajnë ende sot plotësisht, apo pjesërisht karakterin e urbanistikës së vjetër, e cila si vlerë e rëndësishme kulturore, në mjaft raste, ruhet dhe mbrohet në cilësinë e monumentit.

Gjatë shek. XII-XIV, qyteti shqiptar njohu një rritje të vazhdueshme si pasojë e zhvillimit të forcave prodhuese. Një zhvillim të mirë mori zejtaria, e cila u favorizua dhe nga mundësia që fshatarët të shkëmbenin prodhimet bujqësore e blegtorale me prodhimet e zejtarëve. Në këtë drejtim ndikoi dhe politika fiskale e shtetit bizantin, i cili në gjysmën e parë të shek. XI, e zëvëndësoi taksën në natyrë të fshatarëve me taksë në të holla[1]. Gjallërimi i tregtisë ndërmjet zonave bregdetare shqiptare me qytetet e brigjeve të Adriatikut si Venediku, Raguza etj., gjithashtu i dhanë shtytje ngritjes së qyteteve mesjetare në Shqipëri[2].

Qyteti i shek. XII-XIV ishte një qendër zejtaro-tregtare, e cila kryente dhe funksionin e tregut për krahinat përreth. Ekonomia e mbyllur natyrore, detyronte banorët e qytetit, që të ushtronin pjesërisht dhe bujqësinë, kulturat frutore dhe blegtorinë, siç dëshmojnë trojet relativisht të gjera, rreth qyteteve, të cilat ishin në pronësi të tyre[3]. Ndër qytetet e kësaj periudhe një vend të rëndësishëm zënë qytetet bregdetare si Shkodra, Durrësi dhe Vlora, të cilët kryenin tregti dhe me viset përtej detit si dhe qytetet e bregut Dalmatin, deri në Venedik. Kjo binte si pasojë dhe zhvillimin e mjeteve të lundrimit, të cilat përbënin një fushë të rëndësishme në jetën ekonomike të qyteteve. Peshkimi dhe sidomos kriporet, i jepnin të ardhura të mëdha qytetit. Zhvillimi ekonomik i qyteteve, theksoi më tepër diferencimin klasor të banorëve të tyre. Qytetarët sipas pozitës së tyre ekonomike ndaheshin në popullorë (populares), qytetarë (cittadini) e fisnikë (nobiles). Në radhët e popullarëve, bënin pjesë shtresat e varfëra të qytetit si kallfët, çirakët, punëtorët e krahut, hamejt etj., në radhët e qytetarëve hynin shtresat e mesme, që zakonisht kishin një pronë të vogël. Këta përbënin shumicën e popullsisë. Ndërsa në shtresën e lartë të dhët e popullorëve, bënin pjesë në shtresat e varfëra të

1) **Historia e Shqipërisë,** Vol. I, Tiranë, 1959 fq. 184.
2) Po aty, fq. 184.
3) M. Šufflay, **Stadte und Bürgen Albaniens hauptsachlich wahrend des mittelalters** Wien und Leipzig, 1924, fq. 40.



Fig. 1

tarë, tregtarët e mëdhenj, pronarët e pasur të tokave në juridiksionin e qytetit etj.[4]

Radhët e shtresave të varfëra të popullsisë i shtonin vazhdimisht fshatarët e shpronësuar ose bujkrobërit e arratisur të cilët vinin në qytet për punë si mëditës të thjeshtë[5]. Ndër zejtaritë kryesore që ushtroheshin, ishin ato të përpunimit të lëkurëve, të endjes së mëndafshit, argjendaria, poçeria, të përhapura qenë gjithashtu mjeshtëritë e kovaçëve, furxhive, kasapëve, këpucarëve etj. Aristokratët përveç nëpunësive të larta, kishin në dorë edhe tregtinë. Veçanërisht në Shkodër dhe në Durrës u krijua një aristokraci tregtare e fuqishme me që këta qytete ishin ndërmjetës të tregtisë me krahinat e brendshme të vendit.

Shkatërrimi i shtetit të Bizantit pruri pasoja në marëdhëniet ndërmjet qyteteve dhe feudalëve që zotëronin hapësirat në kufi me pronat përreth qyteteve. Këta të fundit kërkonin shuma të hollash për të siguruar tokat e qytetit. Lidhur me marrëdhëniet e qyteteve me fqinjët feudale, është me interes rasti i ndërtimit nga Muzakajt i një kulle në Durrës në shek. XIV[6], krahas ndërtimit të banesave të feudalëve në qytete.

Qyteti shqiptar i kohës është përgjithësisht një qendër e fortifikuar, d.m.th. e rrethuar me mure mbrojtës, të cilët janë të pajisur me hyrje dhe kulla. Pasiguria, lidhur sidomos me lëvizjet e popujve, e theksoi edhe më tepër përkujdesjen për sigurimin e qendrave qytetare të banuara nga sulmet e mundshme. Shumica e qyteteve të kësaj periudhe, ashtu si përgjithësisht ata mesjetare, janë vazhdimi i qyteteve më të lashtë, që lidhen me qendrat e fortifikuara ilire. Këta të fundit, siç dihet, ndërtoheshin në terrene me mbrojtje të mirë natyrore, me përjashtim të qyteteve bregdetare si Durrësi (fig. 1)+). Pra dhe qytetet mesjetarë, vazhdim i atyre më të lashtë, si dhe ata të ndërtuar gjatë mesjetës, si Gjirokastra, ngrihen zakonisht, mbi lartësi me mbrojtje natyrore, duke u shtrirë kështu përgjithësisht mbi terrene të aksidentuara.

Zhvillimi urbanistik i këtyre qendrave të banuara qytetare, është kushtëzuar ndjeshëm nga fortifikimi me mure rrethues. Praktikisht ky rrethim kufizonte qartë truallin brenda të cilit zhvillohej qendra e banuar, duke bërë që ngushtësia e terrenit të ishte një faktor me rëndësi i dorës së parë në kompozimin urbanistik. Pikërisht për këtë arsye ndërtimet ishin mjaft të dendura, dhe shpesh të kompozuara në formë vargu. Ato përgjithësisht dilnin drejtpërdrejt në rrugë, oborret thuajse mungonin, ose ishin tepër të vegjël. Zgjerimi i qytetit çonte shpesh dhe në ndërtime fare pranë, apo dhe mbështetur mbi muret rrethues. Ngushtësia e truallit përcaktonte dhe mbisundimin e ndërtesave me kat. Në pjesën më të mirë të qytetit, zakonisht në zonën më të lartë, ndërtonin shtresat e pasura. Qyteti në zhvillimin e tij, nuk paraprihej nga planifikimi. Rrjeti rrugor niste nga hyrjet e fortifikimit duke u shpërndarë në një numër të dendur rrugësh të ngushta e të përthyera, shtruar me kalldrëm. Shpesh për të fituar sipërfaqe banimi, praktikohej ndërtimi i qemereve mbi rrugë. Një vend i rëndësishëm në ndërtimet e qytetit, duke spikatur me volumet dhe trajtimin arkitektonik, zinin ndërtimet e kultit, të cilat ngriheshin në trojet më të mira. Nuk mungonin dhe ndërtimet shoqërore[7].

Një vend të rëndësishëm zinin në qytet dhe dyqanet e artizanëve, për të cilët nuk ka të dhëna mbi formën dhe mënyrën e ndërtimit. Pranë mureve mbrojtëse të qyteteve zhvilloheshin dhe pazaret, ku popullsia fshatare e rretheve tregtonte në shesh të hapur produktet e veta.

Zhvillimi i qytetit mesjetar shqiptar, rritja e numrit të banesave, binte si pasojë nevojën e zgjerimit të qytetit, i cili filloi të shtrihej përtej mureve rrethues. Fillimi i këtij procesi shumë të rëndësishëm, për të ardhmen e qendrave të banuara qytetare, i cili shënon lindjen e qytetit të hapur, nuk dihet me saktësi se kur filloi. Sigurisht që kjo dukuri nuk është e njëkohshme për mbarë qytetet shqiptare të kohës, sepse ajo është

4) **Historia e Shqipërisë,** Vol. I, Tiranë 1959, fq. 219, 220.
5) **Po aty,** fq. 219.
6) M. Šufflay, **Vep. Cit.** 44.
+) Fig. 1, 2, janë marrë nga monografia e Z. Shkodrës «**Esnafet shqiptarë**». Tiranë, v. 1973.
7) M. Šufflay, **Vep. Cit. 46.**

DO NOT COPY

e kushtëzuar nga zhvillimi i brëndshëm ekonomiko-shoqëror i tyre. Kështu në Berat përmendet një lagje jashtë kështjellës (suburbia castri Bellogradi) që më 1280[8]. Dalja e ndërtimeve nga muret rrethuese të kalasë së Gjirokastrës, duhet t'i përkasë gjysmës së parë të shek. XIV[9]. Më i hershëm se këto duhet të ketë qënë qyteti i poshtëm mesjetar i Lezhës.

Lagjet e jashtme të qyteteve mesjetare u quajtën, mbas shek. XV, në mbarë Ballkanin, «Varosh» (nën kështjellë). Në shumicën e tyre lagjet e jashtme ishin të pambrojtura me mure rrethues, por nuk mungonin dhe raste kur dhe këto lagje mbroheshin me mure, duke qënë këta të fundit të lidhur me muret rrethues të kalasë. Lagjet e para jashtë kështjellës, vendoseshin gjithmonë pranë kalasë, e cila në raste rreziqesh strehonte brenda saj dhe banorët e lagjeve të jashtme. Vetëkuptohet se së pari, jashtë rrethimit, u vendosën shtresat e varfëra dhe të mesme të popullsisë çka presupozon ndërtime të vogla me materiale jo të qëndrueshme. Vendosja e lagjeve të jashtme pranë kalasë, kushtëzoi dhe vendosjen e tyre në terrene të pjerrëta shkëmbore, duke ndikuar kështu në formulimin urbanistik të këtyre ansambleve. Me krijimin e lagjeve të para jashtë mureve rrethues, filloi procesi i rëndësishëm i zgjerimit të qytetit duke u vendosur një raport dinamik ndërmjet kalasë dhe Varoshit. Ky raport me kalimin e kohës është në dobi të faktorit të dytë, por deri aty nga fundi i shek. XV, ende qendra e banuar brenda kalasë mbetet pjesa kryesore, për të mos thënë vetë qyteti.

Qyteti i Shkodrës (fig. 2) paraqet një shembull interesant të zhvillimit dhe të karakterit të qytetit të kohës. Rreth kalasë së Rozafatit qyteti i poshtëm, lëviz vend disa herë, duke qenë i rrethuar me mure. Krahas këtyre lagjeve të mbrojtura kishte dhe lagje të hapura si ajo ndërmjet lumit Bunë dhe mureve të qytetit, si dhe një përtej Kirit në fushë[10]. Lezha gjithashtu gjatë kësaj periudhe paraqitet me dy njësi të veçanta, qytetin e sipërm mbi mal dhe varoshin e fortifikuar, ndërmjet qytetit të sipërm dhe Drinit[11]. Siç u përmënd, në vitin 1280 flitet për një lagje të jashtme në Berat, siç duket këtu kemi të bëjmë me ansamblin në perëndim të kalasë. Në mesin e shek. XV, lagjet e jashtme të Beratit kanë qënë të fortifikuara. Përveç këtyre qendrave dhe shumë të tjerave, të lidhura me qendra të lashta ilire, interes të veçantë paraqesin qytetet e rinj, që lindin në mesjetën e mesme. Shembulli më tipik



Fig. 2

i kësaj dukurie është lindja e Gjirokastrës në shek. XIII[12], së pari si kala dhe shumë shpejt, gjithashtu qendër e banuar qytetare, e cila shfaq dukurinë, tashmë të zakontë, të zgjerimit jashtë mureve rrethues.

Procesi i rëndësishëm i lindjes së qytetit të jashtëm, të cilit i përkiste e ardhmja, në prag të shek. XV kishte arritur ku më shumë e ku më pak një zhvillim të dukshëm, që lidhej me forcimin e qendrave qytetare në ekonominë e vendit.

Pushtimi turk pruri pasoja në zhvillimin dhe karakterin e qytetit shqiptar, i cili në prag të tij kishte arritur në një shkallë të rëndësishme zhvillimi. Krijimi i lagjeve të banuara, pranë kalave, që përgjithësisht rrethonin qytetet, kohë përpara pushtimit turk, shënonte fillimin e lindjes së qytetit të hapur. Qëndresa këmbëngulëse shqiptare karshi pushtuesve turq, që u shoqërua me fushatat shkatërrimtare të tyre, cënuan rëndë qytetet shqiptare, ashtu si mbarë vendin. Masakrimi dhe emigrimi i popullsisë qytetare, ndërprerja e lidhjeve të vjetra me Europën Perëndimore, varfërimi dhe rrënimi i përgjithshëm i vendit, i dhanë një goditje mjaft të rëndë qytetit shqiptar të kohës. Qytete dhe kështjella të lulëzuara si Drishti, Deja e Sfetigradi u shkatërruan përgjithmonë ndërsa qytete të mëdha si Shkodra, Lezha, Kruja, Durrësi, Berati, Gjirokastra, Vlora etj. u shkatërruan rëndë, duke u kthyer mjaft prej tyre në pika të fortifikuara strategjike, ku u vendosën garnizone ushtarake të pushtuesve[13]. Me pushtimin turk dhe vendosjen e regjimit

8) M. Šufflay, **Sërbët dhe Shqiptarët,** Tiranë 1926, fq. 55, 56.
9) A. Baçe, **Vështrim mbi qëndrat e banuara antike dhe mesjetare në luginën e Drinos (Gjirokastër).** Monumentet, Nr. 4, v. 1972.
10) M. Šufflay, **Stadte,** 29.
11) M. Šufflay, **Vep. cit.**
12) A. Baçe, **Vep. cit.** 122.
13) Z. Shkodra, **Esnafët Shqiptarë (shek. XV-XX),** Tiranë, v. 1973, 20.

FOTOCOPY



Fig. 3



Fig. 4

DO NOT COPY

feudal ushtarak, vendin e qyteteve të lira sipas sistemit veneto-bizantin, të mbështetur në kushtetutat qytetare dhe në këshillat bashkiake, e zunë qendrat ushtarake-administrative-fetare, të ardhurat e të cilave përfshiheshin në përgjithësi në hasset e Sulltanit dhe të sanxhakbeut. Ndryshe nga emërtimet e mëparshme të qendrave qytetare, civitas, castrum, urbs etj. administrata otomane i cilësoi qytetet me emërtimet shehër dhe kasaba[14].

Gjatë shek. XV dhe deri aty nga fillimi i shek. XVI qytetet shqiptare ishin reduktuar në qendra të vogla, që kryenin dhe funksionet e tregjeve lokale. Gjatë kësaj periudhe e vetmja veprimtari ndërtimore, me rëndësi, lidhet me ngritjen e një numëri faltoresh islame, në kapërcyellin e shek. të XV, në Korçë (fig. 3) Berat dhe Vlorë (fig. 4). Këto ndërtime dhe të tjera të këtij lloji, në shekujt e mëvonshëm do të luajnë një rol të rëndësishëm në karakterin urbanistik të qytetit, veçanërisht të atyre të ndërtuara në terrene të rrafshtë.

Shek. XVI shënoi një rritje të përgjithshme të qendrave qytetare, të cilat shtohen numerikisht, kryesisht për pasojë të popullimit me banorë të rinj të ardhur nga fshati. Një pjesë e mirë e banorëve të rinj, që u sistemuan nëpër qytete ishin zejtarë, ata largoheshin nga fshati për t'i shpëtuar shfrytëzimit të rëndë, duke shpresuar një jetë më të mirë në qytet[15]. Mbisundimi i karakterit natyror në ekonominë fshatare është ende një pengesë serioze në rritjen e qyteteve si qendra të mirëfillta zejtare dhe shkëmbimi. Megjithatë rritja e qendrave qytetare, veçanërisht nga fundi i shek. XVI ishte e dukshme.

Zhvillimi i qytetit në këtë kohë lidhet me një veprimtari të madhe ndërtimore, ku bie veçanërisht në sy ndyrtimi i banesave në lagjet e jashtme, varoshet.

14) Z. Shkodra, **Vep. Cit.,** 26.
15) **Historia e Shqipërisë** (Maket) Vëllimi I, Pjesa III fq. 28. Tiranë 1972.

Aktivizimi i zejtarisë, i dha hov tregjeve lokale dhe si pasojë e këtij zhvillimi, përbri shesheve të hapura për shitjen e produkteve bujqësore filloinë të ndërtohen ansamble dyqanesh sipas zejeve. Një veprimtari e rëndësishme ndërtimore, kryhet gjatë këtij shekulli për ndërtimin e xhamive, mesxhiteve, teqeve etj., të cilat lidheshin me përhapjen e ideollogjisë fetare të pushtuesve, e cila qe veçanërisht intensive në qytet, lidhur me synimin e pushtuesve për islamizimin e qytetarëve. Pas përfundimit të traktatit të paqes me Republikën e Venedikut, më 1502, udhëheqja feudale osmane, lidhi marrëdhënie tregtare me Perëndimin. Tepëricat e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale të feudalëve, që nuk i konsumonin dot qytetet, përbënin artikuj kryesorë të eksportit. Fuqizimi ekonomik i qyteteve lidhej me interesat e shtetit osman për të nxjerrë sa më shumë të ardhura në dobi të vet[16].

Shekulli i XVII përbën një etapë me rëndësi në zhvillimin e qytetit shqiptar, i cili hyn në rrugën e rritjes dhe forcimit ekonomik. Rritja e vrullshme demografike, shtimi i numrit të zejeve që ushtroheshin në qendrat qytetare, prunë një rritje të madhe të veprimtarisë ndërtimore në qytet. Të dhënat e rëndësishme, të Evlia Çelebiut, i përkasin pikërisht këtij shekulli. Nga pasqyra që jep ai, megjithëse në shifra të zmadhuara kuptohet qartë se qyteti shqiptar i kohës kishte pasur një rritje të konsiderueshme. Shtrirja e tij, në disa qendra të rëndësishme si Berati, Gjirokastra, Elbasani etj. kishte arritur thuajse atë, që u ruajt pak a shumë dhe gjatë shekujve XVIII-XIX, natyrisht me një dendësi më të vogël ndërtimesh. Pra qyteti kishte marrë fizionominë urbanistike që u ruajt në tiparet thelbësore dhe në shekuj pasues, duke qenë urbanistika për vetë natyrën e saj elementi më konservator, në krahasim me arkitekturën e ndërtimeve qytetare dhe veçanërisht banesës si elementi mbisundues i tyre. Gjatë këtij shekulli pazaret shndërrohen në qendra të mirëfillta jo vetëm shkëmbimi por edhe prodhimi, ata rriten duke u pasuruar në ndërtimin e dyqaneve-punishte dhe dyqaneve për shitje, që formojnë ansamble të mëdhenj në bazë mjeshtërie, kompozuar në shtrirjen karakteristike në formë vargu, përkundrejt njëri-tjetrit, në dy rreshta. Krahas dyqaneve përdhes, ndërtohen edhe ata me dy kate. Pazaret e qyteteve kryesore pajisen gjatë shek. XVII, me kulla të larta, në të cilat vendosen orë me këmbanë[17].

Gjatë këtij shekulli krahas largimit nga fshati për në qytet të shumë fshatarëve zejtarë dhe bujq, këtë rrugë filluan të ndjekin dhe një numër feudalësh të shtresave të ndryshme[18].

Fuqizimi ekonomik i qytetit solli thellimin e diferencimit klasor, i cili pëson gjatë kësaj periudhe një rritje të shënuar duke i dhënë shkas diferencimit të varianteve të banesave; si dhe shkëputjes përherë e më të dalluar të lagjeve të shtresave të pasura nga ato të varfëra. Pazari, si qendër prodhimi dhe shkëmbimi, shkëputet nga ajo e banuara, duke zënë, sipas qendrave, pozita të ndryshme karshi lagjeve të banuara. Lagjet brenda mureve rrethues, ku vazhdon të qëndrojë administrata si në Krujë, Berat etj. akoma ruajnë një pozitë me rëndësi në qytet, megjithë rritjen e madhe të pjesës së hapur të qytetit.

Shekulli XVIII shënon periudhën e lulëzimit të përgjithshëm të ekonomisë feudale në vendin tonë e cila shprehej në sistemin e esnafëve. Rritja e rolit ekonomik të qyteteve pruri në mënyrë të natyrshme krijimin e tregjeve të mëdha me karakter ndërkrahinor. Ky proçes i rëndësishëm i rritjes së qytetit shqiptar në përgjithësi u pasqyrua me zgjerimin teritorial të disa qendrave, por kryesisht me dendësimin e ndërtimit të banesave në lagjet ekzistuese. Në siluetën e qytetit të kohës fillon të spikasë dendur krahas faltoreve dhe kulla e sahatit, si një ndërtim monumental, që së bashku me ndërtimet e tjera të kultit myslimân dhe ato shoqërore, si banjat publike, medresetë etj., thekson dhe pasuron më shumë qendrën e qytetit, ku ato zakonisht ndërtohen. Por dhe çdo lagje e banuar, tashmë kishte, zakonisht një qendër të vetën, në të cilën ndërtohej xhamia e shoqëruar shpesh me hamam dhe çesmë, si p.sh. në Shkodër, Gjirokastër etj.

Shtresat e pasura, të pasuruara në saje të shfrytëzimit të punës së zejtarëve të thjeshtë, si dhe të të ardhurave nga renta e tokës, në kushtet e shthurjes të feudalizmit ushtarak në fshat, ndërtojnë banesa të mëdha, duke arritur në variantet më të zhvilluara të tipologjisë së banesës qytetare të kohës. Rritja e volumit të shkëmbimit të mallrave i dha shkas rritjes së ndërtimit të mjaft haneve, të cilët përgjithësisht ndërtoheshin pranë pazarit të qytetit.

Shekulli XIX shënon një rritje të mëtejshme të qytetit shqiptar. Gjatë kësaj kohe me rrënien dhe shkatërrimin e esnafëve, sidomos gjatë gjysmës së dytë të këtij shekulli u shfaqën format e para të mënyrës kapitaliste të prodhimit. Po në këtë periudhë, si rezultat i forcimit të lidhjeve ekonomike midis krahinave,

16) **Historia e Shqipërisë** (Maket) Vëllimi I, Pjesa III, fq. 30. Tiranë 1972.
17) S. Dashi, **Kullat mesjetare të Sahatit në vendin tonë,** Monumentet Nr. 12, v. 1977.
18) **Historia e Shqipërisë (Maket)** Vëllimi I, Pjesa III fq. 73, Tiranë 1972.

Botim PDF



Fig. 5



Fig. 6

sistemet e mëparshme ndërkrahinore fillojnë të shkrihen për të formuar tregun kombëtar.

Në urbanistikën e qyteteve tanë gjatë këtij shekulli vërehet një ecuri e pabarabartë, e cila kushtëzohej nga shkallët e ndryshme të zhvillimit ekonomik dhe karakteristikat e veçanta të qendrave qytetare. Kështu Gjirokastra, Berati, Elbasani në përgjithësi nuk ndryshojnë shumë në tiparet e tyre urbanistike, të kristalizuara një shekull më parë. Përkundrazi Shkodra, gjatë këtij shekulli, njohu një proces të theksuar zgjerimi, në zonën ku shtrihet sot, duke i'u larguar kalasë, e cila nga mesi i këtij shekulli humbi përfundimisht çdo funksion, me largimin prej saj të administratës më 1865. Rritje të bujshme pati dhe Korça, qendër tipike zejtaro-tregtare. Por në dallim nga Shkodra, e cila në lagjet e reja ruajti konceptin urbanistik mesjetar, zhvillimi i lagjeve të banuara nuk u parapri nga një projekt, në Korçë zgjerimi i qytetit u krye sipas një plani, duke u shkëputur kështu plotësisht nga tradita e mëparshme. Vetëkuptohet se veprimtaria ndërtimore, veçanërisht në Shkodër dhe Korçë, është mjaft e dendur, ajo ka intensitet të madh dhe në Berat, sidomos gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, ndërsa është më e paktë në Elbasan, Gjirokastër, Tiranë e gjetkë. Gjatë këtij shekulli, veçanërisht gjatë gjysmës së dytë të tij, një veprimtari e dendur ndërtimore përfshin komplekset e pazareve, për shkak të rritjes së prodhimit dhe shkëmbimit. Shpesh shkas për ritrajtime të ansambleve të pazareve, qenë dhe zjarret e shumtë që dendur rrafshonin një numër të madh dyqanesh. Kullat e Sahateve (fig. 5) përhapen gjerësisht dhe në qendra relativisht të vogla zejtare.

* * *

Qyteti mesjetar shqiptar me një histori të pasur zhvillimi në kohë, mori tiparet themelore urbanistike, aty nga gjysma e dytë e shek. XVII, duke zgjidhur konkretisht çështjet më kryesore si atë të shtrirjes së tij, vendosjes së qendrës zejtaro-tregtare qendrës së qytetit, rrjetit rrugor etj. Në shekujt e mëvonshëm, deri aty rreth fillimit të shek. XX, kjo skemë, u ruajt e pa prekur në arritjet e saja kryesore.

Realizimet e rëndësishme urbanistike për kohën, që arriti qyteti mesjetar shqiptar, dëshmojnë qartë për familjarizimin e ndërtuesve me një sërë konceptesh urbanistikë, të cilët në mungesë të një planifikimi të mirëfilltë, kanë qënë mbështetje për këtë veprimtari të rëndësishme ndërtimore. Këto koncepte bazë udhëheqëse, kanë gjetur një zbatim deri diku të larme në qëndra të ndryshme, në përputhje me rrethanat e dhëna, duke arritur në realizime që gjithë duke qëndruar pranë përsa i përket tipareve thelbësore, shfaqin dhe karakteristika të veçanta. Kompozimi i njësive themelore, vendosja e ndërtimeve, rrjeti rrugor etj., tregojnë qartë për kritere të qarta ndërtimore. Kompozimi disi i lirë, i lagjeve të banuara, veçanërisht në qytetet mbi troje të rrafshtë, ku spikat një far spontaneiteti, është vazhdim i këtij tipari të rëndësishëm të qyteti mesjetar. Lidhur me drejtimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme urbanistike, përmendet në

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 8

qytetet tanë kryesorë një funksionar i posaçëm «agai i ndërtimeve» të cilin e hasim duke filluar nga shek. XVII.

Njësitë themelore kompozicionale të qytetit mesjetar shqiptar janë qendra zejtaro-tregtare dhe ajo e banuar. Qendra e qytetit, në përgjithësi nuk është një njësi e spikatur qartë, ajo në shumicën e rasteve nuk përputhet me qendrën administrative, e cila deri vonë nga mesi i shek. XIX, në qytetet me lagje brenda mureve rrethues, mbeti pikërisht aty, duke qenë më e sigurtë. Përgjithësisht qendra e qytetit qëndron pranë, apo shkrihet me qendrën zejtaro-tregtare. Ajo spikat kryesisht për ndërtimet e kultit, kullën e sahatit, ndërtimet shoqërore si hamame, medrese, etj. Ndërtimet administrative në përgjithësi janë të pakëta dhe shfaqen më shumë gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX.

Qendra zejtaro-tregtare është e shkëputur qartësisht nga ajo e banuara; duke formuar një njësi të dalluar qartë. Raporti urbanistik i qendrës zejtaro-tregtare me atë të banuarën nuk është i njëjtë. Kështu ndeshen pazare pak a shumë në periferi të qendrës së banuar si në Shkodër dhe në Korçë, apo të tillë që ndërtohen brenda saj, madje dhe në qendër si në Krujë (fig. 6), Elbasan, Gjirokastër (fig. 7), Berat etj. Kjo ndarje i lë të qetë ansamblet e banuar, larg trafikut të dendur dhe zhurmës tipike për pazaret e kohës.

Pazari, qendra ekonomike e qytetit, ku kryhej prodhimi zejtar dhe shitja e mallrave, si kompleks ndërtimor është rezultat i zhvillimit të mëtejshëm të pazareve të hapura të shek. XV-XVI+). Komplekset e pazareve, gjatë shumë shekujsh deri aty rreth mesit të shek. XX, nuk përjashtuan pazaret e hapura. Këto ishin troje të veçanta, zakonisht pranë pazarit, në të cilët, në ditë të caktuara, fshatarët e zonave përreth shisnin kryesisht prodhime bujqësore dhe blegtorale.

Nga ana urbanistike pazaret kanë ruajtur të njëjtat tipare gjatë disa shekujve. Karakteristika thelbësore

+) Z. Shkodra, **Vep. cit,**



Fig. 9

e tyre, ishte shtrirja e kompozimit në gjatësi, duke u vendosur dyqanet në vargje të ngjeshur përballë njeritjetrit. Ndërmjet tyre shtrihej rruga, pjesërisht mbuluar nga strehët e gjerë të dyqaneve, në të cilën lëviznin blerësit duke zgjedhur mallin e ekspozuar në ballin e dyqanit dhe madje pjesërisht nën strehë. Ashtu si në mbarë Perandorinë Otomane dyqanet grupoheshin sipas zejeve, duke krijuar njësi të veçanta brenda ansamblit të pazarit. Krahas dyqaneve, në ansamblet e pazareve ndërtoheshin bezistene (pazare të mbyllur) (fig. 8) dhe hane (fig. 9).

Lagjet e banuara, përbëjnë njësi të veçanta, të lidhura në mënyrë të ndryshme me njera-tjetrën, por gjithmonë të shkëputura qartazi nga qendra zejtaro-tregtare. Në dinamikën e rritjes së qyteteve, veçanërisht me lindjen e varosheve, kriteri kryesor udhëheqës lidhur me zgjidhjen e truallit për ndërtimin e një lagjeje të re, ka qënë ai i sigurimit. Për këtë arsye, lagjet e para ndërtohen pranë kalasë, megjithëse shpesh trualli nuk ishte i përshtatshëm. Me zgjerimin dhe fuqizimin e qyteteve dhe rritjen e sigurisë, faktorë të tjerë si orientimi, lloji i truallit, drejtimi i erërave, mundësia e sigurimit të ujit etj., filluan të luajnë një rol me rëndësi në drejtimin e zgjerimit të qyteteve. Përparësia që deri vonë në shek. XIX, i'u dha sigurimit të lagjes së banuar shihet qartë në jetën e gjatë dhe intensive që patën lagjet e banuara brenda kalasë.

Në qytetet e fortifikuara dhe me lindjen e varoshit, lagjia brenda mureve rrethues zë një pozitë të veçantë, aty zakonisht, ngrihen banesat e funksionarëve të lartë, madje në të qëndron dhe administrata. Lagjet e banuara jashtë kalasë përgjithësisht ndahen nga njëra-tjetra me kufij natyrorë, ose rrugë kryesore. Ato, përgjithësisht, sidomos në qytetet mbi rrafshe, nuk shkëputen nga njëra-tjetra. Përkundrazi në qytetet mbi troje të aksidentuar, lagjet zakonisht qëndrojnë si njësi të veçanta, deri diku të shkëputura nga njëra-tjetra, por gjithmonë të lidhura ndërmjet tyre me rrugë. Banesat përbëjnë ndërtimin kryesor të lagjeve të banuara, por në to nuk mungojnë dhe ndërtimet e kultit dhe më rrallë ato shoqërore. Për vetë vendin në kompozim dhe formulimin arkitektonik të tyre, ato nuk luajnë ndonjë rol të rëndësishëm në tërësinë e ansambleve. Në përgjithësi lagjet qendrore kanë një dendësi më të madhe ndërtimesh në dallim nga ato periferiket ku ndërtimet më të thjeshta shtrihen më gjerë.

Qyteti mesjetar mund të klasifikohet sipas disa kriteresh, ndër ta, në rastin tonë, më të rëndësishmit janë dy. Kriteri i parë lidhet me pasjen ose jo në zanafillë të qendrës qytetare, fortifikimin, ndërsa i dyti lidhet me natyrën e terrenit, të pjerrët apo të rrafshtë, mbi të cilin ngrihet qendra e banuar.

Lidhur me kriterin e parë, ndër qytetet, që kanë pasur si zanafillë kalatë mund të përmendim: Berati, Shkodra, Kruja, Elbasani, Gjirokastra etj. Ndër qytetet që nuk kanë lidhje me fortifikimet mund të përmënden: Tirana, Kavaja, Voskopoja, Korça etj. Në shek. XV përmëndet kalaja e Korçës, e cila si kala garnizoni, nuk ka pasur banesa brenda saj, prandaj qyteti i Korçës, nuk është përfshirë në grupin e parë. Qytetet e para janë më të shumtët dhe njëherazi më të lashtët e më të zhvilluarit. Fillimisht, qyteti i lidhur me fortifikimin ishte një qendër e mbyllur e rrethuar me mure mbrojtëse. Me lindjen e varoshit filloi procesi i shtrirjes së qendrës së banuar dhe jashtë fortifikimit. Raporti sasior ndërmjet qendrës së fortifikuar dhe asaj të hapur, luhat ndjeshëm në kohë, në favor të së dytës. Në shek. XIX qendra e banuar brenda mureve rrethues ose shuhet, si në Shkodër dhe Gjirokastër, ose mbetet si njësi e vogël në raport me pjesën e hapur të qytetit, si në Berat, Krujë, Elbasan etj.

Lidhur me natyrën e terrenit mbi të cilën ngrihen qendrat qytetare, dallohen ato mbi terrene të pjerrëta dhe përgjithësisht të aksidentuara, Berati, Shkodra e vjetër, Kruja, Gjirokastra etj., si dhe ato mbi terrene të rrafshta, Shkodra e sotme, Elbasani, Tirana, Kavaja, Korça etj. Në disa raste në të njëjtën qendër ndeshen lagje mbi troje të rrafshta dhe të tjera mbi troje të aksidentuar, si në Berat, Shkodër etj. Zakonisht, qe-

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 10



Fig. 11



Fig. 12

ndrat që lidhen me fortifikimet me histori tepër të lashtë, ngrihen mbi terrene të aksidentuar për arsyen e kuptueshme se fortifikimet parapëlqenin vende lehtësisht të mbrojtshme. Qendrat qytetare në terrene të rrafshta në shumicën e tyre kanë lindur si pasojë e kalimit gradual nga qendrat fshatare në qendër qytetare si pasojë e zhvillimit të natyrshëm ekonomiko-shoqëror.

Në karakterizimin e përgjithshëm urbanistik, të qytetit mesjetar shqiptar, në rradhë të parë vinë në konsideratë tiparet e ansambleve, lidhur me ngritjen e tyre mbi troje të aksidentuar, apo të rrafshtë. Terrenet e aksidentuara mbi të cilët ngrihen mjaft qytete shqiptarë, përfshijnë reliefe të ndryshme, që nga trojet e pjerrët, kurrizet kodrinore, lartësitë kodrinore, luginëzat etj. Terreni i aksidentuar ka ndikuar shumë në karakterin e ansambleve arkitektonikë, që ngrihen mbi të dhe rrjedhimisht në mbarë karakterin e qendrës së banuar. Ansamblet mbi terrene të aksidentuar, kanë orientimin e detyruar, kështu kur ato ngrihen, mbi pjerrësi; të gjithë ndërtimet i vishen faqes shkëmbore, duke krijuar ansamble organike. Kompaktësia e ndërtimeve shquan përgjithësisht ansamblet e këtyre qendrave, për vetë faktin se ngushtica e truallit përbën një problem me rëndësi. Lidhur me karakterin e truallit, ndërtimet vendosen në formë vargu si në lagjen Mangalem të Beratit (fig. 10), ose kanë një shtrirje më të lirë si në disa lagje të Gjirokastrës (fig. 11). Në rastin e parë banesa del drejtpërdrejt në rrugë, duke marrë pjesë aktivisht (fig. 12) në formulimin e saj. Në



Fig. 13

këto ansamble, mbisundon perspektiva e kufizuar, për shkak të terrenit të cilin ndjekin ndërtimet. Në dallim nga kompaktësia e madhe e ansambleve mbi terrene të pjerrët, ata mbi kurrize kodrinorë, shquajnë për karakterin e theksuar dinamik, ndërsa nuk mungojnë dhe vendosjet mjaft piktoreske e të lira në kodërza, apo troje me relief të valëzuar. Në të gjitha rastet kalimi nëpër këto lagje të lë mbresë; me larminë e madhe të zgjidhjeve volumore dhe kompozimet e veçanta, brenda unitetit të përgjithshëm të trajtimit. Lidhja e përsosur me terrenin e rrit monumentalitetin këtyre ansambleve. Terreni ka kushtëzuar ndërtimin e banesës, dy e madje tre katëshe, e cila për vetë kompozimin vertikal dhe vendosjen në formë shkallësh është elementi ndërtimor mbisundues në krejt formulimin arkitektonik. Ndërtimet e kultit humbasin në këto ansamble, duke u shkrirë në masën dinamike e të zhdërvjelltë të banesave (fig. 10).

Një karakter tjetër kanë qendrat qytetare apo lagjet e veçanta, ngritur mbi terren të sheshtë. Në këto qendra krahas ndërtimeve relativisht të rralla si në Shkodër, Tiranë, lagjen Murat Çelebi të Beratit etj. ndeshen dhe ndërtime më të dendura si në lagjet e vjetra të Korçës, në pjesën qendrore të qytetit të Shkodrës etj. Shkaku duhet kërkuar në dy faktorë, së pari në gjendjen ekonomike të shtresave që banonin në këto lagje, e cila ndikonte në mundësinë për të zotëruar troje, atëhere mjaft të kushtueshëm, së dyti në natyrën ekonomike të qytetit, lidhur me peshën e ekonomisë bujqësore karshi zejtarisë. Në qendrat e para banesat qarkohen nga troje të mëdhenj, rrethuar me mure të lartë. Rrugët, plot dredhime janë të varfëra, portat e mëdha e aq më pak muret rrethues nuk thyejnë dot një far monotonie që vihet re. Banesa shumë rrallë merr pjesë në formulimin e rrugës, por edhe në këto raste ajo i tregon asaj shpinën apo njërin ball anësor, të dy pa asnjë përpunim të kujdesshëm arkitektonik. Gjelbërimi i dendur shpesh mbulon krejt banesën. Qetësia kompozicionale këtu thyhet vetëm nga ndërtimet e kultit mysliman, të cilat për vetë kompozimin e theksuar horizontal dhe tepër të shtrirë të ansambleve, marrin një vlerë të madhe. Ato zakonisht ndërtohen në sheshe, duke bërë më të perceptueshëm efektin e volumeve të tyre dinamikë.

Ndryshe është karakteri i ndërtimeve relativisht të dendura në troje të rrafshtë, siç tregon mirë shembulli i qendrës historike të qytetit të Korçës. Këtu banesa del shpesh në rrugë me njërën apo me dy pamje të përpunuara, muret rrethues, mbyllin hapësira të vogla dhe thyhen mirë nga portat e jashtme. Perspektiva e kufizuar, larmia dhe pasuria e elementeve arkitektonik të banesës që theksohet nga efektet e dritë-hijes, i bëjnë mjaft piktoreskt dhe tërheqëse këta ansamble.

Thellimi i diferencimit klasor në qytet, i cili rritet proporcionalisht me fuqizimin ekonomik të këtyre qendrave, pasqyrohet qartë dhe në dallimet ndërmjet lagjeve. Shtresat e pasura të popullsisë, ndërtojnë në zonat më të mira. Për sa kohë çështja e sigurimit nga sulmet, apo turbullirat e mundshme është në rend të ditës, shtresat e pasura ndërtojnë brenda mureve rrethues të qytetit, duke zgjedhur dhe këtu trojet më të mirë. Me fuqizimin e procesit të rritjes së qytetit të hapur, shtresat e pasura ngrenë banesat e tyre në lagjet më të favorshme për ndërtim, zakonisht në zonat e rrafshta, apo me pak pjerrësi, duke rrethuar banesat e mëdha me oborre e kopshte të gjerë. Shtresat e mesme dhe të varfra të popullsisë ndërtonin në zonat më të vështira, mbi troje të vegjël, me ndërtime

DO NOT COPY



Fig. 14



Fig. 15



Fig. 16

DO NOT COPY

përngjitur me ndriçim të paktë dhe shpesh indirekt, apo nëpërmjet baxhave. Shembull tipik i këtij diferencimi të qartë është qyteti i Beratit, ku masa e zejtarëve banonte në lagjet që i qepeshin shkëmbit të kalasë, apo Malit të Goricës, ndërsa shtresat e pasura të feudalëve, ndërtonin në qëndër, apo në lagjen Murat Çelebi në rrafshin perëndimor të qytetit. Shtresat më të përbuzura të popullsisë ishin të detyruara të jetonin në periferi të qytetit, në lagje të ndërtuara pa asnjë kriter urbanistik dhe higjenik.

Dasitë fetare gjithashtu janë pasqyruar qartë dhe në qytetin mesjetar, duke pasur një ndarje të dalluar të lagjeve sipas feve. Popullsia që ruante besimin e vjetër zakonisht ndërtonte në lagjet më të pa përshtatëshme për banim.

Rrjeti rrugor i qyteteve mesjetare ka karakteristika të veçanta, lidhur me natyrën e qyteteve të ndryshëm. Në qëndrat e banuara, rrethuar me mure mbrojtëse, arteriet kryesore zënë fill nga hyrjet për në kala, duke u shpërndarë pastaj në një numër rrugësh të dyta dhe të treta. Shtrati i tyre përgjithësisht ndiqte vijat e niveleve, por shpesh lindte nevoja, për të trasuar rrugë normal tyre, që madje, në disa raste ndërtoheshin në formë shkallësh (fig. 13). Në lagjet e ndërtuara mbi kurrize kodrinore, rruga kryesore trasohej përgjithësisht, gjatë pjesës më të lartë, duke u degëzuar prej saj, rrugë të dyta, në të dy krahët. Një vend me rëndësi në rrjetin rrugor zënë rrugët që lidhin qendrën ekonomike të qytetit me lagjet e banuara, si dhe ato që ndërlidhin, lagjet ndërmjet tyre. Shpesh, veçanërisht në qytetet fushore, rrugët kryesore janë vazhdim i atyre që lidhin qytetin me qendrat e tjera. Në dallim nga rrugët e ngushta në trojet e aksidentuara, në qytetet fushore ato përgjithësisht janë më të gjëra, por po aqë të lakuara dhe shpesh pa krye. Rrugët zakonisht shtroheshin me kalldrëm, duke pasur në mesin e tyre një kunetë, apo dy të tilla, anash saj. Në rrugët me pjerrësi të madhe, shpesh ndërtoheshin breza tërthor me pllaka guri, më të lartë se niveli i rrugës për të penguar shkarjen. Mjaft të përhapura janë prerjet e qosheve të mureve, deri në një farë lartësie mbi rrugë (fig. 14) për të lehtësuar kalimin, veçanërisht të kafshve të ngarkesës. Në mjaft qytete kalojnë lumej, apo përrenj sezonalë, kështu që ka lindur nevoja e ndërtimit të një numri urash të madhësive të ndryshme. Përgjithësisht ato ndërtohen prej guri mbi qemere cilindrikë (fig. 15). Në disa raste përrenjt në zonën e qytetit sistemoheshin duke kaluar rrjedhja e tyre në kolektorë të mëdhenj punuar me gurë dhe mbuluar me qemer cilindrik. Shembull me interes është sistemimi i

një përroi, që përshkon pjesën lindore të qytetit të Beratit pranë Teqesë së Helvetive. Mbi këtë kolektor që derdhet në lumë, janë realizuar ndërtime të shumëta.

Gjelbrimi i dendur është një karakteristikë tjetër e qytetit të kësaj kohe. Pemët frutore, ullinjtë dhe pjergullat gjatë periudhës së gjelbërimit ndikojnë mjaftë në pamjen e ansambleve të ndryshme. Veçanërisht në lagjet mbi terrene të aksidentuar ku gjelbërimi bën që lidhja e ndërtimeve me trojet të jetë më e natyrëshme, duke zbutur shpesh dhe karakterin e theksuar monumental të banesës, veçanërisht përpara shek. XIX.

Furnizimi me ujë i qytetit ka qenë një problem me rëndësi për kohën. Ai është zgjidhur në mënyra të ndryshme në përputhje me kushtet e veçanta të çdo qendre. Në rradhë të parë janë shfrytëzuar burimet natyrore, të realizuar me kanalizime, shpesh me tuba qeramike, të cilat përfundonin në çezmën me një apo disa marrje uji. Puset gjithashtu kanë pasur një përhapje të gjërë. Në zonat e ulëta si në qytetet e Shqipërisë së Mesme dhe në Shkodër, ata përbëjnë të vetmin burim uji. Lumenjtë që përshkonin disa qytete, kanë qenë kurdoherë në të kaluarën, burim i rëndësishëm uji. Një përhapje të gjërë, veçanërisht në Gjirokastër dhe më pak në Berat, kanë sterat e ujit, që janë rezervuare të cilët depozitojnë ujërat e rreshjeve. Krahas këtyre në disa qytete kanë qenë ndërtuar dhe ujësjellës, që sigurojnë ardhjen e ujit nga burime të largëta natyrore, siç është rasti i ujësjellësit të Sopotit që siguronte ujin për kalanë e Gjirokastrës (fig. 16). Disa ujësjellësa, krahas puseve, siguronin furnizimin me ujë të qytetit të Voskopojës.

Karakteri urbanistik i qytetit të vonë mesjetar mund të pasqyrohet mirë duke ndjekur zhvillimin e qyteteve të Gjirokastrës, Beratit, Shkodrës, Elbasanit, Tiranës, Voskopojës dhe Korçës, të cilët pak a shumë përmbledhin mbarë larminë e qytetit shqiptar të kohës. Në lagjet e sotme, qytetet – muze të Beratit dhe Gjirokastrës, qëndrat historike të Korçës dhe të Elbasanit dhe së fundi qyteti i Shkodrës etj., megjithë ndryshimet e mëdha që kanë pësuar, i përgjigjen në kompozimin urbanistik tërësor apo pjesor arritjeve të shek. XVIII-XIX. Por siç është përmendur, në drejtimet themelore kjo skemë është më e vjetër, kështu që me të drejtë që karakterizimi i këtyre qëndrave shtrihet në një diapazon kohor më të gjatë.

Qyteti i Gjirokastrës (fig. 17) zë një pozitë qëndrore në luginën e Drinos. Rrugë të ndryshme e lidhin që në kohën e lashtë atë me qytete të tjera dhe me krahi-



Fig. 17

DO NOT COPY



Fig. 18

nat përreth. Lindja e qytetit është e lidhur me kalanë, ndërtimi i së cilës duket se i përket gjysmës së dytë të shek. XIII. Gjatë gjysmës së dytë të shek. XIV Gjirokastra u bë qëndër feudalëve Zenevisë, ndërsa më 1419 ajo bie në duar të pushtuesve turq. Roli i rëndësishëm i kësaj qendre, në trevat e Shqipërisë jugore, dëshmohet nga caktimi i saj më 1431 kryeqendër e Sanxhakut të Shqipërisë. Aty rreth gjysmës së parë të shek. XIV kishte filluar zgjërimi i qytetit jashtë mureve rrethues. Gjatë shek. XVI, Gjirokastra shënon fillimin e rritjes së saj, proçes i cili fuqizohet ndieshëm gjatë shek. XVII, duke arritur qyteti, rreth çerekut të tretë të tij thuajse shtrirjen që ruajti gjatë dy shekujve të mëvonshëm. Kështu pra u trasuan linjat themelore të formulimit urbanistik. Fillimit të shek. XVII, i përket dhe proçesi i formimit të tregut të ri, në zonën që shtrihet ende sot, duke u zhvendosur nga zona e mëparshme pranë kalasë, atje ku ende ruhet toponimi «Pazar i Vjetër».

Gjatë shek. XVIII dhe veçanërisht shek. XIX, qyteti pëson një rritje të ndjeshme, duke u ndërtuar mjaft godina, ndër të cilat vendin kryesor e zënë banesat. Në zhvillimin e qytetit të Gjirokastrës qendra e tij ka ndryshuar në kohë. Që me themelimin e tij e deri aty nga fillimi i shek. XVII, kalaja ka qenë dhe qendra kompozicionale e qytetit. Me zgjërimin e tij, një rol me rëndësi filloi të luante pazari siç dëshmon rrjeti rrugor, i cili e ndërlidh atë me të gjitha lagjet e qytetit. Në kompleksin e pazarit ndërtohet më 1757 xhamia më e madhe e qytetit, duke luajtur së bashku me medresenë rolin qëndror në kompozimin urbanistik të qytetit.

Gjirokastra (fig. 18) bën pjesë në grupin e madh të qendrave qytetare që ngrihen mbi terrene të aksidentuar dhe që përgjithësisht e kanë zanafillën e tyre në kalatë. Në këtë grup të madh dhe më karakteristik të qyteteve shqiptare, Gjirokastra shquan për larminë e theksuar të relievit, i cili ka kushtëzuar tiparet



Fig. 19



Fig. 20

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 21



Fig. 22

e veçanta të lagjeve si dhe dinamizmin e theksuar të kompozimit.

Grupet më tipikë të ansambleve në qytet janë ato të lagjeve Pazar i Vjetër, Pllakë dhe Hazmurat (fig. 19) të ngritura mbi dy kreshta thuajse paralele. Një arter kryesor përshkon kuotën më të lartë të dy kreshtave, duke u degëzuar prej tij me rrugë sekondare në të dy krahët. Ndërtimet anash këtyre rrugëve kanë orientim të detyruar, duke ndjekur rënjet e terrenit në formë të shkallëzuar. Kompaktësia e ndërtimeve, lidhja e goditur me truallin dhe larmia e pamjeve të tyre i shquajnë këto lagje në mbarë qytetin. Ndryshe kompozohen ansamblet masive të lagjeve Palorto (fig. 20) dhe Manalat (fig. 11), të ndërtuara mbi terrene të pjerrët. Ata, paraqiten si njësi të mëdha, të trajtuara me të njëjtën gjuhë arkitektonike,



Fig. 23

ku banesat shfaqen mirë në volum. Këto ansamble i karakterizon monumentaliteti dhe disi uniformiteti, brënda kuadrit dinamik të Gjirokastrës. Të dy ansamblet e lagjes Dunavat (fig. 21) që paraqesin shembuj të lidhur mjeshtërisht me truallin, janë kompozuar më lirë dhe ndërtimet shfaqen më qartë individualisht, duke bërë më të larmë kompozimin, pa cënuar unitetin. Trajtimi më i lirë dhe njëherazi më piktoresk ndeshet në lagjen Cfakë (fig. 22). Megjithë karakteristikat e veçanta të ansambleve të ndryshëm të qytetit të Gjirokastrës, ato përbëjnë një të tërë organike, sepse tiparet thelbësore janë të njëjta.

Berati, (fig. 23) është një nga qytetet më të larmë përsa i përket karakterit të ansambleve arkitektonikë, për shkak të natyrave të ndryshme të trojeve mbi të cilat ngrihen ato. Kështu krahas vendosjeve mjaft kompakte në terrene me pjerrësi të theksuar ndeshim në vendosje më të lira, si dhe në ansamble mbi terrene të sheshta. Qendra e banuar brenda mureve rrethues mbeti gjatë gjithë kohës, deri më sot, një ansambël i rëndësishëm i qytetit. Fillimi i shtrirjes së tij jashtë mureve të kalasë, duhet t'i përkasë shek. XIII, duket se lagjet e para të kenë qënë ndërtuar në pjesën perëndimore të kalasë. Më pas duket të kenë filluar ndërtimet në lagjen Mangalem, dhe në zonën lindore të Kalasë. Mesi i shek. XVII e gjen qytetin thuajse me shtrirjen e sotme, duke pasur përtej lumit një lagje më vete, krahas shtrirjes në pjesën qendrore dhe në rrafshinën perëndimore. Qendrën e qytetit e formonte pazari, i cili shtrihej në pjesën e ulët, në lindje të lagjes Mangalem (fig. 10), si dhe një kompleks i rëndësishëm monumentesh kulti. Po në qendër të qytetit ngrihej dhe kompleksi i godinave të një familjeje feudalësh të mëdhenj. Qendra e spikatur qartë dhe e veçuar dallueshëm nga lagjet e banuara, lidhej me rrugë kryesore me të gjitha këto. Për në lagjen Goricë, përtej rrjedhjes së Osumit, kalohej mbi një urë, e cila u ndërtua e gurtë prej Kurt Pashës (fig. 24), në vendin e urës së vjetër prej druri. Ndërsa deri vonë, në shek. XIX, qendra administrative e qytetit qëndroi në lagjen Kala.

Nga ana e kompozimit urbanistik vlera të rëndësishme ruan veçanërisht lagjia Mangalem, e cila paraqet rastin më të skajmë të ndërtimit në terrene të pjerrët. Trualli shkëmbor dhe mjaft i thikët i kësaj lagjeje, ka kushtëzuar ndërtime në formë vargjesh paralele me banesa të bashkëngjitura (fig. 12), që dalin drejtpërdrejt në rrugë. Kompaktësia e ndërtimeve këtu shënon pikën më të lartë duke arritur një shfrytëzim dhe lidhje të përsosur me truallin. Rrugët, ashtu si janë në formë brezash gjatësore, ndërpriten aty këtu nga kalime tërthore, shpesh mjaft të thikëta (fig. 13) në formë shkallësh. Së largu ndërtimet shkrihen në një njësi të vetme, duke marrë pjesë në pamjen kryesore çdo ndërtim i veçantë. Ansambli shquan për kompozim të qartë dhe të ekuilibruar, përkundrazi kalimi nëpër të, të vë përpara zgjidhjesh dinamike dhe tepër intime, për shkak të perspektivës së kufizuar dhe rrugicave të mbyllura nga të dy anët me ndërtime të ngjeshura.

Lagjia Goricë (fig. 25) ngritur në një terren më pak të pjerrtë, madje me një lloj ultësire buzë lumit, shquan për vendosje disi të lirshme të ndërtimeve, në pjesën e poshtme, ndërsa në të sipërmen ato përsërisin karakteristikat e lagjes Mangalem. Në këtë lagje, banesat shpesh paraqesin volumet e tyre, në dallim nga ato të Mangalemit ku kompaktësia e ndërtimeve shuan çdo mundësi për paraqitje individuale të tyre.

Lagjia Kala, ka një vendosje më të lirë, terreni ka detyruar grupime ansamblesh të vegjël me orientime të ndryshme, që rrethojnë thuajse në formë kurore terrenin kodrinor brenda mureve rrethuese. Zhvillimi urbanistik i pjesës fushore të qytetit, përsërit karakteristikat e njohura të këtyre qendrave.

Berati, ashtu si dhe Gjirokastra paraqet një prej shembujve më të arritur të lidhjes së ansambleve me terrenin dhe shfrytëzimin me mjeshtëri të tij në dobi të një urbanistike ku spikat qartë gjenia krijuese dhe prakticizmi i ndërtuesve shqiptarë.

Qyteti i Shkodrës, një nga më të lashtët e vendit, pas rënies që pati me pushtimin turk, nga fundi i shek. XVI po fitonte përsëri rëndësinë e vet si qendra kryesore ekonomike për krahinat përreth. Gjatë shek. XVII, qyteti vazhdon procesin e zhvillimit, duke qënë një nga më të rëndësishmit e Shqipërisë veriore me rreth dymijë banesa. Gjatë gjysmës së dytë të shek. XVIII Shkodra



Fig. 24

FOTOCOPY



Fig. 25

kthehet në treg ndërkrahinor për një sërë krahinash ku zhvillohej një veprimtari e gjerë prodhimi dhe këmbimi. Ky zhvillim ekonomik u pasqyrua dhe në zhvillimin urbanistik dhe ndërtimor të kësaj qendre të lashtë.

Lindja dhe zhvillimi i qytetit të Shkodrës[19], ashtu si Gjirokastra dhe Berati është i lidhur me kalanë e qytetit. Lidhja e kalasë me qytetin e hapur ka ardhur me kohë duke u dobësuar deri sa rreth mesit të shek. XIX, kalaja kthehet në një relik historik. Shkodra e sotme (fig. 26) është krejt e shkëputur nga kalaja, dhe shtrihet në një rrafsh në verilindje të saj. Ajo është relativisht e re si vendbanim. Deri aty rreth mesit të shek. XVIII, qyteti shtrihej kryesisht në anën lindore të kalasë, deri te lumi i Kirit, duke përfshirë lagjet Qafë, Ajazmë, Tabak (fig. 27), e Tepe. Në veri të kalasë shtrihej pazari. Në krijimin e qendrës së re të banuar, Shkodrës së sotme, dallohen dy momente, së pari rritja e natyrshme e qytetit që kërkonte sipërfaqe të reja shtrirjeje dhe së dyti shvendosja nga qendra e vjetër për arsye të tjera. Rritja e qytetit, veçanërisht gjatë gjysmës së dytë të shek. XVIII shtronte nevojën e krijimit të zonave të reja të banuara. Fusha, ku shtrihet sot qyteti, plotësonte më së miri kërkesat për të vendosur aty këto zona. Por krahas këtij procesi, kemi edhe atë të shvendosjes graduale nga qendra e vjetër, i cili mori shtytje dhe për arsye të tjera. Ai përfundimisht pati shtytjen vendimtare, pas vitit 1860 për shkakun madhor të rikthimit të lumit të Drinit në shtratin e tij të parë. Pra Shkodra e sotme është një qendër relativisht e re, e cila për rrethanat në të cilat u krijua nuk mundi të paraprihej nga një projekt, duke ruajtur kështu tiparet tradicionale në kompozim. Shtrirja e qytetit filloi së pari në lagjen Tophane, më vonë grumbuj banesash filluan të ngrihen në lagjet Rus, Ndocaj, dhe Perash.

Ndarja e qartë ndërmjet qendrës së banuar dhe pazarit, karakterizon dhe Shkodrën, deri aty rreth çerekut të parë të shek. XX. Lidhja e qendrës së banuar me rrugë sa më të shkurtëra me tregun, ka kushtëzuar trasimin e një sëre rrugësh kryesore, që duke përshkuar qytetin shkarkojnë në pazar. Rrugë të tje-

19) E. Riza, **Banesa popullore në Shkodër gjatë shekujve XVIII-XIX,** «Monumentet» nr. 4, 1972.

DO NOT COPY

ra të dorës së dytë dhe më shumë të tretë, shumica qorre, ndërlidhin qytetin. Qendra e qytetit fillon të kristalizohet vonë, aty nga fundi i shek. XIX. Ndërtimet rreth saj janë relativisht të dendura, për të kaluar pastaj në lagjet më në periferi, ku ndeshet karakteri tipik i qytetit me kompozim të shtrirë. Aty banesat rrethohen nga troje shumë të gjera, që mbrohen nga mure të lartë rrethues. Rrugët e gjera, portat e mëdha dhe muret e lartë prej guri, janë shprehje tipike e këtyre lagjeve, që kanë secila nga një qendër të vogël, ku zakonisht dallon volumi i ndërtimeve të kultit mysliman.

Elbasani zë një vënd të veçantë në historinë e qytetit shqiptar, sepse ai lidhet me një fortifikim fushor, ringritur për qëllime strategjike, nga pushtuesit turq më 1466, mbi themelet e një kështjelle bizantine, në vijim të luftërave shqiptaro-turke të shek. XV[20]. Qyteti i populluar me banorë të qendrave përreth pati një rritje të shpejtë, në sajë të pozitës së tij të favorshme. Një shekull më pas themelimit, ai kishte një varosh të madh, pranë kalasë[21] duke u zhvilluar mjaft shpejt, për shkak të pozitës së tij në mes të rrugëve tregtare e ushtarake. Rreth çerekut të tretë të shek. XVII, qyteti i hapur përsa i përket numrit të banesave[22] ishte rreth 2,5 herë më i madh se qendra e banuar dendur brenda mureve rrethuese të kalasë. Gjatë shek. XVIII, Elbasani qe treg i rëndësishëm i Shqipërisë së Mesme, me një prodhim të madh zejtar. Gjatë kësaj kohe ai pësoi një shtrirje të gjerë, duke u rritur së bashku me të dhe qendra zejtaro-tregtare, që zinte një vend qendror, para kalasë.

Me karakteristika të veçanta paraqitet lagjia e banuar brenda mureve rrethues (fig. 28) e cila dallohet për dendësinë e madhe të ndërtimeve. Rrugët kryesore, zënë fill nga hyrjet e kalasë, rrugë të tjera me një zhvillim mjaft të lirë copëtojnë kryq e tërthor lagjen. Përkundrazi, lagjet e jashtme janë më të qeta, me karakteristikat e njohura të qyteteve fushore, por në përgjithësi me dendësi më të madhe ndërtimesh se lagjet e Shkodrës. Megjithatë kopshtet, rrallë i mungojnë banesës së hapur elbasanase, përgjithësisht përdhese me shtrirje të theksuar horizontale. Ndërtimet e kultit mysliman në këtë qytet kanë qenë më të shumëta se në qytetet e tjerë, duke marë pjesë më qartazi në siluetën e tij.

Tirana (fig. 29) po merrte funksionet e një qendre qytetare, që prej shek. XVII. Ajo lindi nga nevojat ekonomike të zonës për një qendër qytetare, duke para-



Fig. 26



Fig. 27

20) Gj. Karaiskaj, **Kalaja e Elbasanit** «Monumentet» Nr. 1, 1971.
21) **Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë,** III, Tiranë, 1967, 164.
22) E. Çelebi, **Shqipëria para dy shekujsh,** Tiranë, 1930, fq. 102-103.

DO NOT COPY



Fig. 28



Fig. 29

qitur shembullin e kalimit gradual nga fshati në qytet. Deri aty nga çereku i parë i shek. XX, kur ajo caktohet kryeqytet dhe si pasojë pëson një rritje të bujshme, qyteti shtrihej rreth qendrës tij ku qe ndërtuar pazari dhe dy xhamitë më të shquara. Arterie kryesore, pak a shumë në formë radiale, lidhnin qendrën e qytetit me lagjet e banuara rrallë, ku banesat, si në Shkodër rrethoheshin me troje shumë të gjerë. Lidhja e një pjese të mirë të popullsisë, përveç zejtarisë me blegtori e bujqësi, ka kushtëzuar dhe karakterin urbanistik të kësaj qendre, veçanërisht në lagjet periferike të saja.

Fillimet e Voskopojës[23] së pari qendër fshatare nuk janë shumë të qarta. Historia e saj para shek. XIV është e errët. Gjatë shek. XV-XVI ajo duket se njohu një zhvillim të ndjeshëm, duke marrë nga fundi i shek. XVII, fizionominë e një qendre qytetare. Lulëzimin e vet, kjo qendër e rëndësishme zejtaro-tregtare e arriti gjatë shek. XVIII deri rreth çerekut të tretë të tij (fig. 30). Fundi i shek. XVIII, shënon rënien e Voskopojës, për shkak të sulmeve të përsëritura grabitqare të feudalëve të zonave përreth.

Në periudhën e lulëzimit të tij, qyteti i Voskopojës, kishte një shtrirje të gjerë, ai ishte ndërtuar mbi tarraca me tri shkallëzime të njëpasnjëshme, të ndërprera nga përenjtë që i përshkojnë. Qyteti përfshinte 14 lagje të banuara. Tregu i këtij qyteti të zhvilluar zejtaro-tregtar, për kohën, zinte pozitën qendrore në qytet, duke zënë fill prej tij arterie të shumtë që lidhnin pazarin me lagjet e banuara. Një numër i madh urash guri ngriheshin mbi përrenjt e shumtë që çanin qytetin, përveç urës së madhe mbi lumin e Voskopojës, rindërtuar nga fundi i shekullit të kaluar. Dendësia e ndërtimeve ka qenë relativisht e madhe. Karakteristikë e këtij qyteti është ndërtimi i një numri të madh kishash, disa prej tyre me vlera të mëdha jo vetëm për arkitekturën por dhe për pikturat murale. Pranë qendrës, ngriheshin ndërtesat e kolegjit «Akademia e Re», shtypshkronjës etj., të cilat tregojnë për zhvillimin e dukshëm kulturor të saj për kohën. Një numër ujësjellësash, siguronte furnizimin me ujë të qytetit. Krahas tyre ndërtoheshin dhe puse.

Një vend të veçantë në historinë e zhvillimit të qytetit shqiptar zë Korça, në të cilën aty nga gjysma e parë e shek. XIX, për herë të parë ndeshet ndërtimi i planifikuar (fig. 31) i lagjeve.

Lindja dhe zhvillimi i kësaj qendre të banuar, ende nuk është qartësuar plotësisht. Megjithkëtë, të dhënat e derisotme, lejojnë të krijohet një panoramë e zhvillimit të qytetit të Korçës. Në regjistrin fiskal të vitit 1431-32 përmendet dhe kalaja e Korçës, e cila duket se është ndërtuar nga turqit si kala garnizoni. Gjurmë të kësaj kalaje janë gjetur, aty ku janë ndër-

23) S. Adhami, **Të dhëna rreth fizionomisë urbanistike të qytetit mesjetar të Voskopojës,** «Monumentet» Nr. 3, 1972. Plani i qytetit është marrë nga i njëjti artikull.

DO NOT COPY

tuar sot banjot e qytetit. Toponimet, «varosh» dhe «katavarosh» dëshmojnë gjithashtu për këtë. Në këto troje, gjatë shek. XV, shtrihej fshati Peshkopie, i cili më 1484, së bashku me disa të tjera i'u dhurua si mylk, Mirahor Iljaz beut. Ky më 1496 ndërtoi xhaminë e Mirahorit (fig. 3), e cila u bë epiqendra e zhvillimit të mëtejshëm të këtij vendbanimi, që duket se ka pasur që herët funksione administrative. Kushtet e përshtatshme ndikuan që ky vendbanim të zhvillohet relativisht shpejt, duke arritur në shek. XVII, në një qendër të vogël qytetare. Shekulli XVIII, sidomos fundi i tij, shënon një rritje të bujshme të qytetit, lidhur dhe me shkatërrimin e qytetit të zhvilluar të Voskopojës. Mbi bazën e rritjes së prodhimit zejtar, si dhe të marëdhënieve tregtare me qendrat e tjera, në mesin e shek. XIX Korça bëhet një nga qendrat më të zhvilluara të Shqipërisë së Jugut. Lagjet e para të banuara, së pari duket se janë ndërtuar rreth xhamisë së Mirahorit, duke u shtrirë më tepër në perëndim të saj. Më pas, qyteti u zgjerua në juglindje dhe veri të xhamisë, duke pasur pranë kësaj të fundit pazarin. Këto ansamble, duke gjykuar nga qendra historike, që i përket kryesisht shek. XIX, përsërisnin tiparet e njohura të qytetit mesjetar. Rritja dhe fuqizimi i borgjezisë së qytetit, lindi nevojën e zgjerimit të tij. Në dallim nga të gjithë qendrat e tjera ky zgjerim u parapri nga planifikimi. Fillimi i ngritjes së lagjes së re[24], në



Fig. 30



Fig. 31

PROTOCOPY

24) P. Thomo, **Mbi urbanistikën dhe arkitekturën e qytetit të Korçës,** «Monumentet historike në vendin tonë», Tiranë, v. 1978.



Fig. 32



Fig. 33

lindje të pazarit, duket se i përket viteve rreth mesit të shek. XIX. Në këtë lagje (fig. 32) dhe ato të ndërtuara më vonë, në terren me pjerrësi të lehtë pranë saj (fig. 33) spikat një koncept i qartë dhe i përparuar urbanistik për kohën. Rrugët e gjera dhe të drejta formojnë me kryqëzimet e tyre, në kënd të drejtë, parcela ndërtimi në forma të rregullta. Anash tyre, buzë rrugës ose pak larg saj ndërtohen banesat, njëra pranë tjetrës, duke pasur brenda mureve rrethues oborre të vegjël. Rrugët e shtruara me kalldrëm, me trotuare dhe kuneta anësore për kalimin e ujërave janë të gjera dhe të drejta. Muret rrethues jo shumë të lartë, portat dhe pjesërisht pamjet e vetë banesave, përgjithësisht me kat, gjallërojnë mjaft pamjen e rrugëve, në dallim nga karakteri disi monoton i atyre të Shkodrës dhe Tiranës. Dhe Pazari i Korçës, veçanërisht në pjesën qendrore të tij shquan për të njejtin koncept urbanistik, rast ky gjithashtu i vetëm në qytetet tona të vona mesjetare. Karakteristikat urbanistike të lagjeve të ndërtuara, gjatë shek. XIX, në Korçë, flasin qartë për kalimin nga konceptet e vjetra, ku mbizotëronte spontaneiteti karakteristik mesjetar, në konceptet e reja që kërkonin planifikimin, si kusht të domosdoshëm për zhvillimin e qytetit të mirëfillt, ku borgjezia luante rolin mbisundues si forcë prodhuese dhe drejtuese e jetës ekonomiko-shoqërore.

* *
*

Qyteti i vonë mesjetar shqiptar, natyrisht nuk u zhvillua brenda një suaze të ngushtë etnike. Përfshirja e vendit tonë, gjatë gjithë kësaj periudhe, brenda një njësie të vetme politike me popujt e tjerë të ballkanit, padyshim ka prurë tipare të përbashkëta dhe në karakterin e qytetit. Më qartë këto paralele shihen në qytetet fushor të vendit tonë. Përkundrazi zhvillimi dhe karakteri i qendrave qytetare, që ngrihen mbi troje të aksidentuar dhe që përgjithësisht lidhen me fortifikimet paraqet veçanti të qarta, që i shkëpusin këto të fundit nga karakteri i përgjithshëm i qytetit ballkanik të kohës. Është me rëndësi të theksohet se janë pikërisht qytetet mbi troje të aksidentuar ata më të lashtit, tek të cilët procesi i krijimit të qytetit të hapur kishte filluar kohë më parë pushtimit osman. Kjo traditë pati arsye dhe kushte të ruhej dhe zhvillohej, duke na dhënë gjatë shekujve të mëvonshëm realizime me të vërtet madhore si Beratin dhe veçanërisht Gjirokastrën.

DOWOTOOK

Emin RIZA

DO NOT COPY

APERÇU SUR L'URBANISTIQUE DE LA VILLE ALBANAISE (XIIe-XXe s.)

RESUME

Par le présent article on s'est fixé le but de tracer un panorama général de la nature et de l'évolution de la ville albanaise (à l'état actuel de nos confins politiques) depuis la moitié du moyen âge jusqu'au développement des rapports de production capitalistes, soit approximativement du XIIe au XXe siècle. Les documents sur lesquels se fonde ce panorama depuis la période ancienne jusqu'au XVIIe s. appartiennent aux sources écrites et aux ouvrages de divers auteurs, surtout des historiens, qui ont traité aussi collatéralement des problèmes de l'évolution et du caractère urbanistique de nos villes. Les données relatives à la période successive à l'occupation turque, à partir du XVIe s. et tout particulièrement depuis le XVIIe, ne cessent de croître de jour en jour. En ce qui concerne la situation de la ville albanaise aux XVIIIe-XIXe siècles les données sont de loin plus complètes, du fait que plusieurs centres préservent de nos jours même en tièrement, ou en partie, le caractère de l'ancienne urbanistique, en tant qu'importante valeur culturelle qui est souvent conservée et protégée comme monument.

Pendant les XIIe-XIVe s. la ville albanaise a connu un essor continu, par suite du développement des forces productives. L'artisanat en particulier fut favorisé en ce sens, du fait que les paysans eurent la possibilité d'échanger leurs produits exédentaires avec des productions artisanales. La politique fiscale de l'Etat byzantin, qui, dans la première moitié du XIe siècle, en substituant l'impôt en nature que devait payer les paysans à l'impôt en espèce, exerça également une influence positive dans cette direction. L'épanouissement du commerce entre les zones côtières albanaises et les villes situées sur les rives de l'Adriatique, comme Venise, Raguse et autres, imprimèrent aussi une impulsion à la construction des villes moyenâgeuses en Albanie.

La ville des XIe-XIVe siècles représentait un centre artisanal et commercial, remplissant aussi la fonction de marché pour les régions environnantes. L'économie fermée naturelle contraignait les habitants des villes de s'occuper aussi d'agriculture, de la culture des fruits et d'élevage, ce qui est démontré par les terres de superficie relativement étndue qu'ils possédaient aux alentours de la ville. Du nombre des villes de cette période une place importante revient à celle du littoral comme Shkodra, Durrës et Vlora, qui entretenaient des relations commerciales même avec les régions d'outre-mer ainsi qu'avec les villes de la côte dalmate, y compris Venise. Ce fait eut évidemment des conséquences sur le développement des moyens de navigation, qui constituaient un important domaine dans la vie économique de la ville albanaise. La pêche, et notamment les salines, assuraient d'importants revenus aux villes. Le développement économique des centres urbains accentua davantage encore la différenciation de classe de leurs habitants. Ceux-ci, en fonction de leur position économique, se répartissaient en populares, cittadini *et* nobilis. *Parmi les principaux métiers de l'époque, mentionnons celui du traitement des peaux, le tissage de la soie, le travail de l'argent, la poterie. Les métiers de forgeron, boulanger, boucher, cordonnier etc. étaient aussi assez répandus. Les aristocrates, outre les fonctions publiques d'importance, avaient la haute main sur le commerce. A Shkodër et à Durrës notamment se forma une puissante aristocratie commerciale, du fait que ces villes remplissaient le rôle d'intermédiaires dans le commerce avec les régions internes du pays.*

A l'époque la ville albanaise constituait en général un centre fortifié, entouré de murs d'enceinte qui étaient pourvus d'une entrée et flanqués de tours. L'incertitude due notamment à la migration des peuples, accentua encore plus la nécessité de garantir les agglomérations urbaines de toute attaque éventuelle. La plupart des villes de cette période, comme en général celles de la période moyenâgeuse, sont une continuation des villes anciennes se rattachant aux centres fortifiés illyriens. Les villes moyenâgeuses, en tant que continuation de celles plus anciennes, et les villes construites pendant le moyen âge, exemple Gjirokastra, surplombent d'habitude des hauteurs offrant une défense naturelle; bref, elles se dressent en général sur des terrains accidentés.

Le développement urbanistique de ces agglomérations a été profondément conditionné par la fortification à murs d'enceinte. Pratiquement cette enceinte délimitait clairement le terrain sur lequel s'étendait l'agglomération urbaine et, en conséquence, l'étroitesse du terrain constituait un facteur de première importance dans la composition urbanistique. C'est ju-

PO NOTCOPY

stement pour cette raison que les constructions étaient très denses et souvent composées en forme de chapelet. En général ces habitations regardaient directement la rue, elles manquaient souvent d'une cour ou celle-ci était très petite. L'agrandissement de la ville s'accompagnait souvent par des habitations se dressant l'une près de l'autre ou s'appuyant aux murs d'enceinte. L'étroitesse du terrain explique aussi la prévalence des maisons à étage. Dans la majorité des villes, la zone plus élevée était réservée aux habitations des couches riches. Le développement de la ville ne se rattache pas à un plan d'aménagement. Le réseau des rues commence à l'entrée des fortifications et se répartit en un grand nombre de rues étroites, sinueuses et pavées. Dans le but de se procurer un terrain de construction, on construisait souvent des ceintures au-dessus de la rue. Parmi les constructions des villes, une place à part occupent les édifices du culte qui se distinguent par leurs volumes et leur traitement architectonique.

Dans les villes une place importante revient aussi aux boutiques des artisans. C'est à proximité des murs d'enceinte des villes que furent aussi mis en place les marchés, où la population paysanne vendait sur une place ouverte ses produits.

L'évolution de la ville moyenâgeuse albanaise, le croissance du nombre de ses habitations, entraîna la nécessité d'élargir son enceinte qui commença à dépasser ses limites. On ne connaît pas exactement le commencement de ce processus, très important quant à l'avenir des agglomérations urbaines et qui marqua la naissance de la ville ouverte. Evidemment ce phénomène ne se vérifia pas simultanément dans toutes les villes albanaises de l'époque, du fait qu'il était conditionné par leur développement économique et social. Ainsi, à Berat l'on mentionne dès 1280 un quartier hors de l'enceinte (suburbia castri Bellogradi). A Gjirokastër, par contre, les habitations sont construites hors des murs d'enceinte de la forteresse dès la première moitié du XIVe siècle. La basse villé de Lezhe appartient sans doute à une période de plus ancienne.

Kullat në mbrojtje të hyrjeve (fig. 3) gjenden vetëm 9,50-9,96 m larg njera-tjetrës. Prej tyre janë zbuluar kullat e anës perëndimore 2 dhe 3 (fig. 20, 9), ndërsa ato të anës lindore, 8 dhe 9, janë ende të pazbuluara prej dheut. Megjithëkëtë konturi i tyre mund



Fig. 13



Fig. 14



Fig. 15

PHOTOCOPY

DO NOT COPY



Fig. 16 a

PRERJE 1-1 KULLA Nº 1



Fig. 16 b

PRERJE 2-2 KULLA Nº 1

DO NOT COPY



Fig. 17 a



Fig. 17 b

të ndiqet në mënyrë të përafërt. Kullat i kanë faqet anësore dhe të pasmet të drejta, ndërsa balloren të lakuar lehtë me mesin rreth 1,10 m më të dalë se skajet. Nëpërmjet këtij trajtimi kullat fitojnë një planimetri në formë të shkronjës U, por që dallon nga kullat klasike të këtij tipi, si ato të Skampinit, ku balli paraqet një gjysëm rrethi. Rrjedhimisht për përcaktimin e kësaj forme na duket më i përshtatshëm emërtimi kullë me ballë të lakuar. Kullat janë të tërhequra në brendi, ashtu si dhe kullat e mureve të anëve jugore e veriore, por në një thellësi më të madhe, 2,30 m. Kjo tërheqje lejon hapsirën e nevojshme për krijimin e oborrit të brendshëm të fortifikuar (propugnaculum), muret e të cilit nga jashtë gjenden në një plan me kurtinat, ndërsa brenda në një linjë me faqen e pasme të kullave.

Kullat kanë përmasa të jashtme 8,5 – 8,7 x 12,3 – 12,5 m dhe mure 1,70 – 1,80 m të gjerë. Nëpërmjet faqeve të gjata anësore të tyre arrihej një kontroll i mirë i hapsirës para hyrjes dhe oborrit. Në anën nga kurtina kullat projektohen rreth 7,80 m pa ja penguar shikimin reciprok kullave të skajeve.

Në ambientin e katit të parë të kullave, 5,10 – 5,40 x 8,8 – 9 m, të verbër nga jashtë, të fusin hyrje rreth 1,20 m të gjera dhe 2,40 m të larta tek themrat, të mbuluara me qemer dhe me konstrukt të njejtë me hyrjet e kullave të tjera.

Oborret e fortifikuara gjenden në meset e anëve lindore dhe perëndimore të mbrojtur prej kullave të mësipërme. Prej tyre oborri i anës perëndimore është zbuluar plotësisht (fig. 20, 9), ndërsa oborri i anës lindore është ende i mbuluar prej dherave. Oborri perëndimor nga anët kufizohet prej mureve të kullave mbrojtëse, në ballë gjendet një mur 1,10 m i gjerë, faqja e jashtme e të cilit gjendet në një plan me faqet e jashtme të kurtinave, ndërsa mbrapa, në të njëjtin plan me faqet e pasme të kullave, gjendet muri i pasëm i oborrit, po 1,10 m i gjërë. Në këtë mënyrë krijohet një vëllim i mbyllur me planimetri drejtkëndëshe me përmasa 9,95 x 2,60 m. Në mesin e tij ai përshkohet prej dy hyrjesh prej të cilave ruhen të plota shpatullat e majta. Shpatullat janë të rrafshta, pa paturë, të punuara me gurë të gdhendur në pjesën e poshtëme. Hapsirat e portave të tyre janë e jashtmja 3,45 m, ndërsa e brendshmja, ndonëse jo e kapur me siguri, 3,86 m.

Teknika e ndërtimit. Muret e kështjellës së Vigut, si të kurtinave ashtu dhe të kullave, janë ndërtuar me teknikën «opus mixtum», me muraturë guri të shkëmbyer me breza tulle. Këta të fundit e nivelojnë dhe lidhin më mirë murin e gurtë, duke i shpërndarë uni-



Fig. 18 a



PRERJE A-A KULLA Nº3



PRERJE B-B KULLA Nº3



PRERJE B-B KULLA Nº2



PRERJE A-A KULLA Nº2

Fig. 18 b

DO NOT COPY



PRERJE 1-1 KULLA Nº 12



PRERJE 2-2 KULLA Nº 12

Fig. 18 c

formisht goditjet e predhave të gurta dhe lëkundjet sizmike. Muratura prej guri përbëhet prej faqeve anësore dhe pjesës së mesit. Faqet janë punuar me kujdes me gurë lumi me madhësi mesatare (rreth 0,30 x x 0,15 x 0,15 m) të papërpunuara, të rradhitur në rreshta horizontalë me anën e kurbëzuar jashtë (fig. 21). Gurët janë vendosur sheshazi, puqur me njeri-tjetrin, duke u rindërfutur gurët e një rreshti me ata të rreshtit tjetër në formë fushe shahu, kjo vendosje shmang boshllëqet e mëdha dhe siguron një lidhje më të mirë të tyre. Në vendet e ruajtura shihet se llaçi mbulon sipërfaqen më të madhe të gurit, duke i lënë në dukje vetëm mesin.

Pjesa e mesit, në ndryshim prej muraturës së derdhur, ku gurët përzihen në mënyrë të çrregullt me llaçin, janë vendosur me një farë shtresëzimi horizontal (fig. 22). Por ndryshe prej faqeve gurët kanë përmasa nga më të ndryshmet që lëvizin prej 7 x 8 cm deri në 1 x 0,60 x 0,5 m. Së fundi në themelet kemi të bëjmë me një muraturë të derdhur, ku gurët janë përzier pa kriter me një sasi të madhe llaçi (fig. 12).

Brezat e tullës kanë 3 rreshta dhe një gjerësi rreth 24-26 cm (fig. 23). Vetë tullat kanë përmasa 39 x 26-27 x 4-6 cm kryesisht 39 x 26 x 4,5. Fugat horizontalë të tullave lëvizin nga 4-5 cm, duke pasur një trashësi afërsisht të njëjtë me tullat. Brezat nisin mbi murin e gurtë të ndarë nga një shtresë llaçi 4-8 cm, ndërsa në pjesën mbi brezin shtresa e llaçit nuk i kalon 2-3 cm. Ata vijojnë në drejtim horizontal, pa u shkëputur ose zhvendosur në lartësi në bashkimet e faqeve të kulave me kurtinat. Si pasojë për shkak të luhatjeve që pëson terreni lartësija e tyre prej tabanit ndrron nga 1,3 në 1,7 m por normalisht ajo është 1,60 m. Brezi i dytë nis po 1,60 m mbi të parin. Brezat nuk e përshkojnë tejpërtej trashësinë e murit. Rreshtat e skajeve, që hynë në një thellësi 0,67 m, përbëhen prej një sërë tullash të vendosura me anën e ngushtë jashtë dhe një sërë tjetër në brendi të vendosur nga ana e gjerë. Rreshti i mesit, i cili ndërhyn 0,39 m në gjerësi, përbëhet vetëm prej një sëre tullash të vendosura me anën e ngushtë jashtë. Siç shihet në ballet e mureve pasqyrohet vetëm ana e ngushtë 0,27 m.

DO NOT COPY



Fig. 19

Në brinjët e takimit të kullave me kurtinat, midis dy brezave, gjenden rripa tulle të cilët nisin mbi brezin e parë duke u zgjeruar në formë pyke nga 1 gjer në 3 tulla, deri tek brezi i II (fig. 13). Po kështu në rakordimet e faqeve anësore me ballet e kullave sektoriale ose ballëlakuara, brinjët e takimit përforcohen me rripa tulle 5-7 tulla të gjerë, të cilët nisin që në taban (fig. 10). Me tulla janë punuar dhe pjesët e sipërme dhe qemeret e hyrjeve.

Bashkimi i gurëve dhe i tullave është kryer me llaç shumë të fortë, me sasi të madhe gëlqereje, që kuptohet nga ngjyra e tij e bardhë, me mbushës të ashpër, rërë lumi, me granula 1-3 mm, të përzier me zhavor të imët me granul 10 mm. Gjurmë të një grumbulli mbeturinash të nxjerra nga shuarja e gëlqeres tregojnë se shuarja e saj kryhej në afërsi të mureve.

Në muraturën e gurtë dhe mjaft rrallë në brezat e tullës shihen vrima kuadratike 0,10 x 0,10m, të vendosura 1,5 – 2,4 m larg njera-tjetrës në drejtim horizontal dhe 1,7 m në drejtim vertikal. Vrimat e mësipërme nuk mund të jenë vrimat e skelerisë pasi ato shpesh nisin 0,3 – 0,5 m mbi taban. Mendojmë se ato janë vrima të lëna për rrjedhjen e shpejtë të ujit të llaçit. Pak mundësi ka që ato të kenë shërbyer si rrjet i drunjtë, veçori që haset në ndërtimet mesjetare, pasi këtë rol e luajnë brezat e tullës dhe nga ana tjetër mungojnë trarët gjatësorë. Së fundi rrjetin e drunjtë nuk e kemi hasur në asnjë fortifikim tjetër të kësaj kohe.

Gjetjet. Në kështjellën e Vigut si në brendi të saj ashtu dhe jashtë gjetjet mungojnë thuajse tërësisht. Në brendi të kështjellës shtresa kulturore është mjaft e cekët rreth 15 cm. dhe përbëhet veç prej fragmentesh tjegullash që tregojnë praninë e ndërtimeve të



Fig. 20

DO NOT COPY

lehta prej druri ose qerpiçi të mbuluara nga sipër. Ndër to shumicën e zënë tegulae-t, ndërsa imbriciset janë më të pakët. Tegulat nuk ruhen në ekzemplare të plotë, kështu që përmasat e tyre nuk i nxjerrim dot. Nga fragmentet e ruajtur kuptojmë se ato qenë të sheshta me trashësi 2-3 cm ndërsa buzët i kishin të profiluara me kënd të drejtë, 2-3 cm të larta dhe po 2-3 cm të gjera. Për të lejuar mbivënien e njëra-tjetrës, nga ana e sipërme buza mbaron 3-5 cm para fundit. Imbriciset kanë trashësi 1.5 cm dhe kanë profil të kulmëzuar shumë lehtë në mes. Tjegullat janë punuar me një brumë kompakt, i cili mbas pjekjes ka marë ngjyrë okër ose të kuqëremtë. Në brumin e disa ekzemplarëve shihen kokriza gëlqereje, ndoshta të futura për dobësimin e majmërisë së brumit, ndërsa tek të tjerat kokriza shtufi dhe grimca tulle. Në syprinën e tyre shihen të vizuara vija diagonale ose zik-zake. Në brendi të territorit u gjend një monedhë e Kostandinit[8]. Përveç saj në kështjellë është zbuluar prej S. Anamalit një pjesë mbishkrimi, i cili lexon



Fig. 21

EX PRAESIDES OFICI

Punimet e restaurimit. Si pasojë e kohës, vërshimit të lumenjve dhe dëmtimit prej banorëve para vënies së monumentit në mbrojtje, muret e kurtinave dhe kullave paraqiten të degraduar. Më keq është ana veriore në të cilën vërshimet e përroit kanë shkatërruar kullat dhe një pjesë të madhe të murit. Për të eliminuar dëmtimin dhe degradimin e mëtejshëm u ndërmorën punime restaurimi në anën jugore dhe veriore të fortifikimit. Anët veriore dhe lindore nuk u prekën pasi zona e përroit në lindje të tyre parashikohet të disiplinohet nëpërmjet mbjelljes sistematike të drurëve të formacioneve halorë. Nëpërmjet këtij pyllëzimi do arrihet stabilizimi i terrenit dhe vetëm pas tij mund të bëhen të mundura punimet e mëtejshme të restaurimit, pasi në të kundërt ujërat e vrullshëm do gërryenin dhe rëzonin muraturën. Në këtë rast efekti i saj do të qe i kundërt pasi muratura do të shërbente si pritë duke i bërë më aktive ujërat. Po kështu ndërtimi i një pende në lindje të anës veriore përveç shpenzimit të konsiderueshëm do të shkaktonte devijimin e përroit para anës lindore duke i shtuar depozitimet dhe duke e dëmtuar këtë anë. Për këtë arsye u parashikua që punimet të kryhen në dy etapa. Në të parën do të restaurohej ana jugore dhe veriore dhe më tej pas pyllëzimit ajo lindore dhe veriore. Në fazën e I në vitin 1976 u kryen punime në kullat 1,2,10,11,12



Fig. 22



Fig. 23

8) faqe: CONSTANTINUS AVG.
shpinë: PROVIDENTAE AVG.
Æ 1,75 gr, 17 mm
H. Cohen, **Medailles Imperiale,** Leipzig, 1830, VII, 281, Nr. 454. Monedha i përket fillimit ose mesit të sundimit Kostantinit, rreth viteve 312-320.

POOR COPY



Fig. 24

(fig. 24) dhe kurtinat 10-10, 11-12, 12-1. Domosdoshmëria e punimeve në kullat e kësaj ane qe e domosdoshme se konturi i tyre nuk paraqitej i mbyllur, me ballin e jashtëm të rrëzuar. Si pasojë muret anësorë të pastabilizuara me profil të pjerrët, ishin në gjendje të vazhduar degradimi dhe rrëzimi (fig. 25). Ky rrezik shtohej pasi në momentet e prurjes maksimale uji arrinte një lartësi 1-1,20 m nga tabani duke rrokullisur me vete dhe gurë të mëdhenj mbi 1 m, të cilët e godisnin dhe e rrëzonin murin. Për ta shmangur këtë muret e kullave të kësaj ane u ngritën mbi nivelin e prurjes.

Muret e ngritur rrishmë në pjesën e sipërme u sollën në një linjë horizontale, por vende-vende konturi i tyre u zbrit 1-2 rreshta më poshtë në mënyrë që të thyhet rregullsia që do krijonte një perceptim të gabuar, sikur kjo ka qenë lartësia fillestare e murit. Në bërthamë muret u punuan, ashtu si dhe muret origjinalë, me gurë me përmasa mesatare pa ndjekur ndonjë uniformitet në madhësi, por të lidhur me llaç bastard të markës 30.

Në anën e jashtme gurët u zgjodhën sipas përmasave të mureve ekzistuese rreth 26-35 x 15-20 cm me trajta të rrumbullakosura. Për lidhjen e tyre u përdor llaç bastard M. 15. Gurët e vendosën në rreshta të rregullt horizontalë, duke u zgjedhur me lartësi afërsisht të njëjtë për rresht. Në vendosjen e tyre u mor parasysh dhe ndërfutja e gurëve të rreshtit të sipërm me të poshtëmin në formë fushe shahu, sipas teknikës origjinale, që njëkohësisht siguron zhvendosjen e fugave vertikale nga njëra-tjetra. Duke ndjekur teknikën origjinale, gurët u niveluan nga jashtë me llaç duke lënë të dukshme vetëm pjesën e mesit të gurëve që i jep një pamje karakteristike muraturës së këtij fortifikimi.

Një problem tjetër që mbetej për t'u zgjidhur ishte plotësimi i brezave të tullës, të cilët në shumicën e tyre paraqiteshin të grabitur. Brezat ekzistues kanë pasur gjerësi rreth 0,30 m dhe 3 rreshta tulle në brez, përjashtuar këtu skajet në të cilat brezat zgjerohen së tepërmi. Përmasat e tullave të brezave janë 39 x 26 x 46 m. Siç shihet gjerësia e këtyre tullave është thuajse e njëjtë me gjerësinë e tullave të sotme (26 ndaj 25 cm). Për këtë arsye u përdorën tullat e zakonshme të cilave ju gdhend paraprakisht në mënyrë diagonale njëra nga brinjët. Në këtë mënyrë përmasat e tullave të reja janë të njëjta me tullat origjinale dhe u krye markimi i ndërhyrjes restauruese. Brezat e tullave u riplotësuan në kullat 12,11, 10, në anën e brendshme dhe të jashtme si dhe në kurtinat 10-11 dhe 12-1, në pjesët ku mbi brezin vijon muri i gurtë. Në kurtinat ku brezi shënonte mbarimin e murit ai nuk u plotësua. Duke qenë se dhe sipas teknikës origjinale brezi nuk e përshkon gjerësinë e murit, tullat në të u vendosën vetëm nga ana e jashtme.

Në kullën 10, me tulla u punua brezi në afërsi të



Fig. 25

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 26

brinjës së takimit me kurtinën 10-11, ndërsa pjesa tjetër ku brezi ulej në lartësi u la e lirë. Përveç kësaj me tulla u punuan dhe brinjët ku shpatullat e kullës nga të drejta lakohen. Në këtë vend sipas gjurmëve ekzistuese gjerësia e brinjës prej tulle lëvizte nga 3 në 5 rreshta (fig. 15). Nëpërmjet këtyre punimeve u shmang rreziku i dëmtimit të mëtejshëm të anës jugore dhe monumenti fitoi vizitueshmërinë. Punimet e fazës së II që do kryhen vitet e ardhshëm do ta shmangin përfundimisht degradimin e monumentit.

* *
*

Studimi për hartimin e projektit të restaurimit të kështjelës së Vigut, punimet e restaurimit dhe pastrimet krijuan mundësi për rikonstruksionin e plotë të planimetrisë së kështjellës dhe në një farë mase, në bazë të krahasimit tipologjik, dhe zhvillimin altimetrik.

Duke i rigrupuar dhe plotësuar të dhënat e mësipërme, rezulton se kështjella e Vigut ka pasur planimetri në formë trapezi të shmangur lehtësisht nga trajta drejtkëndëshe dhe një sipërfaqe prej 0,65 hektarësh (fig. 26). Kështjella paraqet një fortifikim të fuqishëm me kurtina 2,35-2,45 m të gjera, të ndërtuara me muraturë të përzier. Duke marë parasysh se muret e kështjellës së Odruhut, tipologjikisht e njëjtë me Vigun dhe e ruajtur në lartësi të plotë, janë 5,70 m

të larta deri në shtegun e kalimit të kurtinës[8/1], përmasë që përkon me atë të kurtinave të kështjellës tjetër fushore në vendin tonë, asaj të Paleokastrës[9], po këtë lartësi paramendojmë se kanë pasur dhe kurtinat e Vigut. Në fakt duke u nisur nga lartësia 1,90 m e pjesës së sipërme të brezit të parë nga tabani dhe nga një lartësi po e tillë e brezit të II; syprina e brezit të III do përkonte pikërisht me tabanin e shtegut të kalimit, i cili në rastet e muraturës së përzier zakonisht shtrohet me tulla.

Punimet e pastrimit treguan se në kështjellë mungonin shkallët për në shtegun e kurtinës, ngjitja tek i cili kryhej nëpërmjet shkallëve të drunjta në katin e I të kullave. Mungesa e shkallëve të mësipërme, megjithëse nuk përjashtohet mundësia e pajisjes me shkallë të përkohshme provizore të mbështetura tek dhëmbëzimet e brendshme të kullave, të cilat hiqeshin në rast luftimi, ndonëse sjell një farë pavolitshmërie në zënien e shpejtë të pozicioneve të luftimit në kurtinat, e rrit mbrojtjen e fortifikimit. Armikut që arrinte të ngjitej nga jashtë në shtegun e kurtinës i duhej të hidhej nga një lartësi prej rreth 6 metrash me paimet e plota, në një kohë që goditej si nga brenda fortifikimit, ashtu dhe nga faqet anësore të kullave, gjë kjo e pamundshme.

Thellësia e vogël e themelit, rreth 1-1,30 m, si e mureve ashtu dhe e kurtinave, lejonte përdorimin e «minës» së galerive nëntokësore. Kjo thellësi, e njejtë me atë të kështjellës në Paleokastër, mendojmë se shpjegohet me mosnjohjen e kësaj teknike nga armiqtë e mundshëm ose me nivelin e cekët të ujit nëntokësor.

Kështjella përforcohej prej 12 kullash të fuqishme me ballët mbi 8 m të gjerë dhe gjatësi 10 m e më tepër. Kullat ndërlidhen organikisht me murin duke paraqitur një ndërtim monolit, veçori kjo për fortifikimet pas shek. III[10]. Kjo si dhe përmasat e kullave, mjaft të mëdha për një fortifikim të vogël, dëshmojnë se kullat luanin një rol me mjaft rëndësi në sistemin e fortifikimit.

Kullat gjenden në një largësi 21-25,6 m larg njëra-tjetrës, ndërsa ato që mbronin hyrjen vetëm 10 m larg[11] (fig. 3). Duke marë parasysh përmasat dhe strukturën e kullave që lejonte vendosjen e armëve të rënda në to, kjo largësi siguronte mbulimin e plotë të dyanshëm të kurtinës dhe kullave me zjarr nga të gjithë nivelet e luftimit të kullave. Në fakt një shpeshtësi e tillë haset kryesisht në muret e përforcuar me kulla më të vogla, si Paleokastra, por në muret e pajisur me kulla të fuqishme si ato të Vigut, si në Skampin[12], ato gjenden mbi 50 m larg njëra tjetrës.

Kullat e kështjellës së Vigut kanë planimetri drejt-



Fig. 27

8/1) R. E. Brunov – A. Domaszevski, **Die Provincia Arabia,** strassburg, 1905, II, 437. Lartësinë e kullave të skajit në Odruh ata e japin 12,90 m. Lartësi kurtinash të përafërta kanë Trieri 6, 13, Aosta 6, 7, Turini 6, 33 (A. M. Schneider – W. Karnapp, **Die stadtmauer von Iznik (Nicaea),** Berlin, 1938, 40).

9) A. Baçe, **Kështjella e Paleokastrës,** material në arkivin e I.M.K.

10) R. Schultze **Die romischen Stadttore,** Boner Jahrbücher, Heft 118, Bonn, 1909, 348.

11) Ky proces që vërehet në fundin e shek. III-IV (R. Schultze, **Po aty),** nuk është rigoroz, kështu në Skampin kullat janë mjaft më larg.

12) Përmasat e kullave të Vigut, i afrohen tepër atyre të Skampinit, ku kullat në formë të shkronjës U kanë përmasa 11 x 9, ndërsa sektorialet reze 13,5 m (Gj. Karaiskaj **Kalaja e Elbasanit,** Monumentet 1, f. 72 tab. II), dhe janë më të mëdha se të Paleokastrës, me përmasa rreth 4,5 x 3,5.

DO NOT COPY

këndëshe në meset, me ballë të lakuar afër hyrjeve dhe sektoriale në anët. Një shpërndarje e tillë nuk është e rastit, por e studjuar. Kullat sektoriale sigurojnë nëpërmjet harkimit të ballit një rikoshetim të mirë të goditjeve të makinave gurhedhëse, drejtimi i të cilave në skajet është më me kënd dhe shpeshtësia më e madhe. Po për këtë qëllim u është lakuar balli dhe kullave në mbrojtje të hyrjeve, zona këto po aq të goditura. Madje nga ky shkak në të dy tipet e mësipërme janë lakuar edhe brinjët e takimit të faqeve të drejta anësore me ballët e harkuara. Nëpërmjet faqeve të drejta anësore, si kullat sektoriale ashtu edhe ato me ballë të lakuar, siguronin flankimin e duhur të kurtinave. Vendosja e kullave sektoriale në skajet shpjegohet dhe me shmangien e zonave të vdekura që do sillte vendosja e kullave kënddrejta, siç shihet nga skema e kryqëzimit të zjarrit. (fig. 27). Këto zona nuk krijohen në meset ku mbulohen prej kurtinës.

Nga ana tjetër për një perimetër të njejtë, përkatësisht për një harxhim të njëjtë materiali, kullat kuadratike kanë një sipërfaqe 50 % më të madhe të ambienteve. Po kështu ndërtimi i kullave të drejta paraqitet teknikisht më i lehtë se i mureve të harkuar. Vendosja e kullave sektoriale në skajet, e atyre me ballë të lakuar tek hyrjet dhe i kullave kënddrejta në meset, tregon se ndërtuesit e kështjellës qenë të vetëdijshëm për këto cilësi dhe i përdornin elementet përbërës të fortifikimit në mënyrë racionale, të studiuar.

Duke u nisur nga analogjia me fortifikimet e tjera të ruajtura kullat e skajit duhet të kenë pasur 3 kate[13]. Prej tyre kati I i verbër nga jashtë shërbente për mbajtjen e kafazit të shkallëve dhe si depo, ndërsa katet e tjerë duhet të kenë qenë pajisur me frengji. Mungesa e fragmenteve të tjegullave, si në kullat e anës ashtu dhe ato të meseve, tregojnë se ato kurorëzoheshin prej taracës me gjoksmbrojen e dhëmbëzuar. Komunikimin e kullës me kurtinat, i domosdoshëm ky nga mungesa e shkallëve të jashtme, e supozojmë si në skicë, nëpërmjet një koridori diagonal, të degëzuar (fig. 28).

Kullat e meseve në anallogji me fortifikimet e tjera duhet të kenë qenë 2 katëshe, duke e pasur dyshemenë e katit II në nivelin e shtegut të kalimit të kurtinës. Ambienti i katit të II duhet të ketë qenë më i gjerë se ai i katit I për të krijuar mundësi për hapjen e domosdoshme të dyerve anësore për në kurtinë, e pamundur kjo në se gjerësia e mureve do mbetej po ajo e kateve të parë. Ky dhëmbëzim do



Fig. 28

shërbente dhe për vendosjen e trarëve të dyshemesë së katit II (fig. 19).

Muret e oborrit të fortifikuar (fig. 29) duhet të kenë qenë në një nivel me pjesën e sipërme të kurtinës. Gjerësia e pakët prej 1.10 m e tyre e heq mundësinë e pajisjes me gjoksmbrojë të dhëmbëzuar. Në fakt pranija e ushtarëve mbi këto mure nuk qe e nevojshme pasi e tërë hapsira e ngushtë prej 10 metrash mbulohej më së miri prej faqeve mjaft të gjata të kullave. Për të mbuluar më mirë zonën para oborrit dhe për të siguruar zjarrin e kryqëzuar duket se shërbente dhe harkimi e rakordimi i balleve të kullave. Mungesa e paturës së hyrjeve dhe e bllokut të mesit tregon se bllokimi i të dy portave nga hapja jashtë kryhej nëpërmjet harkut i cili mbulonte hapsirën e murit dhe se portat vareshin në kasa të brendshme. Mungesa e vrimave të katarahut tregon dhe se sigurimi i portës kryhej me anë të një sistemi llozesh.

Shqyrtimi arkitektonik dhe rikonstruksioni i kështjellës na jep mundësi për krahasimin me fortifi-

13) R. E. Brunov. A. Domaszevski, **(vep. cit.** II, 435) japin shembullin e Odruhut. I këtij mendimi është për Skampinin Gj. Karaiskaj **(Kalaja...,** 64).

DO NOT COPY



Fig. 29

kimet e tjera fushore të kësaj kohe. Kullat e skajeve të fortifikimeve fushore të periudhës së vonë antike janë kuadratike ose në formë freskoreje dhe rrallë rrethore. Tipi I gjendet më i përhapur në fortifikimet e provincës Arabia[14] dhe mjaft rrallë në prefekturën e Ilirikut (Mogorjelo)[15]. Këtë tip e gjejmë dhe në kështjellën e Paleokastrës, por në anën ngjitur me lumin ku nuk mund të vendoseshin makina gurhedhëse dhe nuk krijoheshin zona të vdekura. Raporti i mësipërm paraqitet i përmbysur për kullat freskore. Kulla të tilla gjenden me shumicë në kështjellat e prefekturës së Ilirikut[16] ku mund të ndiqet dhe evolu-

14) R. E. Brunov – A. Domaszevski, **(Vep. cit.** I, II, III), japin një sërë kështjellash të tilla: Castra praetoria Mobeni, Gadiumfala. Zbatitla, Kessera, Heushir Sguidani, Trajja, Raba etj.

15) D. Basler, **Bazilika na Magorjelu,** Nase starine, Sarajevo, 1958, V, 45.

16) Drobeta: **Römer in Rumanien,** 139, Vojvoda, A. Милчев – C. Damahob, **Археологическу разконки при воивода,** И.А.И, 1972, XXXIII, 263-275. Abritusi T. Ивано**в Укрепителната система на Абрумуç** Axpeolosua, 4, 1966, 23; Dinogetia: I. Barnea. P. Garvan, **Dinogetia,** Bucuresti, 1962; Tropeum Traiani; R. Velpe I. Barnea, **Din Istoria Dobrogei,** Bucuresti, 1968; II, 384; Kapidava; G. Florescu – R. Florescu P. Diaconu, **Capidava,** Bucuresti 1958, I, 25-72; Jatrus, T. Ubahob Apxeolorua III, 1961, 18, V, 1963, 4. Për Provincën Arabia R.E. Brunov – A. Domaszevski **(vep. cit.,** I, 435, III, 36), japin El-legunin dhe Odruhun thuajse identikë me njeri-tjetrin.

DO NOT COPY

cioni i tyre[17]. Në vendin tonë këtë tip e gjejmë në tërë fortifikimet e njohura fushore: Skampin (Elbasan), Vig, Paleokastër. Në të kundërt në provincën Arabe ai haset rrallë. Kjo veçori mund të shpjegohet se armiqtë e mundshëm në drejtime të ndryshme prej atyre në Ilirik duke pasur një shkallë më të ulët zhvillimi të teknikës së rrethimit nuk i përsosën gjerë armët gurhedhëse. Në kullat e skajeve mund të dallohen dy tipa. I pari me planimetri një çerek rrethi, ndërsa i II afërsisht në formë patkoi të ngushtuar në bazë. Prej tyre tipi parë, të cilit i përkasin Vigu e Skampini, haset më shpesh, ndërsa tipi II më rrallë. Këtë tip në vendin tonë e gjejmë në Paleokastër, ndërsa jashtë në Tropeum Trajani[18] dhe Jatrus; prej tyre dy të parat datohen prej mbishkrimeve në periudhën e sundimit të Licinit. Gjetjet në kështjellat me kulla skaji në trajtë çerek rrethi i përkasin kryesisht periudhës së Konstantinit, kështu që për këto kulla si datë më të mundshme shohim çerekun I të shek. IV.

Përsa i përket kullave të meseve vihet re se në tërë fortifikimet me skajet e pajisura me kulla kuadratike, edhe kullat e meseve janë po kuadratike, ndërsa tek ato me kulla skaji në formë freskoreje, kullat e mesit janë kryesisht në trajtë patkoi[19]. Rastet kur në skajet kullat janë në formë freskoreje, ndërsa në meset drejtkëndëshe janë mjaft më të pakëta (Drobeta, pjesërisht Kapidava), por në të dy kështjellat fushore në vendin tonë, në Vig dhe Paleokastër, kullat e mesit kanë formë kënddrejtë ndonëse në të parën, në hyrjet, ato janë me ballë të lakuar lehtë. Siç shihet ndonëse ky proces është i njohur (Skampini, si dhe lakimi i ballit tek kullat e hyrjes në Vig) në meset e kështjellave të Vigut dhe Paleokastër parapëlqehen kullat kënddrejta, të cilat kanë anët e tyre pozitive, por dhe negative në krahasim me kullat patkua.

Së fundi oborri i fortifikuar (propugnaculum) i kështjellës së Vigut, krejtësisht i njëjtë me atë të Skampinit, paraqet një nga variantet më klasikë dhe të studiuar të këtij elementi. Në fakt mbrojtja e hyrjes nga dy kulla anësore është një element që haset që në fortifikimet antike ashtu dhe në ato romake të hershme[20]. Nga fundi i shekullit III në një pjesë të kështjellave hyrja vazhdon të mbrohet prej dy kullash, tashmë të dala nga muri[21]. Por në një sërë fortifikimesh të tjera mbrojtja e hyrjeve kryhej nëpërmjet oborrit të fortifikuar (propugnaculum) dhe kullave. Qëllimi i këtyre oborreve ishte që në se armiku do shpërthente portën e parë të goditej nga lart i kufizuar në numër. Këtë mënyrë mbrojtjen e shohim që në fortifikimet e hershme perandorake[22]. Të ngjashme me oborret e Vigut dhe Skampinit janë në rradhë të parë Istanbul Kapi-ja në Iznik (Nikae)[23] ku dy kullat janë në formë patkoi, ndërsa obori 10 m i gjerë gjendet në plane të njëjtë me kurtinën dhe faqet e pasme të kullave. Një trajtim të tillë shohim dhe në Slaveni[24], me sa duket në fazën II që i përket shek. III-IV, si dhe në Bologa[25] dhe Ed Dumer[26]. Si koncept këta oborre i hasim dhe në Dinogetia dhe Abritus, por në to si faqe anësore të oborreve nuk shërbejnë faqet e kullave, por mure të veçantë. Prej tyre tipin klasik e paraqet grupi I ku hynë Skampini dhe Vigu, pasi si hyrja ashtu dhe oborri gjenden nën kontrollin e plotë të kullave, ndërsa në grupin II ky kontroll s'është efikas. Duke marë parasysh se fortifikimet e mësipërme në pjesën më të madhe i përkasin periudhës së sundimit të Konstandinit dhe në vazhdim të shek. IV këta oborre zhduken[27], mendojmë se ky grup daton në çere-

17) Kështu në Arutela ose Drobeta në fazën e shek. II-III ato janë të brendshme, ndërsa në fazën e shek. të IV në Drobeta ato dalin jashtë, por të ndikuara nga lakimi i skajit marrin një formë më të shtrirë.

18) R. Vulpe – I. Barnea, **vep. cit.** II. 384.

19) Të tilla janë Skampun El. Ieggyni, Odruhu, Vojvoda, Abritusi, Slaveni, Dinogetia etj.

20) G. Boon **Carleon Vindonisa – Windisch,** jep fortifikimet e Çesterit, Pinnatës, Karnuntit, Lauriakut, Lambezës, Ksantenit, Bonit, Nimazenit etj., ku shihet se deri në shek. II hyrjet mbroheshin prej dy kulash, por të brendshme.

21) Të tilla në Ilirik janë Dioklecianopoli **К. Маджаров, Нови разкопки и Проучвания на Хисарската Крепост, И. А. И.** XXX, 1967 113-141. Paleokastra, Tropeum Trajani, ndërtime këto të periudhës së Dioklecianit dhe Licinit.

22) A. M. Schneider – W Karnapp, **Die stadtmauer von Iznik (Nicaea)** Berlin), 1938, Tab. 16.

23) R. Schultze, **Die römische Stadttore,** Borner jahrbücher, Heft 118, Bonn 1909 (Aosta, Nimes, Bon, Trier etj.)

24) D. Tudor, **Recentele săpături archaelogice romane,** Acta musei Napocensis, Alba Iulia, XI, 1973 117-120.

25) D. Alicu, **Turnuri de Porti,** Acta Musei Napocensis, X, 1973.

26) R. E. Brunov – A. Domaszevski **(Vep. cit.)** Por në Ed Dumer nuk është e qartë pranija e murit të pasëm të oborrit.

27) R. Schultze **vep. cit.** 347.

DO NOT COPY

kun I të shek. IV, ndërsa mbrojtja vetëm me kulla parapëlqehet në kapërcyellin e shekujve III-IV.

* * *

Për nga sipërfaqja, prej 0,615 ha, Vigu mbetet midis kështjellave klasike 1 hektarshe të destinuara për dislokimin e një kohorte mijëshe këmbësorie ose rrallë kalorsie (cohors peditata, ose equitata, miliaria) dhe fortifikimeve të vogla rreth 0,10 hektarshe për një çenturie ose më pak[28]. Rrjedhimisht, mendojmë se në kështjellë dislokohej një kohortë pesqindëshe këmbësorie (cohors peditata quingenaria) me 6 centurie (500 vetë) ose, me ngushtësi, një kohortë pesqindëshe kalorie (cohors equitata quingenaria) me 6 centurie dhe 6 turma (480 vetë dhe 120 kuaj).

Në ndryshim prej Nopçës, Ippenit dhe Shtatmylerit të cilët shohin në Vig një postbllok për ndalimin e inkursioneve të malësorëve në zonën fushore, jemi të mendimit se kështjella e Vigut ka qenë një stacion kontrolli ushtarak i rrugës Lis-Ratiaria, në traktin e saj të parë. Në fakt popullsia e zonës malore që e njihte mjaft mirë terrenin mund të ndiqte shtigje nga më të ndryshmit, duke e shmangur plotësisht Vigun. Kjo ka rrjedhur nga që për caktimin e funksionit të kështjellës studiuesit e parë u nisën nga gjendja aktuale dhe jo fillestare. Në fakt rruga e sotme prej Lezhës ose Shkodrës për në Pukë, Vaun-Spas dhe më tej në Prizren, pika në të cilat kalonte dhe rruga për në Ratiaria, i përmbahet luginës së Guminës, duke e lënë mënjanë luginën e Gjadrit. Ky itinerar, më i volitshëm në se pikënisja e kësaj rruge është Shkodra dhe jo Lezha, duket se i takon periudhës së pushtimit turk, kur Lezha e kishte humbur rëndësinë e saj të dikurshme si skelë dhe kryestacion rrugor, nga dobësimi i tepërt i lidhjes lindje-perëndim. Si pasojë në këtë kohë në drejtimin ekonomik e tregtar Shkodra fiton një rëndësi të dorës së parë dhe rruga ndjek trasenë më të shkurtër. Në të kundërt në shekullin IV, Lisi (Lezha) paraqitej mjaft më i përshtatshëm si pikënisje se Skodra (Shkodra), pasi ishte i pajisur me një skelë detare mjaft të mirë (Nymfeu – Shën Gjini i sotëm).

Rruga siç e tregon Tabula Peutingerriana shkëputej nga trungu Skodër – Lis – Dyrrah mbas Lisit, midis tij dhe Pistumit (Ishmit). Mëtej ajo duket se vijonte deri tek ura e Gjadrit sipas itinerarit të rrugës së sotme Lezhë – Vau i Dejës dhe duke ndjekur rrëzë kodrave shtratin relativisht të gjerë të lumit, arrinte pa vështirësi në Vig. Prej këtej nëpërmjet luginës së Kaftallit ajo të nxirrte në Korthpulë – Pukë e Vaun Spas. Krahas kësaj nëpërmjet luginës së Gjadrit kalohej në Kaçinar, ndërsa nëpërmjet asaj të Vomës në Kalivaç e Rëshen. Siç shihet Vigu paraqet një nyje të rëndësishme, ku prej rrugës kryesore degëzoheshin rrugë të tjera të dorës II, kontrolli i së cilës qe i nevojshëm.

Lidhur me identifikimin e kështjellës së Vigut mund të nisemi nga të dhënat e Tabula Pentingerianës. Sipas saj stacioni i parë pas Lisit është Ad Picaria i cili duke u nisur nga afria Pukë – Pikaria është identifikuar me Pukën dhe më tej Kreveni[29]. Por Tabula e cakton atë 30 mile pasum (44,445 km) larg Lissit, largësi që përkon mirë me rrugën Lezhë – Vig, 43 km, dhe jo me atë Lezhë – Pukë, 60 km. Rrjedhimisht, mendojmë se Ad Picaria duhet të ketë qenë Vigu ku dhe i gjejmë gjurmët materiale. Në të mirë të këtij mendimi është dhe fakti se në kozmografinë e anonimit të Ravenës, e cila i përket një kohe kur kështjella e Vigut ishte braktisur, shek. V-VI, pas Lisit jepet menjëherë Kreveni[30].

Fragmenti mbishkrimor i gjetur prej S. Anamalit do parë si mbishkrim votiv, i dedikimit të ndërtimit të kështjellës prej presidit perandorit. Këto mbishkrime, me të cilat dëshmohet veprimtaria ndërtimore e

DO NOT COPY

28) Ndër kështjellat e studiuara për dislokimin e trupave janë Drobeta (**Römer in Rumanien,** Köln, 1969, 296) dhe Dadxhamia (R. E. Brunov – A. Domaszevski, **Die provincia Arabia,** Strassbourg II, 1905, 8 ff). Ndër këto kështjella bën pjesë dhe Paleokastra. Fortifikimet e vogla rreth 0,10 ha janë tipike për Arabinë. Brunovi dhe Domaskevski përmendin një numër të madh kështjellash të tilla si Ain el Wahede, Rugum Rishan, Abu Rukbe, Trajja, Boshta etj. (vep cit. II, III). Të këtij tipi në vendin tonë duket se janë kështjellat e Iballës dhe Vranishtit (A. Baçe, **Kështjella e Vranishtit,** material në arkivin e I.M.K.).

29) **Miller IR** col 555-559
Scobre XXX
Lissum XXX
Ad Picaria XXX
Creueni XVII
.....
Ratiaris
Apikaria përmendet dhe nga Ptolemeu (Ptol. II 16, 7) me kordinata 45° 30′, 41° 15′.

30) **Rav.** IV, 15.

organeve shtetërore ose perandorit, nëpërmjet drejtuesve të dioçezave dhe provincave i përkasin periudhës pas Dioklecianit. Ky fakt për territorin tonë dëshmohet prej gjetjes së mbishkrimit të Paleokastrës, ku ndërtimi i kështjellës i blatohet perandorit Licin prej presidit të provincës së Epirit të ri. Ky fakt na jep si «Terminus post quem» fundin e shek. III.

Nga ana tjetër siç u pa nga shqyrtimi Vigu ka një sërë elementesh identikë me Skampinin (kullat freskore, oborrin e fortifikuar, teknikën) që tregon se të dy fortifikimet i përkasin së njëjtës kohë, në mos të njëjtit arkitekt. Datimi i Skampinit nga tulla me kryq e gjetur në brez, pas ediktit të Milanit (v. 313).[31] na jep një «terminus post quem» dhe për Vigun. Nga ana tjetër gjetja e monedhës së Kostandinit na jep si «Terminus ante quem» mesin e sundimit të tij (312-320). Rrjedhimisht, për kështjellën e Vigut dhe Skampinin si kohë të mundshme ndërtimi shohim vitet 313-320. Por në se Skampini e ruan rëndësinë dhe në shek. VI, Vigu merr fund nga gjysma II e shek. IV, ashtu si dhe kështjella tjetër fushore Paleokastra, e cila ka një hiatus deri në shek. e V. Braktisja e Vigut do parë fillimisht e lidhur me invazionin Got dhe më tej me ndarjen përfundimtare të perandorisë dhe humbjen e rëndësië së rrugës Lis--Ratiaria.

DO NOT COPY

31) Gj. Karaiskaj, vep. cit.

Apollon BAÇE

DO NOT COPY

LE CASTELLUM DE VIG

RESUME

Le castellum de Vig est mentionné pour la première fois en 1867 par I.G. Hahn (Reise durch die Gebiete der Drin und Vardar). *Au commencement de notre siècle il fut visité par F. Traeger* (Begrebnis – Platze und Tumuli in Albanien und Macedonien) *et plus tard par Th. Ippen* (Die Gebierge des Nordwestlichen Albaniens), *F. Nopcsa* (Archeologischen aus Nordalbanien) *et C. Praschniker-A. Schober* (Archaeologische Forschungen in Albanien und Montenegro). *Ces hommes d'étude définissent justement le Castellum de Vig comme un camp romain, Nopcsa en offre un croquis planimétrique qui fut amélioré plus tard par C. Praschniker-A. Schober (Fig. 1). Or ce croquis ne correspond pas entièrement à la réalité, du fait que le monument était couvert de terre et ses auteurs n'avaient beaucoup de temps à leur disposition.*

Le castellum de Vig se trouve à l'endroit où confluent le fleuve Gjadër et les torrents de Vame et de Kaftall, dont les vallées s'introduisent en profondeur dans la zone montagneuse facilitant de la sorte le passage des voies de communication.

A ce point les collines longeant le fleuve s'éloignent les unes des autres et cèdent la place à un lit relativement large. C'est ici que coule le Gjadër (Fig. 5) et ses petits torrents, peu profonds et que l'on peut franchir à n'importe quel point par beau temps. Mais dans la saison des pluies les eaux du fleuve montent et remplissent son fleuve jusqu'à un niveau de 2 à 3 mètres. Le seul endroit qui est épargné par les eaux est une bande de terre étroite et longue, juste au point où confluent le Gjadër et le torrent de Kaftall. C'est justement au milieu de cette bande de terre, subissant l'action indirecte des eaux du Kaftalli qui a détruit les tours du côté nord et est en train de réduire en ruines le mur, que se dresse la forteresse de Vig. Si ce panorama était tel il y a 1500 ans ou il s'est créé à la suite de la destruction des forêts et du grossissement des fleuves, c'est là une question à laquelle nous ne pouvons donner une réponse.

Comme il ressort des levés topographiques, à la différence des planimétries précédentes, cette forteresse à une planimétrie en forme de trapèze irrégulier (Fig. 3). Il se peut qu'une telle déformation soit un résultat de son adaptation au terrain, respectivement au courant du fleuve et du torrent.

Le castellum de Vig est flanqué de 12 tours imposantes, dont huit conservent entièrement leur planimétrie, trois autres ne conservant que des traces très faibles et une qui est disparue complètement. De leur nombre les tours flanquant les extrémités ont la forme d'un éventail et celles du milieu sont angulaires. On accédait à la forteresse à travers deux entrées amménagées sur les côtés est et ouest, flanquées chacune de deux tours angulaires ayant leur partie frontale légèrement inclinée et pourvue d'un «propugnaculum».

Les courtines, larges de 2,35-2,45 m (Figs. 6,7,8,9), tout comme les tours, s'appuient sur des fondements qui ont une profondeur de 1 m environ et sont de 0,3-0,6 m plus larges que le mur maçonné dans le fossé creusé à cette fin (Fig. 12). Les courtines ont une longueur de 21 à 25.5 m.

A la différence de ce qui passe dans une série d'autres fortifications, elles sont reliées organiquement avec les tours (Fig. 13).

Du point de vue planimétrique, les tours angulaires (Figs. 14,15) ont la forme d'un quart de cercle. Leurs faces latérales suivent une ligne droite pendant 7,5-8,2 m, soit environ 1 m de plus que les tours du milieu, tandis que leur partie frontale en forme arquée couvre un périmètre variant de 14 à 14,50 m. La réunion de la partie arquée frontale avec les côtés droits ne se réalise pas en angle, mais se raccorde avec un rayon de 0,50-0,60 m, et cela afin de faire ricocher les balles et d'éviter les dégâts éventuels. Les murs des tours sont un prolongement, bien que non rigoureux, des courtines angulaires. Cette continuation ressort à l'évidence dans la tour N° 1 (Fig. 16), dont les faces latérales suivent fidèlement la direction de la courtine. Par conséquent la tour a une planimétrie formant à la base un angle de 81°, égal à celui de la tour angulaire.

On accède aux pièces du Ier étage des tours, non illuminées de dehors, à travers une entrée en forme de couloir large de 1,20 m environ et long de 3,50 m, dont le plancher est en pierres et mortier (Fig. 17). L'entrée passe diagonalement à l'extrémité, en le retrécissant de 1,50 m au point plus étroit, soit à l'angle de recontre de la tour avec la courtine. A 2,30 m du niveau des assises, l'entrée est couverte d'une voûte de briques en flèche abaissée, 0,10 m (Fig. 16). Les briques de la voûte s'inclinent très légèrement, environ 85°, à leurs talons, en formant de la sorte une construction d'appui entre la voûte et l'architrave. Le poids de la maçonnerie ne repose pas unique-

ment sur la voûte, mais il se décharge sur les supports du couloir à travers 5 grosses poutres.

Sur les côtés S. et N. les tours de la partie centrale (Figs. 3, 5, 6, 11, 12) ont une planimétrie à angle droit. Elles se replient de 0,70 à 0,80 m en profondeur. C'est ainsi que le partie intérieure de la tour devient plus spacieuse, que l'on assure l'espace nécessaire à l'ouverture de la porte du IIe étage conduisant au sentier de passage et la séparation complète des courtines l'une de l'autre (Fig. 19). Les tours ont une dimension extérieure de 8,2 — 8,3 x 9,75 — 10 m et sont projetées à 6,50 m de la courtine.

Les tours protégeant les entrées (Fig. 3, 20, 9) ne sont séparées les unes des autres que d'une distance variant de 9,50 à 9,96 m. Les faces latérales et antérieures des tours sont droites, leur partie frontale est légèrement inclinée, avec leur milieu faisant saillie environ 1,10 m des extrémités. Par suite d'un tel traitement les tours acquièrent une planimétrie en forme de fer à cheval, qui se distingue de celle des tours classiques de ce type, où leur partie frontale est semi-circulaire. Par conséquent la définition la plus appropriée nous semble celle de tour à partie frontale courbée. Ces tours se replient sur elles-mêmes vers l'intérieur, tout comme les tours des murs situés sur les côtés S. et N., mais cependant à une plus grande profondeur: 2,30 m. Ce repliement permet la création de l'espace nécessaire au propugnaculum, dont les murs se trouvent à l'extérieur sur un même plan que les courtines et à l'intérieur sur une même ligne que la face postérieure des tours.

La dimensions extérieure des tours est de 8,5 — 8,7 x 12,3 — 12,5 m et la largeur de leurs murs varie de 1,70 à 1,80 m. La longueur de leurs faces latérales est telle qu'elle permet un contrôle satisfaisant de l'espace, s'étendant devant leur entrée, et leur cour. Du côté des courtines, les tours se projettent environ 7,80 m de manière à ne pas entraver la vue réciproque entre les tour flanquant les extrémités.

Les propugnaculum (Figs. 20,9) se trouvent au milieu des côtés E. et O., qui sont protégés par les tours susmentionnées. Latéralement ils sont délimités par les murs des tours de défense, frontalement il y a un mur long de 1,10 m, dont la face extérieure se situe sur le même plan que les faces extérieures des courtines, et par derrière, sur le même plan que les faces postérieures des tours, s'élève le mur postérieur dont la largeur est également de 1.10 m. Ainsi se crée un volume fermé à planimétrie angulaire, dont la dimension est de 9,96 x 2,60 m. Juste en son milieu il est traversé par deux entrées dont la partie inférieure est en pierres gravées. En ce qui concerne l'espace de leurs portes, celui extérieur est de 3,45 m et celui intérieur de 3,86 m selon les apparences.

Les murs de la forteresse de Vig, ceux de leurs courtines comme ceux de leurs tours relèvent de la technique de construction «opus mixtum», à maçonnerie en pierres traversée par des bandes de briques. Ces dernières nivellent et lient mieux le mur en pierres, en répartissant uniformément les coups des balles de pierre et les secousses séismiques. La maçonnerie en pierres comporte des faces latérales et le noyau. Les faces sont travaillés soigneusement avec des pierres fluviatiles, disposées en rangées horizontales avec leur partie courbée en dehors (Fig. 21). Les pierres sont mises à plat, l'une à côté de l'autre, de manière à ce que les pierres d'une rangée forment avec celles de l'autre rangée un échiquier. Cette disposition évite les grands vides et assure une meilleure liaison des pierres. Dans les parties conservées on voit que presque toute la surface de la pierre, à l'exception de son milieu, est couverte de mortier. Le noyau comporte des pierres de dimensions différentes, mais disposées horizontalement (Fig. 22).

Les bandes de briques, larges de 24 à 26 cm. (Fig. 23), sont à trois rangées. Les briques ont une dimensions de 39 x 26-27 x 4-6 cm. Les jointures horizontales des briques varient de 4 à 5 cm., elles ont une épaisseur égale à celle des briques. Les bandes se prolongent horizontalement sans interruption ou sans déplacement en hauteur au point où les faces des tours se joignent aux courtines. La bande I commence à 1,6 m au-dessus du niveau des assises, la bande II commence à une même hauteur à partir de la première bande. Ces bandes ne traversent pas de part en part toute l'épaisseur du mur. Les rangées extrêmes, qui s'introduisent jusqu'à une profondeur de 0,67 m, comportent une série à l'intérieur dont les briques sont disposées du côté large. La rangée du milieu, qui s'introduit en largeur jusqu'à 0,39 m, comporte une série de briques disposées extérieurement du côté étroit.

Sur les côtés des tours se joignant aux courtines, entre deux rangées il y a des ceintures de briques qui commencent au-dessus de la première rangée et s'élargissent en forme de coin de 1 à 3 briques jusqu'à la rangée II (Fig. 13). De même, aux points de raccordement des faces latérales avec les parties frontales des tours de secteur ou à front incliné, les côtés de jonction sont renforcés par des bandes qui commencent dès les assises (Fig. 10) et ont une largeur de 5 à 7 briques.

La liaison des pierres et des briques est réalisées avec du mortier très solide comportant beaucoup de chaux, des matériaux de remplage grossiers, du sable fluviatil à grains de 1-3 mm. mélangé à du gravier fin à grains de 10 mm.

La maçonnerie montre des trous quadratiques de 0,10 x 0,10 m, disposés à 1,5-2,4 m l'un de la'utre en direction horizontale et à 1,7 m en direction verticale. A ce qu'il semble, ces trous servaient à assurer l'écoulement rapide de l'eau du mortier.

Dans la forteresse de Vig, tant dans sa partie intérieure que dans celle extérieure, les trouvailles manquent presque totalement. A l'intérieur de la forteresse la couche culturelle est peu profonde, environ 15 cm., et ne comporte que des fragments de briques indiquant la présence de constructions légères en bois ou crépi qui sont recouvertes. Ici la plupart des trouvailles sont représentées par des briques. A l'intérieur du territoire, on a même découvert une monnaie de Constantin et une inscription incomplète comportant le texte suivant: «EX PRAESIDES OFICI».

DO NOT COPY

DOWNLOAD

En considération des dommages causés par le temps et les eaux des fleuves, les murs des courtines et des tours se trouvaient dans un état de dégradation avant de prendre sous protection le monument en question. La partie nord est plus endommagée, et cela du fait des eaux du torrent qui ont détruit les tours et une grande part des murs. Afin d'éliminer les dégâts causés et la dégradation ultérieure de cette fortification, des travaux de restauration furent entrepris dans sa partie S. et N. Les parties orientales et septentrionales ne furent pas touchées, du fait que la zone du torrent délimitant leur côté est sera amménagée en plantant des conifères. C'est pour cette raison qu'il fut établi d'exécuter les travaux en deux étapes. Au cours de la première étape on allait restaurer la partie méridionale et septentrionale du monument et après le boisement les parties orientales et septentrionales. Dans la phase I, en 1967 furent exécutés des travaux dans les tours 1, 2, 10, 11, 12 (Fig. 24) et dans les courtines 10-10, 11-2, 12-1 (Fig. 26 et Fig. 27). La nécessité urgente des travaux dans les tours de cette partie découlait du fait que leur front extérieur s'étant écroulé, elles ne disposaient pas d'un contour fermé. Conséquemment, leurs murs latéraux à section inclinée se trouvaient dans une situation constante de dégradation et d'écroulement (Fig. 25). Ce péril s'accroissait surtout pendant la période des crues, lorsque le niveau des eaux atteignant une hauteur de 1 à 1.20 m au-dessus des assises, transportaient des pierres d'une dimension de plus de 1 m qui en heurtant le mur ne faisait que le détruire. C'est pourquoi les murs des tours situées en cette zone furent élevés au-dessus du niveau des eaux.

Les murs élevés à cette fin furent ramenés dans leur partie supérieure à une ligne horizontale, mais parfois leur contour fut abaissée de 1 à 2 rangées afin de briser la régularité qui pourrait créer une fausse perception, comme s'il s'agissait là de la hauteur initiale du mur.

En ce qui concerne la face extérieure, on s'est servi de pierres ayant une forme arrondie et des dimensions égales à celles des murs existant. La liaison fut réalisés avec du mortier pauvre de la marque 15. Les pierres furent disposées en des rangées horizontales régulières, avec une hauteur à peu près égale dans chaque rangées, en respectant en ce cas aussi la disposition des pierres de chaque rangée en forme d'échiquier. En suivant la technique originale, les pierres furent nivellées extérieurement avec du mortier en ne couvrant pas leur milieu, ce qui est une caractéristique de la maçonnerie de cette fortification.

Les bandes de briques furent complétées dans les tours 12, 11 et 10, extérieurement et intérieurement, ainsi que dans les courtines 10-11 et 12-1, aux endroits où au-dessus de la bande de briques se prolonge le mur de pierres. Dans les courtines, où la bande marque la terminaison du mur, celle-ci ne fut pas complétée. Etant donné que même selon la technique originale la bande ne traverse pas l'épaisseur du mur, les briques ne furent disposées que dans sa partie extérieure.

A travers ces travaux fut évité le péril d'une dégradation ultérieure de la partie méridionale du monument et celui-ci est actuellement accessible aux visiteurs. Les travaux de la phase II, qui seront portés à terme dans les années prochaines, éviteront définitivement la détérioration de cette fortification.

o

o o

Les études accomplies pour dresser le projet de restauration de la forteresse de Vig, les travaux de restauration et de nettoyage nous ont permis de reconstruire complètement la planimétrie de cette fortification, et cela dans une certaine mesure sur la base de la confrontation typologique et du développement de l'altimétrie.

En regroupant les données susmentionnées, il ressort que le castellum de Vig avait une planimétrie en forme de trapèze, déviant légèrement de la forme à angle droit, et s'étendait sur une surface de 0,65 ha (Fig. 26). Il représente une puissante fortification, dont les courtines larges de 2,35 à 2,45 m se caractérisent par une maçonnerie mixte. Les travaux de nettoyage portés à terme, on s'est aperçu que manquait l'escalier conduisant au sentier de la courtine, et que l'accès à cette pièce se faisait à travers les escaliers en bois qui se trouvaient au premier étage des tours. Le manque de ces escaliers, bien qu'il rend plus difficile aux défenseurs l'occupation rapide des positions de combat dans les courtines, accroits cependant la défense de la fortification. Même si l'assaillant réussit à monter de dehors jusqu'au sentier de la courtine, il doit faire une saut d'environ 6 m avec ses armes, en un moment qu'il est attaqué tant de l'intérieur de la fortification que des faces latérales des tours, donc il n'a aucune chance de réussite.

La petite profondeur des assises, de 1 à 1,30 m environ, tout comme celle des murs et des courtines, permettait l'usage de la «mine» des galeries souterraines. Cette profondeur égale à celle du castellum à Paleokaster, s'explique à notre sens par le fait que les ennemis éventuels ignoraient cette technique ou par le bas niveau des eaux souterraines.

Le castellum de Vig était flanqué de 12 puissantes tours, dont les parties frontales avaient une largeur de plus de 8 m et dont la longueur était de 10 m et même plus. Les tours se relient organiquement au mur d'enceinte, en présentant une construction monolitique, ce qui est une particularité des fortifications construites après le IIIe siècle. Ce fait même ainsi que les dimensions relativement grandes des tours pour une fortification si petite, mettent en évidence le rôle important que celles-ci remplissaient dans le système des fortifications. Les tours se trouvent à une distance de 21 à 25,6 m l'une de l'autre, tandis que celles destinées à la protection de l'entrée ne sont séparées que par une distance de 10 m (Fig. 3). Considérant ces dimensions et la structure des tours qui permettait l'installation d'armes lourdes, cette distance assurait la protection totale et bilatérale des courtines et des tours munies de bouches à feu à tous les niveaux de combat de celles-ci.

Les tours de la forteresse de Vig ont une planimétrie quadrangulaire au milieu, avec leur partie frontale courbée à proximité des entrées, et sont à secteurs sur les côtés. Une telle

DO NOT COPY

répartition n'est point fortuite, mais étudiée d'avance. Les tours de secteur, dont la partie frontale est arquée, font ricocher bien de ce fait les balles des pierriers dont le trajectoire aux extrémités est plus angulaire. Pour cette même raison les tours destinées à la protection des entrées, une cible préférée des assaillants, ont leur partie frontale inclinée. Dans les deux types sumentionnés, même les côtés où se joignent les faces rectilignes latérales avec les parties frontales arquées sont également inclinés. Les tours de secteur, comme celles dont la partie frontale est courbée, flanquent convenablement les courtines grâce à leurs faces rectilignes latérales. La disposition des tours de secteur aux extrémités s'explique aussi par le fait d'éviter la création de zones mortes, ce qui arrive dans le cas de tours à angle droit. Ces zones ne se créent pas dans les parties centrales, du fait qu'elles sont couvertes par le feu des courtines.

Par ailleurs pour un périmètre égal, et en plus avec une même quantité de matériaux de construction, les tours quadratiques ont la surface de 50 pour cent plus grande. De même, la construction des tours rectilignes présente moins de difficultés techniques que la construction des murs arqués. L'installation des tours d'éventail aux extrémités des tours à la partie frontale inclinée se trouvant près des entrées et des tours à angle droit dans les parties centrales, sont autant de faits qui indiquent que les constructeurs de cette forteresse étaient bien conscients de ces avantages et qu'ils se servaient des éléments constitutifs de la fortification de façon rationnelle, approfondie.

L'étage I non illuminé des tours comportait la cage des escaliers et servait comme dépôt. Quant aux autres étages, ils étaient sans doute garnis de meurtrières. Le manque de fragments de briques, tant dans les tours latérales que dans celles centrales, indiquent que celles-ci étaient surmontées par une terrasse à crénelures. La communication entre la tour et les courtines, en l'absence surtout des escaliers extérieurs, était assurée, à notre sens, de la manière indiquée sur le croquis de la Fig. 28.

Les murs de propugnaculum (Fig. 29) se trouvaient probablement à un niveau égal à celui de la partie supérieure des courtines. Leur petite largeur de 1.10 m exclut l'existence de crénelures. En effet la présence de soldats sur ces murs n'était pas nécessaire, du fait que l'espace étroit de 10 mètres est bien protégé par les faces assez longues des tours.

o

o o

L'examen architectonique et la reconstruction de cette forteresse, nous offre la possibilité de procéder à des confrontations avec les autres fortifications de l'époque. Les tours flanquant les extrémités des fortifications de la première période antique sont quadratiques ou en forme d'éventail et rarement circulaires. Le type I connaît une plus grande diffusion dans la Province Arabia et il est plutôt rare dans la Préfecture de l'Illiricum. Nous le trouvons chez nous dans la forteresse de Paleokastra, mais sur le côté à proximité du fleuve où l'on ne pouvait installer des catapultes et des pierreries et où ne pouvait se créer des zones mortes. Ce rapport fut complètement renversé par les tours en forme d'éventail. De telles tours sont bien nombreuses dans les fortifications de la Préfecture de l'Illiricum (Drobeta, Voivoda, Abritus, Dinogetia, Tropeum Traiani, Capidava Jatrus, etc.). Nous la trouvons chez nous dans toutes les fortifications de campagne connues: Skampin (Elbasan), Vig, Paleokastra. Dans la Province arabe, par contre, elles sont rares (El leggun, Odruh). Ce fait s'explique par le fait que les éventuels assaillants de la Province arabe, à la différence de ceux de la Province illyrienne, ayant un niveau de développement moins élevé dans la technique d'encerclement, faisaient un usage fort limité des machines de guerre lançant des pierres.

Les tours flanquant les extrémités sont de deux types. Le premier a une planimétrie semi-circulaire et le deuxième une planimétrie en forme de fer à cheval dont la base est étroite. Le premier type, auquel sont attribuées les forteresses de Vig et de Skampini, connaît une plus grande diffusion; quant au deuxième, il est plutôt rare. Celui-ci nous le trouvons à Paleokastra, à Tropeum Traiani et à Jatrus, dont les deux premiers, selon les inscriptions, datent la période de domination de Licinius. Les trouvailles des forteresses, ayant des tours en forme d'éventail à leurs extrémités, appartiennent principalement à la période de Constantin ou de ses fils. En ce qui concerne les tours des parties centrales, il ressort que dans toute fortification dont les extrémités sont flanquées de tours quadratiques, les tours de la partie centrales sont également quadratiques; tandis que dans les fortifications dont les extrémités sont flanquées de tours en forme d'éventail, les tours des parties centrales sont en forme de fer à cheval. Il est vraiment rare de rencontrer des tours centrales à angle droit correspondant à des tours en forme d'éventail flaquant les extrémités (Drobeta, et Kapidava partiellement). Mais dans les deux forteresses chez nous, à Vig et à Paleokastra, les tours centrales sont à angle droit quant à leur forme, bien que dans la première, dans les entrées, leur partie frontale est légèrement inclinée. Comme on voit, en ce qui concerne la partie centrale les constructeurs ont préféré à Vig comme à Paleokastra les tours à angle droit, qui ont des côtés positifs mais aussi négatifs par rapport aux tours en forme de fer à cheval.

Enfin le propugnaculum de la forteresse de Vig, en tout et pour tout identique à celui de la forteresse de Skampin, représente une des variantes les plus classiques et les mieux étudiées de cet élément. En fait la protection de l'entrée par deux tours latérales est un élément que nous retrouvons dans les fortifications de l'antiquité et dans celles romaines de la première période impériale (Cester, Pinatta, Carnunt, Lauriat, Bonn, etc.). Même vers la fin du IIIe siècle, dans de nombreuses forteresses leur entrée est toujours protégée par deux tours, mais qui font désormais saillie du mur (Dioclécianopol, Tropeum Traiani, Paleokastra). Toutefois, dans une série d'autres fortifications les entrées sont protégées par le propugnaculum et des tours. Si l'ennemi réussissait à abattre la première porte, les défenseurs se trouvant au propugnaculum en nombre limité pouvait l'assaillir d'en haut. Ce mode de défense nous le retrouvons dans les an-

POVIJEST

ciennes fortifications impériales (Aosta, Nimes, Bon, Trier, etc.). Les avant-cours de Vig et de Skampin, se répètent avant tout à Istanbul Kapi, Isnik Nicaea), où les deux tours sont à fer de cheval, tandis que la cour d'une largeur de 10 m également se trouve sur un même plan que la courtine et les faces postérieures des tours. Un traitement pareil caractérise les fortifications de Slavenie, de Bologa et de Ed Dumer. Du point de vue de la conception, ces cours nous les retrouvons aussi à Dinogetia et Abritus, mais ici les faces latérales des cours ne sont pas constituées par les faces des tours, mais par des murs particuliers. De leur nombre le type classique est représenté par la groupe I, duquel font part Skampin et Vig, en raison du fait que tant l'entrée que la cour sont complètement contrôlées par des tours, tandis que dans les fortifications du groupe II ce contrôle n'est pas efficace. En considération du fait que ces fortifications appartiennent dans leur majorité à la période de domination de Constantin et de ses fils et que vers la fin du IVe siècle ces cours furent éliminés, à notre avis ce groupe doit être attribué à la premier moitié du IVe siècle, tandis que la défense à travers les seules tours appartient à la période allant du IIIe au IVe siècle.

En ce qui concerne sa surface de 0,615 ha, Vig se range parmi les forteresses classiques de 1 ha destinées au séjour d'une cohorte de mille fantassins ou rarement de cavaliers (cohors peditata, ou equitata, miliaria) et des petites fortifications pour le séjour d'une centurie et même moins. En conséquence, nous pensons que dans cette forteresse séjournait une cohorte de 500 piétons (cohors peditata quingenaria) comportant six centuries (500 persones) ou, avec difficulté, une cohorte de cinq-cent cavaliers (cohors equitata quingeneria) avec 6 centuries et 6 escadrons (480 personnes et 120 chevaux).

F. Nopsca, Th. Ippen et G. Stadtmüller, partant des conditions actuelles, considèrent Vig comme un poste destiné à empêcher l'incursion des montagnards dans la zone plate. A notre avis, la forteresse de Vig fut une station destinée à contrôler militairement la route Lis-Ratiaria, dans son premier tronçon. En fait la population de la zone montagneuse, qui connaissait bien le terrain, pouvait emprunter divers sentiers afin d'éviter complètement l'obstacle que constituait la forteresse de Vig. En fait l'actuel route partant de Lezhe ou de Shkodra vers Puka, Vau-Spas, et plus loin, vers Prizren, itinéraire que suivait aussi la route allant à Ratiaria, longe la vallée de Gumine, en laissant de côté la vallée du fleuve Gjader. Cette route qui se présente plus convenable, à condition que l'on prenne comme point de départ Shkodra et non pas Lezha, appartient à ce qu'il paraît à la période de l'occupation turque alors que Lezha avait perdu son importance d'autrefois en tant qu'escale et principal noeud de communication, et cela en raison du fait de l'affaiblissement des liens entre l'Orient et l'Occident. En conséquence, à cette époque Shkodra joue un rôle prépondérant dans la vie économique et commerciale et la route suit le tracé le plus court. Par contre, au IVe siècle Lissus (Lezha) offre de meilleures conditions comme point de départ que Shkodra (Scodra), du fait qu'il disposait d'une escale à Nymphée, l'actuel Shën-Gjin.

Cette route, comme l'indique la Tabula Peutingeriana, se sépare du tronçon Scodra-Lissus-Dyrrach à peine avoir rejoint Lis, entre cette ville et Pistum (Ishmi). Plus loin elle se prolonge jusqu'au pont de Gjader, selon l'itinéraire de l'actuelle route Lezha-Vau i Dejes, puis longe les collines du lit relativement large du fleuve pour atteindre sans difficulté la forteresse de Vig. Et d'ici, à travers la vallée de Kaftall, elle arrive à Puka et Vau Spas. D'autres routes d'une importance secondaire conduisent aussi à Vig.

En ce qui concerne l'identification de la forteresse de Vig, un point de départ convenable sont les données de la Tabula Pentingeriana. Il en ressort que la première station après lissus est Ad Picaria, laquelle, en raison de l'affinité Puka-Picaria, a été identifiée avec Puka et plus tard avec Greven. Mais la Tabula l'indique à 30 mille passum loin de Lissus, distance qui correspond parfaitement à celle séparant Lezha de Vig, 43 Km., et non pas à celle existant entre Lezha et Puka, qui est de 60 Km. Conséquemment, à notre vis Ad Picaria correspond à Vig où existent aussi des traces matérielles. Cette thèse est étayée aussi par le fait que la Cosmographie de l'anonyme de Ravenne, rédigée à une époque où la forteresse de Vig avait été abandonnée, mentionne immédiatement Creven après Lissus. L'inscription fragmentaire EX PRAESIDES OFICI doit être considérée come une inscription votive, à travers laquelle praesides dédie à l'empereur la construction de la forteresse. Ces inscriptions, qui témoignent de l'activité de construction déployée par les organes étatiques ou l'empereur, et cela pour le truchement des diocèses et des provinces, appartiennent à la période successive à Dioclétien. En ce qui concerne notre territoire, ce fait ressort aussi de l'inscription découverte à Paleokastra, selon laquelle praesides de la province du nouvel Epire dédie la construction de cette forteresse à l'empereur Licinius. Ce fait nous donne comme «Terminus post quem» la fin du IIIe siècle.

Par ailleurs, comme cela ressort de l'examen de Vig, cette forteresse comme celle de Skampin ont plusieurs éléments en commun (les tours en forme d'éventail, la cour fortifiée, la technique de construction), ce qui montre que toutes deux appartiennent non seulement à la même période, mais peut être aussi au même architecte. La datation de Skampin sur la base de la brique à croix découverte dans sa bande, selon l'édit de Milan (313), nous fournit aussi un terminus post quem pour Vig également. Par ailleurs, la découverte de la monnaie de Constantin nous donne comme «terminus ante quem» la moitié de son règne (312-320). Ainsi, tant pour Vig. que pour Skampin, à notre avis leur période de construction plus probables sont les années 313-320. Toutefois, si Skampin conserve son importance même au VIe siècle, Vig met un terme à son activité vers la deuxième moitié du IVe, tout comme l'autre forteresse de Paleokastra, qui exerce cependant ses fonctions jusqu'à la fin du Ve siècle. L'abbandon de Vig doit être envisagé au commencement en rapport avec l'invasion des Goths, et plus tard comme une conséquence de la division de l'empire et de la perte de l'importance qu'avait la route reliant Lissus à Ratiaria.

Valter SHTYLLA

DO NOT COPY

DISA URA TË VJETRA NË SHQIPËRINË E JUGUT

Në këtë artikull do të përshkruajmë disa ura të vjetra të ndërtuara me hark guri, që ruhen ende në këmbë në rrethin e Përmetit dhe në krahinën e Mokrës në Pogradec, si dhe disa ura, sot të shkatërruara, të cilat ruajnë akoma pjesë të tyre.

I. URA TË VJETRA NË RRETHIN E PËRMETIT

Rrethi i Përmetit përshkohet nga juglindja në veriperëndim prej lumit Vjosa, një nga lumenjtë më të mëdhenj të vendit tonë. Duke i kaluar pothuaj mes për mes rrethit malor të Përmetit, Vjosa ndan gjeografikisht ndërmjet tyre disa krahina si Rrëzën e Malëshovën majtas rrjedhjes me krahinën e Shqerisë e të Dëshnicës djathtas rrjedhjes, krahina këto të popullura e me zhvillim gjatë periudhave të ndryshme historike. Përmeti e Këlcyra përmenden në shekullin XVI, krahas qyteteve të tjera, si qendra të banuara, të pajisura me pazare, dyqane, magazina dhe hane. Këtu bëheshin edhe pazaret e pasura javore me produkte të ndryshme të ekonomisë fshatare[1]. Në këto kushte të marrëdhënieve shoqërore-ekonomike ndërmjet krahinave e fshatrave të ndryshme të Përmetit, sigurisht lindte domosdoshmëria e një rrjeti të gjërë komunikacioni të përbërë nga rrugë dhe ura. Që në kohë të hershme gjatë luginës së Vjosës kalonte rruga prej Korçe e Leskoviku për në Përmet e vazhdonte për Këlcyrë, ku ndaheshin dy degë, njëra për në Berat e tjetra gjatë Vjosës nëpër grykën e Këlcyrës për Tepelenë, etj. Duke ndjekur pikërisht itinerarin e kësaj rruge do të përmendim disa ura të ndërtuara në pika të ndryshme mbi Vjosë e mbi degë të saj, të cilat lidhnin ndërmjet tyre krahina dhe fshatra (fig. 1). të ndryshme të Përmetit, duke lejuar zhvillimin normal të marrëdhënieve social-ekonomike. Parashtrojmë që në fillim se mendimi ynë është se urat që do të preken në artikullin tonë duhet të jenë ndërtuar nga shekulli XVII e lartë në shekullin XVIII e XIX-të. Itinerari i vjetër i rrugës Leskovik – Përmet bashkohet me rrjedhjen e Vjosës menjëherë pasi lë në të majtë urën e gurtë të Peratit (sot e prishur) mbi lumin Sarandapor, për të cilën Hjugsi[2], më 1830 thotë se «duke kaluar lumin e madh të quajtur Sarandapor, kaluam mbi një urë me një hark të vjetër, ku kalonte rruga për në Janinë». Nga kjo urë sot kanë mbetur vetëm gjurmë të mbështetjes anësore. Rruga për në Përmet vazhdon gjatë anës së djathtë të Vjosës. Në fshatin Çarshovë ndodhet përroi me të njëjtin emër, degë e djathtë e Vjosës, i cili 600 m. para derdhjes së tij në Vjosë, ka pasur një urë guri, sot e prishur[3]. Gjatë këtij përroi qe projektuar xhadeja nga Janina në Korçë[4]. Rruga e sotme për në Leskovik e Korçë kalon pikërisht anash këtij përroi. Pasi lë fshatin Çarshovë, gjithmonë djathtas rrjedhjes së Vjosës, rruga vazhdon pë në Petran. Rreth 500 m. mbi urën e varur të Petranit, ruhen gjurmët e një ure hark, sot e rrënuar. Duke folur për të Pukëvili përmend se «arrimë mbi një urë guri me tri harqe, mbi të cilën kalohet Vjosa, pak më sipër bashkimit të saj me lumin Levkarica (Langarica)[5]. Kjo urë lidhte fshatrat e anës së majtë të rrjedhjes së sipërme të Vjosës si Zhepën, Biovizhdën, Draçovën, Kaludhin, etj., me Petranin dhe Shqerinë. Në këtë vend brigjet e Vjosës janë shkëmbore prej

1) Z. Shkodra, **Esnafet shqiptare,** Tiranë, 1973, 35.
2) T. S. Hughes, **Travels in Greece end Albania,** London, 1830, II, 1, 400.
3) F. C. H. L. Pouqueville, **Vouage dans la Greece,** Paris, 1820, I. 200.
4) A. Wald Kampf, **Griechenland und Sud – Albanien,** Leipzig, 1897, 98.
5) F. C. H. L. Pouqueville, **vep. cit.,** 200.

DO NOT COPY



Fig. 1

konglomerati dhe të ngritura vertikalisht thikë rreth 10 m. mbi nivelin e ujit. Nga ura e vjetër ruhen vetëm pjesë të shpatullave të mbështetjes, të ngritura mbi shkëmb, me taban rreth 10 m. mbi nivelin e ujit (fig. 2). Duke gjykuar nga vetë gjërësia e shtratit të lumit, rreth 15 m., nga burimet e shkruara dhe nga krahasimi me urat e tjera mbi Vjosë, të prishura vonë, arrijmë në përfundimin se kjo urë ka qenë ndërtuar me një hark të madh kryesor gjysëmrrethor me hapsirë drite sa ngushtica e lumit. Me këtë zgjidhje ura ngrihej me kurriz të lartë në qendër të saj. Për të evituar mbushjet masive të shpatullave anësore, konstruksioni në hyrje e dalje të urës ish realizuar respektivisht me nga një hark të vogël bregor, mbi të cilin shtrihej kalldrëmi i pjerrët i trasesë së urës me gjerësi 2,2 m. Ura qe ndërtuar me gurë pllake gëlqerorë me lartësi deri në 10 cm., të lidhur me llaç gëlqere. Duke vazhduar rrugën, rreth 500 m. më në veri arrihet në qendër të fshatit Petran, ku rruga e vjetër e kalonte Vjosën mbi një urë guri dhe vazhdonte pastaj për në Përmet, gjatë bregut të majtë të Vjosës në ndryshim nga rruga e sotme që kalon djathtas lumit. Ura e Petranit e ndërtuar pak më sipër se derdhja e lumit Langaricë në Vjosë, përmendet që në 1806 prej

Pukëvilit[6]. Sipas burimeve ajo ka ekzistuar deri në vitet 50[7]. Nga ura e Petranit sot ruhen vetëm fragmente në nivelin e mbështetjeve të harkut kryesor (fig. 3). Sipas një fotografie të vjetër del se kjo urë ka qenë ndërtuar me shtatë harqe dhe dy dritare lehtësuese anash harkut kryesor (fig. 4). Në qendër të kompozimit të urës është harku kryesor me hapësirë drite rreth 20 m., me dy harqe më të vegjël anash. Katër harqet e tjera ishin të vegjël. Ura e Petranit hyn në grupin e urave të mëdha. Ka pasur një siluetë interesante arkitektonike që i është imponuar asaj nga vetë disniveli i brigjeve. Si urë kyçe në rrugën Përmet – Leskovik dhe për lidhjen e krahinës së Rrëzës me atë të Shqerisë, ajo i është përshtatur mirë shtratit të lumit dhe brigjeve. Ura është ngritur mbi formacion shkëmbor konglomerat. Nga bregu i majtë ku niveli i terrenit është më i lartë, traseja e urës vinte e rrafshtë. Në kyçin e harkut të madh traseja binte me pjerrësi drejt bregut të djathtë që është pak a shumë i sheshtë. Në ndërtimin e urës është përdorur guri gëlqeror me lidhës llaç gëlqereje.

Langarica është një nga degët kryesore të Vjosës në rrethin e Përmetit. Pak kilometra sipër derdhjes së saj në Vjosë, pikërisht në banjat e Bënjës ndodhet ura e Katiut, urë me interes dhe e ruajtur relativisht mirë (tab. I). Ura e Katiut lidh Bënjën me Delvinën e Shqerisë. E ndërtuar mbi brigje shkëmbore ajo paraqet interes për nga kompozimi arkitektonik dhe zgjidhja konstruktive. Në qendër të kompozimit të urës ndodhet harku kryesor në formë segmenti rrethor me hapsirë drite 15,5 m. dhe lartësi 6 m. mbi nivelin e ujit. Përfshirë dhe arkivoltën[8] qemeri i harkut ka trashësi 1 m. dhe është punuar me gurë gëlqerorë pllakë. Nga ana (bjefi) e poshtëme e urës në ballin e harkut ruhen ende dy ganxha metalike për mbërthimin e gurëve ballorë.

Qemeri konturohet nga sipër prej arkivoltës me trashësi 50 cm. e ndërtuar dhe kjo me gurë gëlqerorë, e cila del me dhëmbë 10 cm. mbi ballin e qemerit të poshtëm. Në pjesën qendrore të harkut të sipërm (arkivoltës), nga të dy anët e rrjedhjes janë inkastruar nga shtatë kollona të vogla shtufi, që lartësohen 30-40 cm, mbi kalldrëm, të cilat kanë shërbyer për lidhjen e parapetit të urës, që sot nuk ruhet më. Në pjesën



Fig. 2

e kyçit të harkut ura ngrihet me kurriz, me lartësi 7 m. mbi nivelin e ujit. Gjatësia totale e urës në projeksion horizontal arrin 37 m. Majtas harkut kryesor është hapur një dritare lehtësuese me gjerësi 1,3 m. dhe lartësi 2,7 m. Qemeri i saj kufizohet sipër prej një kornize me rrasë guri me trashësi 9 cm. Kjo dritare është hapur në lartësinë 1,5 m. nga toka. Nga sa shihet në teknikën e ndërtimit, vërejmë se ura e Katiut ka pësuar dëmtime në kohë, që kanë kushtëzuar riparimin e mureve masive të urës nga të dy brigjet. Pjesët e poshtëme të shpatullave anësore të urës deri në lartësinë 1,5 m. nga toka, që përbëjnë fazën e parë të ndërtimit, janë muraturë me gurë gëlqerorë pllakë, ku

6) F. C. H. L. Pouqueville, **vep. cit.,** 209.

7) J. Adami, **Rrugët e Shqipërisë gjatë mesjetës dhe pushtimit turk,** Buletin për Shkencat shoqërore, Tiranë, 1953, 3, 36.

8) Arkivolta – detaj arkitektoniko-konstruktiv, që konturon nga sipër linjën e harkut të urës. Në urat, ajo është pjesë përbërëse konstruktive e qemerit të saj, pasi punon bashkë me të në konstruksion. Në ballin e harkut arkivolta vjen sipër si kornizë kufizuese ndaj pjesës së poshtëme të harkut, duke formuar një dhëmb së jashtëmi ndaj planit të harkut të poshtëm.

POZOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

fugat janë të mbushura mirë me llaç gëlqereje. Kjo pjesë muri është mjaft solide dhe i ngjan një ndërtimi me buto-beton.

Muratura e shpatullës së majtë, faza e dytë, është ndërtuar me gurë gëlqerorë, por këtu fugat janë të qarta e të pa mbyllura me llaç. Në fazën e dytë, në muraturën e shpatullës së djathtë, pjesa e sipërme, janë vendosur edhe dy rrjeshta me gurë gëlqerorë masivë të skuadruar disi dhe mbi to është muratura e përzjerë me gurë gëlqerorë e shtufi me fuga pa llaç.

Kalldrëmi i urës, me gjerësi 2,65 m. është ndërtuar me gurë shtufi pllakë vendosur këlliç. Nga të dy anët e kyçit ngrihen 5 cm, mbi kalldrëm dy rrjeshta tërthore me gurë lumi, që lehtësojnë ngjitjen mbi kurrizin e urës.

Tipi i urës së Katiut, urë me kurriz, me theksim horizontal, me një hark kryesor e me një më të vogël anash tij, është tip mjaft i njohur si te ne, ashtu dhe gjetkë. Afërsisht të tilla janë Ura e Kamares në Librazhd, e ndërtuar në vitin 1715, e Tabakëve në Tiranë, e ndërtuar në gjysmën e parë të shekullit XIX[9], e Golikut në Mokër, etj. Ndërtimi i këtij tipi ure ka qenë i përhapur gjatë shekullit XVIII, e kryesisht në gjysmën e dytë të tij, kohë gjatë të cilës mendojmë se duhet të jetë ndërtuar dhe Ura e Katiut në banjat e Bënjës.

Në të hyrë të fshatit Bënjë, në lagjen e poshtëme të tij, ndodhet përroi i Bënjës, që kalon nëpër një grykë të ngushtë e derdhet në lumin e Langaricës, pak më poshtë se ura e Katiut. Rruga që çon në fshat e kalon përroin me një urë guri të vogël (tab. II). Ura mbi përroin e Bënjës ka një pamje mjaft tërheqëse. E ngritur mbi një hark tip shigjetë të realizuar me finesë, mbi grykën e ngushtë të përroit, ku qëndron proporcionalisht, ura e Bënjës harmonizohet bukur me ambientin natyror rrethues. Në ngritjen e saj është pasur parasysh mirë ngushtica minimale e përroit në atë pjesë të rrjedhjes si dhe fortësia e brigjeve, duke e ndërtuar urën në pjesën më të ngushtë të përroit dhe duke e mbështetur në brigje shkëmbore të qëndrueshme.

Ura e përroit të Bënjës ngrihet mbi një hark të vetëm tip shigjetë me hapsirë drite 6,4 m. dhe me lartësi 7,5 m. nga niveli i ujit në kalldrëm. Qemeri i harkut përfshirë dhe arkivoltën, ka trashësinë 70 cm. Arkivolta (harku i sipërm) shkel me dhëmb 7 cm. mbi harkun e poshtëm. Në pjesën qendrore të arkivoltës janë inkastruar katër kollona të vogla prej shtufi, që sigurojnë një lidhje të mirë të muraturës së urës. Kollona të tilla formë brezash vertikalë vërehen dhe të tjera në muret bregorë të urës. Gjatësia e urës e matur në kalldrëm, i cili është i rrafshët, arrin 9,6 m., ndërsa gjerësia është 2,3 m.

Lidhur me datimin, ura nuk ruan asnjë mbishkrim, gjithashtu të dhëna të tjera nuk kemi, pra për kohën e datimit do t'i referohemi krahasimit tipologjik. Ura

9) K. Frashëri, **Vështrim mbi zhvillimin shoqëror, arsimor e kulturor, në Tiranë, deri në mesin e shekullit XIX-të.** Arësimi Popullor, nr. 4, 1964, faqe 70.

e Grofçanit[10] dhe ura e Jokçiut[11] mbi lumin e Tabakut në Kratovo të Maqedonisë të ndërtuar në fundin e shekullit XVII-të si dhe ura e Zhepës[12] në Bosnje e ndërtuar në fundin e shekullit XVI, kanë ngjasim me urën e Bënjës, që përshkruajmë. Për analogji mendoj që si kohë ndërtimi të urës së Bënjës të pranojmë gjysmën e dytë të shek. XVII. Në këtë kohë dhe gjatë shekullit XVIII në vendin tonë janë ndërtuar shumë ura.

Më në veri nga Petrani duke vazhduar rrjedhjen e Vjosës, majtas saj, shtrihet fshati Badëlonjë. Në këtë fshat mbi Vjosë ruhen gjurmët e urës së Badëlonjës, e cila e lidhte këtë me fshatrat e tjerë të krahut të djathtë të Vjosës. Edhe kjo urë ka qenë e ndërtuar me kurriz mbi një hark të madh kryesor me hapsirë drite rreth 20 m.; mbështetur mbi brigje shkëmbore konglomerate, anash të cilit, mbi brigjet qenë hapur dy harqe të vegjël. Sot nga kjo urë ruhet vetëm një fragment i mbështetjes së majtë, ndërtuar në faqet e dukshme me gurë pllakë shtufi lidhur me llaç gëlqereje dhe me teknikë me gurë lumi të rrumbullakët në brendësi. (fig. 5). Ura e Badëlonjës, si urë me tri harqe, përmendet që në fillim të shekullit XIX-të nga Pukëvili[13] e Hjugsi[14]. Ka funksionuar deri në çerekun e parë të shekullit tonë.

Duke vijuar rrjedhën e Vjosës për në qytetin e Përmetit, pikërisht në hyrjen për në Përmet, mbi Vjosë kanë ekzistuar dy ura të mëdha prej guri. Ura e sipërme, disa qindra metra mbi urën e sotme të qytetit, duhet të ketë qenë më e hershme se ura tjetër prej guri më poshtë saj. Prej urës së sipërme sot ruhet vetëm një fragment i vogël i mbështetjes së djathtë, i ndërtuar me gurë shtufi. Rreth strukturës së saj nuk kemi asnjë të dhënë.

Në vendin ku ndodhet ura e sotme e re e hyrjes për në qytet, dikur ka pas ekzistuar një urë guri e madhe. Një pjesë e mirë e saj ruhej deri në vitet '30, ndërsa sot ruhet vetëm një hark i vogël në bregun e majtë. Duke folur për të në fillim të shekullit XIX Pukëvili[15] e Hjugsi[16] theksojnë se «për të hyrë në qytet kalojmë nëpër një urë të bukur me shtatë harqe». Sipas një fotografie të vitit 1927, kur nga të dy brigjet ruhen ende pesë harqe të vegjël, del se kjo urë e madhe e kalonte Vjosën me një hark të madh me hapsirë drite rreth 15 m., në qendër të të cilit ura ngrihej



Fig. 5



Fig. 6

me kurriz. Pra kjo urë përsa i takon madhësisë dhe numurit të harqeve është e ngjashme me urën e Petranit që kemi përmendur më sipër. Duke ndjekur rrje-

10) N. Kataniç, M. Gojkoviç, **Graça za proucavanje starih kamenih mostova i akveduката u Srbiji, Makedoniji i Crnoj Gori,** Beograd, 1961, 136.
11) N. Kataniç, M. Gojkoviç, **vep. cit.,** 141.
12) D. Çeliç, M. Mujezinoviç, **Stari mostovi u Bosni i Hercegovini,** Sarajevo, 1969, 185.
13) F. C. H. L. Pouqueville, **vep. cit.,** 210.
14) T. S. Hughes, **vep. cit.,** 399.
15) F. C. H.L. Pouqueville, **vep. cit.,** 217.
16) T. S. Hughes, **vep. cit.,** 398.

DO NOT COPY

dhjen e Vjosës gjatë grykës së Këlcyrës, rreth 3 km. në të dalë të Këlcyrës, ruhen gjurmët e një ure tjetër të madhe mbi Vjosë, urës së Muço Hysës. Kjo urë lidhte Këlcyrën me krahinën e Malëshovës si dhe më tej me Zagorinë e Gjirokastrës.

Ura që përmendëm është ndërtuar në dhjetëvjeçarin e parë të shekullit XVIII nga Muço Hysoja, i cili historikisht njihet si dizdar[17] i kalasë së Tepelenës dhe si prijës i kryengritësve në kazat e Tepelenës, Kurveleshit e Beratit, gjatë viteve 1701 – 1704, kur banorët e kazave në fjalë kundërshtonin regjimin osman për detyrimet e taksave[18]. E dëmtuar në pjesën qendrore të saj, kjo urë ka ekzistuar deri para luftës (fig. 6). Duke bërë një rikonstruksion të urës, bazuar në fotografinë, arrihet kompozicioni fillestar i saj, që është një hark i madh, me hapsirë rreth 20 m., mbi të cilin ura ngrihet me kurriz dhe dy harqe më të vegjël bregorë anash (fig. 7). Brigjet e urës janë shkëmborë konglomerate shtresëzore. Sot nga ura ruhen pjesë të mbështetjeve të harkut kryesor, ndërtuar me gurë shtufi pllakë në faqet e me gurë lumi të rrumbullakët në bërthamë.

Në mbështetjen e djathtë ruhen gjurmë të një teknike më të hershme. Në bazament vërehen tre rrjeshta me gurë blloqe të punuar, me lartësi 15 – – 20 cm., të lidhur me llaç, gjë që na shtyn të mendojmë se ura e Muço Hysës është ndërtuar mbi mbeturinat e një ure tjetër më të vjetër. Duke qenë ndërtuar në një grykë të ngushtë me brigje të thikëta, ura e Muço Hysës nuk ka madhësinë e urave në Petran e Përmet, ku shtrati i lumit ka po këtë gjerësi, por ku brigjet janë më të sheshta. Nga urat më monumentale të rrethit të Përmetit është ura e Limarit. Ndodhet në fshatin Limar të krahinës së Malëshovës dhe është ngritur mbi lumin e Zagories. Ura e Limarit lidh krahinën e Malëshovës me Peshtanin dhe më tej rruga e kalon Vjosën me urë të varur për t'u lidhur me rrugën nacionale Këlcyrë-Tepelenë. Rreth kohës së ndërtimit të urës nuk kemi asnjë të dhënë. Ajo përmendet prej Pukëvilit si ura e Malëshovës[19], fshat ngjitur me



Fig. 7

17) Dizdar – komandanti i forcave ushtarake që ruan kështjellat, qytetet, komandant kështjelle.

18) S. Pulaha, **Qëndresa e popullit shqiptar kundër sundimit osman nga shekulli XVI-të, deri në fillim të shekullit XVIII-të,** Tiranë, 1978, 230.

19) F. C. H. L. Pouqueville, **vep. cit.,** faqe 223.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Limarin. Mbi lumin e Zagories në Hllomo dhe Nivan ekzistojnë dy ura guri të ndërtuara sipas thënies së vendasve, nga Ali Pashë Tepelena. Studimi i tyre ndoshta do të jetë një orientim për vendosjen në kohë të urës së Limarit. Kjo urë është ndërtuar në një grykë relativisht të ngushtë të lumit e është mbështetur në brigje shkëmbore. Shtrati i lumit i mbushur me gurë të mëdhenj, në kohë vere ka pak ujë. Ura e Limarit ngrihet me kurriz mbi harkun e madh duke na dhënë një siluetë interesante arkitektonike, që të imponohet me theksimin e saj vertikal. (tab. III). Veç harkut të madh, ura ka dhe një dritare lehtësuese majtas saj. Gjatësia totale e urës, sipas kalldrëmit arrin 35 m. dhe lartësia e urës nga kreu deri te niveli i ujit është 18,5 m. Harku i madh me hapsirë drite 22 m. ka formën e segmentit rrethor. Mbështetjet e tij janë mbi brigje shkëmbore e me nivel 7,5 m. mbi shtratin e lumit. Trashësia e qemerit të harkut të madh arrin 150 cm., ku 74 cm. është trashësia e arkivoltës (harkut të sipërm), e cila shkel 10 cm. mbi harkun e poshtëm me trashësi 76 cm. Qemeri është punuar me gurë shtufi pllake me trashësi 10-14 cm. të punuar drejtë në faqen e dukshme, të lidhur me llaç gëlqere. Nga linja e sipërme e arkivoltës çdo 80 cm. dalin qartë disa kollonçina shtufi, që kanë shërbyer për lidhjen e parapetit, i cili sot nuk ekziston. Në dy ballet e harkut kryesor dalin nga 10 ganxha metalike për mbërthimin e gurëve të ballit midis tyre (pjesërisht të dëmtuara). Harku i vogël me hapsirë drite 3,5 m. është në formën e gjysmës së rrethit dhe është hapur 6 m. mbi terrenin, afër kalldrëmit. Qemeri i tij me trashësi 60 cm, është punuar me gurë pllake shtufi. Edhe muret mbushës të urës, nga të dy brigjet janë punuar po me gurë shtufi. Në fazën e parë kalldrëmi i urës ka qenë më i pjerrët, por më vonë, pjesët në hyrje e dalje të urës janë mbushur me një lartësi prej 1,5 m., duke e zbutur mjaft pendencën e kalldrëmit të urës. Kalimi me pjerrësi më të madhe është kalldrëmi mbi pjesën qendrore të harkut. Këtu ruhet kalldrëmi origjinal me gjerësi 2,7 m. me gurë shtufi pllakë vendosur këlliç, ku çdo 1 m. ngrihen breza tërthore të theksuar mbi kalldrëm për të evituar rrëshqitjen gjatë kalimit mbi urë. Teknikisht kjo urë ruhet në gjendje të mirë.

Në lagjen e sipërme të fshatit Limar, mbi një vijë uji është ndërtuar një urë e vogël karakteristike me një hark (tab. IV). Harku me hapsirë drite 4,7 m. ka një linjë të kurbëzuar karakteristike, që nuk e hasim në urat e tjera. Linja e harkut përbëhet nga dy vija të drejta që takohen me një rakordim të butë në kyç. Trashësia e qemerit është 46 cm., ku 20 cm. është arkivolta që del 3 cm. mbi qemerin e poshtëm. Arkivolta konturohet sipër nga një kornizë 5 cm. me rrasa guri gëlqeror. Qemeri është ndërtuar me gurë shtufi e gëlqerore. Kalldrëmi është i rrafshët me gjerësi 1,3 m. Në qoshen e djathtë nga bjefi sipërm, ura ka një pllakë me mbishkrim, ku lexohet «VITI M 04», pra këtu nuk del i qartë datimi, kemi të bëjmë me 1804 apo 1904.

Nga pikpamja teknike e restaurimit, në urat e Përmetit ka nevojë për ndërhyrje. Më tepër probleme paraqet ura e Katiut në Bënjë. Në muraturën e mbështetjes së djathtë të harkut kryesor nga ana e rrjedhjes së poshtme të lumit është hapur një zgavër, si pasojë e grryerjes së lumit. Për këtë arsye në objekt duhen kryer punime. Duhet së pari të hapet tabani për të siguruar një mbështetje të shëndoshë me themel guri apo dhe buto – betoni. Mbi këtë do të ngrihet pjesa e muraturës së dëmtuar e do të rikompozohet pjesa e themrës së harkut të dëmtuar në këtë anë, sipas teknikës origjinale me gurë pllakë gëlqerorë. Veç kësaj duhen kryer punime dhe në plotësimin e disa pjesëve të dëmtuara të kalldrëmit. Pjesa e brendshme e kalldrëmit do të bëhet me gurë pllakë shtufi, vendosur këlliç, ndërsa bordurat e anëve do të vendosen me gurë pllakë shtufi e gëlqerorë, me trashësi deri në 15 cm., shtrirë veratë. Probleme konsolidimi paraqet dhe ura e Bënjës në fshatin Bënjë. Këtu duhet përforcuar tabani i mbështetjes së djathtë me mur mbajtës gjatë bregut, pasi shkëmbi shtuf i mbështetjes nga kjo anë është grryer mjaft nga uji. Duhet ndërhyrë gjithashtu në riparimin e muraturës së harkut të sipërm, majtas nga ana e sipërme e rrjedhjes, ku është hapur një zgavër e vogël. Këto punime do të konsolidonin mjaft këto dy objekte inxhinierike me vlerë. Pra, vemë re se mbi Vjosë, në rrethin e Përmetit, gjatë shekujve të kaluar, janë ndërtuar dy tipa urash prej guri në varësi të gjerësisë së grykës së lumit në aksin e dhënë. Në aksin sipër Petranit, në Badëlonjë dhe tek ura e Muço Hysës vërejmë tipin me një hark të madh me dy bregorë të vegjël anash, ndërsa tek ura e Petranit dhe e Përmetit hasim tipin e urës së madhe me një hark kryesor mbi Vjosë dhe me një numur harqesh më të madh se një nga të dy brigjet. Në të dy tipet udhëtarëve e karvaneve tregtarë iu duhej të ngjiteshin mbi kurrizin e lartë të urës në kyçin e harkut kryesor, zgjidhje kjo karakteristike për urat e ndërtuara gjatë periudhës së përfshirë në shekujt XVIII-XIX.

Ndërtimi i një sërë urash të mëdha në rrethin e Përmetit, mbi Vjosë e në degë të saj, tregon për nivelin e lartë dhe për njohuritë e mëdha të mjeshtrave vendas në fushën e ndërtimit. Ndërtimi i pesë urave monumentale mbi Vjosë në një distancë rreth 15 km., nga Petrani në Përmet, është një tregues i qartë i një tradite të njohur në këtë zonë për ndërtimin e urave. Këto ura ruajnë në vetvete vlera kompozicio-

DO NOT COPY



Fig. 8

nale — arkitektonike dhe janë dëshmitare të një aftësie të rrallë përsa i takon realizimit tekniko — konstruktiv. Ndërtimi i harqeve të mëdha me hapsira rreth 20 m., që kërkojnë një skeleri të rëndë e të madhe, kërkonte një mjeshtri të rrallë. Vjosa është një nga lumenjtë më të mëdhenj të Shqipërisë. Në zonën e Përmetit ajo ka prurjen maksimale rreth 200 m^3/sek. dhe thellësinë maksimale 2,3 m. në Petran dhe deri në 6 m. në Përmet. Natyrisht këto shifra nuk përkojnë me treguesit e para 2 — 3 shekujve, kur janë ndërtuar urat, por me afërsi mund t'i referohemi. Pra kuptohet se ndërtimi i urave të gurta në një lumë si Vjosa, me prurje 200 m^3/sek, shpejtësi 30 m/sek. dhe thellësi të ujit 2 deri në 6 m., kërkon një pregatitje dhe një eksperiencë të madhe, gjë që nuk i ka munguar mjeshtrave tanë, siç e kanë vërtetuar dhe ndërtimet e tjera në periudha të ndryshme historike.

* *
*

II. URA TË VJETRA NË KRAHINËN E MOKRËS — POGRADEC

Krahina e Mokrës është krahina më e madhe e rrethit të Pogradecit. Nga pikëpamja gjeografike Mokra paraqet një zonë malore, që kufizohet nga jugu me rrethin e Korçës, nga perëndimi me malësinë e rrethit të Gramshit, nga veriu me ultësirën e Domosdovës të Prrenjasit, ndërsa nga lindja malet e Mokrës

e ndajnë këtë krahinë nga liqeni i Ohrit. Në pjesën lindore të kësaj malësie e ka burimin e tij Shkumbini, një nga lumenjtë më të mëdhenj të vendit tonë. Lugina e Shkumbinit përshkon një pjesë të mirë të zonës qendrore të Mokrës, ku ndodhen fshatrat Zemçë, Slabinjë, Somotinë, Kërçovë, Proptisht, Selca e Poshtëme, Slatinjë, Golik, majtas e djathtas rrjedhjes, duke dalë pastaj në Prenjas, Qukës e vazhdim.

Historikisht krahina e Mokrës ka qenë e populluar dhe e zhvilluar që në kohët antike. Selca e Poshtëme, me pozitë kyçe në rrugën që çonte për Çervenakë, Pogradec, fushën e Korçës e Maqedoni, e krijuar në shek. III p.e.s., ka qenë një vend banim i madh qytetar i luginës së Shkumbinit[20]. Gradishta e Slabinjës, ku kalonte rruga nëpërmjet luginës së Shkumbinit, për në Hondisht, Qafën e Panjës e luginën e Devollit, ka qenë një ndërtim romak i vonë ose bizantin i hershëm[21]. Te shkëmbi i qytetit në veri të fshatit Shpellë, ruhen qeramika të periudhës së parë të hekurit si dhe fragmente të periudhës qytetare ilire[22].

Pra kuptohet vetiu se duke qenë një krahinë e populluar e me një zhvillim që në kohët antike e më vonë dhe në mesjetë, krahina e Mokrës ka pasur një rrjet të zhvilluar rrugor për marrëdhënie politiko-ekonomike dhe shkëmbime tregtare me viset e tjera të vendit dhe me jashtë si dhe për komunikim e marrëdhënie dhe brenda vetë krahinës. Gjatë këtyre rrugëve ishin ndërtuar dhe ura hark prej guri, disa prej të cilave ruhen akoma sot e mund të studiohen nga ne (fig. 8).

Si pikënisje e shpërndarjes së rrjetit rrugor në krahinën e Mokrës ishte Goliku. Një nga rrugët kryesore të krahinës, qe ajo që nisej nga Goliku, përshkonte gjithë anën perëndimore të malësisë së Mokrës, duke kaluar nëpër fshatrat Selcë e Poshtëme, Proptisht, Slabinjë, Shpellë, Shpellë-Jollë, Llëngë e vazhdonte përtej për në Niçë, Prenishtë, etj. Nga Llënga për në fshatin Jollë rruga futet nëpër një grykë të ngushtë e të lartë shkëmbore, ku kalon rrjedha e sipërme e Shkumbinit. Në këtë pjesë të rrugës ruhen gjurmë kalldrëmi të hershëm i punuar me kujdes, që llëngarët e quajnë «Rruga e Gurit» (fig. 9). Sipas terrenit kalldrëmi ka gjerësi të ndryshueshme 2-3 m. Pjesa e mezit të tij është shtruar me gurë të zakonshëm gëlqerorë, ndërsa nga të dy anët konturohet me gurë të mëdhenj bordurë me gjerësi 40 – 60 m. e thellësi 70 – 80 cm., të futur në kalldrëm. Veç kalldrëmit të trajtuar me mjeshtëri e zgjedhjes së mirë të trasesë, një karakteristikë tjetër e kësaj rruge të rëndësishme e të sistemuar është dhe ndërtimi i çezmave interesante nëpër pika të ndryshme të saj. Një çezmë e tillë e punuar me mur guri, ku uji rrjedh nëpër një gur të gdhendur formë lugu, ruhet afër urës së Llëngës (fig. 10).

Ura e vjetër e Llëngës ose «Ura e Gurtë» siç e quajnë vendasit, e cila lidh midis tyre fshatrat Jollë e Llëngë e që është pjesë përbërëse e rrugës perëndimore të Mokrës e përmendur më lartë, është ndërtuar mbi përroin «Uji i Ftohtë», që buron nga Guri i Topit (tab. V.). Përbëhet vetëm prej një harku dhe është ndërtuar në një grykë piktoreske me pemë të shumta. Në ditët tona ura ka arritur shumë e dëmtuar. Ruhet vetëm gjysma e gjerësisë së qemerit të harkut nga ana e rrjedhjes së poshtëme. Harku ka formë të thyer me një theksim të lehtë në mes me hapësirë drite 5,4 m. dhe lartësi 3,4 m. nga kyçi në nivelin e ujit. Gjerësia e qemerit është 1,7 m., ndërsa trashësia e tij 1,1 m., duke përfshirë këtu dhe trashësinë 60 cm. të arkivoltës ose harkut të sipërm, i cili e shkel me një dhëmb 7 cm. pjesën e poshtëme. Balli i harkut është punuar me gurë gëlqerorë të latuar, me trashësi 8-15 cm. të lidhur me llaç gëlqere, që inkastrohen një po, një jo gjatë thellësisë së qemerit, i cili është punuar me fuga të rregullta horizontale. Mbështetjet e harkut janë të inklinuara e të larta 1,7 m. mbi nivelin e tokës. Në këtë urë mungojnë muret e shpatullave anësore, pra si pasojë dhe krejt pjesa kaluese e urës me kalldrëm. Kalimi nëpër përrua sot kryhet nëpërmjet një ure të lehtë, konstruksion druri, e cila mbështetet në dy brigjet dhe në kyçin e harkut të urës së gurit.

Një variant i rrugës që kemi përmendur më lart është dhe dega Proptisht – Somotinë – Bishnicë – Llëngë, ku ngjitur rrugës së sotme automobilistike, afër fshatrave Somotinë e Proptisht, mbi përroin Vërriri i Velçanit, ndodhet «Ura e Tereziut» Proptisht (tab. VI). Është ngritur pikërisht aty ku përroi i Vërririt derdhet në Shkumbin. Përbëhet prej vetëm një harku dhe konstruktivisht ruhet në gjendje të mirë. Afërsisht harku ka formën e një segmenti rrethor me hapësirë drite 8 m. Gjatë trasesë, e cila është horizontale, ura arrin gjatësinë totale 16 m. Lartësia maksimale nga niveli i ujit deri në trase është 4,8 m. Gjerësia e urës në pjesën e kyçit është 2,8 m. Qemeri i harkut të urës ka

20) N. Ceka – L. Papajani, **Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike,** Monumentet 1. 1971, 46.
21) N. Ceka – A. Baçe, **Vrojtime arkeologjike në rrethin e Pogradecit, luginën e Devollit dhe Shkumbinit.** Monumentet 3, 1972, 206.
22) **Po aty,** 207.

POR OSOBY

DO NOT COPY



Fig. 9



Fig. 10

trashësinë 65 cm., përfshirë këtu dhe arkivoltën me trashësi 25 cm., që shkel me dhëmb 7 – 10 cm. mbi pjesën e poshtëme të ballit të harkut. Balli është i ndërtuar me blloqe smërçi me trashësi 16-20 cm., që një po, një jo inkastrohen në thellësi të qemerit, i cili është punuar me fuga të drejta horizontale. Në pjesën e kyçit të ballit, në fugat midis blloqeve të smërçit janë futur dhe pllaka shtufi me trashësi 4 cm. Mbështetjet e harkut janë të pjerëta e të ngritura deri në 2 m. mbi nivelin e ujit. Në gjithë muraturën e urës është përdorur llaç gëlqereje.

Nga të dy anët e harkut, 50 cm. nën themrat, janë hapur nga dy vrima 25 x 25 cm. e 40 cm. të thella, për konstruksionin e skelerisë gjatë ndërtimit të urës. Muratura nën mbështetjet e harkut është ndërtuar me gurë masivë smërçi 80-100 të gjata e deri në 40 cm. të larta. Shpatullat anësore të urës janë ndërtuar me gurë shtufi. Shpatulla e djathtë është e riparuar ngjitur me bregun. Nga ana e rrjedhjes së sipërme shpatulla e majtë rrëzë mbështetjes së harkut, del në formë pile duke iu mbështetur bregut të majtë, e duke u lartësuar drejt tij me tri palë shkallë që arrijnë deri në nivelin e kalldrëmit të urës, i cili është punuar me gurë shtufi pllakë. Në këtë urë në vitin 1976 u kryen punime restaurimi në pjesën e djathtë të qemerit nga ana e rrjedhës së sipërme si dhe në pjesë të kalldrëmit nga kjo anë.

Një tjetër rrugë e vjetër në krahinën e Mokrës[23] është ajo që fillon nga Goliku e vazhdon nëpër Selcën e Poshtëme, Slabinjë, Zemçë, Trebinjë, Dunicë, Çezmë, Hondisht, Llëngë. Kjo rrugë e kalonte Shkumbinin me anën e një ure hark guri, afër urës së Tereziut, sot e shkatërruar. Në këtë rrugë hasim dy ura të vjetra me interes në fshatin Çezmë e Madhe dhe një urë të vogël fshati në Kalivaç (tab. VII). Kjo urë ndodhet mbi përruan e fshatit, ngjitur me mullirin. Këtej kalon rruga që lidh Kalivaçin me Dunicën. Ngrihet mbi një hark të vogël gjysmërrethor me hapësirë drite 1,5 m., i cili mbështetet nga të dy anët mbi shkëmb konglomerat. Qemeri me trashësi 47 cm. është punuar me gurë gëlqerorë pllake. Kalldrëmi, që ngrihet pak kurriz në pjesën e kyçit, me lartësi 2,3 m. mbi nivelin e ujit, është punuar me gurë të mëdhenj shtufi lumi dhe ka gjerësinë 1,7 m.

Në fshatin Çezmë e Madhe, pikërisht aty ku bashkohen përroi i Çezmës së Madhe me lumin e Trebinjës, ka ekzistuar një urë e madhe me disa harqe, që lidhte Çezmën e Madhe me Trebinjën. Prej kësaj ure sot ruhet vetëm një fragment i qemerit të harkut të parë nga bregu i majtë, nga ana e Çezmës. Ky qemer me trashësi 53 cm. është punuar me gurë shtufi formë pllake me trashësi 15-20 cm. të lidhur me llaç gëlqereje. Sipër qemeri ka një kornizë me rrasa shtu-

23) Vangjush Manastirliu, **Të dhëna të reja mbi qëndrat arkeologjike në rrethin e Pogradecit,** Buletin Arkeologjik, Tiranë, 1971, IV, 200.

fi me trashësi 7 cm. që formon një dhëmb me qemerin duke e shkelur atë 8 cm. Mbeturinat e kalldrëmit, 1,8 m. i gjerë, janë prej guri lumi shtufi. Aluvionet dhe prurjet e lumit e të përroit e kanë mbushur dhe rritur nivelin e shtratit të lumit, duke mos na lejuar kështu të shohim mbeturinat e këmbëve të urës, për të caktuar të paktën numurin e harqeve të urës.

Rruga Trebinjë – Çezëm e Madhe sot e kalon lumin e Trebinjës, rreth 200 m më lartë urës që përmendëm më sipër, pranë mullirit. Këtu për këtë qëllim është ndërtuar një urë interesante prej druri, ndërtimi i së cilës duhet t'i takojë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar (Tab. VIII). Kjo urë paraqet interes edhe për faktin se për vetë karakterin e materialit të ndërtimit, urat e drurit nuk jetojnë gjatë, kështu që megjithëse sipas burimeve, në vendin tonë kanë qenë ndërtuar shumë ura druri, deri në ditët tona janë të rralla urat e vjetra prej druri të ruajtura. Është e gjatë 20 m., 2,5 m. e lartë dhe ka një zgjidhje të lehtë konstruktive. Përbëhet nga tri mbështetje dhe dy hapësira ndërmjet tyre. Si mbështetje e majtë shërben një shkëmb bregor. Me interes është zgjidhur mbështetja e mezit. Ajo paraqitet në formën e një pile prej mur guri shtufi me llaç gëlqereje, e cila nga ana e rrjedhjes së sipërme është trajtuar e mprehtë për të hapur rrjedhjen e ujit. Është 1,5 m. e gjerë, 3 m. e gjatë dhe 2 m. e lartë. Pjesa e sipërme e saj nga ana e rrjedhjes së sipërme është trajtuar me tri shkallëzime të vogla deri në nivelin e mbështetjes së traut prej druri të pjesës kaluese. Mbështetja e djathtë është një pilë me profil të rrumbullakët nga rrjedha e sipërme, 2,8 m. e gjatë dhe 1,25 m. e gjerë. Ngjitur me të pastaj vijon një rampë me mur guri të thatë prej shtufi, që zbret me pjerrësi drejt bregut. Pjesa kaluese e urës përbëhet prej katër trarësh lisi me seksion 30 x 30 cm., që mbulojnë hapsirat ndërmjet tri mbështetjeve, 7,2 m. dhe 3,7 m. (e djathta) sipër të cilave janë shtrirë tërthorë anje të trasha lisi, të cilat luajnë rolin e kalldrëmit. Kjo paraqet një urë tipike druri me interes në gjininë e saj, për kompozimin, finesën konstruktive dhe teknikën e ndërtimit. Ndërtimi i saj në kohë duhet të jetë kushtëzuar me prishjen e urës tjetër prej guri që pamë më sipër, pasi nuk mund të mendohet ekzistenca e dy urave afër njera – tjetrës për të njejtin qëllim.

Një tjetër rrugë e vjetër me rëndësi, që shkonte tranzit nëpër Mokër, ish ajo që kalonte nëpër Golik, Selcë e Poshtëme, Çervenakë, Memëlisht, Pogradec, Tushemisht e degëzohej për në Manastir e në Korçë. Rrugët e vjetra të krahinës së Mokrës janë përdorur gjerësisht jo vetëm për këmbësorët, por dhe për karvanët tregtare që kalonin për në Korçë e në Manastir.

E lamë për në fund urën e Golikut, jo vetëm sepse është më me interes nga gjitha urat e Mokrës, por edhe pse ndodhet më poshtë rrjedhës së Shkumbinit e të burimeve të tjera ujore që derdhen në Shkumbin e që përshkojnë këtë krahinë (Tab. IX).

Pamë se Goliku kishte pozitë kyçe, pasi që këtej kalonin tërë rrugët e vjetra të krahinës së Mokrës. Ura e Golikut është një nga urat më interesante të vendit tonë si në aspektin kompozicional arkitektonik, ashtu dhe në drejtim të realizimit teknik. Kjo është ndërtuar mbi lumin Shkumbin. Mbi të kalon rruga që lidh Golikun e Proptishtin me Manastirecin, Zall-Torrën, Debrovën, Sllatinjën, etj.

Në pjesën e lumit ku është ngritur ura, shtrati i Shkumbinit ka një farë gjerësie, prandaj edhe ura është ndërtuar mbi dy harqe gjysmërrethore me hapsira të ndryshme, ndërmjet të cilave është hapur një dritare lehtësuese (shkarkuese). Brigjet e urës janë: shkëmborë nga e majta dhe argjilorë djathtas, ku bregu është dhe më i ulët. Gjatësia totale e urës e matur gjatë kalldrëmit arrin 37 m. Në qendër të kompozimit të urës ndodhet harku i madh gjysmërrethor i ndërtuar pranë bregut të majtë, me hapsirë drite 7,4 m. Mbi kyçin e këtij harku ura formon kurriz me lartësinë maksimale 8,5 m. mbi nivelin e ujit. Trashësia e qemerit arrin 90 cm. me gjithë arkivoltën, e cila shkel në dhëmb 10 cm. mbi pjesën e poshtëme dhe ka trashësinë 30 cm. Qemeri në të dy ballët është ndërtuar me gurë smërçi 15-20 cm. të trashë e në lartësi të kombinuar ose sa trashësia e qemerit ose prej dy copësh. I tërë qemeri edhe gjatë thellësisë, është punuar me blloqe smërçi të skuadruar, ku dallohen qartë e në një drejtim fugat horizontale të cilat nisin të drejta që prej fugave të blloqeve të ballit të harkut. Blloqet e ballit çdo 2-3 rreshta inkastrohen 40-50 cm. në thellësi të qemerit për lidhjen më të mirë të tyre, aq më tepër që në këtë urë mungojnë ganxhat metalike të mbërthimit të gurëve ballorë të harkut. Qemeri i harkut kryesor gjatë thellësisë së tij është i ndërtuar me blloqe smërçi dhe shtufi dhe është 2,8 m. i gjerë. Mbështetjet e harkut kryesor janë horizontale e të larta 70 cm. mbi nivelin e ujit. 40 cm. mbi nivelin e mbështetjeve nga të dy anët e harkut janë hapur nga tri vrima 20 x 20 cm. në thellësi të murit për qëllim skelerie gjatë ndërtimit.

Harku i vogël gjysmërrethor i ndërtuar pranë bregut të djathtë ka hapsirën e dritës 6,3 m. Qemeri i tij, me trashësi 75 cm. të dy ballet i ka të punuar me gurë smërçi. Edhe këtu sikurse në harkun e madh ka arkivoltë me trashësi 25 cm., e ndërtuar me gurë smërçi e shtufi, e cila shkel në dhëmb 8 cm. mbi pjesën e poshtëme të qemerit. Gjithashtu edhe në këtë hark mbështetjet janë horizontale e në të njëjtin nivel me ato të harkut të madh. Gjashtë vrimat e skelës

janë hapur edhe në mbështetjet e këtij harku. Një trajtim me interes nga pikëpamja teknike ka këmba e mezit të urës, që ndan dy harqet midis tyre. Pjesa e poshtëme me gjerësi, 2 m. nga ana e rrjedhjes së sipërme është ndërtuar e mprehtë për të hapur rrjedhjen e ujit nëpër hapsirat e harqeve. Në pjesën e sipërme të këmbës është hapur një vrimë lehtësuese ose shkarkuese me gjerësi 1,23 cm. e lartësi 3 m. e konstruktuar nga sipër prej një harku të vogël gjysëmrrethor. Ky hark me trashësi 28 cm. është punuar me gurë smërçi dhe sipër ka një kornizë me gurë shtufi, me trashësi 10 cm. që del me dhëmb 8 cm. ndaj harkut të poshtëm (arkivolta). Muratura ndërmjet hapsirave të urës është punuar me gurë shtufi e gëlqerorë, lidhur me llaç gëlqereje e me një rregullsi të fugave horizontale, si pasojë e latimit të gurëve. Mbështetja e bregut të djathtë rreth 1 m. nga mbështetja e djathtë e harkut të vogël, është e një faze të dytë ndërtimi, gjë që dallohet nga një fugë e qartë vertikale në këtë pjesë.

Për të zbutur pjerrësinë nga ana e djathtë e urës, në një fazë të dytë, kalldrëmi nga bregu i djathtë deri në kyçin e harkut të madh është mbushur nga 0 deri në 60 cm. Kalldrëmi i urës me gjerësi 3 m. është i punuar me gurë lumi me shkallëzim tërthor gurë këlliç çdo 1,2 m., për të evituar rrëshqitjen. Pjerrësia e kalldrëmit të urës nga bregu i djathtë është 16 përqind, pasi bregu është më i ulët, ndërsa nga ana e majtë, ku bregu është shkëmbor i lartë, pjerrësia është më e vogël, 11 përqind.

Lidhur me datimin e urës së Golikut nuk kemi asnjë të dhënë. Mungon ndonjë mbishkrim në objekt, gjithashtu deri më sot në burime të ndryshme nuk kemi hasur ndonjë të dhënë rreth datimit. Në mungesë të burimeve të sakta, rreth datimit, mendoj t'i referohemi analizës tipologjike me ura të tjera të këtij tipi të ndërtuara gjetkë.

Urat me dy harqe të ndryshme, me dritare lehtësuese midis tyre, me kurriz mbi kyçin e harkut të madh e me theksim horizontal, përbëjnë një tip më vete të njohur, me mjaft interes. Të tillë në vendin tonë kemi urën e Mirakës, në Librazhd, e ndërtuar në vitin 1715, të Tabakëve në Tiranë, e ndërtuar në gjysmën e parë të shekullit XIX-të, etj.

Në Mal të Zi mbi lumin Ribnicë ndodhet ura e Njemanit[24], identike me urën e Golikut, për të cilën thuhet vetëm se është ndërtuar në mesjetë. Në Kosovë, Dibër të Madhe dhe Mal të Zi njihet një tip ure shumë i afërt me urën që studiojmë, që mund të themi se është një variant më i zhvilluar i tipit të urës së Golikut. Në këtë rast kemi të bëjmë me ura të ndërtuara me kurriz mbi harkun e madh kryesor, nga të dy anët e të cilit është nga një hark më i vogël. Edhe në këtë rast në këmbën midis harkut të madh e të vogël është hapur dritare lehtësuese e rrallë dhe ndonjë rozetë. Këtu harqet anësore qëndrojnë simetrikisht ndaj aksit vertikal, që kalon nga kyçi i harkut kryesor. Pra, si konceptim arkitektonik është po ai, vetëm se përdorimi i këtij apo atij varianti kushtëzohet nga gjerësia e shtratit të lumit. Kemi gjithashtu të njejtën teknikë ndërtimi, si në punimin e harqeve me arkivoltë, në realizimin e muraturës, etj. Ura të ndërtuara me simetri janë: ura e Gurit në Prizren[25], datuar me supozim si e shek. XVI, ura e Taliçit në Gjakovë[26], (shek. XVIII), ura mbi Radike[27], në Dibër të Madhe (shek. XIX). Ura mbi Bistricë në Bjellopolje të Malit të Zi (fundi shek. XVIII – fillimi shek. XIX)[28] etj.

Pa, Me afërsi mund të shprehemi se ura e Golikut duhet të jetë ndërtuar në gjysmën e parë të shek. XVIII.

Urat e Mokrës, të ndërtuara me mjeshtri e koncept të qartë tregojnë për nivelin e lartë dhe traditën e mjeshtrave popullorë në ngritjen e objekteve inxhinjerike në këtë krahinë, ku ndërtimi i rrugëve dhe urave ka qenë i zhvilluar.

Urat e rrethit të Përmetit dhe të krahinës së Mokrës, përbëjnë vetëm një pjesë të urave të ndërtuara në Shqipëri gjatë shekujve XVII, XVIII e XIX. Gjurmimi i kësaj gjinie arkitektonike në të ardhmen edhe në krahina të tjera të vendit tonë do të sjellë një material akoma më të bollshëm e interesant në këtë fushë. Pavarësisht nga kjo, bazuar edhe në materialin e shtjelluar në këtë artikull, arrimë në përfundimin se ndërtuesit vendas kanë ditur të zgjidhin me mjeshtri shumë probleme që dalin në këto lloj ndërtimesh inxhinierike, si zgjidhja e përshtatja me terrenin, përdorimi me nikoqirllëk i materialit, sigurimi i qëndrueshmërisë së konstruksionit, realizimi i skelerive, e së fundi trajtimi me finesë i tyre që kanë nxjerrë në pah monumentalitetin e kësaj gjinie arkitektonike.

24) N. Katanic – inxh. M. Gojkoviç, **vep. cit.**, 192.
25) **Po aty**, 27.
26) **Po aty**, 65.
27) **Po aty**, 158.
28) **Po aty**, 301.

POVIJEST

DO NOT COPY



URA E KATIUT
NE FSHATIN BENJE - PERMET



DO NOT COPY



URE NE PROIN E BENJES - BENJE

Përmet







DO NOT COPY

URA E LIMARIT

Përmet











TAB. IV

URA NE LAGJEN E SIPERME - LIMAR
Përmet





Premjé A-A





DO NOT COPY

DO NOT COPY

URA MIDIS FSHATRAVE

JOLLE DHE LLENGE

Pogradec





DO NOT COPY

URA E TERZIUT
• Pogradec











URE E VOGEL NE FSHATIN
KALIVAÇ - Pogradec



DO NOT COPY













URE DRURI NE FSHATIN ÇEZEM

Pogradec





DO NOT COPY

DO NOT COPY



URA E GOLIKUT
Pogradec







Valter SHTYLLA

DO NOT COPY

CERTAINS PONTS ANCIENS DANS L'ALBANIE DU SUD

RESUME

Cet article a pour objet la description de certains ponts anciens en arc de pierre, dans un bon état de conservation dans le district de Përmet et dans la région de Mokër (Pogradec), ainsi que d'autres ponts de ces mêmes zones dont on ne conserve actuellement que certains éléments. L'étude de ces ponts se répartit en deux chapitres.

1. Ponts anciens dans le district de Përmet

La Vjosa, un des plus grands fleuves du pays, traverse le district de Përmet du S.-E. au N.-O. En parcourant de part en part presque toute la zone montagneuse de Përmet, il divise les régions de Rrëzë et Malëshovë situées sur la gauche de son cours d'autres régions comme Shqeri et Dishnica qui s'étendent sur sa rive droite. Nous avons affaire à des régions qui ont eu une population bien dense et un développement satisfaisant pendant les différentes périodes historiques. Pour assurer le développement normal des rapports sociaux et économiques entre les différentes régions et les villages de la zone de Përmet, la mise en place d'un réseau de communication comportant des routes et des ponts était indispensable. Depuis bien longtemps la vallée de la Vjosa est traversée par la route venant de Korça et de Leskovik en direction de Përmet pour rejoindre Këlcyra; ici, elle se ramifie en deux branches, dont l'une se dirige vers Berat et l'autre, toujours le long de la Vjose, traverse le col de Këlcyra pour atteindre la ville de Tepelena. C'est justement en suivant l'itinéraire de cette route que nous allons mentionner certains ponts franchissant en divers points la Vjose et ses affluents, et cela dans le but de relier entre eux les régions et les villages de cette zone.

A notre avis les ponts, objet de cet article, ont été mis en place dans la période allant du XVIIe aux XVIIIe-XIXe siècles. L'ancien itinéraire de la route Leskovik-Përmet rejoint le cours de la Vjose immédiatement après avoir laissé à gauche le pont en pierre de Perat (actuellement en ruine) sur le fleuve Sarandapor, où passait la route conduisant à Gianina. La route en direction de Përmet longe la rive droite de la Vjose. Au village de Çarshove se trouve le torrent de même nom, qui est un affluent de la Vjose. A 600 m du point où celui-ci se jette dans la Vjose, il y avait un pont de pierre, actuellement en ruine. Après avoir dépassé le village de Çarshove toujours sur la rive droite de la Vjose, la route avance en direction de Përmet. A environ 500 m du pont suspendu de Përmet se trouvent les ruines d'un pont de pierre en arc. Ce pont reliait les villages du cours supérieur de la Vjose: Zhepë, Biovizhdë, Draçovë, Kaludhi, et autres, à la zone de Petran et Shqeri.

En suivant cette même route plus au nord on arrive au centre du village de Petran, où l'ancienne route franchissait la Vjose à travers un pont de pierre pour continuer sa marche vers Përmet le long de la rive gauche de la Vjose, à la différence de la route actuelle qui en longe la rive droite. Le pont de Petran, qui se trouve un peu plus loin du point où la Longaricë se jette dans la Vjose, est mentionné dès 1806 par Pouqueville. Actuellement on ne conserve que quelques fragments des supports de son arc principal, mais selon une ancienne photographie il ressort qu'au moment de sa construction il était pourvu de sept arcs et deux ouvertures sur les côtés de l'arc principal.

Longarica est un des principaux affluents de la Vjose dans le district de Përmet. A quelque kilomètres du point où il se jette dans la Vjose, à la station thermale de Benjë, se trouve le pont de Katiut; un ouvrage vraiment intéressant, bien conservé et mis en place dans la deuxième moitié du XVIIIe siècle.

A l'entrée du village de Benjë, sur le torrent de même nom, se trouve un petit pont en un arc type flèche, finement exécuté pendant la deuxième moitié du XVIIe siècle.

Plus à nord de Petran le pont de Badëlonjë, en un arc principal et deux autres plus petits latéralement, franchit la Vjose. Actuellement il n'en reste que quelques fragments de ses supports. Dès le commencement du XIXe siècle, Pouqueville et Hughes citent le pont de Badëlonjë.

En suivant le cours de la Vjose en direction de Përmet, précisément à l'entrée de cette ville il y avait sur ce fleuve deux grands ponts de pierre qui n'existent plus. Le pont supérieur, à quelques centaines de mètres du pont actuel de la ville, est vraisemblablement plus ancien que l'autre qui franchit la Vjose plus près de Përmet. Au point où se dresse actuellement le pont de Përmet, il y avait autrefois un grand pont en pierre dont

Aleksandër MEKSI, Gjergj FRASHËRI

DO NOT COPY

ARKITEKTURA DHE RESTAURIMI I XHAMISË SË HAXHI ETHEM BEUT NË TIRANË

Si qytet mesjetar Tirana fizionominë e saj e fitoi gjatë periudhës së pushtimit turk duke patur në qendër të ndërtimit të vet urbanistik, pazarin, faltoret e kultit islamik, kullën e sahatit, banja dhe hane. Faltoret e kultit islamik fillojnë të ndërtohen në vendin tonë me pushtimin osman gjatë gjysmës së dytë të shek. XV. Ndër monumentet e para, që nga burimet mund të vendoset me saktësi në kohë është xhamia e Fatihut mbi kullën me portën kryesore të kalasë së Elbasanit, e tipit me çati druri, ndërtuar nga Sulltan Mehmeti II në vitin 1466, e cila është shembur nga tërmeti i vitit 1930. Gjatë periudhës së parë të vendosjes së pushtuesit, me sa duket ndërtohen një numër i kufizuar faltoresh myslimane të cilat i shërbenin vetëm administratës pushtuese dhe garnizoneve turke. Me sa duket mjaft prej xhamive të para janë rënuar me kohë edhe për shkak të materialeve jo të qëndrueshme të përdorura në ndërtimin e tyre. Ndonjë prej tyre është transformim kishe në xhami siç kemi rastin e Shën Stefanit në kala të Shkodrës (rënë në vitin 1479) apo kishën pranë kalasë së Lezhës.

Me stabilizimin e pushtimit osman dhe fillimin e islamizimit të popullsisë vendase, faltoret myslimane — xhamitë dhe mesxhidet fillojnë të ndërtohen në territorin e vendit tonë, duke zënë një vend qendror në organizimin urbanistik të qendrave të banuara.

Xhamia e Haxhi Ethem Beut, që përbën objektin e këtij shkrimi, ndodhet në qendër të Tiranës. Dikur kjo bënte pjesë në kompleksin e ndërtimeve që përbënin qendrën e Tiranës. Përballë saj ndodhej Pazari, më në lindje xhamia e Sulejman Pashës (1614) me banjon pranë, në veri perëndim xhamia e Karapicëve. Xhamia e Haxhi Ethem Beut sot përbën një kompleks së bashku me kullën e Sahatit.

Nga mbishkrimi që ndodhet mbi portën në krahun verior të portikut mësojmë se xhamia ka filluar të ndërtohet në vitin 1794 nga Molla Beu prej Petrele e stërnip i themeluesit të Tiranës dhe u mbarua në vitin 1821 nga i biri i tij Ethem Beu. Nga mbishkrimi mësojmë se Molla Beu vdiq në vitin 1807 mbasi arriti të mbarojë kupolën, ndërsa Ethem Beu përfundoi punimet duke bërë portikun, çatinë, minaren dhe pikturat[1]. Studiuesit e parë të këtij monumenti L. Rej dhe H. Ceka supozojnë se lufta ndërmjet sundimtarit të Tiranës Kapllan Pashës dhe Ibrahim Pashës të Shkodrës duket se ndërpreu punimet e ndërtimit të xhamisë, çka shpjegon dhe zgjatjen në kohë të tyre[2].

ARKITEKTURA

Xhamia e Ethem Beut, përbëhet nga salla e lutjeve, portiku që e rrethon atë nga lindja dhe veriu, si dhe minarja (Tab. I). Përpara xhamisë janë varret e Ethem Beut dhe gruas së tij Ballkize. Aty ka qenë edhe një pus që sot është i mbuluar nga dherat. Salla e lutjeve është ndërtuar me vëllim unik mbuluar me kupol. Ajo ka planimetri katrore. Në të hyet nga një portë e vetme në anën veriore. Vëllimi i sallës përbëhet nga një kub dhe kupola që ngrihet drejtpërdrejt mbi të nëpërmjet trompave në qo-

1) L. Rey, H. Ceka, **La mosquée de Ethem Bey,** Albania, 5 (1935) 65-66. Ky artikull do të kishte një vijim ku do të trajtohej më gjerë arkitektura e monumentit, por që nuk u dha në shtyp. Në të datat jepen jo saktë. Drejt këto mbishkrime gjehen tek K. Frashëri **Vështrim mbi zhvillimin shoqëror, arsimor e kultural në Tiranë deri në mesin e sh. XIX.,** Arsimi popullor, 4-1964, 65.

2) L. Rey, H. Ceka **vep. cit.** 66.

shet (Tab. II). Çdo faqe e kubit, përjashtuar ajo veriore ku ndodhet hyrja, ka nga pesë dritare. Dritaret janë vendosur në tri radhë, duke qenë me nga dy të poshtëmet dhe një rreshti i sipërm. Dritaret e radhës së poshtëme janë kuadratike, me shpatulla të ndërtuara prej gurësh të gdhendur e të profiluara. I njëjti profil kalon dhe në arkitraun e gurtë. Pragu i dritareve është edhe ai i gurtë por i paprofiluar. Kjo dritare është më thellë ndaj faqes së murit, duke krijuar një shkallëzim ndaj saj, që vijon dhe sipër me një hark me majë të mprehtë ndërtuar prej gurësh të gdhendur dhe që lot rolin e një mbulese për këtë dritare-kornizë. Dritaret e tjera janë me hark të mprehtë, të trajtuara njëlloj si kjo e fundit.

Të gjitha dritaret e radhës së poshtëme kanë në anën e jashtme kangjella prej hekuri të punuar me rafje. Këto kangjela mbërthehen në gurët e gdhendur që janë rreth dritares. Dritaret e sipërme, kanë xhama të ngjyrosur të vendosur në një skelet gëlqereje sipas vizatimeve karakteristike për artin e kohës. Nga këto radha e dytë ka dy dritare, nga një mbi dritaret e poshtëme. Rradha e tretë ka vetëm një dritare.

Si zakonisht përballë hyrjes ndodhet mihrabi, i punuar si nikja e thelluar, me stabaktite në pjesën e sipërme gjysëm konike. Forma e tij karakteristike nënvizohet dhe nxirret në dukje nga piktura murale që e konturon atë dhe që thellon dritë hijet e stalaktiteve. Në të djathtë të tij (më nga perëndimi) është mimbari që shërbente për faljet e të premteve. Ai është në formën tradicionale të mimbareve dhe i ndërtuar prej druri, si në strukturat ashtu dhe parmakët e shkallëve dhe baldakini në pjesën e sipërme të tyre. Trajtimi i jashtëm i tyre është mjaft elegant. Të gjitha elementet dhe sipërfaqet e drunjta janë të gdhendura me profile të kurbuara dhe të pikturuara me mjaft shije duke respektuar trajtimin tektonik të mimbarit. Po prej druri por mbi dy shtylla guri dhe pilastra në muret është edhe mafili, i vendosur mbi hyrjen për në sallë në tërë gjerësinë e saj. Në mafil hipet nëpërmjet shkallëve të minares. Mafili është i tëri i pikturuar, në kolonat, trarët mbi to, tavanin dhe parmakët. Dekori i përdorur është edhe këtu bimor.

Dyshemeja e sotme e xhamisë është e re dhe e shtruar me pllaka keramike në fillim të viteve 40, kohë në të cilën janë riparuar dhe dritaret e poshtëme nga ana e brendshme (nga salla).

Kalimi nga faqet e rafshta të vëllimit kubik në kupolën sferike bëhet nëpërmjet trompave në qoshet të cilat tashmë janë një zgjidhje tradicionale për arkitekturën myslimane të vendit tonë. Pjesa e sipërme e mureve të rafshta përfundon me harqe të mprehtë që vijojnë me elegancë nga ato në trompat, duke krijuar me linjën e tyre një përfundim jo të prerë të mureve dhe në të njëjtën kohë një vazhdim të qetë të shikimit nga to në kupolën. Këto harqe nënvizohen edhe nga dekori piktorik nëpërmjet bordurave me ngjyrë të errët. Dritarja e sipërme ndodhet pikërisht nën harqet në të katër muret anësorë.

Një kornizë krijohet aty ku fillon kupola, e cila zotëron qetë volumin e kubit nën të. Kupola është gjysëm sferike dhe e verbër d.m.th. pa dritare nën të dhe pa tambur të mirfilltë në anën e brëndshme, si pjesa më e madhe e xhamive të vendit tonë.

Në anën e jashtme xhamia përbëhet prej xokolit dhe vet mureve. Duke qenë e vendosur në teren të pjerët, sot xokoli shihet vetëm në anën jugore sepse në anët e tjera është trotuari i rrugës pranë (ana lindore), dheu i oborrit të vogël pranë (ana perëndimore) ose hyrja për në xhaminë që është një rregullim i vonë (ana veriore). Të tre pjesët përbërëse të xhamisë, salla e lutjeve, portiku dhe minarja edhe pse të lidhura organikisht me njëra tjetrën janë të trajtuara në drejtim të soditjes arkitekturore deri në një farë mase të pamvarura, mundet si rezultat i ndërprerjes në kohë në ndërtimin e xhamisë dhe i dy ktitorëve e mbase dhe dy grupeve ndërtuesish.

Vëllimi qendror me kupol, në anën e jashtme përbëhet prej dy pjesësh, prej pjesës kubike dhe tamburit të ulët me kupol. (Tab. III). Pjesa kubike që i takon vëllimit të brendshëm kubik, deri në fillimin e kupolës, është me faqe të rafshta e të suvatuara duke patur me gurë të gdhendura vetëm qoshet. Suvatimi i mureve është bërë nga që ato janë ndërtuar me gurë lumi, siç shihet në pjesët që i tokojnë çatisë, çka tregon se suvatimi është bërë me përfundimin e të tërë godinës. Muret e pjesës kubike përfundojnë me një kornizë mjaft të thjeshtë prej rasash të zeza guri. Në këtë pjesë janë dhe dritaret e vendosura në tre radhë.

Mbi këtë vëllim kubik, nëpërmjet një ngushtimi ngrihet tamburi me kupolën. Në qoshet e formuara nga ky ngushtim kemi pjesë të mbuluara me çati në formë trekëndëshe më të ulëta anash, ndërsa përgjatë faqeve pjesë të ngushta mbuluar me tjegulla. Tamburi është i ulët dhe tetë faqësh dhe përfundon me një kornizë të rafshtë me një radhë rrasash guri. Në të fillon mbulesa me plumb e kupolës.

Portiku i xhamisë së Haxhi Ethem Beut në aspektin funksional ka shërbyer për krijimin e një ambienti me një mihrab të dytë në të cilin të mund të faleshin ata që vinin vonë apo nuk gjenin vend në sallën e lutjeve. Ndryshe nga zgjidhja tradicionale e portikëve që shërbenin për këtë qëllim, të cilët zinin ballin përballë vëllimit qendror me kupol apo mbuluar me çati druri, portiku i xhamisë së Haxhi Ethem Beut e qarkon atë nga dy anët veriore dhe lindore, duke patur të vendosur mihrabin e dytë në murin që mbyllte nga jugu portikun. Anash këtij

DO NOT COPY

BOTIMET

mihrabi të dytë janë nga dy dritare të vendosura njëra mbi tjetrën (Tab. IV-2). Duke i vrojtuar në anën e jashtme rezulton se ato janë në të njëjtin nivel me dritaret e sallës së lutjeve, në të njëjtën formë dhe të punuara me të njëjtët materiale. Gjithashtu shihet që ato janë në një plan me faqen lindore të sallës duke patur fillimet e harqeve që i mbulojnë, dritarja e poshtëme edhe shpatullën me gurë të gdhendur, pjesë të murit të sallës. Këto dy fakte tregojnë se muri i portikut është ndërtuar në një kohë me sallën e lutjeve dhe se portiku bënte pjesë në projektin fillestar të xhamisë.

Portiku ka në planimetri formën e shkronjës L dhe ndërsa nga jugu mbyllet me murin e mësipërm, nga anët e tjera është i hapur me tri arkada mbi kolona, të cilat në kontaktet me muret janë gjysëm kolona. Hyrja në portik bëhet me disa këmbë shkallë dhe është në nivelin e dyshemesë së sallës së lutjeve me të cilin lidhet me një koridor. Dyshemeja e portikut si zakonisht është në nivel më të lartë, duke rezultuar akoma më lart ndaj rrugëve dhe terrenit pranë xhamisë. Në këtë mënyrë portiku ngrihet mbi një podium që shërben si bazament ndaj arkadave mbi kolona. Deri në vitin 1940, muri-bazament i arkadave ishte i suvatuar prej llaçi gëlqeror mbi strukturën prej gurësh lumi me madhësi mesatare, si të mureve të sallës së lutjeve. Në atë kohë në anën e jashtme ndërtohet një perde gurësh të gdhendur, të lidhur në aspektin arkitekturor me mjeshtëri me arkadën, sa që pa njohjen e këtij fakti, të dokumentuar në dhjetëra fotografi të kohës, mund të mirej si i njëkohshëm me portikun.

Krahu lindor i portikut kufizohet nga lindja me një pjesë muri, vazhdim i murit jugor dhe arkadë. (Tab. VI-3). Arkada përbëhet prej shtatë harqesh gjysëm rrethore që mbështeten në gjysëm kolonën pilastër, pranë murit nga jugu dhe tek shtatë kollona. (Tab. V). Mbi murin bazament, është një rradhë pllakash të rrafshta të gdhendura me profil të lakuar nga ana e jashtme, gdhendje që vazhdon për tërë gjatësinë por jo rigorozisht në një vijë të drejtë. Kolonat ngrihen mbi to nëpërmjet një baze të gurtë. Baza është një copë dhe ka si pjesë të poshtëme një pllakë me bazë katrore mbi të cilën vjen një pjesë me kalime të lakuara deri tek trupi i kolonës mbi të. Trupi i kolonës është një copë, prej guri gëlqeror. Kolonat janë të tëra të njëjta për gjithë portikun, me përjashtim të kolonës në qoshen veri-lindore, e cila në qoshe ka të ngjitur një kolonë më të hollë, që vazhdon dhe në bazën e kapitelit, gdhendur me mjaft mjeshtëri, pa cënuar unitetin e vet kolonës së qoshes. Kjo zgjidhje mjaft e rallë është bërë për ta bërë më të qëndrueshme në dukje kolonën, për t'i dhënë asaj një peshë më të madhe në shikimin e spektatorit, pra për arsye estetike. Kapitelet janë të njëjta për nga përmasat, por jo nga trajtimi i jashtëm dekorativ. (Tab. VIII). Ato janë një copë dhe të gdhendur në gurë gëlqeror. Kapitelet përbëhen nga vetë kapiteli dhe jastëku mbi të. Kapiteli ka dekoracion floreal prej gjethesh dhe degësh të ndërthurura i cili i mvishet trupit pa qenë pjesë përbërëse e tij. Një dekor më të lehtë ka edhe jastëku.

Arkada perëndimore ka vetëm tri harqe. Kolona e qoshes së saj nuk ndryshon nga të tjerat, pra jo si ajo e qoshes verilindje.

Arkada veriore, përbën ballin e hyrjes për në portik. (Tab. III). Ajo formohet prej katër hapësirave të mbuluara me harqe dhe portalit të hyrjes, të vendosur jo në mes të arkadës por në një hapësirë më nga perëndimi për t'u përputhur me hyrjen për në sallën e lutjeve.

Harqet e kësaj ane janë më të mëdhenj, rezultat i aplikimit të arkadës në një bazament të ndërtuar më parë.

Hyrja është trajtuar me mur të rafshtë, duke ndërprerë arkadën e cila mbështetet në dy gjysëm kolona. Deri në nivelin e kapiteleve, muri i mësipërm është punuar me gurë të gdhendur. Në mes të tij është porta, e trajtuar jo më si portalet tradicionale të xhamive, por me arkitra të rafshtë, i cili si edhe shpatullat e saj janë përpunuar me shkallëzime me profil të drejtë. Mbi arkitraun është mbishkrimi i Haxhi Ethem Beut ndërsa sipër anash tij janë dy pllaka me ornamente bimore në relief. Mbi të një hark i verbër, i nënvizuar dhe nga bordurat e ngjyrosura, bën lidhjen e harqeve të arkadës dhe krijon idenë e vazhdimësisë së saj. Sidoqoftë trajtimi arkitekturor i murit që mbyll arkadën, përmasat e portës, njollat me ngjyra (mbishkrimi, reliefet) si dhe harku i verbër në pjesën e sipërme, nuk e dëmtojnë në aspektin estetik vlerën e arkadës as ndjenjën e vazhdimësisë së saj nga të tëra anët.

Portiku mbulohet nga një çati me konstruksion druri dhe tavan të rafshtë dërrasash. Çatia është me katër kullime uji dhe vazhdon tej portikut me strehë të gjëra (1.65 m) që janë karakteristike për arkitekturën popullore të Shqipërisë së Mesme. Në gjendjen përpara restaurimit, për shkak të pjerësisë së vogël të çatisë origjinale, çatia ishte ngritur duke prurë për pasojë si prishjen e çatisë në formë trekëndëshi në qoshen verilindore të vëllimit kubik, ashtu edhe të formës së çatisë së vjetër. Kështu mbyllen pjesërisht dritaret e rradhës së sipërme në anët veriore e lindore dhe takohen në një pikë mahit e flegrës veriore. Po të shikosh në anën e brendshme çatia ruhet nga rasat e gurit që tregonin vendin e çatisë së dikurshme me pjerrësi më të vogël mahitë e së cilës përfundonin në mur në pika të ndryshme dhe në të njëjtin nivel.

DOKTORI

(Tab. IV, 4). Rrasat e mësipërme shërbenin për të kaluar mbi tjegulla uji që ridhte nëpër mure. Nën rrasat janë vrimat e trarëve të çatisë së vjetër.

Forma e vjetër e çatisë me pjerësinë e saj nën minimale (sidomos në flegrën veriore që është më e madhja) shtron një sërë problemesh lidhur me përcaktimin e ndërtimeve të bëra nga Molla Beu dhe atyre të të birit të tij Haxhi Ethem Beut, që lindin nga interpretimi i mbishkrimeve ndërtimore të tyre dhe të dhënat që ofron monumenti. Së pari, duke patur parasysh vazhdimësinë e murit jugor të portikut ndaj atij të xhamisë (nuk ka fugë), bazamentin ndërtuar me gurë lumi, rrasat e gurit lënë në faqet veriore dhe jugore të sallës së lutjeve, arrijmë në përfundimin se edhe në idenë e Molla Beut, ndërtuesit të parë, xhamia kishte portik në shkrirjen planimetrike që ze dhe sot. Mbishkrimi i tij thotë gjithashtu se si arriti ta përfundonte kupolën[3]. Së dyti, është e qartë se portikun e ndërtoi Haxhi Ethem Beu siç del dhe nga mbishkrimi[4], por, për mendimin tonë me këtë duhet kuptuar ndërtimi i arkadave dhe çative mbi të sepse muri jugor është ndërtuar njëherazi me xhaminë bashkë me bazamentin e portikut. Nuk mund të shprehemi nëse edhe Molla Beu kishte ndërmend të ndërtonte një portik të tillë të gurtë apo si zakonisht me kolona druri. Sidoqoftë ndërprerja në kohë që shpjegohet edhe me luftrat e sundimtarit të Tiranës Kapllan Pashës dhe atyre të Shkodrës në fillim të shekullit XIX mund të ketë prurë për pasojë që Haxhi Ethem Beu të ketë përdorur të tjerë ndërtues dhe në këtë mënyrë forma e sotme e portikut i dedikohet atij dhe atyre. Për këtë nisemi nga ambicja e Haxhi Ethem Beut për të ndërtuar një xhami që të ishte për Tiranën si Shën Sofia për Stambollin, çka shprehet qartë në mbishkrimin e tij. Po kështu nuk duhet lënë mënjanë ndryshimi cilësor në punimin e mureve. Ato të sallës lutjeve janë me gurë lumi dhe të suvatuara duke patur gurë të gdhendur vetëm në qoshet, ndërsa portiku dhe minarja tregojnë qartë për një ndryshim cilësor në këtë drejtim.

Pikërisht Haxhi Ethem Beut dhe mjeshtrave të përdorur nga ai i takon ndërtimi i minares, që është një përbërës me vlerë në këtë monument. Minarja si zakonisht ndodhet në të djathtë të sallës së lutjeve dhe lidhet me të në dy nivele, në dyshemenë e sallës dhe atë të mafilit. Pjesa e poshtëme e minares është me seksion drejtkëndësh dhe shkon në lartësi deri ku fillon çatia e ulët trekëndëshe e qoshes veriperëndimore, duke përfunduar me një kornizë të hollë gurësh të rafshtë. Mbi të vjen një pjesë e ulët trung piramide shumë faqëshe, në të cilat janë vizatuar një sërë trekëndësha të zgjatur e të përmbysur nga një për çdo faqe. Mbi këtë me një kornizë që ndjek ritmin e pjesës së sipërme fillon trupi i minares i cili shkon deri tek kazani duke u ngushtuar lehtazi. Trupi është shumëfaqësh, duke qenë faqet të kurbuara nga brenda si kanelyrat e kollonave antike. Mbi trupin e minares vjen kazani, më i gjerë dhe i punuar me gurë të nxjerrë njeri ndaj tjetrit por të profiluar bukur që krijojnë idenë sikur është gdhendur prej një cope. (Tab. IV. 3). Punimi i pjesë së poshtëme të kazanit ndryshon nga ato të sh. XV-XVI të ndërtuara në vendin tonë dhe ka paralele me minaret bashkëkohëse të Stambollit. Mbi kazanin vjen pjesa e sipërme e hollë dhe e lartë që përfundon me çati druri konike veshur me plumb. Për daljen në kazan ka një portë të ngushtë e të ulët.

Në brendësi minarja ka vetëm funksionin e shkallës për t'u ngjitur në kazan. Shkallët janë helikoidale prej gurësh një cope që lëvizin ndaj njeri-tjetrit duke patur pjesën qendrore njëri mbi tjetrin dhe që formon «shtyllën» e murit të minares. Në anën e jashtme janë gurët në dukje që lidhen me njeri-tjetrin dhe me gurët e shkallëve me ganxha hekuri të fiksuara në gurë me plumb. Kjo mënyrë lidhje bën të qëndrueshme dhe si një copë minaren. Me të njëjtën mënyrë janë forcuar dhe pllakat e parapetit të kazanit si edhe vetë gurët e shkallës në pjesën e mezit.

Shkallët e brendshme të minares ndriçohen nga pak dritare të vogla si frengji.

Minarja ndërtohet, së paku në pjesën e poshtëme njëkohësisht me xhaminë dhe lidhen me të për t'i siguruar asaj një qëndrueshmëri më të madhe. Në të dy mbishkrimet ka një mospërputhje. Mbishkrimi për Molla Beun thotë se ai nuk arriti ta plotësojë minaren pra është vepruar si thamë më lartë dhe duke lënë të ndërtohej veçmas trupi i minares gjë që nuk arriti ta bëjë dot. Mbishkrimi i Ethem Beut thotë që Molla Beu nuk mundi ta ndërtojë minaren dhe se ai ngriti minaren. Për mendimin tonë kjo duhet interpretuar si mos përfundim i ndërtimit të minares nga i pari dhe ngritje e trupit të minares nga i dyti. Të dy pjesët janë ndërtuar me të njëjtin gur, madje në pjesën e poshtëme, bazament i minares, janë vendosur disa gurë mermeri të gdhendur me zbukurime bimore në sipërfaqe sipas teknikës dekorative të kohës. (Tab. VIII).

Me përfundimin e ndërtimit në vitet 1820-21 (1236 H. sipas mbishkrimit) bëhet edhe pikturimi i ndërtesës brenda dhe jashtë, ndërsa pikturimi i arka-

3) K. Frashëri vep. cit. 65.
4) **Po aty,** 65.

dës në vitin 1823 (1238 H.) siç kuptohet nga mbishkrimi në peisazhet mbi portën e jashtme[5].

E krahasuar me xhamitë e tjera të Tiranës, xhamia e Ethem Beut përbën një hop cilësor që nuk u arrit dot më nga ato që tentuan ta imitojnë. Kështu u pajis në vitin 1844 me një portik dykatësh mbi kolona guri edhe xhamia e Sulejman Pashës[6]. Një portik të njëjtë kishte edhe xhamia e Karapicëve (Esnaf Xhami)[7]. Si u tha dhe më lart këto nuk ishin veçse kopjime pa ndonjë vlerë artistike.

Në aspektin arkitekturor xhamia e Haxhi Ethem Beut përmban mjaft vlera që e bëjnë të zërë një vend të rëndësishëm për monumentet e kultit mysliman që u ndërtuan në vendin tonë gjatë sh. XV-XIX. Brendësia e sallës karakterizohet nga vëllimi unik e i ngurtë i kubit me kupol, i ndriçuar bollshëm nga dritaret. Kemi të bëjmë pra me një zgjidhje tradicionale për xhamitë. Vëllimet e të dy pjesëve janë të ekuilibruara me njëra-tjetrën, kalimi nga kubi për tek kupola është i qetë për përdorimin e arritur të trompeve me stalaktite që fshehin shtytjet dhe vijueshmërinë e tyre përgjatë mureve me harqe të mprehta. Një rol të rëndësishëm për një ndjenjë të tillë lot dhe dekoracioni i kupolës dhe i pjesës së sipërme të mureve, dekor që në të njëjtën kohë i unifikon dhe i dallon pjesët nga njera-tjetra. (Tab. VI. 1, 2). E para arrihet nëpërmjet përshtypjes së përgjithshme të paretit të pikturuar në të njëjtën mënyrë e dyta nëpërmjet konturimit me bordura ngjyrash të erëta të pjesëve të kontaktit ndërmjet tyre. (Tab. VII, 2-4). Dekori i matur i brendësisë që dendësohet tek mihrabi (Tab. VI, 4). përmasat e goditura të minberit dhe mafilit (Tab. VII, 1). dhe dekori i tyre elegant bëjnë që hapsira e brendshme të jetë intime dhe e ngrohtë për spektatorin.

Si në xhamitë e tjera edhe këtu kemi një përputhje të plotë të brendësisë me anën e jashtme. Muret e jashtme siç mund të gjykohet për ata perëndimor dhe jugor, janë të rafshtë, pa ngjyrë, të suvatuar. Por, kjo nuk mund të quhet karakteristike e monumentit, për derisa pjesët e tjera të tij ofrojnë një pamje krejt të ndryshme.

Në saje të portikut, xhamia e Haxhi Ethem Beut ka në anën e jashtëme dy fytyra, rezultat deri në një farë mase i dy ndërtuesve. Më afër zgjidhjeve të zakonshme është xhamia kur vështrohet nga jug-perëndimi, që nga portiku është i pandjeshëm. Vëllimi është i lartë, i hedhur, por i ftohtë, shihet qartë përputhja e brendësisë me anën e jashtme, kemi ekuilibër të pjesëve të plota me dritaret. Një pamje krejt të ndryshme kemi nga anët e tjera ku portiku lot rolin kryesor në përcaktimin e xhamisë. Në këtë mënyrë shikimit të spektatorit i ofrohet tërësia portik-salla e lutjeve-minare. Lëvizja e shikimit kalon nga portiku që e rrethon nga dy krahët tek vëllimi kubik me kupol, që shihet në pjesët e sipërme të tij, e përfundon me minaren, në një kalim gjithnjë në ngritje. Portiku, sidomos krahu lindor i tij me përmasat e tij dhe proporcionet e gjetura ndërmjet kolonave dhe arkadës, ritmit të saj, përbën një element mjaft me vlerë. E ngritur mbi një bazament të lartë, përmasat e portikut mund të jenë më të vogla, pra më afër shkallës njerëzore, duke i rezervuar në këtë mënyrë brendësisë së tij një intimitet të nevojshëm ndër të tjera dhe nga funksioni. E njëjta shkallë vërehet edhe tek portali i hyrjes për në portik. Në perceptimin si një vëllim i vetëm i portikut lot rol dhe dekori piktural i tij që i nënrendohet arkadës.

Për vetë thellësinë e tij portiku është njëherazi transparent dhe lëndor. Dritë hija dhe ngjyrat e mureve të brendshme kontribuojnë në këtë. Portiku i xhamisë është ndër ato raste kur çatia lot një rol jo të vogël për prezencën e saj. Ajo mbulon, duke zvogëluar pjesët e dukshme të vëllimit me kupol dhe bën më të natyrshëm portikun e thellë. Portiku i qëndrueshëm në tërësi me linjën e tij të lehtë dhe të lëvizshme, kalon në një plan të dytë vëllimin kubik, i jep një vend më të justifikuar minares, që si asnjë minare e xhamive të vendit tonë lot rol kaq aktiv në vlerësimin e tërë ndërtesës me siluhetën e saj elegante dhe dinamike.

Që mjaft nga ndërtuesit e xhamisë janë mjeshtra vendas apo që veprojnë në Shqipërinë e Mesme e tregon fakti se i njejti dekor i gurëve të gdhendur dhe kapiteleve me ndryshime të pakëta në formë, por i të njejtit nivel haset edhe në varrin e Kapllan Pashës, si dhe në kullën e sahatit që tradita ja atribuon po Haxhi Ethem Beut, i cili ngriti edhe një medrese.[8].

RESTAURIMI

Duke qenë në qendër të qytetit, xhamia i është nënshtruar punimeve të herëpashershme që kanë patur për qëllim mirëmbajtjen e godinës. Kështu është bërë një rindërtim kapital i çatisë duke shfrytëzuar

5) Po aty 68-68, L. Rey, H. Ceka, **vep. cit.** japin një paraqitje të gjerë të tematikës dhe përmbajtjes së këtyre pikturave duke i ilustruar.
6) K. Frashëri **Po aty,** 69.
7) A. Degrand **Souvenirs de la Haute Albanie,** Paris 1901, fq. 195.
8) K.Frashëri, vep. cit. fq. 68.

DOWNLOAD

DOKTORATURE

strukturën bazë dhe duke e ngritur atë më lart, duke ritur pjerësinë. Në këtë kohë është ndryshuar dhe çatia trekëndëshe në qoshen verilindore dhe janë zvogëluar dritaret e këtyre dy anëve. Gjithashtu është bërë në vitin 1940 veshja me gurë e bazamentit të portikut. Si një ndërhyrje duhet konsideruar edhe rindërtimi i minares në kohën e luftës.

Nga ana e Institutit të Monumenteve të Kulturës janë marë herë pas here ndërhyrje konservuese si ato të pikturës (1960-63) dhe rindërtimi i çatisë konike me strukturë të drunjtë të minares (1969).

Në vitin 1974 duke patur parasysh nevojën e një ndërhyrje kryesore në strukturat e drunjta dhe në mbulesën e portikut, u ndërmor studimi i monumentit për të përcaktuar qartë formën e çatisë së vjetër dhe masën e ndërhyrjes. Siç e pamë dhe më lart rezultoi se çatia e sotme është rezultat i meremetimeve që i janë bërë monumentit në kohë dhe se në gjendjen origjinale krijohej mundësia për një vlerësim më të mirë të tij edhe pse pjerësia ishte nën minimalen, pasojat e këqija të së cilës mund të eliminohen gjatë mbulimit me tjegulla. Mbi një bazë të tillë u hartua projekti i restaurimit i cili parashihte të rindërtohej çatia në formën e vet origjinale, të riformohej çatia e ulët trekëndëshe e qoshes verilindore si dhe të kthehej në formën e parë dyshemeja e hajatit.

Projekti i restaurimit parashihte të mos rikthente në formën e parë, murin bazament të arkadave për dy arsye. Së pari, sepse ky është bërë tashma pjesë e fizionomisë së portikut në sajë të zgjidhjes së goditur dhe ngjyrës së fakturës së materialit të përdorur – gurë gëlqeror, pra sepse në aspektin estetik monumenti edhe mund të humbte. Së dyti, sepse mendohej që mveshja me gurë është bërë duke dëmtuar në një farë mase edhe murin e vjetër me gurë lumi për t'u lidhur me të.

Përsa i përket minares, si u tha dhe më lart, në gjendjen e sotme të studimit ishte e vështirë të përcaktohej forma dhe përmasat e pjesëve të humbura gjatë luftës, për t'u gjykuar riformimi i saj menjëherë mbas çlirimit të vendit, që për mendimin tonë ishte i goditur[9].

Punimet e restaurimit filluan me prishjen e çatisë, gjatë së cilës u vërejt se ishte ruajtur një pjesë e strukturës së vjetër të saj – tip vendi. Gjatë prishjes së çatisë së vjetër u pa se qoshja verilindore ishte e mbushur me mur të ri me gurë dhe copa tjegullash. Përpara ndërtimit të çatisë së portikut pra u riformua kjo qoshe njëlloj si të tjerat, u ndërtuan kornizat e saja të pjerta (më të ulëta në qoshe), dhe u mbulua me tjegulla. Mbas kësaj u hoqën murosjet e pjesshme të dritareve veriore e lindore dhe u vazhdua me ndërtimin e çatisë së portikut dhe tavanit të tij me dërrasa. Çatia e re u ndërtua duke ruajtur daljen e strehës në masën 1,65 m dhe përfundimin e saj nën rasat e gurit që dilnin nga muri lindor dhe verior i sallës së lutjeve. Në këtë mënyrë kulmi i qoshes verilindore përfundonte në këndin respektiv të sallës dhe çatia përfundonte në të në vija horizontale deri sa takonte me vijat e pjerrëta të çatisë.

Gjithashtu u hoq shtresa e vonë me dërrasa e dyshemesë së portikut nën të cilën ruhej edhe pse e dëmtuar shtresa e vjetër me llaç gëlqereje me pluhur tjegullash (harasan), mbi një nënshtresë llaçi gëlqeror të zakonshëm dhe kalldrëmi prej gurësh lumi mesatar. Në pjesën ku vite më parë ishte krijuar ambienti i çezmave nën nivelin e dyshemesë në të cilin zbritej me shkallë në të majtë të hyrjes për në portik doli në dritë mbulesa me strukturë të drunjtë. Projekti parashihte të ruante këtë ambient, duke mbuluar atë me soletë beton-armeje mbi të cilën të vazhdonte shtresa me harasan e dyshemesë. Me këtë rast u meremetua edhe dyshemeja e vjetër në vendet ku mungonte. Punimet e restaurimit në portik dhe çatinë e qoshes verilindore krijuan mundësi për një vlerësim më të mirë estetik të xhamisë së Haxhi Ethem Beut sepse rikrijuan ekuilibrin e dikurshëm ndërmjet portikut dhe vëllimit kubik të sallës së lutjeve. Gjithashtu çatia e re përsëriste natyrshëm formën e portikut në planimetri nëpërmjet përfundimit me vija horizontale të ndërprerjes së çatisë me faqet veriore dhe lindore të sallës së lutjeve.

Në aspektin tipologjik xhamia e Haxhi Ethem Beut bën pjesë në grupin e madh të xhamive me kupol. Ajo i takon një tipi të vjetër, i cili fillon të përdoret gjithnjë e më rallë në Stamboll në periudhën klasike të arkitekturës turko-osmane (sh. XVI-XVII) kur sulltanët porositnin xhami madhështore, me sallën e lutjeve jo më të përbërë prej një vëllimi unik. Pararendëse të këtij tipi janë xhamitë e vjetra që i takojnë periudhës së principatave si Jeshil Xhami në Iznik ndërtuar në vitin 1349[10], xhamia e Mahmut Çelebiut po në Iznik ndërtuar në vitin 1400[11], xhamia e Ilias

9) Përcaktimi i lartësisë u bë mbi bazën e fotografive nga ark. A. Lufi, ndërsa punimet u kryen nën drejtimin e mjeshtrit Adem Mata me gurë të mara nga gurorja e vjetër.

10) S.K. Jetkin, L'architecture turque en Turquie Paris 1962 fq. 66 shënimi i H. Gluck, E. Diez **Die kunst der Islam,** Berlin 1925, 247, 554.

11) H. Gluck, E. Diez., **vep. cit.** 247, 554;

12) S.K. Jetkin, vep. cit. 77-79, fig. 22.

Beut në Balat ndërtuar në 1404[12]. Të gjitha këto karakterizohen nga vëllimi qendror kubik dhe i ulët mbuluar me kupol. Në vendin tonë xhamia më e vjetër e tipit me sallë mbuluar me kupol është xhamia e Ilias Mirahorit në Korçë ndërtuar në vitin 1496[13], bashkëkohëse e xhamive të këtij tipi që ndërtohen në Stamboll si e Firuz Agait (1491)[14], e Bali Pashait (1504)[15], e Iskandër Pashait (1505)[16], të cilat kanë të përbashkët jo vetëm sallën me kupol por edhe portikun me kolona e mbuluar me kupola të vogla. E ndërtuar me teknikën e kluasonazhit, pra jo si të Stambollit, të cilat ndërtohen ose me gurë ose me reshta gurësh dhe rreshta tullash, xhamia e Mirahorit tregon qartë për punën e mjeshtrave vendas. Prej këtij shembulli të parë në vendin tonë fillon një rrugë e gjatë e këtij tipi i cili fillon të përdoret në gjithë qytetet e rëndësishme të kohës duke filluar nga sh. XVI. Kjo tregon se për xhaminë me sallë unike mbuluar me kupol pati mjaft preferenca në vendin tonë, ashtu si dhe në Ballkan. Xhamia e Ethem Beut është një pasuese e tyre, që arrin pikën e fundit në këtë rrugë të gjatë të zhvillimit të tipit kur tashma është humbur përdorimi i teknikës kluasonazh. Ndërtimi i saj bëhet dhe në rrethana të caktuara kur porositësit deshën të afirmonin veten e tyre si sundimtarë jo të vegjël. Më e madhe është në këtë drejtim ambicja e Haxhi Ethem Beut, që desh t'i dhuronte Tiranës një xhami që të ishte më e bukura. Edhe nga përmasat vëllimi me kupol i përmbahet madhësisë së ndërtimeve të tjera të këtij tipi në vendin tonë. Si shumica e xhamive të shekullit XVIII-XIX, xhamia është menduar me një portik, që këtu zinte edhe anën lindore. Përgjithësisht xhamitë e tjera kanë portik vetëm në pjesën e përparme dhe në shumicën e rasteve sa vetë gjerësia e xhamisë. Megjithatë nuk mungojnë raste të ndërtimit të portikut që rrethon edhe një krah të godinës. I tillë është ndër të tjera portiku i shtuar më vonë i xhamisë Eski Valide në Skutari pranë Stambollit[18], e cila me portikun e xhamisë së Ethem Beut ka gjasime në formën e arkadave, murin ballor me portën, që ka në anë dy gjysëmkolona. Dallon nga këto, përdorimi i pilastrave masiv në qoshet e portikut. Me portik në dy të anët është xhamia e Pazarit në Gjirokastër ndërtuar në vitin 1757.[19]

Për mendimin tonë ndërtimi i portikut të tillë u bë për arsye funksionale, për të pasur një portik të madh që të tërhiqte një numër sa më të madh besimtarësh, që të rivalizonte pra me xhaminë e vjetër dhe të bëhej faltorja më me rëndësi e Tiranës. Sigurisht që zgjidhja arkitektonike për më tepër realizimi konkret, janë rezultat i idesë së porositësit dhe mjeshtrave ndërtues që arritën të na japin një vepër mjaft të bukur.

Përsa i përket asimetrisë, apo zhvillimit të njëanshëm të portikut, ky u bë i tillë, sepse ishte zakon që minarja t'i lihej e lirë. Një rol jo të paktë në këtë zgjidhje duhet të ketë luajtur edhe vendosja urbanistike e xhamive, në ekstremin perëndimor të qendrës, tej të cilës ishte një fushë që përdorej për treg të hapur. Përdorimi i portikut asimetrik i kombinuar me vendosjen e detyruar asimetrike të minares krijojnë një zgjidhje sa të ekuilibruar aq dhe dinamike[20]. Problemi tjetër që ngrihet është ai i përdorimit të harqeve rrethore në vend të atyre të mprehtë ose fund lundre, karakteristike për arkitekturën islamike. Harku rrethor në këtë kohë kishte një përdorim të gjerë në tërë vendin tonë si në banesa, kisha ashtu dhe ndërtime të kultit mysliman (përmendim këtu xhaminë e Kavajës dhe Teqen e Helvetive në Berat). Ai ka qenë pjesë përbërëse e arkitekturës sonë dhe zëvendësohej nga harku i mprehtë vetëm në ndërtimet islamike për arsye të qarta. Dhe me sa duket nuk arriti të bëhej dominues. Nga ai u hoq dorë gjatë kësaj kohe ndër të tjera për arsye se edhe në Stamboll ishte zëvendësuar nga harku gjysëm rrethor.

Xhamia e Haxhi Ethem Beut pati pasuese të tjera. Në vitin 1844 po në Tiranë rindërtohet portiku i xhamisë së vjetër të Sulejman Pashës sipas modelit të saj. Po kështu kemi xhaminë e Peqinit e cila ndërtohet me një portik më të vogël vetëm në pjesën e përparme, duke patur pjesën e hyrjes të njëjtë me atë të xhamisë sonë. Po gjatë shekullit të XIX në Tiranë ndërtohet xhamia e Karapicëve (apo Esnaf Xhami) e tipit me sallë të mbuluar me çati druri, portiku i së cilës ripërsërit atë të xhamisë së Haxhi Ethem Beut edhe në detaje të tilla si muri-portë i hyrjes për në hajat.

13) P. Pepo, **Dy dokumente mesjetare mbi Shqipërinë – Berati i Sulltan Bajazitit të II dhe Vakëfnameja e Mirahor Ilias Beut,** B.SH.SH. 3. 1956, 289.
14) **Po aty.** 113 Edhem **Nos Mosquees de Stamboul,** Stamboul 1934, 59, fig. 12.
15) **Po aty,** 12, fig. 17.
16) **Po aty,** 69-70, fig. 19.
17) Çelebi E, **Sejahatnamesi** (Shqipëria para dyqindvjetësh). Tiranë 1930.
18) Ethem H, **vep. cit.** 111, fig. 73.
19) E. Riza, **Qyteti muze i Gjirokastrës,** Tiranë 1977 (Dizertacion), 34, fig. 39, 40.
20) K. Miho, **Kontributi i traditës vendase në arkitekturën e xhamisë tipike të Tiranës,** Monumentet, 11, 1976, 194.

DOKUMENTE

Xhamia e Haxhi Ethem Beut është një monument me mjaft vlerë i arkitekturës së shekujve të fundit të mesjetës për vendin tonë. Ai dëshmon për nivelin mjaft të lartë jo vetëm të ndërtimeve por edhe të arkitekturës. Këto duken në ndërtimin e kupolës, që përballohet mjaft mirë prej mureve, në proporcionet e goditura të arkadave të portikut, në dekorin piktorik, në përmasat dhe proporcionet e minares dhe mbi të gjitha, meritë me sa duket e ndërtimeve të fazës së dytë, në harmonizimin planimetrik e vëllimor të sallës së lutjeve, portikut dhe minares. Të tëra këto e bëjnë këtë monument që të jetë një nga kulmet e arkitekturës islamike të vendit tonë.

Problemi i kontributit të traditës vendase dhe lidhjes me arkitekturën popullore mbetet një problem i rëndësishëm në studimin e këtij monumenti[21]. Me traditën vendase lidhet zgjedhja e tipit, përdorimi i ngjyrës (kujtojmë këtu kluasonazhin si një shmangje nga monokromatizmi turko-osman), përdorimi i hajatit me arkada, i strehëve të gjera, çatitë e vogla trekëndëshe të ulura në qoshet e kubit. Me arkitekturën popullore e lidhin dhe mjaft nga elementet e mësipërme si hajati me kolona, strehët e gjera, shkalla njerëzore. Është pikërisht kjo tërësi aspektesh që i jep vlerë të veçantë studimit në mjaft drejtime të këtij monumenti.

DO NOT COPY

21) Po aty, 194-195.

XHAMIA E HAXHI ETHEM BEUT
TIRANE



PLANIMETRIA

0 2 4m



PAMJE NGA PERENDIMI
PAS RESTAURIMIT

DO NOT COPY

XHAMIA E HAXHI ETHEM BEUT.
TIRANE



PRERJE GJATSORE



0 2 4M

PRERJE TERTHORE

DO NOT COPY

DO NOT COPY

XHAMIA E HAXHI ETHEM BEUT
TIRANE



PAMJE NGA VERIU
PAS RESTAURIMIT



0 2 4 6 8M

TAB. IV









DO NOT COPY

DO NOT COPY

XHAMI E HAXHI ETHEM BEUT
TIRANE





PAMJE NGA LINDJA
PAS RESTAURIMIT



1



2



3



4

DO NOT COPY



1



2



3



4

DO NOT COPY

DO NOT COPY



1



2



3



4



5



6

Aleksandër MEKSI – Gjergj FRASHËRI

DO NOT COPY

ARCHITECTURE ET RESTAURATION DE LA MOSQUEE DE HAXHI ETHEM BEY A TIRANA

RESUME

C'est pendant la période de l'occupation turque que Tirana acquiert la physionomie d'une ville moyenâgeuse, en avant à la base de sa structure urbanistique le bazar, des édifices du culte islamique, une tour d'horloge, des bains publics et des auberges.

La stabilisation du pouvoir ottoman et l'islamisation de la population locale furent accompagnées par la construction sur notre territoire de mosquées et de masdjitas, édifices qui occupent une place centrale dans l'organisation urbanistique des agglomérations urbaines.

Las mosquée de Haxhi Ethem bej, qui est l'objet de cet article, se dresse au centre de Tirana. Autrefois elle faisait part du complexe d'édifices constituant le centre de la ville. Vis-à-vis de cette mosquée se trouvait le Bazar, plus à l'est la mosquée de Sulejman Pacha (1614) et le hammam, et en direction N.-O. la mosquée des Karapice. La mosquée de Haxhi Ethem bey constitue aujourd'hui un complexe avec la tour d'horloge.

l'inscription figurant sur la porte du côté nord du portique indique que sa construction, commencée en 1794 par Molla bey de Petrela, neveu du fondateur de la ville de Tirana, fut portée à terme en 1821 par son fils Ethem bey. Cette même inscription indique que Molla bey est mort en 1807 après avoir achevé la coupole et que c'est son fils, Ethem bey, qui a achevé les travaux concernant le portique, le toit, le minaret et les peintures. Les premiers hommes d'étude, qui se sont occupés de ce monument, L. Rey et H. Ceka, avancent l'hypothèse que c'est à cause des hostilités entre le gouvernant de Tirana, Kapllan Pacha, et le dominateur de Shkodra Ibrahim Pacha, que les travaux de construction furent interrompus provisoirement, ce qui explique aussi leur prolongement dans le temps.

Ce n'est qu'après la construction du monument, pendant les années 1820-21 (année 1236 de l'hégire, selon l'inscription), que l'on commença la peinture de son intérieur et de son extérieur; la peinture de l'arcade fut portée à terme en 1823 (année 1238 de l'hégire), comme cela ressort de l'inscription figurant sur les paysages de la porte extérieure.

Par rapport aux autres mosquées de Tirana, celle de Haxhi Ethem bey constitue un bond qualitatif qui ne fut plus atteint par la suite malgré les tentatives faites en ce sens. A son exemple, la mosquée de Sulejman Pacha fut dotée en 1844 d'un portique à deux étages s'appuyant sur des colonnes de pierre. Il en fut de même en ce qui concerne la mosquée des Karapice (la Mosquée des corporations d'artisans). Comme nous venons de le souligner, il ne s'aggissait que d'imitations d'aucune valeur artistique.

Du point de vue architectural, la mosquée de Haxhi Ethem Bey est d'un grand intérêt et de ce fait elle occupe une place de relief parmi les édifices du culte musulman construits chez nous pendant les XVe-XIXe siècles. L'intérieur de la salle est constitué par le volume unique et solide d'un cube à coupole, illuminé abondamment par des fenêtres. Nous avons donc affaire à une solution traditionnelle en ce qui concerne les mosquées. Les volumes des deux parties sont bien équilibrés entre eux, le passage du cube à la coupole a lieu tranquillement grâce à l'emploi de trompes à stalactites dissimulant leurs poussées verticales et leur prolongement le long des murs à arcs aigus. Un rôle important en ce sens remplit aussi la décoration de la coupole et de la partie supérieure des murs, décor qui dans le même temps unifie et distingue les différentes parties l'une de l autre (Tab. VI, 1,2). La première est réalisée à travers l'impression générale de la paroi peinte de la même manière et la deuxième en contournant avec des bordures à couleurs sombres les parties en contact entre elles (Tab. VII, 2, 4). Le décor pondéré de l'intérieur qui s'intensifie au mihrab (Tab. VI, 4), les proportions réussies du minbar et du mafil (Tab. VII, 1) et leur déocration élégante confèrent une note intime et chaude à l'espace intérieur.

Comme dans les autres mosquées, ici aussi on relève une conformité totale entre l'intérieur et l'extérieur. Les murs extérieurs, comme cela ressort des murs O. et S., sont plats, sans couleur, crépis. Mais ce n'est pas là une caractéristique du monument, du fait que d'autres éléments offrent un aspect entièrement différent.

Grâce à son portique, la mosquée de Haxhi Ethem Bey offre de l'extérieur deux visages correspondant, à ce qu'il paraît, à ses deux constructeurs. Elle présente une solution plus proche à celle traditionnelle du côté S.-O., car ici le portique ne joue aucun rôle. D'un volume élevé, élancé mais froid, on relève clairement la concordance entre l'intérieur et l'extérieur, le balancement des parties entières avec les fenêtres. Un aspect dia-

métralement opposé offrent les autres côtés du monument, du fait que le portique joue ici un rôle de premier ordre dans la détermination de la mosquée. Ainsi l'oeil du visiteur embrasse l'ensemble portique-salle des prières-minaret. Le mouvement de l'oeil passe ainsi du portique qui l'entoure des deux côtés au volume cubique à coupole, qu'il perçoit dans ses parties supérieures et qui se termine au minaret, à travers un passage toujours en montée. Le portique, et notamment son aile orientale aux dimensions et aux proportions réussies entre les colonnes et les arcades, son rythme, constituent un élément de grand intérêt. Se dressant sur un soubassement élevé, les dimensions du portique peuvent être plus petites, donc plus voisines de la mesure humaine, en conférant de la sorte à son intérieur une intimité entre autres nécessaire sur le plan fonctionnel. On relève la même mesure dans le portail donnant accès au portique. Dans la perception du portique, en tant que volume unique, la peinture de l'arcade y influe sensiblement.

En raison de sa profondeur, le portique est à la fois transparent en matériel. Le contraste de lumière et d'ombre, ainsi que les couleurs des murs de l'intérieur, contribuent aussi en ce sens. Le portique de la mosquée appartient au type où le toit remplit un rôle non sans importance. Celui-ci couvre, en réduisant leurs dimensions, les parties visibles du volume à coupole et confère un aspect plus naturel au portique profond. Le portique, solide en général, par sa ligne légère et mobile, fait passer à un deuxième plan le volume cubique et donne une place plus justifiable au minaret, qui remplit ici pour la première fois un rôle actif dans l'appréciation de tout l'édifice par sa silhouette élégante et dynamique.

Que les bâtisseurs de cette mosquée furent des maîtres artisans du pays ou qui ont travaillé dans l'Albanie centrale, cela ressort de la décoration des pierres gravées et des chapiteaux, à quelque différence près mais d'un niveau égal, que l'on retrouve tant dans le tombeau de Kapllan Pacha que dans la tour d'horloge, que la tradition attribue à Haxhi Ethem Bey, qui a construit aussi un séminaire.

Située au centre de la ville, cette mosquée a été plus d'une fois l'objet de travaux d'entretien. Ainsi son toit a été entièrement reconstruit; on s'est servi à cette fin de sa structure base, en l'élevant et en en augmentant le pendage. C'est à cette occasion que fut modifié aussi le toit triangulaire, situé sur le côté N.-E., et que furent réduites latéralement les dimensions des fenêtres. En 1940 fut revêtu de pierres le soubassement du portique.

L'Institut des Monuments de Culture y est intervenu à plusieurs reprises pour la conservation de la peinture (1960-63) et pour la reconstruction du toit conique à structure de bois du minaret (1969).

En 1974, en considération de la nécessité d'une intervention plus à fond dans les structures de bois et dans la toiture du portique, des études furent entreprises pour déterminer clairement la forme de l'ancien toit et la mesure de l'intervention. Comme on l'a vu plus haut, le toit actuel est le résultat des réparations effectuées successivement au monument et qu'à son état original on pouvait l'apprécier mieux du fait aussi que son pendage était minimal, dont les effets négatifs peuvent être éliminés par sa couverture avec des tuiles. C'est sur cette base que fut élaboré le projet de restauration, qui prévoyait la reconstruction du toit en sa forme originale, la réédification du toit peu élevé triangulaire du côté N.-E. et la reconstitution du plancher du «hayat».

Le projet de restauration ne prévoyait pas la reconstitution en sa forme première du mur du soubassement des arcades, et cela pour les deux motifs que voici. Premièrement, parce que celui-ci fait désormais part de la physionomie du portique en raison de la solution réussie et de la couleur de la facture des matériaux employés – pierres calcaires, donc le monument pouvait subir une perte du point de vue esthétique. Deuxièmement, parce que le revêtement avec des pierres a endommagé jusqu'à une certaine mesure l'ancien mur à pierres fluviatiles.

En ce qui concerne le minaret, comme nous l'avons énoncé plus haut, à l'état des études il était difficile d'en définir la forme et les dimensions des pièces qui furent détruites pendant la guerre, aussi sa reconstitution effectuée au lendemain de la Libération est, à notre vis, réussie.

Les travaux de restauration furent commencés par la destruction du toit, dont l'ancienne structure-type local était en partie conservée. Durant ces travaux on constata que le toit N.-E. était rempli d'un mur nouveau en pierres et morceaux de tuiles. Avant la construction du toit du portique, on procéda à la reconstitution de cet angle comme de tous les autres, ainsi qu'à de ses corniches inclinées (plus basses aux angles); puis furent entamés les travaux de couverture. Ensuite furent éliminés les parties emmurées des fenêtres N. et E. et l'on construisit le toit du portique et son plafond avec des planches. Le toit fut reconstruit en conservant la saillie de l'auvent dans la mesure de 1.65 m, de manière à ce que celui-ci se trouvât au-dessous des plaques de pierre en saillie du mur E. et N. de la salle des prières. De la sorte le comble de l'angle N.E. se terminait à l'angle respectif de la salle et le toit aussi se terminait au même point jusqu'à l'intersection de ses lignes horizontales par ses lignes verticales.

Il fut également procédé à l'élimination de la couche plus récente en bois du plancher du portique, qui couvrait l'ancienne couche de mortier actuellement endommagée et préparée avec de la chaux et des tuiles en poudre (crépi) et comportant une sous-couche de mortier avec de la chaux habituelle et un pavé de pierres fluviatiles de dimension moyenne. Là où quelques années auparavant on avait installé le complexe des fontaines, au-dessous du niveau du plancher auquel on y accédait à travers un escalier aménagé à la gauche de l'entrée du portique, il a été mis au jour la couverture en structure de bois. Selon le projet de restauration, cette pièce devait être conservée en la couvrant d'un plancher de béton armé ayant par-dessus la couche en crépi du plancher. A cette occasion, on procéda aussi à la réparation de l'ancien plancher en y complétant les pièces qui manquaient. Les travaux de restauration ef-

DO NOT COPY

DOKTORAT

fectués au portique et au toit de l'angle N.-E. permirent de faire ressortir mieux les valeur esthétiques de la mosquée de Haxhi Ethem Bey, en recréant l'équilibre antérieur entre le portique et le volume cubique de la salle des prières. Par ailleurs, le nouveau toit ne faisait que répéter de façon naturelle la forme du portique en planimétrie à travers sa terminaison en lignes horizontales au point d'intersection du toit avec les faces septentrionale et orientale de la salle des prières.

Du point de vue typologique, la mosquée de Haxhi Ethem Bey fait part du grand groupe de mosquées à coupole. Elle appartient au type ancien, dont l'exécution devient toujours plus rare à Istanbul à l'époque classique de l'architecture turco-ottomane (XVIe-XVIIe s.), alors que les sultans construisaient des mosquées imposantes dont la salle des prières ne comportait plus un seul volume. A ce type appartiennent les anciennes mosquées de la période des principautés, entre autres la mosquée de Yeshil Djami d'Iznik mise en place en 1349; la mosquée de Mahmut Celebi, toujours à Iznik, construite en 1400; la mosquée d'Ilias Bey à Balat (1404). Tous ces monuments se caractérisent par le fait que leur volume central en forme de cube peu élevé est couvert par une coupole. Chez nous la mosquée plus ancienne du type à salle de prières couverte d'une coupole est la mosquée d'Iljas Mirahori à Korçe, construite en 1496, donc contemporaine des mosquées de même type édifiées à Istanbul. Citons de leur nombre la mosquée de Fizur Aga (1491), celle de Bali Pacha (1504) et la mosquée de Iskander Pacha (1505), qui ont en commun non seulement la salle à coupole mais aussi le portique à colonnes couverte de petites coupoles. Construite selon la technique du cloisonnage, et non pas selon la technique d'Istanbul en pierres ou en rangées de pierres et en rangées de briques, la mosquée de Mirahor fait ressortir on ne peut mieux la maîtrise des bâtisseurs du pays. Ce premier exemple ouvre chez nous, à partir du XVIe siècle, la voie à la construction de plusieurs autres mosquées de ce même type dans toutes les villes importantes de l'époque. Ce qui montre que la mosqué à salle unique couverte d'une coupole fut préférée chez nous, comme dans les autres contrées des Balkans. La mosquée de Haxhi Ethem Bey en est un des derniers exemplaires, alors que l'usage de la technique à cloisonnage avait fait désormais son temps. Sa construction se rattache aussi au fait que ses donateurs cherchaient par cet acte d'affirmer leur pouvoir en tant que dominateurs. L'ambition de Haxhi Ethem Bey en ce sens est de beaucoup supérieure, du fait qu'il a voulu offrir à Tirana une mosquée n'ayant pas d'égale par sa beauté. De par ses dimensions aussi, le volume à coupole s'en tient aux dimensions des autres constructions de même type du pays. Comme la plupart des mosquées de XVIIIe-XIXe siècles, elle a été conçue avec un portique s'étendant aussi sa partie orientale. En général le portique des autres mosquées n'occupe que leur partie antérieure et dans la plupart des cas s'étend sur toute la largeur de la mosquée. Malgré cela, il y a aussi des portiques cernant une aile de l'édifice. Entre autres tel est le portique qui a été ajouté plus tard à la mosquée Eski Valide à Yskydar d'Istanbul, et qui ressemble à celui de la mosquée de Haxhi Ethem Bey par la forme de ses arcades, par le mur se trouvant en face de la porte et ayant latéralement des demi-colonnes. La seule différence consiste dans l'emploi de pilastres massifs aux angles du portique. Nous retrouvons un portique intéressant les deux côtés dans la mosquée du Bazar à Gjirokaster, construite en 1757.

A notre sens la construction d'un tel portique s'explique par des raisons fonctionnelles, car un grand portique serait en mesure d'attirer le plus grand nombre possible de croyants et de rivaliser avec l'ancienne mosquée, en devenant de la sorte le temple le plus important de Tirana. Evidemment la solution architectonique, et notamment sa réalisation concrète, sont un résultat de la conception du donateur et des maîtres bâtisseurs qui ont réussi à nous offrir une oeuvre remarquable.

En ce qui concerne l'asymétrie, ou le développement unilatéral du portique, ce fait s'explique par l'habitude de laisser le minaret libre. La disposition urbanistique des mosquées, à l'extrémité occidentale du centre de la ville, au-delà de laquelle il y avait une place employée comme marché ouvert, a évidemment rempli un rôle non sans importance dans le choix de cette solution. L'usage du portique asymétrique en combinaison à la disposition obligatoire asymétrique du minaret nous fournit une solution à la fois équilibrée et dynamique. Un autre problème soulevé est celui de l'emploi des arcs circulaires au lieu des arcs aigus, qui sont une caractéristique de l'architecture islamique. A l'époque l'arc circulaire était largement employé chez nous dans les habitations, les églises et les édifices du culte musulman (mentionnons entre autres la mosquée de Kavaja et le Teqe des Helvetis à Berat). Il était partie intégrante de notre architecture et ne cédait sa place à l'arc aigu que dans les constructions islamiques pour les motifs que l'ont sait. Et à ce qu'il paraît, il n'a pas réussi à se créer une position dominante. On y renonça à l'époque pour le fait aussi qu'à Istanbul également on avait commencé à se servir largement de l'arc semi-circulaire.

La mosquée de Haxhi Ethem Bey fut prise en exemple par d'autres monuments. En 1844, le portique de l'ancienne mosquée de Sulejman Pacha fut reconstruite selon son modèle. La mosquée de Peqin fut édifiée avec un portique plus petit dans sa seule partie antérieure, en ayant toutefois son entrée identique à celle de la mosquée de Haxhi Ethem Bey. Pendant le XIXe siècle, toujours à Tirana, fut construite la mosquée des Karapice (ou mosquée de la corporation des Artisans) qui relève du type à salle de prières couverte d'un toit en bois et dont le portique répéter celui de la mosquée de Haxhi Ethem Bey même dans le détail mur-porte d'entrée au «hayat».

La mosquée de Haxhi Ethem Bey est un monument important de l'architecture des derniers siècles du moyen âge. Elle témoigne des niveaux assez élevés atteints chez nous non seulement par les constructions, mais aussi par l'architecture. Cela ressort de la construction de la coupole, que les murs supportent relativement bien; des proportions réussies des arcades du por-

tique, de la peinture décorative, des dimensions et des proportions du minaret et surtout de l'équilibre caractérisant la planimétrie et le volume de la salle des prières, du portique et du minaret, dont le mérite revient sans doute aux travaux effectués dans la deuxième phase de construction. Tous ces éléments font de ce monument une des réalisations plus réussies de l'architecture islamique chez nous.

Le problème de la contribution apportée par la tradition locale et celui des rapports avec l'architecture populaire revêtent une importance de premier ordre dans l'étude de ce monument. La tradition locale y est présente dans le choix du type, l'usage de la couleur (rappelons à cette fin le cloisonnage en tant que déviation du monochromatisme turco-osman), l'emploi du «hayat» à arcades, d'auvents larges, de petits toits triangulaires inclinés aux angles du cube. En ce qui concerne l'architecture populaire, elle apparaît dans les éléments susmentionnés, entre autres le «hayat» à colonnes, les auvents larges, les dimensions humaines. Ce sont précisément ces différents aspects dans leur totalité qui confèrent une valeur particulière à l'étude de ce monument en diverses directions.

DO NOT COPY

Stilian ADHAMI

DO NOT COPY

TRI BAZILIKA TË NDËRTUARA NË VOSKOPOJË BRËNDA KATËR VJETËVE

Është një dukuri e rrallë që tri bazilika të mëdha të ndërtohen brenda katër vjetëve në të njëjtin qytet, siç është rasti i bazilikës së Shën Kollit (1721), bazilikës së Shën Mëhillit (1722) dhe asaj të Shën Thanasit (1724) në Voskopojë. Kjo sigurisht tregon vrullin e madh e të shpejtë që kanë marrë ndërtimet në përgjithësi në këtë qytet gjatë periudhës së mesjetës së vonë.

Bazilikat janë ndërtime kulti të një tipi arkitekturor, që ka tradita në gadishullin ballkanik dhe që kanë gjetur përhapje të gjerë edhe në vendin tonë, duke filluar që nga shekulli XVII. Ky tip, që gjatë shekullit XVIII u shtri në mbarë Shqipërinë Jugore dhe atë të Mesme, ka gjetur arritjet më të zhvilluara te bazilikat e Voskopojës. Këto dallohen nga pikëpamja e konceptimit të hapësirës së brendshme, nga përmasat e tyre, mbulesat me qemere e kalota sferike dhe trajtimi arkitekturor i tyre në tërësi, si edhe për pikturat e shumta murale dhe punimet e tjera me vlerë artistike. Në këto monumente gjen shprehjen e vet tendenca e krijimit të trajtave të zgjatura bazilikale. Ndoshta nga ana e jashtme këto nuk paraqesin ndonjë gjë të jashtëzakonëshme, me përjashtim të portikëve të dekoruar, por me të hyrë brenda menjëherë bie në sy madhështia e ndërtimit të brendshëm të tyre dhe punimet artistike të shquara, me të cilat janë pajisur. Vetë hapësira e madhe e këtyre bazilikave, po të marrim parasysh se secila prej tyre mund të zinte rreth 1000 vetë, si edhe numuri i tyre i shumtë, flasin qartë për përpjesëtimet që kishte marrë qyteti i Voskopojës dy shekuj e gjysëm më parë, për potencialin ekonomik në rritje të tij, shtimin e popullatës, zhvillimin e forcave prodhuese dhe me to edhe të krijimtarisë artistike.

Megjithatë, para se të trajtojmë këto tri bazilika, është vendi këtu të ndalemi sadopak në parashtrimin e kushteve historike, ekonomike e shoqërore në të cilat u zhvillua ky qytet nga ana ekonomike e kulturore.

Mbi të gjitha duhet pohuar se shkaqet e lulëzimit ekonomik të Voskopojës, që u bë faktori kryesor për shndrrimin e saj nga një fshat i zakonshëm në një qytet të begatë, duhen kërkuar në kuadrin e përgjithshëm të zhvillimit të marrëdhënieve monetare të mallit në tokat e gadishullit Ballkanik, në përgjithësi, gjatë shekullit XVIII; kjo mëkëmbje ekonomike është deri — diku e lidhur edhe me një farë stabilizimi të pushtetit otoman në këtë periudhë, të cilit i kundërviheshin mosbindja, qëndresa dhe kryengritjet e vazhdueshme të krahinave të ndryshme të vendit tonë. Duhet shtuar se shekulli XVIII, ashtu si në pjesën tjetër europiane të perandorisë otomane, regjistron edhe për territoret shqiptare një ritëm zhvillimi më të shpejtë se dy shekujt e përparshëm. Ky shekull shënon një farë kthese për Shqipërinë; është epokë kur nxjerrin krye procese të rëndësishme në jetën ekonomike e shoqërore. Marrëdhëniet feudale hyjnë në dekompozim për t'i lënë vend shfaqjes relative të elementeve të parë të marrëdhënieve të reja në prodhim, të atyre kapitaliste. Nëpërmjet zhvillimit të blegtorisë, përpunimit zejtar të lëndëve të para bujqësore e blegtorale, si edhe tregtisë, voskopojarët mundën të pasurohen e të grumbullojnë mjaft kapitale, duke u formuar kështu një shtresë e fuqishme shoqërore-tregtarët dhe zejtarët voskopojarë. Ata arritën të krijojnë edhe agjenci tregtare në shumë vende të gadishullit Ballkanik dhe të Europës Qendrore e Lindore.

Në këtë fuqizim të përgjithshëm të Voskopojës ndikuan një sërë faktorësh të karaktereve të ndryshme. Voskopoja ndodhej në afërsi të rrugëve tregtare dhe të qyteteve të Korçës, Beratit, Ohrit, Strugës, Manastirit, Elbasanit, Janinës, etj., me të cilët voskopojarët,

Do not copy

që albanologu I. G. Han i ka cilësuar si puntorë të palodhur dhe kursimtarë[1], zhvillonin tregëti të dukshme. Duke qenë në thellësi të vendit në një zonë malore të pakontrollueshme mirë nga okupatori, atje nuk u ndie për një kohë drejtpërdrejt pesha e rëndë e feudalizmit ushtarak shkatërrimtar turk. Nga ana tjetër, për shkak se procesi i muslimanizimit nuk u përhap fare në këtë qytet[2], popullata pati një rritje të shpejtë me familje të krishtere të ngujuara aty, të cilat përpiqeshin t'i shmangeshin muslimanizimit, ndjekjeve dhe persekutimeve të pushtuesit turk. Me pasurimin e Voskopojës aty u vendosën edhe banorë nga vende të largëta, si qyteti i Mecovës, qyteza e Skamnelit të Zagorës, etj., të cilët u shpërngulën me gjithë familjet e tyre për të gjetur kushte jetese më të mira e komode. Vakalopulos[3] shkruan për një tërheqje në masë të popullatës drejt maleve dhe krahinave të pakalueshme.

Jemi në kohën kur voskopojarët e kishin rritur ndikimin e tyre ndaj autoriteteve turke aq sa kishin mundur të arrinin një farë administrimi të veçantë apo një farë autonomie relative, ku drejtonte këshilli i parisë së qytetit, i ndihmuar nga esnafët e tregtarëve dhe zejtarëve të shumtë të kësaj qendre urbane[4], të cilët jepnin një kontribut të ndieshëm në zhvillimin e gjithanshëm të qytetit. Në këtë kohë lulëzimi të qytetit edhe korespondenca diplomatike midis Venedikut dhe Stambollit bëhej nëpërmjet Voskopojës (per via di Voscopoli). Voskopojarët, të cilët merreshin edhe me qiraxhillëk, kanë qenë organizatorët e një farë shërbimi postar prej Durrësi në Stamboll e anasjelltas me anën e karvanëve të tyre të stërvitura në vendet malore.

Ritmin e ndërtimeve masive në këtë qytet e favorizonte patjetër sigurimi i materialeve ndërtimore në vend dhe kontributi i mjeshtërve vendës, që kanë qenë me tradita në zonën e Oparit dhe rrethet e Korçës dhe Kolonjës, përfundim që ne e nxjerrim edhe nga fakti se esnafi i muratorëve në Voskopojë, një ndër më të pasurit, përfshinte në gjirin e tij më shumë antarë. Megjithatë vëllimi i madh i ndërtimeve në një periudhë relativisht të shkurtër diktoi nevojën e sjelljes edhe të një numuri mjeshtrash ndër më të mirët e Shqipërisë Jugore, të Maqedonisë apo Thesalisë, etj., gjë që dëshmohet edhe nga dokumentet mbishkrimore.

Të gjithë këta faktorë, që flasin për lulëzimin ekonomik të Voskopojës në këtë kohë, krijuan mundësi të tilla te shtresat zejtaro-tregtare dhe një klimë të tillë favorizuese për të derdhur fonde të mëdha në fushën e zhvillimit të arsimit, kulturës dhe ndërtimeve të kultit, ku artistët ushtronin krijimtarinë e tyre. Le të kujtojmë, nga ana tjetër, se pikërisht në këtë periudhë të ndërtimeve më të rëndësishme të kultit, konkretisht më 1720, Voskopoja u pajis me një shtypshkronjë, që ish një nga të parat në Ballkan dhe në tërë perandorinë osmane. Sigurisht kanë lënë gjurmë te voskopojarët edhe kontaktet e tyre tregtare me metropolet e ndryshme europiane, që u jepnin rast atyre të njiheshin me arritjet kulturore më të përparuara dhe, pra, të merrnin edhe inisiativa të ndryshme në fushën kulturore-arsimore. Ata shpërndaheshin për tregti nëpër vende të ndryshme dhe zakonisht kthehesin në gjirin e familjeve të tyre, duke ndërtuar me të hollat që fitonin banesa të hijshme e duke ndërmarrë vepra të tjera mirëbërëse, arsimore, kulturore, etj.[5]. Le të sjellim ndërmend një fakt tjetër, dy dekada e ca më vonë, kur brenda një dite u mblodhën shuma të tilla të hollash që mjaftonin jo vetëm për themelimin e Akademisë së famshme të këtij qyteti, por edhe për një sërë bursash për dërgimin e rinisë në qendrat e mëdha jashtë shtetit për studime[6]. Ndodhemi, pra, para faktesh të tillë që tregojnë më së miri jo vetëm rritjen e mirëqënies së qytetarëve voskopojarë, por edhe gatishmërinë dhe solidaritetin e popullatës vendase për ndërtime shoqërore, etj. Vetë jeta intelektuale mjaft e zhvilluar e kësaj krahine në atë kohë kishte sjellë si pasojë edhe zhvillimin e madh të artit[7]. Është karakteristike se voskopojarët, si edhe shumë shqiptarë të tjerë, edhe duke qenë në mërgim kujdeseshin për lulëzimin e qytetit të tyre të lindjes

1) J. G. Hahn, **Albanesische Studien,** Jena 1854, f. 296.
2) Z. Shkodra, **Roli dhe pozita e veçantë e esnafit të tabakëve gjatë sundimit turk,** BUSHT, seria e shk. shoq., Nr. 1, 1962, faqe 41.
3) N. Todorov, **Balkanskijat grad' XV – XIX vek. Sofia. Izd. Nauka i iskustvo, 1972, f. 3;** shih shkaqet edhe në botimin e J. Rexhepagiq **«Zhvillimi i arsimit dhe sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së sotme deri në vitin 1918.** Prishtinë, 1970, f. 23 – 29.
4) K. Skënderi, **Istoria tis arhais kai syghronou Moskopoleos,** Athinë, 1928, f. 10-11. Veçanërisht më e favorshme në këtë fushë ka qenë periudha 100-vjeçare (1656-1757) e sundimit të vezirëve shqiptarë, Qyprilinjve.
5) Martiniani, **Symbolai eis tin istoria tis Moskopoleos...** Athinë, 1939, f. 20-21.
6) L. Moccas, **La question albanais,** Paris 1921, f. 41.
7) V. Puzanova, **Prapë mbi artin shqiptar të shekullit XVIII,** në BUSHT, Seria e shk. shoq., Nr. 2, 1958, f. 152.

DO NOT COPY



Fig. 1

dhe e ndihmonin atë për zhvillimin e gjithanshëm të tij[8]. Dhe në Voskopojë çdo gjë është bërë me ndihmën e përbashkët[9].

Vlen të përmendet edhe se lulëzimi i Voskopojës ndodhte në një kohë kur në vendet e ndryshme të Europës perëndimore lëvizja iluministe, e filluar në shekujt e mëparshëm, arriti kulmin e vet në shekullin XVIII[10].

Gjithë sa parashtruam më lart, dëshmon në radhë të parë për ndryshime të ndijshme të kushteve historike, ekonomike e shoqërore në këtë periudhë në truallin tonë e sidomos në trevën e Voskopojës. Kjo shpjegon edhe rrethanat në të cilat u bë e mundur të ndërtohen brenda katër vjetësh tri bazilikat që vijojnë:

I. BAZILIKA E SHËN KOLLIT

Arkitektura, – Midis pesë bazilikave të mëdha të ndërtuara në Voskopojë gjatë një periudhe 60-vjeçare (1699-1759), kisha e Shën Kollit (fig. 1) është një nga godinat më madhështore të këtij stili dhe ndër ato që u kanë qëndruar më mirë rrebesheve të ndryshme. Me këtë çelet seria e të tri bazilikave që ndërtohen brenda katër vjetëve. Vetëm naosi i saj, pa narteks, hajat e absidë, ka përmasa rreth 21,50 m. në shtrirje gjatësore dhe 10,70 m. gjerësi[11]. Bazilika është ndarë në tri nefe, nëpërmjet tetë shtyllave dhe dy pilastrave, me dy kupola mbi tambur (me lartësi maksimale 9,55 m.) dhe me qemere e kalota sferike (fig. 2). Nga jashtë godina nuk ka kube, kurse brenda tavani ndahet në 18 kube të vogla. Vizitori ndien madhështinë dhe kompleksitetin e kësaj ndërtese, që e pasurojnë pikturat e shumta dhe pajisjet e tjera artistike.

Si çdo bazilikë tjetër nefi qendror është më i gjerë se dy nefet anësore dhe kubetë e tij janë më të mëdha, të cilat mbulohen nga çatia e saj dy-ujse, e ribërë pas djegjes së vitit 1943.

Hajati i gjatë i kësaj bazilike (21 x 3 m.) përkufizohet nga 7 harkada të mbështetura mbi 6 shtylla me kapitele të pikturuara, pjesërisht të prishura (fig 3). Në kolonadën e hajatit përjashta, midis ornamen-

8) V. Puzanova, **shënime mbi artin shqiptar në shek. e XVIII,** në BUSHT, Seria e shk. shoq., Nr. 1, 1957, f. 46. Shkolla e parë në Voskopojë është ndërtuar më 1710 me ndihmat e kolonisë shqiptare të Venedikut.

9) I. Llambridhis, **Mbi institucionet bamirëse në Epir,** Vol. I, f. 158.

10) **Historia e Shqipërisë,** vëll. I, Tiranë, 1959, f. 414-415.

11) V. Puzanova, **Shënime mbi artin shqiptar në shekullin XVIII,** në BUSHT, Nr. 1, 1957, f. 54, shënon përmasat 33 x 18 m. (si duket duke përfshirë naosin, absidën, narteksin dhe hajatin.)



Fig. 2

teve dhe zbukurimeve me tulla, mbi harqet ndërmjet shtyllave me motivin e pishës, etj., është gdhendur mbi gur një figurë me këmishë ose me kaftan, me një çekan të madh në dorë (fig. 4). Me sa duket kështu e përfaqësonin vetveten mjeshtrit që ndërtonin faltoret. Hajati i kësaj kishe, si dhe ai i Shën Thanasit, mbulohet me çati me pllloça guri, që është vazhdimi i çatisë së kishës. Mbulesa e këtyre hajateve është ndërtuar me kube e mbajtur nga ana e jashtme me harqe mbi kolona. Kolonat, harqet dhe kubetë janë prej guri. Hajati në formën e një katërkëndëshi këndrejtë me përmasa 22 x 2,81 m., ka 7 kube gjysëm sferike. Kolonat janë të rrumbullakta ndërtuar prej gurësh, me lartësi 1,97 m. Ka mundësi që si ndërtim hajati të jetë bërë më vonë se ndërtimi i vetë kishës, gjë që konstatohet dhe nga fakti se muret e hajatit nuk janë të lidhura me muret e kishës dhe në disa vende ku duket një farë lidhje, kjo është e mëvonshme dhe jo e shëndoshë.

Shtresa e parë me të cilën janë mbuluar faqet e mureve dhe të kubeve të hajateve është e përbërë prej rëre dhe gëlqereje, kurse shtresa e sipërme, mbi të cilën është pikturuar, përbëhet prej gëlqereje të përzier me pak kashtë dhe ka trashësi të ndryshme. Hajati i ka pasur të suvatuara edhe kolonat, por në shumicën e vendeve ajo ka rënë.

Narteksi i saj që mbështetet mbi pesë shtylla, arrin gjithashtu përmasa të tilla (20,5 x 7 m.), që ndeshen rrallë nëpër kishat e vendit tonë. Nga ana veriperëndimore brinja nuk është kënddrejtë, por e përthyer, për shkak të pozicionit të saj.

Në hyrje të anës juglindore lartësohet një kumbanore e madhe me katër hapsira drite, e lartë 11 m., përveç majës konike. Nga mbishkrimi që ka në pllakë, del se është rindërtuar më 1936.

Absida e kësaj bazilike nga jashtë dekorohet nga 7 harqe të verbër dhe dy të tjerë në të dy krahët e saj, që qëndrojnë mbi dy dritare të vogla. Në një mbi-

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

shkrim greqisht të trajtuar me tulla në harkun e verbër të majtë, dallohet me vështirësi viti 1721 që ka lidhje me ndërtimin.

Nga mbishkrimi kryesor rreth 2 metërsh, që ndodhet në faqen e murit perëndimor, ndërmjet dy dritareve, merret vesh se kjo bazilikë madhështore është ndërtuar nga qershori i vitit 1721 deri në shtator të vitit 1722, gjithsej në 17 muaj, dhe se është përfunduar së pikturuari në vitin 1726 nga piktori ynë i shquar i shekullit XVIII David Selenicasi me dy ndihmësit e tij Kostandinin dhe Kriston[12].

Nga ana jugore e narteksit dhe ngjitur me të vërehen gjurmë rindërtimi të një pjese që ka qenë përdorur për shkollë deri në kohët e vona. (fig. 5). Është fjala për dy dhoma anekse të kësaj faltoreje, në të cilën ka pas shërbyer si efimer shkrimtari i shqipes Dhanil M. Adham Haxhiu, qysh nga viti 1793 edhe gjer në mbarim të jetës së tij në vitin 1823. Dihet njëkohësisht se Dhanili ka shërbyer në të njëjtën kohë edhe si pedagog pas vdekjes së Kavaliotit. Kjo kishë ka qenë e themeluar prej arkondit Haxhi Jorgji Jira, i cili, sipas I. M. Qafëzezit[13], duhet të jetë i vëllaj i gjyshit të Dhanilit, i quajturi Adham Jira[14].

Ngjitur me kishën e Shën Kollit ka pas qenë kishëza e Shën Thimiut, që tani nuk ekziston.

Përveç punimeve të ndryshme me karakter mirë-

12) Ja përkthimi i tekstit të mbishkrimit greqisht, ku përmenden të gjithë pjesëmarrësit që ndihmuan për themelimin e saj: «Ky tempull i Shën Kollit ndërtuar (në mënyrë) të qëndrueshme në vitin 1721, në muajin qershor mori përfundim të lumtur më 19 shtator 1722... është pikturuar në mënyrë shembullore altari me shpenzimet e të krishterëve të rrethit, tani për tani u pikturua (në mënyrë madhështore) përshtatshmërisht rrethe e përqark kishës (qendrore) përgjithësisht me dorën e të shumëndriturit dhe me forcën e mprehtë (elegante) të gjithë oshenarit Z. David Selenicasit dhe me shoqërimin e Kostandinit dhe të Kristos, me dhurimin e bollshëm të të hollave të Z. Haxhi Jorgjit, që mbaroi jetën lumturisht. Në kohën e Episkopit Joasaf në kohën e kujdestarisë të Epitropit Papanikolla, më 18 Tetor vjetin 1726. (Mbishkrimet e shek. XVIII në kishat e Shqipërisë së Jugut, drsh. në Institutin e Historisë G.I.10 (G.I.9, f. 6).

13) I. M. Qafëzezi, Historia e qytetit Voskopojës (drsh), f. 51.

14) Mbiemëruar Haxhi pas një pelegrinazhi (haxhillëk) që pat bërë ky në Jeruzalem.



Fig. 5



Fig. 6

mbajtjeje, në këtë monument, janë kryer edhe punime me karakter konsolidimi. Tërmeti i vitit 1960 që ra në rrethin e Korçës i shkaktoi dëmtime serioze dhe portikut të kësaj bazilike. Këto dëmtime u vërejtën në shkëputjen e kyçeve të harqeve mbajtës të kupolave si dhe në largimin e shtyllave të portikut nga vertikaliteti deri në 28 cm. Një gjendje e tillë nga tërmeti ishte krijuar nga mungesa e tiranteve të drurit që janë zhdukur nga rebeshet e kohës.

Kjo situatë vinte në rrezik zhdukjen e portikut të kishës dhe bashkë me të të gjithë afreskave brenda saj, vepra të piktorëve Kostandin dhe Athanas Zografi.

Prandaj në vitin 1962, një ekspeditë e grupit të kulturës materiale të Universitetit të Tiranës, ndërmorri punime me karakter restaurimi e konsolidimi të portikut të kësaj bazilike (fig. 6). Punimet u përqëndruan në afrimin e gjithë faqes së jashtme të portikut në drejtimin e shtyllave (lidhjen me tiranta metalike) dhe mbylljen e kyçeve të harqeve. E gjithë kjo punë u krye me sukses të plotë, duke mos dëmtuar pikturën murale. Tërheqja e faqes së portikut u bë e mundur nëpërmjet shtytjes me krika nga jashtë dhe tërheqjes me anë muftash nga mbrenda.

b) Piktura dhe vepra të tjera artistike

Brendësia e gjithë bazilikës është e mbuluar me një qilim afreskash me rreth 1000 figura (fig. 7, 8, 9). Duart e piktorëve tanë të talentuar shihen në të gjitha faqet e mureve, të kubeve dhe të kolonave, që janë veshur me piktura, me skena dhe zbukurime të tjera agjiografike. Nga dora e kryemjeshtrit David Selenicasi kemi të punuara afreskat e faqeve të mureve në kungë, ato në dy faqet murale të naosit, të gjitha figurat e radhës së poshtëme, skenat lart në kube, në harqe, kompozimet kryesore. Punimet e tjera që paraqiten të dobëta, të pikturuara në vende të kishës që dalin pak në reliev, figurat e dorës së dytë, sfondet, imtësitë, janë punuar nga ndihmësit e tij që përmënden në mbishkrim. Ndryshe ndodh me pikturat e hajatit të kësaj bazilike (fig. 10, 11, 12), të cilat janë vepra të dala nga duart e piktorëve të mirënjohur korçarë Kostandin dhe Athanas Zografi, në vitin 1750[15].

Duke qenë se pikturat më me vlerë në këtë monument janë vepra të piktorit të talentuar David Se-

15) Kjo del nga mbishkrimi greqisht mbi portën jugore të kishës nga jashtë ku lexojmë: «Është pikturuar ky hajat më 1750 ..... me dorën e Kostandin e Athanasit nga qyteti Korçë, Gusht 28» **(Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë,** III, f. 201).

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 9



Fig. 8

lenica, për të cilin është shkruar mjaft[16] po ndalemi shkurtimisht në vlerësimin artistik të këtyre punimeve. Davidi njihet si piktor vetëm i pikturës murale. Punët e tij që ruhen brenda kësaj bazilike konsiderohen nga ana artistike më të mirat ndër ato që janë pikturuar gjatë shek. XVIII në vendin tonë, ndofta më të mira në të gjithë kishën lindore në përgjithësi gjatë atij shekulli. Deri tani afreska të dorës së tij në vende të tjera nuk janë gjetur. E vetmja e dhënë që ne kemi prej këtij piktori të shquar shqiptar është koha kur ai mbaroi pikturimin e kësaj kishe, në vitin 1726, që figuron në mbishkrimin kryesor që ndodhet në faqen perëndimore të interierit të saj. Ky është i vetmi burim që hedh dritë mbi krijimtarinë artistike të tij. Në këtë krijimtari ne gjejmë afreska të tilla që duken sikur janë pikturuar në natyrë. Davidi interesohet për ambientin, për karakterin e tij, për detajet, planet dhe perspektivën. Vlera e pjesës më të madhe të tyre nga ana artistike i kapërcen kufijtë e interesit kombëtar. Vizitori habitet nga pasuria e madhe e fantazisë dhe përsosuria e ekzekutimit të disa pikturave murale të dala nga dora e tij.

Tematika e freskave të Davidit është po ajo e përdorur edhe nga piktorët e tjerë shqiptarë dhe të huaj nëpër kishat tona dhe që është zhvilluar dhe për-

16) Shih më gjerë V. Puzanova, **Shënime mbi artin shqiptar në shekullin XVIII,** në BUSHT, Nr. 1, 1957, faqe 54 – 55, H. Nallbani, **Rreth krijimtarisë së piktorit David Selenicasi,** në «Monumentet», Nr. 1, 1971, f. 123. – Dh. Dhamo, **Piktura murale e mesjetës në Shqipëri,** Tiranë, 1974, f. 16 – 17.



Fig. 10

dorur gjatë shekujve në kishën lindore, domethënë tema nga dhiata e vjetër dhe e re, nga historia dhe gojëdhana e kishës, nga liturgjika dhe disiplina të tjera teologjike. Davidi ka përdorur tema që ruhen rrallë në pikturën tonë të vjetër. Në nefin jugor të kishës ka pikturuar disa skena nga jeta e Shën Kollit, emrit të të cilit i kushtohej kisha.

David Selenicasi është mjeshtri i parë shqiptar në portretet e të cilit vihen re elemente realiste. Në këtë vështrim ai na paraqitet si një mjeshtër që ka zotëruar me përsosmëri mjeshtërinë e pikturës në natyrë. Është fjala për portretin e madh 2 m. të figurës laike të ktitorit, themeluesit të kishës, Haxhi Jorgjit (fig. 13). Kjo freskë, që trajton temën «dhurata e tempullit të Shën Kollit» zë gjithë hapsirën e murit jugor që nga hyrja deri te skaji jugperëndimor. Ndodhemi përpara një kompozimi të bukur, figurës impozante të ktitorit, që qëndron i gjallë dhe plot jetë, duke treguar tempullin që dhuron. Përveç vlerës artistike, ky portret ka edhe vlerë të madhe historike dhe etnografike, sepse në të është pasqyruar një personazh real,



Fig. 11



Fig. 12

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 13



Fig. 14

një plak voskopojar nga rrethi i klasës së tregtarëve, person historik i caktuar me veshjet e tij të kohës, të aristokracisë qytetare shqiptare, me një xhybe të madhe të zezë, të veshur me gëzof. Nën të shihet anteria e gjatë, e ngjeshur në mes me një brez të gjatë, të kuq, më poshtë, nën anterinë shihet këmisha e bardhë deri në dysheme, dhe në këmbët e tij pantofla të buta shtëpiake të quajtura «pashmangë». Me interes është edhe fesi i ktitorit, i cili përreth përbëhet nga një cohë e gjerë e zezë dhe nga brenda nga një pëlhurë e kuqe që përfundon me majë. Ky është një portret i vërtetë realist si në formë dhe në përmbajtje.

Nga pikpamja e elementeve etnografike vendase, paraqet interes edhe kompozimi i skenës «mbjellësi i farës», ku pasqyrohet një bujk i veshur me këmishë, me mëngë të përveshura, ngjeshur në mes, me trastën e farës në qafë, me të mbathura futur në kallçet, me opinga lope në këmbë dhe me një qylaf të mbështjellur me rizë në kokë, skenë kjo ndër më të bukurat në këtë gjini arti.

Ndër freskat e tjera që i atribuohen dorës mjeshtërore të artistit David mund të përmenden ato të altarit: arqidhjakonët, Stefani dhe Romanoici, pleqtë në absidë, platitera në absidë me të dy kryeengjëjt dhe kryeengjëlli Gavril në murin jugor. Ashtu si freska e ktitorit, edhe këto freska janë shprehëse, gati portrete. Shquan figura e arqidhjakonit të ri, Stefanit, (fig. 14), me shikimin e tij të dlirtë, tipike shqiptare, punuar në mënyrë shumë reale dhe të gjallë. Edhe nëpër portrete të tjerë spikat fryma realiste, një prirje për t'ia afruar tipet jetës së vërtetë, për t'i bërë më të thjeshtë, më tokësor. Po ashtu ka rëndësi fakti se skema bizantine e pikturimit, me kanonet e saj të rrepta, në pjesën më të madhe është shkelur. Skenat janë shpërndarë pa rregull, pa rradhë, kanë humbur në një farë mase sistemin e rreptë të dikurshëm.

Pasuria e ornamentikës, nga një herë harmonike dhe e bukur, janë karakteristike e krijimtarisë artistike të mjeshtër Davidit. Ai e vë në përdorim atë shpesh në armët e luftëtarëve, në heshtat, në veshjet. Midis disa kompozimesh bien në sy dekoracione të ndryshme me fruta dhe lule të stilizuara.

Krijimtaria artistike e Davidit shquhet nga kujdesi i artistit për ta paraqitur temën sa më reale, sa më emocionale, sa më njerëzore. Në afreskat e tij çdo gjë është në lëvizje, bile shpesh herë në lëvizje të te-



Fig. 15

përuar[17]. Pra përpjekjet e reja për të futur në ikonografi tiparet e realizmit të vërtetë, dëshirën për t'u çliruar nga kanonet e mërzitshme të kishës, që nuk kënaqin më njeri, sepse nuk kishin mbetur gjë tjetër veçse një formë pa përmbajtje – të gjitha mund t'i vishen krijimtarisë së David Selenicës.

Ashtu siç vërehet me të drejtë nga studiuesit e kësaj pikture[18] fryma jetësore e artit të Davidit diktohet nga rrethanat ku ka jetuar e punuar piktori. Shekulli i tij është ai i lëvizjeve të mëdha përparimtare, ideologjike dhe artistike, që e patën bazën në idetë iluministe të kohës, të cilat ndikuan edhe në kulturën e qytetit të Voskopojës. Arti i Davidit, fryma përparimtare e veprës së tij e ndikuar nga këta faktorë, është produkt i kësaj baze dhe i këtyre rrethanave, të cilat bënë të mundur një lulëzim të tillë të artit në një kohë kur piktura kishtare kishte pësuar një degradim të plotë.

Siç përmendëm më lart hajati i kësaj kishe është pikturuar nga dy mjeshtrit e tjerë korçarë Kostandin e Athanas Zografi, 24 vjet më vonë se pikturimi i kishës.

Ashtu si në hajatin e Kishës së Shën Thanasit ku kanë pikturuar po vëllezërit korçarë, edhe në këtë hajat janë pikturuar faqet e mureve, të kubeve dhe të qemerëve, por jo të gjitha me skenat e apokalipsit. Kubeja e hajatit mbi portën jugore, ruan skena ungjillore dhe jo nga apokalipsi. Me shenjtorët e ndryshëm, piktorët korçarë kanë radhitur edhe shenjtorët e vendit, si Shën Naumin e Pogradecit dhe Shën Jonin e Elbasanit. Disa mbeturina të freskave në faqen perëndimore të hajatit, tregojnë se edhe kjo faqe ka qenë pikturuar.

Ndër pikturat e vëllezërve korçarë të ekzekutuar në këtë hajat, që në përgjithësi janë mjaft të dëmtuara, mund të përmendim si më të realizuara freskat me temë: «skena e luftës ndërmjet qengjit dhe bishës», «ushtritë qiellore», «gruaja e mbarsur», «24 pleqtë me harfa», etj.[19]

Megjithëse dy hajatet e Shën Kollit dhe Shën Thanasit të pikturuara prej dy vëllezërve korçarë kanë të njejtën temë, duke mos qenë punuar në një kohë (hajati i Shën Thanasit në vitin 1745), ato paraqesin ndryshime në mënyrën e ekzekutimit.

Me vlerë artistike është edhe ikonostasi i kësaj bazilike, i cili është i gdhendur në dru në vitin 1743, vepër e periudhës së lulëzimit të artit të gdhendjes në dru, por që nuk ruan formën e tij të parë. (fig. 15). Ai përbëhet prej copash ikonostasesh të ndryshme të radhitura jo mirë. Ka të dhëna që këto pjesë ikonostasesh të jenë sjellë aty pas djegieve të viteve 1916 dhe 1943 nga Kishat e Shëndëlliut, Shën Pjetrit, etj., ndërsa të vetë Kishës së Shën Kollit janë proskinitari dhe froni i dhespotit. Mbi këtë të fundit mjeshtri Andon Korfjati ka lënë një mbishkrim të vitit 1758, datë e punimit artistik të kësaj ksilogravure[20]. Amvoni i kësaj bazilike është i një kohe të mëvonshme. Në ikonostas janë vendosur 24 ikona të mëdha e të vogla, të cilat janë gjithashtu me vlerë artistike.

17) **Historia e Shqipërisë,** I, 1959, f. 419. Një analizë e hollësishme pikturës së Davidit i është bërë nga këta autorë: V. Puzanova, **Shënime mbi artin shqiptar në shek. XVIII,** Bul. shk. shoq., Nr. 1, 1957; H. Nallbani, **Rreth krijimtarisë së piktorit David Selenicasi** në «Monumentet», Nr. 1, 1971, f. 119-124.

18) H. Nallbani, **vep. cit.,** f. 124.

19) Skenat e ndryshme të apokalipsit të pikturuar në hajat, janë trajtuar në artikullin e V. Puzanovës, **Prapë mbi artin shqiptar të shek. XVIII,** në BUSHT, Seria shk. shoq., Nr. 2, 1958, f. 154 – 155.

20) Mbishkrimi mbi thronin episkopal të kishës është i vetmi ku mjeshtri drugdhendës ka vënë emrin e tij në punën artistike të vetën. «Ky thron së bashku me amvonin janë stolisur (punuar) në vitin 1758, me shpenzimet e kësaj kishe të Shën Kollit, me dorën time të Andon Qerqirjotit...». **Mbishkrimet e kishave të Shqipërisë si burime historike,** në BUSHT, Nr. 1, 1958, f. 232.

DO NOT COPY

II. BAZILIKA E SHËN-MËHILLIT

a) **Arkitektura:** – Është një monument tjetër i tipit bazilikal 3 nefësh, që ndodhet jo shumë larg nga faltorja tjetër e Shën Kollit, ndërtuar nga ana jug-perëndimore e saj dhe e qytetit për t'i shërbyer lagjes së dikurshme, që kishte marrë emërin e Shën Mëhillit.

Përmasat e naosit, 20,80 x 9,74 m., përveç narteksit, absidës dhe hajatit, flasin për një monument relativisht të madh, (fig. 16). Është me dy kupola mbi tambur dhe me qemerë e kalota sferike mbështetur mbi dy pilastra dhe tetë shtylla. Lartësia e dy kupolave në nefin qendror arrin në 10,35 m. Po me qemere e kalota sferike është edhe narteksi i saj jo i zakonshëm, me përmasa m. 12,25 x 9,05, mbështetur mbi 4 pilastra dhe 4 shtylla. Narteksi në këtë bazilikë është më i gjerë edhe se vetë naosi (fig. 17). Duket se nga ana veriore e kësaj faltore duhet të ketë pasur një hajat të dytë, për ekzistencën e të cilit flasin disa gjurmë trarësh e gurësh çmërsi, që ndodhen në atë anë. Ndriçimi i naosit bëhej nga 6 dritare mbi hajatin e anës jugore (nga të cilat sot katër janë të mbyllura), ndërsa ndriçimi i narteksit bëhej nga dy dritare të anës perëndimore dhe dy të tjera të anës jugore.

Absida e kishës nga jashtë është e dekoruar nga 9 pseudoharqe. Në të dy krahët e saj ndodhen dy



Fig. 16

KISHA E SHEN MEHILLIT



Fig. 17

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 18



Fig. 20



Fig. 19



Fig. 21

dritare, që më vonë janë pasuar edhe nga disa dritare të vogla për të plotësuar ndriçimin e absidës (fig. 18).

Sipas disa materialeve dokumentare, skica e fotografi të vjetra, hajati i gjatë i kësaj bazilike nga ana jugore me drejtim gjatësor dhe përmasa 23,40 x 3,50 m. ka qenë përkufizuar nga 9 harkada të mbështetura mbi 8 shtylla me kapitele, që përbënin portikun e saj të bukur (fig. 19, 20, 21). Prej këtyre shtyllave sot ekziston vetëm një më këmbë, sepse hajati me kohë është shkatërruar për shkak të lidhjes së dobët që ka pasur me murin e kishës, duke qenë se nuk janë ndërtuar në të njëjtën kohë. Për shkatërrimin e tij sigurisht kanë ndikuar edhe faktorë të tjerë, si rrebeshet e luftërave, ndezja e zjarreve nga trupat gjatë Luftës së Parë Botërore, mosmirëmbajtja e çatisë në të kaluarën, etj.

Ajo që bie në sy në këtë bazilikë nga ana arki-

tektonike e konstruktive është fakti që, ndërsa në bazilikat e tjera vërehet një përdorim më i lirshëm në konstruksionet dhe një shumëllojshmëri në përdorimin e sistemeve të kurbëzuara, në rastin e bazilikës së Shën Mëhillit shohim një ndërtim më rigoroz nga ana konstruktive[21]. Diçka që vrojtojmë në këtë bazilikë është narteksi mjaft i plotë dhe i trajtuar bukur. Diçka jo e zakonshme është edhe ndarja e hajatit në pjesën e narteksit.

Ngjitur kësaj faltoreje, thuajse në oborr të saj, ndodhen edhe rrënojat e një paraklisi, të Shën Spiridhonit, dhe aty pranë, nga ana jug-perëndimore, rrënojat e një paraklisi tjetër, të Shën Varvarës. Dy ndërtime të vogla pa vlerë i ngjiten narteksit, prej të cilave mendojmë se duhet të çlirohet.

b) **Vepra artistike.**

Kjo bazilikë, si edhe gjithë të tjerat, ka qenë e pajisur me ikonostas edhe punime të tjera të gdhendhura në dru, si edhe me ikona e pajisje të tjera me vlerë artistike. Kjo nuk është vetëm gojëdhanë, për këtë flasin edhe pjesë të ikonostasit që na kanë ngelur, siç janë kryqi dhe pjesa qendrore e tij. Është e vërtetë se në ditët tona nuk kemi trashëguar asgjë me vlerë nga punimet e gdhendura në dru dhe ato ikonografike; këto humbje janë të lidhura me djegiet e grabitjet që janë bërë sidomos nga pushtuesit e huaj gjatë Luftës së Parë Botërore. Por nga kjo bazilikë ruhen si vlera artistike, pikturat murale, me të cilat është veshur përbrenda ky monument në të katër faqet e murit, në absidë dhe pjesërisht në anën lindore e veriore të hajatit, të dy pilastrat si edhe një pikturë mbi portën lindore të narteksit (fig. 22, 23, 24).

Ekzekutimi i këtyre freskave është bërë në një kohë kur, siç vëren Puzanova[22], teknika e ikonografisë, kryesisht ajo e pikturave të murit, kishte filluar të binte në rangun e një mjeshtërie të thjeshtë, kur freska e mirë gadi është zhdukur dhe zëvendësuar me pikturën me tempera të përzier me fresk. Por edhe pse me këtë teknikë të fundit në përgjithësi është punuar dobët, në këtë monument ne shohim piktura ndër më të mirat që trashëgojmë nga shek. XVIII. Në pikturimin e kapiteleve vërehen motive floreale.



Fig. 22



Fig. 23

21) Për këtë shih edhe A. Meksi – P. Thomo, **Arkitektura pasbizantine në Shqipëri,** «Monumentet» 11, 1976, f. 130 – 131.

22) V. Puzanova, **Shënime mbi artin shqiptar në shek. XVIII,** në BUSHT, 1957, nr. 1, f. 45.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 24



Fig. 25

KISHA E SHEN THANASIT



Fig. 26

DO NOT COPY

c) **Rreth datimit**

Sipas kumtimit që na bën J. Martiniani[23], një studiues i zellshëm i Voskopojës, kjo bazilikë duhet të jetë ndërtuar në vitin 1696, megjithëse për këtë nuk jep asnjë të dhënë burimore dhe argumentuese; por kjo nuk i përgjigjet së vërtetës. Për këtë dëshmon mbishkrimi që ndodhet përbrenda mbi derën perëndimore, me të cilin, siç duket, nuk ka qenë njohur Martiniani. Nga ky mbishkrim, edhe pse është ruajtur në gjendje të keqe dhe vende-vende me fjalë të zhdukura, nxjerrim se është themeluar në vitin 1722, pra në çerekun e parë të shekullit XVIII, kur lulëzimi ekonomik e kulturor i këtij qyteti të mesjetës së vonë ishte në rritje[24].

Fatkeqësisht mbishkrimi që ka arritur te ne i cunguar nuk na sqaron rreth mjeshtrave që e kanë ndërtuar apo pikturuar. Edhe burimet e tjera heshtin mbi këtë çështje.

Nga mbishkrimi që përmendëm dhe nga një burim tjetër, siç është kodiku i Shën Harallambit, i mbiemëruar kodiku i esnafit të bakejve, marrim vesh për kontributin e qytetarëve voskopojarë në favor të kësaj faltoreje jo vetëm për ndërtimin e saj, si edhe për mirëmbajtjen e meremetimet e saj, për të cilat dallohet kontributi i esnafit të bakërxhinjve, «por edhe» në atë periudhë të shkatërrimit të parë të qytetit[25].

III. BAZILIKA E SHËN THANASIT

a) **Arkitektura.** — Është i vetmi monument (fig. 25, 26), jo vetëm në Voskopojë, por edhe në qendra të tjera të vendit tonë, ku ndërtuesit dhe pikturuesit na kanë lënë më shumë gjurmë për t'u identifikuar dhe më tepër të dhëna të vlefshme, nëpërmjet një sërë mbishkrimesh (fig. 27, 28). Po të marrim parasysh se ne kemi ende të dhëna shumë të pakëta për ndërtuesit tanë të së kaluarës, dy nga mbishkrimet e kësaj kishe janë të vetmet dokumente mbishkrimore, që janë gjetur deri tani dhe që na japin emrat e të pesë mjeshtërve që kanë punuar këtu nën udhëheqjen e një kryemjeshtri[26].



Fig. 27

23) Më 1696 u ndërtua kisha e Shën Mëhillit (e Taksiarkëve Mihail dhe Gavril), të cilës iu dhuruan ara dhe vreshta që ndodheshin në Polenë, disa në kufi me Osojën, që u takonin voskopojarëve. Për ndihmë më të madhe dallohet edhe esnafi i bakërxhinjve i cili bënte të gjitha meremetimet... (I. Martiniani, **Symbolai eis tin istoria tis Moshopoleos kai i politismos autis,** Athinë 1935, f. 48-49).

24) Ja përkthimi i mbishkrimit greqisht, (shih drsh, në Institutin e Historisë, G.I.10 (G.1.9., f. 7): «Është ndërtuar prej themeleve të tokës ky tempull... me dorën dhe... është pikturuar me shpenzimet e arkondëve... të lagjes Ilia dhe me kontributin e epitropëve... të priftit... Nikollë... Kryepiskopit... Z. Joasaf, në vjetin 1722».

25) Në gusht 1772 me nxitje dhe vërtetësi të Kavaliotit kjo kishë pajiset me një dyqan të Korçës, pronë e Mihal Papa Thanasit, voskopojarit (I. M. Qafëzezi, Theodhor Kavalioti, Drsh. në Muzeun e Korçës, D. 45, Nr. 1834/105/52.

26) Është fjala për mbishkrimet e gdhendura mbi dy kryqe të murosur nga jashtë në murin e hajatit mbi shtyllat. Megjithëse nga prishja nuk mund të lexohet i gjithë, del se mjeshtrit kanë qenë: Adhronis, Mihali, Pavli, Manthoja, Kosta nga fshati Krimi afër Kosturit, dhe se ka dhënë kontribut një farë Dhimitri.

Edhe kjo kishë e tipit bazilikal, trinefëshe, ndodhet në anën verilindore të qytetit, në lagjen e Skamnelit, që më vonë u quajt lagja e Shën Thanasit. Si duket në këtë kohë qyteti ishte zgjeruar, si rrjedhim i rritjes së popullatës me njerëz të ardhur, në drejtim të pllajës që ndodhet midis përroit të Strugut dhe atij të Peltekut. Ajo ka dy kupola mbi tambur dhe qemere e kalota sferike mbështetur mbi dy pilastra dhe tetë shtylla. Përmasat e tri nefeve janë 19 x 10,50 m., ndërsa lartësia e dy kupolave në nefin qendror arrin



Fig. 28



Fig. 29

në 9 m. Absida e saj është e dekoruar së jashtmi nga 7 harqe të verbër dhe dy të tjerë anësore në të dy krahët, që kurorëzojnë dy dritare të vogla (fig. 29).

Ashtu si katedralja (Shën Maria), niveli i kishës është më poshtë se hajati anësor. Hajati, i vendosur në drejtimin gjatësor nga ana jugore në formën e një katërkëndëshi këndrejtë është 18,90 m. i gjatë dhe 2,85 m. i gjerë; i përkufizuar nga 6 arkada të mbështetura mbi pesë shtylla e kapitele, përfundon nga ana lindore me një nikje gjysmë rrethore të piktuar. Fasada e hajatit është stolisur me ornamente në trajtë pishe (fig. 30). prej tulle, me kryqe prej guri, mbi të cilët janë gdhendur mbishkrime, etj. Në këtë fasadë gjenden edhe mbishkrime të tjera të punuara prej tullash të holla me të dhëna interesante mbi rindërtimin dhe ndërtuesit.

Si ky hajat (fig. 31) ashtu edhe ai i kishës së Shën Kollit janë ndërtuar më vonë se vetë kisha, gjë që del nga fakti se muret e hajateve nuk janë të lidhura me muret e kishave dhe në disa vende ku duket një farë lidhje, kjo është e mëvonshme dhe jo e shëndoshë. Si rrjedhim këta dy hajate kanë pësuar plasje. Por dëmtimi i rëndë edhe i këtyre dy hajateve ka ardhur si rrjedhim i rebesheve të luftërave të shpeshta; sidomos gjatë Luftës së Parë Botërore në këta hajate ushtarët kanë pas ndezur zjarre.

Hajati ka gjithsejt 6 kube gjysëmsferike. Shtyllat mbi të cilat mbështeten harqet e fasadës janë 8 këndëshe monolite, punuar prej guri i kuqërremtë, me lartësi 1,31 m.



Fig. 30

DO NOT COPY

Në murin jugor të kishës, në anën e hajatit ka katër dritare me madhësi gati të njëjtë, me distancë të ndryshme prej njera-tjetrës. Për të hyrë në kishë kalohet nëpër harkun e parafundit.

Narteksi që ka patur nga ana perëndimore ka kohë që është shembur, (fig. 32). Pranë kësaj kishe vërehen rrënojat e një paraklisi, me emrin Shën Triadha, shkatërruar gjatë regjimit zogist.

Nga mbishkrimet rezulton se kisha e Shën Thanasit është ndërtuar në kohën e Patrikut të Justinianës së parë (të Ohrit) Joasaf Voskopojarit. Në mbishkrimin prej copash tulle të holla në faqen e jashtme të hajatit mbi shtyllat, megjithëse pjesërisht materiali është dërrmuar dhe ka rënë, pra mbishkrimi nuk është i plotë, deshifrohet data e fillimit të tempullit, 13 Qershor 1724, duke qenë kujdestar një i quajtur Theodhor Argjiri[27]. Këtë datë e konfirmon edhe mbishkrimi tjetër i skalitur mbi një pllocë të murosur në të djathtë të portës jugore nga ana e jashtme[28]. Në një datim të ndryshëm na çon një mbishkrim tjetër i gdhendur mbi një pllakë guri mbi absidën nga ana e jashtme, sipas të cilit **«është ndërtuar tempulli i hyjshëm i Shën Thanasit (në) vjetin 1721»**[29]. Megjithatë jemi të prirur të qëndrojmë në datimin e parë (viti 1724) jo vetëm për shkak se burimet më të shumëta mbishkrimore e bibliografike flasin për këtë dhe, mbase është fjala për ndonjë deformim ose deshifrim të gabuar të mbishkrimit të sipërm, por edhe për faktin se në vitin 1721 kemi dhe ndërtimin e kishës së Shën Kollit.



Fig. 31

b) **Vepra artistike**

Kisha e Shën Thanasit mund të konsiderohet kisha që e ruan pikturën murale më mirë nga të gjitha kishat e tjera të Voskopojës. Në këto vepra artistike, që mbajnë vulën e vitit 1745, është shkrirë talenti i piktorëve vëllezër korçarë, Kostandin e Athanas Zografit[30]. Këtë na e vërteton dhe mbishkrimi i pikturuar mbi portën jugore të jashtme të kësaj faltore, ku thuhet tekstualisht: **«është pikturuar kjo strehë më 1745 kur ishte kujdestar Vrusi Sofroni. Me dorën e vëllezërve Kostandin e Athanasit në muajin qershor 28»**[31].

DO NOT COPY

27) Mbishkrimet e shek. XVIII në kishat e Shqipërisë Jugore, (drsh. në Institutin e Historisë G.I.10, G.1,9, f. 9).

28) Ja përkthimi i tekstit të mbishkrimit: «Është ndërtuar dhe themeluar prej fillimit ky tempull... me kontributin, shpenzimet e rënda dhe ndihmën e të shumëndershmëve të shquarët kryetarë arkondë dhe të ktitorit të lagjes Kamelite (dhe të) krishterëve të devotshëm. Në kohën e kryesimit të... kruepiskopit Joasaf, në vjetin 7232 (baraz me vitin 1724 me kalendarin tonë — S. A.)... **«(mbishkrimet e shek. XVIII në kishat e Shqipërisë Jugore,** Drsh, në Institutin e Historisë G.I. 10, (G.1, 9, f. 8).

29) **Po aty,** f. 9. Ekziston edhe një mbishkrim tjetër i skalitur në një pllocë guri të murosur, në anën e majtë të portës jugore të kishës, ku nuk ka datë ndërtimi, por vetëm përmban një tekst fetar.

30) Për veprimtarinë e gjerë të këtyre piktorëve (brenda e jashtë Shqipërisë), që ka qenë më e madhe nga gjithë piktorët e tjerë mesjetarë shqiptarë, shih artikullin e V. Puzanovës, **«Prapë mbi artin shqiptar të shek. XVIII»,** në BUSHT, Nr. 2, 1959, f. 152-154. Në Voskopojë ata kanë pikturuar, përveç kishës së Shën Thanasit (përfunduar më 28 tetor 1744) dhe hajatit të saj (më 28 qershor 1745) edhe hajatin e kishës së Shën Kollit (më 28 gusht 1750) dhe kishën e 12 apostujve (më 20 tetor 1752), e cila është djegur.

31) K. Skënderi, **vep. e cit.,** f. 126; E. Kurilla **I Moshopolis kai i Nea Akadimeia antis.,** Athinai, 1935, f. 27-28.

DO NOT COPY



Fig. 32



Fig. 33



Fig. 34

Me pikturat e këtyre mjeshtërve janë veshur jo vetëm faqet e brendshme të krejt kishës, por edhe hajati (faqet e mureve, të kubeve dhe të qemerëve si edhe nikja gjysëmrrethore nga ana lindore e hajatit) dhe absida, pra është fjala për një numur të madh freskash (fig. 33, 34), për ekzekutimin e të cilave piktorëve u është dashur kohë e gjatë, pra viti 1745 duhet konsideruar si datë e përfundimit të pikturimit të kësaj kishe, që si karabinà ishte përfunduar 21 vjet më parë.

Me interes janë dhe ikonat në ikonostasin prej druri të gdhendur pjesërisht i restauruar, të cilat janë ruajtur relativisht shumë mirë (fig. 35) dhe që janë vepra të Ieromonak Kostandinit, që pikturon nga fillimi i shekullit XVIII dhe që nga trajta e shkrimit del se duhet të jetë shqiptar. Për kohën kur janë ekzekutuar këto ikona bartin vlerë të theksuar artistike. Si punim i gdhendur në dru është edhe froni i dhespotit, por është i cunguar dhe punuar dobët.

Por rëndësia më e madhe e këtij monumenti qëndron në vlerat artistike të vetë pikturave murale, me të cilat është dekoruar brenda e jashtë. Me që kemi të bëjmë me pikturën e ruajtur në gjendje më të mirë ndërmjet bazilikave të Voskopojës dhe me që në to vërejmë edhe elemente etnografikë, laike e realiste, mendojmë të ndalemi pak në këto dukuri interesante, sepse këta artistë, jo vetëm që na japin portrete personash historikë me veshje shqiptare, por elementet vendase i kanë futur edhe nëpër skena me karakter biblik e kishtar, duke i paraqitur shenjtorët ose fi-

DO NOT COPY



Fig. 35



Fig. 36



Fig. 37

gurat e skenave me veshje vendi të kohës së tyre. Këto i shohim si në figurat e interierit, ashtu edhe të hajatit të kishës. Ato pasqyrojnë skena të shumëta e të ndryshme të testamentit të vjetër, të gjyqit të fundit, portretin e Shën Thanasit, etj. Në mënyrë të theksuar dramatike është bërë sidomos pikturimi i martirizimit të martirëve. Të shquara janë gjithashtu dekorimet me vazo shumëngjyrëshe. Për ekzekutim me vlerë të veçantë mund të përmendim pikturat murale me grupin e muzikantëve (fig. 36), bariun veshur me gunë me kapuç, (fig. 37), me skenën e «Triumfit në mbretërinë qiellore» dhe atë të «Matjes së tempullit nga Joani dhe shembja e qytetit», që ndodhen në hajatin e kishës, etj.[32]. Në disa nga këto piktura siç thamë, nuk mungojnë edhe elemente laike e realiste, kështu, përshëmbull me një veshje të thjeshtë (vetëm me një këmishë e të mbathura) janë paraqitur grupi i muzikantëve, duke u rënë veglave në skenën «Tallia», veshja e ktitorit në skenën «Njeriu që del nga kisha» (figurë shumë e dëmtuar në fytyrë) punuar pranë portës së kësaj kishe, varianti i xhokes, paraqitur në pikturën e Shën Qiriakut-fëmi, ekzekutuar mbi portën jugore në hajatin e kësaj kishe, etj. Siç shihet, pra, piktorët korçarë Kostandin dhe Athanas, në pikturimet e tyre kanë ndjekur tematikën e zakonshme që

32) Për pikturat e hajatit, shih më gjerë: V. Puzanova, **Prap mbi artin shqiptar të shek. XVIII,** në Bul. shk. shoq., Nr. 2, 1958, f. 152.

është krijuar gjatë mesjetës në kishën ortodokse, sidomos atë që është krijuar në manastiret e malit Athos, skena nga Dhiata e Vjetër, festat e mëdha nga Dhiata e Re dhe nga jeta e Krishtit, nga historia e kishës, nga jeta e shenjtorëve me përmbajtje të ndryshme dogmatike historike, liturgjike dhe didaktike. Po ashtu kanë përdorur shumë tema nga jeta e martirëve të kishës, tema të cilat i kanë ekzekutuar në mënyrë të theksuar dramatike. Si në hajatin e Shën Thanasit, ashtu edhe në hajatin e Shën Kollit, ata janë frymëzuar edhe nga tematika biblike që sugjeron libri profetik — Apokalipsi i Joanit, duke i realizuar këto skena me shumë mjeshtëri dhe duke i konkretizuar me një imagjinatë të rrallë artistike.

Në pikturat e naosit dhe altarit të kësaj kishe gjejmë elemente të ngjashme me stilin e freskave të vëllezërve Kostandin dhe Athanas, (mbasi ka vetëm një mbishkrim nga hajati, që flet se pikërisht ky është pikturuar nga Kostandini dhe Athanasi). Me që në këto piktura ka shumë elemente të përbashkëta me disa freska të Davidit nga Selenica, (që ka pikturuar kishën e Shën Kollit në Voskopojë më 1724), ka mundësi të mendohet se bashkë me Kostandinin e Athanasin kanë punuar këtu ndihmësit më të afërt të Davidit, Kostandini dhe Kristua.

Vlera krijuese artistike e këtyre freskave të piktorëve korçarë, bie në sy sidomos në krahasim me artin e piktorëve tanë dhe të huaj, që kanë ushtruar veprimtarinë e tyre artistike gjatë shekullit XVIII. Me përjashtim të pikturave të kryemjeshtrit freskograf David Selenicës në kishën e Shën Kollit, i cili qëndron shumë më lart se piktorët korçarë, të gjithë piktorët e tjerë shqiptarë dhe të huaj që kanë pikturuar **a fresco** dhe **a secco** gjatë këtij shekulli në vendin tonë, si Terpo Zografi, vëllezërit grabovarë, Jorgji dhe Joani të familjes Cetiri, etj., nuk i kanë arritur në art piktorët vëllezër korçarë. Megjithatë edhe në veprat e Kostandinit e Athanasit ka edhe punë të dobëta nga ana artistike, të ekzekutuara pa kujdes e në mënyrë shabllone, siç janë disa nga profetët, që janë pikturuar nëpër harqet e kubeve të hajateve, etj. Në përgjithësi, ashtu si krejt arti kishtar i asaj kohe, edhe arti i këtyre piktorëve në pjesën më të madhe të tij është tepër stereotip, pa atë mjeshtëri të vërtetë që ka karakterizuar veprat e mjeshtërve të mëparshëm[33].

33) V. Puzanova, **Prap mbi artin shqiptar të shekullit XVIII,** në BUSHT, Seria shk. shoq., Nr. 2, 1958, f. 153.

DO NOT COPY

Stilian ADHAMI

DO NOT COPY

TROIS GRANDES BASILIQUES CONSTRUITES A VOSKOPOJE EN L'ESPACE DE QUATRE ANNEES

RESUME

C'est un phénomène vraiment rare que de construire trois grandes basiliques dans l'intervalle de quatre ans dans une même ville, comme c'est le cas de la basilique de Shën Koll (1721), de la basilique de Shën Mëhill (1722) et de celle de Shën Thanas (1724) à Voskopoje. Cela indique évidemment l'essor impétueux et rapide que connurent en général les constructions en cette ville dans la période du bas moyen âge.

Les basiliques, en tant qu'édifices du culte d'un type architectural ayant des traditions dans la péninsule des Balkans et qui a connu une large diffusion même chez nous, s'étendirent pendant le XVIIIe siècle dans l'Albanie du Sud et dans l'Albanie centrale. Les basiliques de Voskopoje représentent des réalisations parmi les plus réussies en ce domaine. Elles se distinguent par leur conception de l'espace intérieur, par leurs dimensions, par leur couverture à ogive et à calotte sphérique, par leur traitement architectural en général, ainsi par leurs nombreuses peintures murales et d'autres ouvrages d'intérêt artistique. Dans ces monuments l'on relève la tendance à créer des formes allongées basilicales. Le volume même considérable de ces basiliques, si l'on tient compte du fait que chacune d'elles pouvaient contenir environ 1.000 personnes, ainsi que le nombre élevé de balisiques mises en place, témoignent clairement des grandes proportions qu'avaient prises la ville de Voskopoje il y a deux siècles et demi de cela, de son potentiel économique en croissance, de l'augmentation de sa population, du développement des forces productives et de l'essor qu'avait connu la création artistique.

L'auteur du présent article expose brièvement les conditions historiques, économiques et sociales qui ont accompagné le développement de cette ville du point de vue économique et culturel. A son avis, les motifs de l'épanouissement économique de Voskopoje doivent être recherchés avant tout dans le développement des rapports argent: marchandise dans les contrées de la péninsule balkanique pendant le XVIIIe siècle. Tout comme pour la partie européenne de l'empire ottoman, le XVIIIe siècle marque pour les territoires albanais aussi un rythme de développement plus rapide que les siècles précédents. Il marque une espèce de tournant pour l'Albanie, du fait qu'au cours de cette époque font leur apparition d'importants processus dans la vie économique et sociale du pays. Les rapport féodaux en désagrégation cèdent la place aux premiers éléments des nouveaux rapports de production, aux rapports capitalistes. Par suite du développement de l'élevage, du traitement artisanal des matières premières végétales et animales, ainsi qu'à travers le commerce, les habitants de Voskopoje réussirent à s'enrichir et à accumuler des capitaux, en constituant de la sorte une puissante couche de commerçants et d'artisans. Ils établirent même des agences commerciales dans plusieurs pays de la péninsule balkanique et de l'Europe centrale et orientale.

Une série de facteurs d'ordre différent ont influé favorablement cette consolidation de la ville de Voskopoje. Celle-ci se trouvait à proximité des voies commerciales et des villes de Korçe, Berat, Ohri, Struge, Monastir, Elbasan, Janina et autres, et entretenaient avec ces centres d'importants rapports commerciaux. Situé à l'intérieur du pays dans une zone montagneuse, que l'occupant ne pouvait contrôler aisément, à Voskopoje ne se fit pas sentir directement le poids accablant du féodalisme militaire destructeur des envahisseurs turcs. Par ailleurs, en raison du fait que cette ville ne connut point le processus d'islamisation, sa population s'accrut considérablement par les nouvelles familles chrétiennes qui s'y réfugièrent pour échapper aux vexations et aux persécutions de l'occupant ottoman.

Nous sommes justement à l'époque quand les habitants de cette ville réussirent à accroître leur influence à l'égard des autorités turques au point de se voir octroyer une administration spéciale ou une certaine autonomie relative. L'administration était dirigée par le Conseil des Notables, aidé dans sa tâche par les corporations de commerçants, et d'artisans, qui apportaient une contribution considérable au développement général de la ville.

Le développement des constructions à des rythmes rapides fut certainement favorisé par la présence sur les lieux des matériaux de construction et par la contribution considérable qu'apportèrent les maîtres bâtisseurs du pays, conclusion que l'auteur dégage du fait que la zone d'Opar et les environs de Korçe et de Kolonje ont d'anciennes traditions en ce domaine et que la corporation des maçons de Voskopoje fut une des plus riches de la ville et comportaient un plus grand nombre de membres.

L'ensemble de ces facteurs ont créé les conditions requises

DO NOT COPY

et une atmosphère favorable à l'investissement de fonds considérables de la part des couches d'artisans et de commerçants pour le développement de l'enseignement, de la culture, ainsi que pour la construction de monuments du culte, où les artistes du pays eurent la possibilité d'exercer leurs talents. C'est précisément durant cette période importante pour la construction des édifices du culte et concrètement en 1720 que Voskopoje fut pourvue d'une imprimerie, une des premières mise en place dans les Balkans et sur tout le territoire de l'empire ottoman. Evidemment, les rapports de commerce que les habitants de Voskopoje eurent avec les différentes métropoles européennes leur permirent de prendre connaissance des acquisitions culturelles plus avancées de l'époque et de les introduire chez eux. L'auteur fournit ensuite des exemples illustrant l'empressement et la solidarité des habitants du pays participer à la mise en place des édifices de caractère social. Dans le même temps il explique les circonstances qui ont rendu possible la construction des trois suivantes basiliques dans l'espace de quatre ans.

I. La basilique de Shën Koll

a. Architecture. Du nombre des cinq grandes basiliques mises en place à Voskopoje pendant une période de 60 ans (1699-1759), celle-ci est une des plus somptueuses et qui a mieux fait face aux adversités des temps. C'est par ce monument que débute la série des trois basiliques construites dans l'espace de quatre ans. Son seul naos a une dimension de 21,50 x 10.70 m. Divisée par trois nefs, il est pourvu de deux coupoles à tambour et par des cintres et des calottes sphériques.

Au-dessus de la colonnade de la cour, parmi les ornements de briques portant le motif du pin, etc., on relève de dehors gravée sur la pierre la figure d'un homme en chemise ou en cafetan, ayant un marteau dans sa main. A ce qu'il semble, c'est ainsi que les maîtres bâtisseurs du temple se reproduisent dans cette scène. Les colonnes, les arcs et les dômes sont en pierres.

Le narthex repose sur cinq pilastres. Ses dimensions de 20.5 x 7 m se retrouvent rarement dans les autres églises du pays.

Sur le côté S.-E. de l'entrée s'élève un grand clocher à quatre ouvertures de lumière, il fut reconstruit en 1936.

L'abside de cette basilique est décorée à l'extérieur par 7 pseudo-arcs et par deux autres à chacune de ses ailes, qui s'appuient sur deux petites fenêtres.

De l'inscription principale d'une dimension d'environ 2 m, figurant sur le parement du mur occidental entre deux fenêtres, il ressort que cette basilique fut construite pendant la période de temps allant du mois de juin 1721 jusqu'au mois de septembre 1722, que sa peinture fut portée à terme en 1726 par l'artiste de renom et plein de talent du XVIIIe siècle David Selenicasi et ses deux aides, Kostandin et Kristo.

Puis l'auteur mentionne certains travaux de consolidation effectués pour faire face aux dégâts causés par le tremblement de terre de 1960 qui, entre autres, endommagea le portique de cette basilique.

b. La peinture et d'autres ouvrages artistiques

L'intérieur de la basilique est couverte par un tapis de fresques comportant environ 1000 figures. Les mains d'or de nos peintres se retrouvent dans tous les parements des murs, des dômes et des colonnes. Le grand maître que fut David Selenicasi a peint les fresques des murs de l'autel, les peintures murales des deux parements du naos, toutes les figures de la rangée inférieure, les scènes reproduites sur le dôme, l'autel, ainsi que les principales les compositions. Quant aux autres travaux, d'une facture plutôt médiocre et figurant en des endroits de l'église peu en relief, les personnages de deuxième plan, les arrière-plans, les détails, sont l'oeuvre de ses assistants mentionnés dans l'inscription citée plus haut. Les choses se passent bien différemment avec les peintures du porche de cette basilique, du fait qu'elles sont l'oeuvre des peintres de renom de Korçe Kostandin et Athanas Zografi (1750).

Etant donné que la plupart des peintures d'intérêt artistique de ce temple sont l'oeuvre de l'artiste de talent David Selenicasi, qui a été l'objet de maintes études, l'auteur du présent article procède brièvement à une appréciation de ces ouvrages. David a été connu jusqu'à présent uniquement comme auteur de peintures murales. L'unique donnée dont nous disposons à propos de cet illustre artiste albanais est l'année 1726, date à laquelle il porta à terme la peinture de cette église, et qui figure sur la principale inscription gravée sur la face occidentale de son intérieur. Le visiteur est enthousiasmé par la grande richesse de sa fantaisie et la perfection dans l'exécution de certaines peintures murales. David Selenicasi fut le premier artiste albanais dont les portraits dénotent des éléments réalistes. Sous cet aspect, nous avons affaire à un maître qui possède à la perfection l'art de la peinture d'après nature. Il s'agit précisément du grand portrait, d'une dimension de 2 m, de la figure laïque du Ktitor, le fondateur de l'église, Haxhi Jorgji. Outre son intérêt artistique, ce portrait revêt également une grande valeur historique et ethnographique, du fait qu'il reproduit un personnage réel, un vieux voskopojar du milieu de la classe des commerçants, un personnage historique vêtu des habits de l'épogue, un personnage appartenant à l'aristocratie urbaine albanaise, portant un long manteau doublé de fourrure.

Sur le plan des éléments ethnographiques locaux, d'un grand intérêt est aussi la composition de la scène «Le semeur du grain». Puis l'auteur cite les autres fresques importantes que le maître David Selenicasi a peintes en cette église. Il convient de relever que le schéma de la peinture byzantine, avec ses canons rigoureux, a été détruit de fond en comble. Les scènes se succèdent dans aucune règle préétablie, sans un ordre fixé d'avance; elles se sont débarrassés dans une certaine mesure du système rigoureux d'autrefois.

La richesse de l'ornementation, parfois harmonieuse et attrayante, est une caractéristique de la création du maître David. On relève cette note dans les armes des combattants, dans leurs lances et leurs vêtements. Dans certaines compositions, l'attention

DO NOT COPY

est attirée par des décorations comportant des fruits et des fleurs stylisés.

La création artistique de David Selenicasi se fait remarquer surtout par le soin que l'artiste apporte à la présentation du sujet de la façon la plus réelle, la plus émotionnelle et plus humaine.

Comme l'ont relevé à juste titre les critiques de cette peinture, l'élan vital caractérisant l'oeuvre de David est dicté par les circonstances dans lesquelles a vécu et travaillé notre peintre. Son siècle fut celui des grands mouvements progressistes, idéologiques et artistiques, qui avaient comme fondement l'illuminisme de l'époque et qui n'ont pas manqué d'exercer leur influence sur la culture de la ville de Voskopoje aussi. L'art de David, l'esprit progressiste de son oeuvre qui a été influé par ces facteurs, sont un produit de cette base et de ces circonstances, qui ont permis un tel épanouissement de l'art alors que la peinture chrétienne s'était complètement dégradée.

L'auteur du présent article mentionne également certaines des fresques les plus réussies des frères Kostandin et Athanas Zografi, originaires de la ville de Korçe, et qui figurent dans la galerie de cette basilique.

D'un grand intérêt artistique est aussi l'iconostase de cette basilique. Gravée sur du bois en 1743, période de temps qui correspond à l'époque de l'épanouissement de l'art de la gravure sur bois. Malheureusement cette iconostase n'est pas conservée dans son état initial. Actuellement il comporte plusieurs pièces d'iconostases différentes apportées d'autres églises de Voskopoje, après les incendies des années 1916 et 1943.

II. La basilique de Shën Mëhill

a. Architecture

